Drejt një qytetërimi botëror me

DASHURI dhe TOLERANCË

Drejt një qytetërimi botëror me

DASHURI dhe TOLERANCË

M. Fethullah Gylen

PRIZMI

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

M. FETHULLAH GYLEN

Drejt një qytetërimi botëror me DASHURI dhe TOLERANCË

Titulli i origjinalit në anglisht:

TOWARD A GLOBAL CIVILISATION OF LOVE & TOLERANCE

Përktheu: Dr. Mithat HOXHA
Redaktoi: Klodian SHEHI
Genti KRUJA

Grafika: Indrit ISUFI

ISBN: 978-9928-156-03-7

Shtëpia Botuese "PRIZMI"
Adresa: Bulevardi Zogu I, Pll. 63, Nr. 12
www.prizmi.al

Tiranë, 2018

Drejt një qytetërimi botëror me

DASHURI dhe TOLERANCË

M. Fethullah Gylen

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 9
HYRJE 13
BIOGRAFIA E AUTORIT 21
DASHURIA DHE MËSHIRA 25
Dashuria 27
Dashuri për njerëzoren 30
Humanizmi dhe dashuria për natyrën njerëzore 35
Dashuria për Zotin 38
Apel për mëshirë 50
MIRËKUPTIMI, TOLERANCA DHE DIALOGU 57
Mirëkuptimi 59
Toleranca dhe bujaria 64
Toleranca 66
Tolerancë në jetën individuale dhe shoqërore 71
Krijimi i atmosferës së një tolerance të qëndrueshme 82
Dy trëndafila për majat e smeraldta: toleranca dhe dialogu 86
Pa duar kundër atyre që ju qëllojnë, pa fjalë kundër atyre që ju mallkojnë 91
Islami – një fe e tolerancës 95
Islami si fe e mëshirës universale 101
Toleranca dhe dialogu në Kuran dhe Sunet 107
Dialogu në frymën dhe kuptimin Muhamedan 109
Dialogu me popullin e librit 113
Sportet dhe procesi i dialogut 116
NJERIU IDEAL 119
Njeriu i ri 121
Portreti i njeriut të zemrës 125
Besimtar ideal – mysliman ideal 131
Shpirtrat idealë dhe heronjtë e dashurisë 135
Ç'duhet të kesh për të qenë besimtar 140
Shpirtrat e dhënë pas Zotit 146

Të devotshmit e sotëm 152
Krijesat njerëzore dhe natyra e tyre 162
Në thellësitë e brendshme të njerëzores 166
Natyra njerëzore dhe përgjegjësitë e saj 173
Një shoqëri ideale 181
MISTICIZMI DHE METAFIZIKA 185
Kuptimi i jetës 187
Besimi: një perspektivë e veçantë 190
Horizontet e besimit 197
Horizontet e shpirtit: mendimi metafizik 204
Kaosi dhe bota mistike e besimit 209
Horizontet e qetësisë 218
Misticizmi dhe origjina e tij 225
XHIHADI – TERRORIZMI – TË DREJTAT NJERËZORE 229
Të drejtat e njeriut në Islam 231
Xhihadi i vogël dhe i madh 234
Dashuria, toleranca dhe xhihadi në jetën e Profetit 239
Myslimanët e vërtetë nuk mund të jenë terroristë 243
Sulmet e fundit terroriste 249
EDUKIMI 259
Shërbimet edukative janë shpërndarë në mbarë botën 261
Edukimi nga lindja gjer në vdekje 272
Një lëvizje me shembujt nga vetja 282
PERSPEKTIVA GLOBALE 289
Jeta e vërtetë dhe natyra e vërtetë njerëzore 291
Një përqasje krahasuese mbi Islamin dhe demokracinë 294
Në prag të mijëvjeçarit të ri 301
Duke u ndërtuar një botë e re 312
Rendi i ri botëror 335
Rreth epokës së informacionit dhe përplasjes së qytetërimeve 339
"Unë besoj në bukurinë e mbështetur në paraqitjen e natyrës njerëzore" ... 344
Mesazhi lidhur me sulmet terroriste të 11 shtatorit 347

PARATHËNIE

Nevoja për dialog midis popujve dhe besimeve është bërë më e theksuar prej ngjarjeve që kanë ndodhur në vitet e fundit. Dialogu ndërfetar është parë si një prej alternativave për të shumëpërfolurën "përplasja e qytetërimeve". Ata që nuk pajtohen me teorinë që përplasja e qytetërimeve është e pashmangshme, këmbëngulin në *dialogun e qytetërimeve,* një shkëmbim vështrimi që ka për qëllim një pasurim të ndërsjellë, një shkëmbim mendimesh që çon drejt kuptimit më të thellë të natyrës së Zotit dhe dëshirës së Zotit për njerëzimin mbi këtë planet.

Kjo është tema e këtij libri. Është paraqitja e mendimeve të njërit prej udhëheqësve shpirtërorë të botës islame në ditët e sotme dhe një prej autorëve myslimanë më me autoritet. Lëvizja e frymëzuar dhe e drejtuar nga Fethullah Gylen u ka ofruar myslimanëve një rrugë për të mbajtur gjallë vlerat islame midis kërkesave komplekse të shoqërisë moderne. Prej Turqisë, vendit ku ka lindur, lëvizja është përhapur me shpejtësi, nëpërmjet shkollave, në shumë vende, përmes aktiviteteve kulturore dhe mediatike, gjatë projekteve sociale dhe në takime me diasporën turke kudo që ndodhet. Një ndikim të madh në lëvizjen e Gylenit ka pasur mbështetja që i kanë dhënë myslimanët kudo ku ata jetojnë në shumicë apo pakicë.

Ky libër ka një qëllim të dyfishtë. Në njërën anë, t'u kërkojë myslimanëve të kenë më shumë dijeni rreth mësimeve të Islamit për nevojën për dialog dhe për faktin që myslimanët janë thirrur për të qenë ndërmjetës dhe dëshmitarë të mirësisë universale të Zotit. F. Gylen e thirri lëvizjen mbasi zotëronte dije të plota

rreth traditës islame ku përfshihen së bashku shkrimet kuranore, hadithet ose tradita e profetit Muhamed e përcjellë prej tij nga brezi në brez gjer në ditët e sotme dhe prej intuitës të myslimanëve të moshuar, për të ndërtuar një argument bindës që toleranca, dashuria dhe mëshira janë vlerat e vërteta të Islamit, të cilat myslimanët e kanë për detyrë t'ia përcjellin botës moderne.

Në anën tjetër, libri është një ftesë për jomyslimanët që të lënë pas paragjykimet, dyshimet dhe të vërtetat e cunguara, në mënyrë që të jenë në gjendje të arrijnë të kuptojnë cila është e vërteta rreth Islamit. Dikush, i cili dijet mbi Islamin i ka kufizuar tek titujt e gazetave të përditshme, ka të ngjarë të besojë që feja ushqen terrorizmin, sulmet vetëvrasëse, shtypjen e femrës dhe urrejtjen për të tjerët, për ata që ndodhen jashtë komunitetit islam. Kush do të dëshironte atëherë të bashkëbisedonte me njerëz a popuj që përkrahnin veprime të tilla? Kush do të dëshironte të bashkëjetonte me popuj me qëndrime të tilla?

Ndërkaq, nëpërmjet shkrimeve të Fethullah Gylenit në këtë libër, lexuesi do të shohë një interpretim të saktë të mjaft prej parimeve udhëheqëse të vlerave të vërteta njerëzore të Islamit si mëshira, qetësia shpirtërore, harmonia shoqërore, ndershmëria dhe besimi në një Zot. Me paraqitjen e këtyre vlerave islame, të cilat janë përvetësuar edhe prej shumë besimtarëve të besimeve të ndryshme, autori nuk u bën thirrje vetëm myslimanëve të hyjnë në dialog. Fjala e tij është një thirrje edhe për jomyslimanët për një diskutim mbi përmbajtjen e idealeve të përbashkëta.

Unë mund t'i referohem rastit tim si një shembull. Unë jam një prift katolik, një amerikan që jetoj në Romë. Për më shumë se një dekadë kam njohur anëtarët e lëvizjes që formoi Fethullah Gylen, dhe mund të shprehem që ata e ndjejnë veten të nderuar e të impresionuar duke jetuar me mësimet e drejtuesit të tyre shpirtëror. Ata e thërrasin z. Gylen me respekt dhe dashuri, "Hoxha Efendi" që do të thotë thjesht "mësues", por që pikërisht për këtë

është shumë i dashur dhe i respektuar për ta! Mësimet e këtij libri e kanë burimin tek Kurani dhe tek parimet islame, tek formimi dhe përcaktimi prej myslimanëve i sjelljes dhe qëndrimeve në zbatimin e angazhimit islam.

Me sjelljen në një tekst të shkrimeve të veçanta dhe intervistave të botuara më parë në gazeta dhe revista të ndryshme, shumë prej të cilave gjer tani s'janë paraqitur kurrë në anglisht, z. Gylen u ka bërë një shërbim të mirë atyre që dëshirojnë të njohin idealet që karakterizojnë këtë lëvizje.

Vitin e kaluar mbajta leksione në Urfa dhe Gaziantep të Turqisë Lindore. Isha ftuar në këto qytete, gjatë kthimit për në Romë, prej një grupi të rinjsh nga Stambolli në një takim të organizuar nga Lëvizja Gylen. Pasi arrita, u befasova nga numri i të rinjve që mund të ishin rreth 4000. Në bisedë me ta, kuptova që përfaqësonin një pjesë të rëndësishme të të rinjve të Stambollit. Disa ishin studentë në inxhinieri, mjekësi dhe informatikë, të tjerët, si djemtë, ashtu dhe vajzat, ishin në punë. Disa nga vajzat ishin punësuar si sekretare, si agjente në agjencitë turistike ose mësuese në shkollat fillore. Unë takova të rinj që punonin si nëpunës bankash, drejtues burse dhe ndërtues.

Të rinjtë ishin të gëzuar dhe entuziastë që do ta festonin së bashku ditëlindjen e profetit të tyre Muhamed. Ishte mjaft kuptimplotë fakti që unë, një prift katolik, isha ftuar prej tyre në takimin me temë "Profeti, një bekim për njerëzimin." Fjala ime u pasua nga një poemë shkruar në nderim të Muhamedit dhe në mbrëmje përfundoi me një këngëtar shumë popullor turk i cili këndoi himne në lavdërim të Zotit shoqëruar me kitarë elektrike. Ndjesia në këtë mbrëmje, si në shumë raste të tjera, ishte se, nëse Fethullah Gylen dhe lëvizja e tij do të jenë të aftë të ngulisnin tek më shumë të rinj dëshirën për të lavdëruar dhe falënderuar Zotin, duke jetuar me dashuri dhe respekt për të tjerët, ata mund të janë duke marrë kështu një nismë shpirtërore shumë të çmuar.

Besimtarët jomyslimanë duhet të pranojnë se ky është populli me të cilin mund të jetojnë dhe bashkëpunojnë në dobi të të gjithëve, por sigurisht që do të pyesin rreth pikëpamjeve të Gylenit si dhe rreth lëvizjeve me drejtim tjetër në botën myslimane, lëvizje që janë të prirura për dhunë. Në këtë libër, edhe vetë autori i ngre këto pyetje "të rënda" në kapitullin "Xhihadi - Terrorizmi - Të drejtat e njeriut" për të shpjeguar synimet e xhihadit dhe për të deklaruar qartazi që myslimanët e vërtetë kurrë nuk mund të pajtohen me terrorizmin.

Po e përfundoj këtë parathënie, duke cituar një thënie që përmbledh pikëpamjet e Gylenit si një mësues shpirtëror:

"Nëse unë do të kisha aftësinë të njihja mendimet e njerëzve, gjë që do të thotë nëse unë do të kisha aftësinë të njihja çdo njeri me karakteristikat e veçanta të tij ose të saj, unë do ta drejtoja çdonjërin prej tyre në kulmin e përsosmërisë dhe kjo do të ishte më e duhura për të. Unë do t'ju rekomandoja të vazhdoni të reflektoni, të mendoni, të lexoni. Do t'ju thoja të studioni dëshmitë e Zotit në univers dhe në vetveten e njerëzve, pra, dëshmitë objektive dhe subjektive që dëshmojnë për Të. Unë do t'i këshilloja njerëzit që ta mbushnin kohën e tyre duke studiuar Kuranin, do t'i këshilloja të tjerët që të këndonin rregullisht pjesë nga Kurani dhe të kryenin rregullisht adhurimet e caktuara. Po kështu, do t'i këshilloja të reflektonin vazhdimisht mbi fenomenet natyrore. Kjo do të thotë se do t'u caktoja njerëzve detyra në fushat ku ata kanë aftësi të lindura."

Thomas Michel, S. J.
25 Maj 2004 Romë

HYRJE

Vlerat bazë që janë tipare të shek. XXI janë modernizmi, pluralizmi, individualizmi dhe feja. Disa pretendojnë që modernizmi i ka bërë njësh jetën vetjake dhe shoqërore, duke krijuar forma të reja të jetës fetare, kulturore dhe pluralizmit politik. Megjithëse trajtohet me pikëpamje të ndryshme, modernizmi ka krijuar dy nënfenomene ideologjike: zhvillimin dhe globalizmin. Shumë teoricienë e kanë përshkruar modernizmin prej perspektivës së shtimit të sovranitetit njerëzor përtej kufirit të tij dhe përparimit të shkencës. Kjo lidhje e drejtpërdrejtë e vendosur midis shkencës, nga njëra anë dhe aftësive e sovranitetit nga ana tjetër, ka treguar mundësinë që u jepet shteteve të superfuqishme për të sjellë forma të reja të dominimit të vendeve dhe popujve të tjerë. Pasionet imperialiste në kohët moderne kanë prodhuar konsekuenca të shumta e të rënda.

Meqë globalizmi ka një kuptim të tillë ideologjik, shumë e shohin të jetë thjesht një imperializëm klasik nën një emër tjetër. Ideologjik ose jo, globalizmi ka shkaktuar një ndryshim fondamental në të gjitha fushat, nga ato ekonomike dhe të shkencave shoqërore, në marrëdhëniet e politikës, në fushën e ligjeve, në historinë dhe gjeografinë e administrimit të shtetit. Në fakt, globalizmi ka vulgarizuar pasurinë, teknologjinë, pluralizmin demokratik, prodhimin, dhe konsumin. Dhe pas kësaj, përsëri, ka ndihmuar të shpalosen të gjitha llojet e përdhosjes: njerëzore, mjedisore, ose politike. Varfëria, ndotja ekologjike, armët e shkatërrimit në masë, terrorizmi dhe violenca janë globalizuar si jo më mirë.

Globalizimi i dijeve, pushteteve dhe teknologjive është pasuar

prej teorisë së një konflikti të mundshëm midis kulturave dhe qytetërimeve. Për pasojë, të gjitha këto, që janë rezultat i modernizmit apo globalizmit, kanë vendosur një numër të madh konceptesh në rend të ditës. Një duzinë konceptesh janë përcaktuar ose ripërcaktuar brenda kontekstit të modernizmit, demokracisë dhe pluralizmit: të qenët njerëzor, individualizmi, liria e të menduarit dhe feja, politika, shoqëria dhe toleranca kulturore, konflikti me konkurrencën, dialogu me konfliktet....

Nuk ka dyshim se bota sot ka nevojë me shumë urgjencë për dialog ndërmjet kulturave dhe qytetërimeve më tepër se kurrë më parë. Shkenca dhe teknologjia e armatimeve - mbase jo krejtësisht, por në një masë domethënëse - mund të jetë e shqetësuar prej shpërdorimit të saj për manipulime ideologjike. Ky lloj i manipulimit ideologjik të shkencës dhe teknologjisë, përhap dhe përgjithëson kërcënimet fetare, kulturore, shoqërore si dhe dallimet krahinore. Reagimet më të mëdha kundër globalizmit vijnë nga vendet në zhvillim. Ky reagim nuk mund të shihet vetëm si një kundërpërgjigje ndaj modernizmit. Dimensionet ideologjike të modernizmit janë perceptuar, në një kuptim të gjerë, si një kërcënim ndaj religjioneve sovrane, kombësive, historisë, kulturës dhe identitetit. Atëherë një situatë e tillë mund të shkaktojë grindje të reja në konfliktet e ngjallura.

Nga njëra anë, për pothuajse një çerek shekulli, platformat e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë dëshmuar një proces me diskutime të ashpra, të rëndësishme dhe me një rrezik të madh, të tillë si një përplasje qytetërimesh. Me ngjyrimet e tyre politike dhe ideologjike, këto janë teza që kanë ardhur nga shekuj të trazuar. Ndoshta akoma mijëra dijetarë, mendimtarë dhe burra shteti gjykojnë dhe mendojnë për të ardhmen e njerëzimit. Tezat e Hantingtonit për konfliktin e qytetërimeve kanë qenë në qendër të vëmendjes ndërkombëtare dhe kanë fituar një vend të gjerë dhe shumë fondamental në diskutimet globale të dekadës së fundit. Jehona dhe efektet e kësaj teorie në marrëdhëniet ndërkombëtare

vazhdojnë akoma.

Atëherë, a nuk kemi mundësi të lexojmë brenda modernizmit dhe globalizmit një synim të shëndoshë? A mundet që modernizmi dhe globalizmi të mos realizojnë më shumë konstruktivitet, a mundet që ata të mos përqendrohen më shumë te vlerat njerëzore dhe etike? Ata që mendojnë t'u përgjigjen këtyre pyetjeve, përpiqen t'i minimizojnë ato ose t'i shohin thjesht si një problem për t'u perceptuar. A janë modernizmi dhe globalizmi, në fakt, fenomene kaq të thjeshta që ta minimizojnë problemin thjesht për t'u perceptuar dhe për t'u kuptuar? Globalizmi dhe modernizmi, në terma ideologjike, janë kuptuar prej popujve që vijnë nga kultura dhe qytetërime të ndryshme, në formën e konflikteve të shkuara dhe llogarive të këqija. Në këtë mënyrë, tezat e këtyre, të të njëjtëve Hantington (Huntington) dhe Fukujama (Fukuyama), që - deri diku - u ndeshën me parashikimet, vijnë në ekzistencën e kësaj platforme të brishtë.

Në anën tjetër, bashkë me problemet kronike të qytetërimit modern, të tilla si përhapja e terrorizmit global, dhuna dhe armët e shkatërrimit në masë, nga të cilat, çdo njëra shkon në mbështetje të tezave të konflikteve, janë bërë edhe përpjekje serioze që vënë në dukje përputhjet midis shoqërive me kultura të ndryshme dhe qytetërimeve përmes demokracisë, tolerancës, dashurisë dhe dialogut. Këto kanë spikatur më tepër në çerekun e fundit të shekullit të XX. Këto përpjekje nuk kanë shkaktuar, direkt ose indirekt, ndonjë konflikt të brendshëm me modernizmin ose globalizmin. Ato kanë prodhuar më shumë vlera etike universale dhe fundamentale njerëzore si edhe dinamizëm për të kapërcyer aspektet shkatërruese të modernizmit dhe globalizmit. Është për të ardhur keq që nëse iniciativa të tilla për dialog midis qytetërimeve dhe kulturave kanë qenë miratuar gjithmonë prej shumicës, për disa mendje, fantazuese të konfliktit dhe shkatërrimit, kanë qenë gjithmonë vetëm zhurmë mediatike dhe asgjë tjetër. Media ndërkombëtare, duke mos iu përmbajtur etikës dhe vlerave

njerëzore, ka popullarizuar pa mëshirë dhe pa maturi vetëm terrorizëm, dhunë, shkatërrim vlerash e rezultatesh dhe në këtë mënyrë, fatkeqësisht ka zmadhuar numrin e këtyre mbështetësve. Reagimin e ashpër kundër tezave të Hantingtonit, në fakt, e shfaqi nevoja e zjarrtë për konkurrencë dhe dialog, ndonëse veprimet konkrete që janë marrë në drejtim të vënies së themeleve për konkurrencën dhe dialogun, janë fare pak për t'u përmendur. Ose përpjekje të tilla nuk kanë pasur efekt global. Arsyet e këtij qëndrimi të përgjithshëm të heshtur dhe indiferent duhen kërkuar në efektet e transformimeve moderniste tek njerëzit dhe shoqëria.

Është fakt që modernizmi ka shtënë egoizëm në qeniet njerëzore, duke i bërë aq të parëndësishëm, sa të bëhen pothuajse të padukshëm. Modernizmi ka nxitur individualitetin, materializmin dhe instinktet vetjake të njerëzve në kundërshtim me shoqërinë, i ka larguar njerëzit nga gjithçka që ata mbajnë të shenjtë, humane dhe etike, nga dashuria, përkujdesja, përkushtimi dhe sakrifica. Në fund, pasoja ka qenë një qenie njerëzore e ulët, që jeton vetëm me instinktet egoiste. Një person që jeton vetëm me instinktet egoiste, në të vërtetë, është i ulët. Të gjitha fetë monoteiste kanë bërë përpjekje për t'i shpëtuar njerëzit e tillë, por era fatale e modernizmit kundër personalitetit dhe koherencës kozmike të qenieve njerëzore i ka bërë ata robër të instinkteve vetjake. Do të ishte, sigurisht, e pamundur të bëhej këtu një hetim i plotë i modernizmit. Dhe as është synim të bëhet një hetim apo ndonjë lloj tjetër pyetësori. Kur vështrojmë degradimin e qytetërimit të sotëm, ajo që kuptojmë është - për çfarëdolloj arsye - se gjithçka përfundon tek problemi i njeriut. Kur njerëzit janë destruktivë, të dëmshëm, armiqësorë dhe agresivë, atëherë ata skllavërojnë bashkësinë shoqërore dhe njerëzore në të cilën bëjnë pjesë edhe vetë po me këto instinkte. Prandaj është e qartë se ku dhe kur kanë qenë të nëpërkëmbura standardet njerëzore. Rruga për të shpëtuar qytetërimin bashkëkohor prej shkatërrimit të shpejtë është t'i riedukojmë qeniet njerëzore në bazë të dashurisë, tolerancës,

dialogut dhe të jemi të bashkuar.

Tani, thirrja e z. Fethullah Gylen gjendet e afishuar në shumë vende ku standardet njerëzore janë nëpërkëmbur. Thirrja e tij nuk është pasive, thjesht një humanizëm filozofik apo një platformë diskutimesh elite ku vetëm përsiatjet teorike zënë vend. Për qindra institucione edukative që shtrihen në të gjithë botën, ky projekt që sillet si një shembull model, është i aplikueshëm në jetën e përditshme, ku themelet e shoqërisë, si dialogu dhe toleranca, janë nëpërkëmbur dhe ku përpjekjet janë bërë për t'iu përgjigjur nevojës për qytetërim bashkëkohor.

Në fakt, modeli i Gylenit është, ashtu si vlerat njerëzore, individuale, toleranca, dhe konkurrenca, vlera që synon shekulli XXI, sintezë e krijuar në esencë prej bashkimit të kulturës turke me Islamin. Turqit myslimanë kanë ushtruar tolerancë dhe konkurrencë, që janë në esencë të një demokracie bashkëkohore, për shekuj me radhë në një hapësirë të pakufi. Islami ka qenë interpretuar, për qindra vjet, në këtë hapësirë me të njëjtën tolerancë. Kjo tolerancë ishte pranuar prej turqve myslimanë dhe ishte injektuar në rrënjët e kombit, duke ndjekur një linjë që shtrihej prej Ahmet Jeseviut tek poeti mistik Xhelaledin Rumi, pastaj, prej poetit kombëtar Junus Emre tek Haxhi Bektash Veliu, që të dy nxënës të Ahmet Jeseviut, në një histori shumë të gjatë. Gyleni, duke ndjekur këtë bazë reale, rikrijoi brenda rrethanave bashkëkohore këtë interpretim tolerant dhe të kuptueshëm për myslimanët, ndonëse duke theksuar një përgjithësim shumë aktiv dhe me një vizion më të orientuar shoqëror. Rumiu, Junusi, dhe Haxhi Bektash Veliu thirrën njerëzinë të zbulojnë botën e brendshme të tyre. Ndërsa etika e tyre dhe e rrethit shoqëror të tyre vinte në dukje tolerancë dhe dialog, Gyleni e zbërtheu këtë strukturë dhe vizion transformues dhe zgjerues për të gjithë popujt në botë. Me fjalë të tjera, misioni i tij përfshinte një aksion shndërrues. E vërteta është që nga një pikë e tillë ai bashkoi misionin dhe lëvizjen e tij me dëshirën për ekzistencë të njerëzve në këtë

botë. Në njërën anë, përmes lëvizjes për dialog dhe konkurrencë, ai është në gjendje të organizojë takime dhe të diskutojë platformat bazuar në dashamirësinë midis kulturave të ndryshme në botë; në anën tjetër, ai vë poshtë një sfidë të ndryshimit të aspektit njerëzor i cili është bërë egocentrik me modernizmin, prandaj ky mund të jetë një shërbim dhe vetëflijim për njerëzimin. Njerëzit modernë janë pasivë, të paaftë për të vepruar drejt me përgjegjësi personale, të plogësht dhe egoistë. Askush nuk mund të gjejë një njeri të tillë që të ketë forcën për të marrë përsipër një përgjegjësi të rëndë dhe të madhe sa dialogu, toleranca, konkurrenca midis feve, kultura dhe qytetërimi. Njerëzit që mund të marrin një përgjegjësi të tillë duhet të jenë të përkushtuar, të sinqertë, të sakrificës dhe zemërgjerë. Po ata që kanë ardhur për të shkatërruar, për të thyer, për të rrënuar, duhet të vijnë në vete dhe të ndihmohen të gjejnë parimet themelore të natyrës së tyre njerëzore. Kështu, njerëzit të cilët Gyleni i ka vënë në qendër të dialogut dhe tolerancës, duhet të kenë në mendim dhe në sjellje një qëndrim të sigurt në të dy termat. Ata nuk duhet të veprojnë nisur prej instinkteve ose prej reagimeve, ose në pajtim të fshehtë me gjykime të huaja. Ata duhet të jenë konstruktivë, jo destruktivë. Prandaj, njerëz të tillë duhet të jenë pionierë të durimit. Kjo nuk është diçka që mund të kryhet vetëm prej fetarëve të zellshëm, ose vetëm duke ekzistuar në një kënd të njohur dhe duke e lënë veten në rrjedhën e zhvillimeve shoqërore. Modeli i Gylenit është i përhershëm, i hapur në të dy anët në pafundësi. Aty as është fundi i kapërcimeve shpirtërore, as kufiri i përkushtimit materialo jetësor, ose i vetëflijimit. Të gjitha këto janë të lira në pafundësi. Asgjë nuk është e mjaftueshme kur është bërë në të mirë të shoqërisë, të njerëzimit, për dashurinë hyjnore.

Pavarësisht nga vizioni i gjerë që ka paraqitur Gyleni, aty mund të jenë disa fusha të cilat e kanë të pamundur të gjejnë vetveten ose të njohin gjykimet e tyre nëpërmjet modelit të tij. Lidhjet e ndryshme ideologjike mund të prodhojnë perspektiva të ndryshme.

Ndonëse, kur e vështrojmë nga këndvështrimi i vlerave dhe lidhjeve njerëzore universale, vizioni i tij, ka, në fakt, mundësinë për të përqafuar të gjithë njerëzit dhe proceset shoqërore. Kjo sepse ai, duke lënë mënjanë të gjitha lidhjet ideologjike, ka krijuar një model për njerëzimin, i cili është një mbështetje e hekurt për të gjitha ideologjitë. Dhe njeriu në këtë model është një qenie e krijuar prej Zotit dhe i përcaktuar si trashëgimtar i botës, një njeri i pastër, sakrifikues dhe në gjendje t'i lërë të gjitha kërkesat dhe dëshirat vetjake për hir të dashurisë hyjnore, dashurisë për njerëzit dhe krijesat. Në këtë mënyrë, ju mund ta vini këtë person në themel të çdo lloj marrëdhënie, sistemi shoqëror, drejtimi dhe udhëheqjeje. Ju mund të krijoni një mizëri modelesh shoqërore duke u bazuar në të tillë njerëz. Shpirtërore, teorike dhe shoqërore, karakteristikat e këtyre njerëzve janë të tilla që qëndrojnë pozitive në çdo rrethanë. Njerëzit që kanë dhënë shpirtrat e tyre për thirrjen e Gylenit dhe që me gjykimet e tyre qëndrojnë në këtë drejtim, marrin një miratim të ngrohtë prej thuajse gjithsecilit kudo në botë, prej njerëzve me ideologji, politikë, fe dhe situatë social-kulturore të ndryshme. Ata evidentojnë vlerat e përbashkëta njerëzore, shoqërore dhe etike, vlera me të cilat çdo njëri prej tyre është bashkuar pa vështirësi.

Ky libër nuk ka përfshirë të gjitha mendimet dhe qëndrimet e Gylenit. Doemos, duke prekur në dinamikën e sigurt rreth bazave teorike dhe kulturore të modelit, ai ka rritur mbështetjen tek dialogu, toleranca, dhe konkurrenca midis grupeve të ndryshme që vijnë prej feve, kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme. Ky model, përqendrohet tek qeniet njerëzore, me mendimet dhe veprimet që rrethojnë gjithë botën e tyre, të cilët janë orientuar drejt dashurisë për Zotin dhe për krijesat.

Artikujt në këtë libër janë një përmbledhje nga shkrimet dhe ligjëratat e ndryshme të Gylenit, të cilat ai i ka mbajtur në kohë dhe raste të ndryshme. Megjithatë, të gjithë artikujt sjellin një pamje të përgjithshme të botës ashtu si e mendon ai. Ne shpresojmë që

ky libër do të bëhet i kuptueshëm, i vërtetë dhe një kontribut i madh në ngritjen e tolerancës dhe dialogut që është në interes të së ardhmes së kombit tonë dhe të botës të sotme.

M. Enes Ergene

Editor

BIOGRAFIA E AUTORIT

I lindur në Erzurum të Turqisë më 1941, M. Fethullah Gylen është një studiues dhe mendimtar islam, njëherazi shkrimtar dhe poet. U arsimua në shkencat fetare nga dijetarë dhe mësues shpirtërorë të shquar islamë të kohës. Gyleni studioi gjithashtu teoritë dhe parimet e shkencave moderne shoqërore e të natyrës. Më 1958, pasi arriti rezultate të shkëlqyera në provime iu dha licenca e predikuesit zyrtar dhe u gradua me një post në qytetin e Izmirit. Kjo ishte koha kur Gyleni filloi të kristalizonte temat dhe të zgjeronte bazat e audiencës së tij. Në predikimet dhe ligjëratat që mbante, ai theksonte çështjet e shtypjes shoqërore në kohë të ndryshme, pasi qëllimi i tij ishte të inkurajonte brezin e ri për të harmonizuar ndriçimin intelektual me urtësinë shpirtërore dhe një përkujdesje për aktivizmin human.

Gyleni nuk u kufizua vetëm me qendrat e qyteteve për të predikuar. Ai udhëtoi nëpër provincat e Anadollit dhe predikoi jo vetëm nëpër xhami, por edhe nëpër tubime shoqërore, madje edhe në kuvende të ngushta rreth filxhanit të kafesë. Kjo mundësoi për të të arrinte një përfaqësim model në popull dhe të tërhiqte vëmendjen e mbarë komunitetit akademik, posaçërisht të studentëve. Përmbajtja e temave në ligjëratat e tij, qofshin ato zyrtare ose jozyrtare, nuk kufizohej vetëm me çështjet fetare; ai fliste rreth arsimit, shkencës, darvinizmit, rreth ekonomisë dhe drejtësisë shoqërore. Ishte thellësia dhe cilësia e ligjëratave të tij në tema kaq të gjera që bëri më shumë përshtypje në komunitetin akademik, duke fituar kështu vëmendjen dhe respektin e tyre.

Ai konsiderohet si nismëtari dhe frymëzuesi i rrjetit shoqëror

mbarëbotëror të vlerave njerëzore të njohur si "Lëvizja Gylen". Ai respektohet nga lexuesit dhe dëgjuesit e tij si një model i gjallë i vlerave të larta si mençuria, besimi, dashuria, butësia, respekti, sinqeriteti, mëshira, ndjeshmëria dhe shërbimi ndaj njerëzimit. Gylen konsiderohet si një nga intelektualët më me ndikim jo vetëm në Turqinë moderne, por edhe në mbarë globin. Në korrik të vitit 2008, ai u rendit mes 100 intelektualëve më të shquar në botë nga revista Foreign Policy dhe në votimin *on-line* u përzgjodh më i shquari. Pavarësisht vlerësimit të madh që miliona njerëz kanë për të, Gylen e konsideron veten, vetëm si një prej vullnetarëve të lëvizjes së shoqërisë civile të cilën ai e ndihmoi të lindte, duke mos pranuar idenë se ai është udhëheqësi i saj. Madje arrin deri aty, sa lëvizjen e themeluar nga vetë ai, e quan "Lëvizja e Vullnetarëve".

Lëvizja Gylen është shfaqur si një fenomen domethënës në Turqi dhe tashmë së fundmi edhe në mbarë botën, ndaj kjo bashkësi e frymëzuar nga mësuesi dhe teologu islam Fethullah Gylen, tashmë përfshin disa miliona pasues. E nisur me një rreth të vogël anëtarësh në Izmir, bashkësi e cila u kristalizua rreth Gylenit aty nga fundi i viteve 70-të, Lëvizja tani fokusohet në projekte globale të shërbimit, veçanërisht në fushat e edukimit, dialogut ndërfetar e ndërkulturor, si dhe në ndihma humanitare.

Mësimet e tij kanë frymëzuar dhe vazhdojnë të frymëzojnë mijëra njerëz të punojnë për edukimin global, paqen dhe përhapjen e tolerancës. Ata ndajnë të njëjtat ideale, parime dhe vlera humane. Fethullah Gylen është shndërruar tashmë në një model për miliona njerëz që jetojnë në vende të ndryshme. Pasuesit e tij janë angazhuar në qindra projekte të shoqërisë civile dhe kanë hapur mbi 1000 shkolla në mbarë botën. Këto shkolla ofrojnë një kurrikulum në përputhje me standardet më të larta lokale. Objektivat edukativë, të frymëzuar nga Gyleni, kanë mobilizuar organizata të panumërta jofitimprurëse mbi baza vullnetare, fondacione dhe shoqata, si në Turqi ashtu edhe jashtë saj, me mbështetjen edhe të mjaft intelektualëve. Këta njerëz

janë vullnetarë dhe profesionistë të cilët punojnë në organizata edukative dhe jofitimprurëse. Megjithatë, ata përjetojnë një gjerësi shpirtërore, përqendrim dhe përkushtim në gjithë jetën dhe punën e tyre. Lëvizja është zgjeruar duke financuar hapjen e kolegjeve, universiteteve, spitaleve, qendrave kulturore, qendrave të dialogut ndërfetar dhe OJQ-ve humanitare.

Gyleni ka vizituar rregullisht dhe ka pritur vizita nga figura fetare të kalibrit botëror si patriarkë, rabinë, madje edhe Papa Gjon Pali II. Në takimin me Papa Gjon Pali II në Vatikan (1998), Gyleni paraqiti një propozim për të ndërmarrë hapa të sigurt në shuarjen e konfliktit në Lindjen e Mesme, parapërgatiti rrugën e bashkëpunimit në këtë vend, ku e kanë origjinën të tri fetë hyjnore. Në propozimin e tij, ai gjithashtu nënvizonte faktin që shkenca dhe feja janë në të vërtetë dy aspekte të ndryshme që rrjedhin nga e njëjta e vërtetë.

Gyleni dënoi aktet terroriste të 11 shtatorit në SHBA, duke i cilësuar si një goditje të madhe për paqen botërore, që padrejtësisht errësuan autoritetin e besimtarëve: "....terrori nuk mund të përdoret në emër të Islamit ose për interesa të çdo grupi islamik. Një terrorist nuk mund të jetë mysliman dhe një mysliman nuk mund të jetë terrorist. Një mysliman mund të jetë vetëm një përfaqësues dhe simbol i paqes, mirëqenies dhe prosperitetit!"

Përpjekjet e Gylenit, për paqe botërore, kanë pasur jehonë në mjaft konferenca dhe simpoziume të ndryshme të përmasave globale. "Simpoziumi i Heronjve të Paqes" (11-13 prill 2003) në Universitetin Agustinian të Teksasit, paraqiti një listë të luftëtarëve të paqes në mbi 5000 vjet të historisë njerëzore. Gyleni përmendej midis heronjve bashkëkohës të paqes, në një listë në të cilën përfshiheshin emra të tillë si Jezusi, Buda, Mohandas Gandi, Martin Luter Kingu dhe Nënë Tereza.

"Lëvizja Gylen" përbën një rast unik të reformimit shoqëror global të bazuar mbi botën shpirtërore në një numër aspektesh.

E pajisur me parimet e mirëkuptimit, dashurisë dhe dialogut, "Lëvizja Gylen" gëzon një pjesëmarrje të madhe vullnetare të të rinjve nga prejardhje, ideologji, kombe, klasa, raca dhe besime të ndryshme fetare në mbarë botën. "Lëvizja Gylen" propozon një model të partneritetit dhe bashkëpunimit shpirtëror të mbështetur mbi pasionet e përbashkëta dhe idealizmin, si dhe një këndvështrim shumëdimensional të vlerave të përbashkëta universale dhe botës shpirtërore. Ajo çfarë e bën Gylenin unik, është se ai ka nxitur dhe mobilizuar mjaft të rinj në mbarë botën për të themeluar institucione edukative dhe civile, si dhe ka qenë në gjendje të vërë në jetë parimet e tij të vlerave shpirtërore dhe globale, duke realizuar kështu idealin e tij të lindjes së "brezit të artë", dhe ecjen përpara drejt paqes globale.

Ndonëse një figurë e mirënjohur publike, Gyleni gjithmonë ka qëndruar larg angazhimit në politikën formale. Ndër admiruesit e Gylenit përfshihen gazetarë, akademikë, personalitete të medies, politikanë dhe shumë autoritete shtetërore turke dhe të huaja. Ata shohin tek ai një novator të vërtetë dhe një reformator të rrallë shoqëror, i cili zbaton atë që ka predikuar. Ata e shohin atë si një aktivist paqeje, si intelektual, si një dijetar fetar, një udhërrëfyes, shkrimtar dhe poet, një mendimtar të madh dhe drejtues shpirtëror që ia ka kushtuar tërë jetën e tij kërkimit të zgjidhjeve për sëmundjet shoqërore dhe nevojave shpirtërore. Ata e shohin lëvizjen që ai frymëzoi, si një lëvizje kushtuar edukimit, por një edukimi për zemrën dhe shpirtin, gjithashtu edhe për mendjen, me synim ripërtëritjen dhe fuqizimin e tërë qenieve, për të arritur mundësinë e të mirave dhe shërbimeve në dobi të të tjerëve.

Opusi i tij përbëhet tanimë nga rreth 70 libra, të përkthyera në mbi 30 gjuhë të ndryshme, një pjesë e mirë e prurë edhe në gjuhën shqipe.

DASHURIA DHE MËSHIRA

DASHURIA [1]

Dashuria është elementi më thelbësor për çdo qenie, është ndriçimi më rrezatues dhe forca më e madhe, e aftë të rezistojë dhe të kapërcejë gjithçka tjetër. Dashuria lartëson çdo shpirt që e rrëmben atë dhe i përgatit këta shpirtra për udhëtimin në amshim. Shpirtrat që kanë qenë të aftë të kenë lidhje me përjetësinë, vënë në përdorim vetveten për të frymëzuar të gjithë shpirtrat e tjerë me çfarë kanë përftuar ata vetë prej amshimit. Ata ia kushtojnë jetën e tyre kësaj detyre të shenjtë, një detyrë për hir të së cilës do të durojnë çdo lloj vuajtje deri në fund fare dhe ashtu siç shqiptojnë "dashuri" me frymën e fundit, gjithashtu do të marrin "dashuri" kur të jenë lartësuar në Ditën e Gjykimit.

Është e pamundur për shpirtrat pa dashuri të ngrihen në horizontin e përsosjes njerëzore. Edhe po të jetojnë për qindra vjet, ata nuk do të mund të përparojnë në rrugën e përsosjes. Ata të cilët janë privuar nga dashuria si dhe janë ngatërruar në rrjetën e egoizmit, janë të paaftë të dashurojnë njeri tjetër veç vetes dhe vdesin pa e ditur që dashuria është ngulitur thellësisht në shumë qenie të ekzistencës.

Një fëmijë është pritur me dashuri kur ka lindur dhe rritet në një atmosferë të ngrohtë të mbushur me dhembshuri, shpirtrat e dashur. Edhe nëse fëmija mund të mos gëzojë të njëjtën dashuri në të njëjtën masë në fazën e fundit të jetës së vet, gjithmonë do të ketë mall për dashurinë dhe do ta kërkojë ngado në jetën e vet.

---

[1] Ky artikull është shkruar në mars të vitit 1987 dhe origjinali i tij përmbahet në librin me titull *Yitirilmis Cennete Dogru*.

Është shenjë e dashurisë pamja e diellit. Uji avullon, ngjitet lart drejt lindjes së këtyre shenjave dhe pasi është kondensuar në lartësi të mëdha, bulëzat bien plot gaz mbi tokë në krahët e dashurisë. Atëherë, mijëra lule çelin përmes dashurisë duke dhuruar buzëqeshje rreth tyre. Pikat e vesës lënë një shkëlqimin të mbushur plot me dashuri dhe vezullojnë me dëfrim. Delet dhe qengjat blegërijnë dhe lodrojnë përreth me dashuri, zogjtë cicërojnë me dashuri dhe në refren për dashurinë.

Çdo qenie merr pjesë në një orkestër të madhe me dashuri në univers, me simfoninë e veçantë të tij dhe provon të vërtetojë, me vullnet të lirë ose për shkak të gatishmërisë, një aspekt të dashurisë së thellë që ka gjetur në ekzistencë.

Dashuria është rrënjosur shumë thellë në qeniet njerëzore, aq sa shumë njerëz lënë shtëpitë e tyre për hir të saj, shumë familje janë rrënuar dhe në çdo qoshe një Mexhnun rënkon me dashuri e me përmallim për Lejlanë e tij. Sa për ata të cilët nuk janë të aftë të zbulojnë dashurinë e natyrshme në qenien e tyre, e vështrojnë një manifestim të tillë të dashurisë si çmenduri!

Altruizmi është një ndjenjë e lartë njerëzore dhe burimi i tij është dashuria. Ai që ka një pjesë të madhe në këtë dashuri, është një hero i madh i njerëzimit. Njerëz të tillë janë të aftë të çrrënjosin çdo ndjenjë urrejtjeje dhe smire në veten e tyre. Heronj të tillë të dashurisë vazhdojnë të jetojnë edhe pas vdekjes së tyre. Këta shpirtra të lartë, të cilët për çdo ditë ndezin një zjarr të ri të dashurisë në botën e tyre të brendshme dhe i bëjnë zemrat e tyre burim dashurie dhe altruizmi, janë të mirëpritur dhe të dashur për njerëzit, janë të privilegjuar në jetën e amshuar prej Gjykuesit Suprem. Vdekja nuk është e njëjtë në Ditën e Gjykimit, kurse ata do të jenë në gjendje të lajnë gjurmët e tyre.

Një nënë që ka dhënë jetën për hir të fëmijës së saj, është një heroinë e dhembshurisë. Individët që ia kushtojnë jetën e tyre lumturisë për të tjerët, janë quajtur "heronj të devotshmërisë,"

por ata të cilët jetojnë dhe vdesin për të gjithë njerëzimin, janë përkujtuar si monumente të pavdekësisë që meritojnë të jenë të ulur në fronet e zemrave të njerëzve. Në duart e këtyre heronjve, dashuria bëhet një eliksir magjik që kapërcen çdo pengesë dhe një çelës që hap çdo portë. Atyre që zotërojnë një eliksir dhe çelës të tillë, do t'u hapen herët ose vonë dyert në çdo pjesë të botës për të përhapur aromën e paqes ngado duke tundur "temjanicën" e dashurisë në duart e tyre.

Rruga më e drejtë për të shkuar në zemrat e njerëzve është rruga e dashurisë, rruga e profetëve. Ata që e kanë ndjekur atë rrugë rrallëherë janë kthyer duarbosh, edhe po të jenë kthyer prej një pakice, ata janë mirëpritur prej mijërave. Kur janë mirëpritur përmes dashurisë, asgjë nuk ka mundur t'i ndalojë ata të përmbushin dëshirën e fundit, pëlqimin e Zotit.

Sa të lumtur dhe të begatuar janë ata të cilët ndjekin drejtimin e dashurisë. Sa fatkeqë, në anën tjetër, ata që e kanë shpënë jetën e tyre "shurdhmemece" pa ditur gjë për dashurinë e bashkëlindur thellë në shpirtrat e tyre!

O Zot, o ti më i Lavdëruari! Sot kur urrejtja dhe smira kanë errësuar gjithçka, ne gjejmë shpëtim në dashurinë Tënde të pafund dhe lutemi në derën Tënde së pari që Ti të mbushësh zemrat e mëkatarëve, robërve të Tu të pamëshirshëm, me dashuri dhe ndjenja njerëzore!

DASHURI PËR NJERËZOREN [2]

Dashuria është eliksir. Një njeri që jeton me dashuri, është lumturuar prej dashurisë dhe ka mbuluar të tjerët përreth ose gëzimin e tij me dashuri. Në fjalorin e njerëzimit, dashuria është jetë. Ne e ndjejmë dhe e kuptojmë njëri-tjetrin me dashuri. Zoti i Plotfuqishëm nuk ka krijuar një marrëdhënie më të fuqishme se dashuria, këtë zinxhir që lidh njerëzit me njëri-tjetrin. Në fakt, bota nuk është asgjë tjetër veçse një rrënojë pa dashurinë që e mban atë në këmbë, të pastër dhe plot jetë. Xhindet dhe njerëzit kanë mbretërit e tyre; bletët, milingonat dhe termitet kanë po ashtu, mbretërit e tyre; për secilin prej tyre ekziston një mbretëri dhe një mbret. Mbretërit dhe mbretëreshat vijnë në fuqi në rrugë të ndryshme dhe ngjiten në fronet e tyre shpesh me luftë dhe viktima. Kurse dashuria është mbret që mbretëron në zemrat tona jo duke shkaktuar përleshje dhe viktima. Gjuha dhe buzët, sytë dhe veshët kanë vetëm një vlerësim për sa kohë mbajnë flamurin e dashurisë, ende dashuria është vetëm e çmueshme në vete dhe për vete. Zemra, pavioni i dashurisë, është shumë e vyer për atë që mban brenda. Kështjellat mund të mposhten pa gjakderdhje por thjesht duke valëvitur flamujt e dashurisë në ballë të tyre. Mbretërit bëhen ushtarë të dhembshurisë kur mposhten prej ushtarëve të dashurisë.

Ne jemi rritur në një atmosferë ku ngadhënjimi i dashurisë është në sytë tanë dhe në zemrat tona kumbon gjëmimi i daulleve të dashurisë. Zemrat tona rrahin me gjallëri kur shohin të valëvitet flamurin e dashurisë. Ne jemi ndërthurur me dashuri që jeta jonë të bëhet krejtësisht e varur nga dashuria dhe ne i dedikojmë

[2] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *Isigin Göründügü Ufuk*·

shpirtrat tanë për të. Kur jetojmë, ne jetojmë me dashuri, kur vdesim, ne vdesim me dashuri. Në çdo frymëmarrje, ne e ndjejmë dashurinë me gjithë ekzistencën tonë. Ajo është zjarri ynë ngrohës në të ftohtë dhe oazi ynë freskues kur është nxehtë.

Në këtë botë të tejprishur, ku e keqja është kudo, nëse ka diçka që ka qenë lënë e paprekur dhe e pastër, kjo është dashuria. Midis të gjitha stolive të venitura të kësaj jete, nëse është një bukuri që ka ruajtur shkëlqimin dhe magjinë pa u fishkur, kjo është gjithashtu dashuria. Asgjë më të vërtetë dhe të qëndrueshme se dashuria nuk ka në çdo komb ose shoqëri të kësaj bote. Kudo ku është dëgjuar zëri i dashurisë, i butë dhe i ëmbël si një ninullë, të gjithë zërat e tjerë, të gjithë instrumentet, kanë heshtur dhe të gjithë të bashkuar kanë soditur në qetësi me përqendrimin e tyre melodik.

Krijesa është rezultat i ndezjes së fitilit të qiriut të dashurisë, qiri për "qeniet që kuptojnë dhe shikojnë." Nëse Zoti nuk e bën krijesën të dashur, nuk do të ketë as hënë, as diell, as yje. Qiellore janë të gjitha poezitë e dashurisë, kurse toka rimon me to. Në natyrë, goditja e rëndë e dashurisë është ndjenjë dhe në marrëdhëniet midis njerëzve, mund të shihet duke u valëvitur flamuri i dashurisë. Në shoqëri, nëse është një pështpëritje që përmban vlera, është dashuria, dhe përsëri vlera e dashurisë është mbështetur në vetë atë. Pesha e dashurisë është më e madhe edhe nëse kundërpesha është ar i kulluar, sepse dashuria peshon më rëndë se ari. Ari dhe argjendi mund ta humbin vlerën e tyre në tregje dhe vende të ndryshme, por dyert e dashurisë janë të mbyllura për çdo lloj pesimizmi dhe asgjë nuk mund të ndryshojë harmoninë dhe qëndrueshmërinë e saj. Deri në këtë moment të vërtetë, vetëm ata që janë zhytur në urrejtje, zemërim dhe armiqësi, planifikojnë të rezistojnë dhe të luftojnë kundër dashurisë. Për ironi, i vetmi mjekim që do t'i qetësonte këta shpirtra mizorë, është dashuria. Përtej efekteve, në tokësorët e dashuruar janë të tjera probleme që vetëm çelësat mistikë të dashurisë mund t'i zgjidhin. Është e pamundur që çdo vlerë në këtë botë të mund

të kalojë ose të konkurrojë njëlloj me dashurinë. Kartat e arit, argjendit, parave, ose të çdo sendi tjetër me vlerë, janë pothuajse gjithmonë të mposhtura në këtë maratonë prej adhuruesve të dashurisë dhe vetë dashurisë. Kur dita vjen me gjithë shkëlqimin e saj, stili madhështor i jetës së pronarëve të pasurive materiale është shuar, arkat e tyre janë bosh, zjarri i tyre është shuar, kurse qiriu i dashurisë vazhdon të digjet për të ndriçuar dhe për ta përhapur atë në zemrat dhe shpirtrat tanë.

Ata njerëz fatbardhë që janë gjunjëzuar në ballë të altarit të dashurisë dhe që jetën ia kanë kushtuar përhapjes së saj, nuk kanë lënë edhe një hapësirë të vogël në fjalorin e tyre për fjalë të tilla si urrejtje, mëri, komplot ose zemërim, dhe, po ashtu, nëse mendimet vënë vërtet në rrezik jetën e tyre, ata kurrë nuk janë mbushur me zemërim. Kokulur dhe të përvuajtur, të mbushur me dashuri, ata kurrë nuk kanë përshëndetur gjë tjetër veç saj. Kur ata lartësohen, ndjenja e urrejtjes kërkon të gjejë një strehë ku të fshihet, mëria bëhet ziliqare, zmbrapsur prej goditjeve, dorëzuar prej dashurisë.

E vetmja magji, e vetmja formulë që mund të shkatërrojë kurthet e djallit, është dashuria. Lajmëtarët dhe profetët, zjarrfikësit e zjarrit të urrejtjes dhe xhelozisë ndezur prej faraonëve, Nemrudit dhe mbretërve të tjerë tiranë, nuk përdorën gjë tjetër veç dashurisë. Shenjtorët kanë provuar të mbledhin së bashku shpirtrat rebelë dhe të padisiplinuar, përhapur kudo si fletë të palidhura, ata kanë shfrytëzuar dashurinë për të iniciuar sjellje njerëzore tek të tjerët. Forca e dashurisë ishte tejet e mjaftueshme për të prishur magjitë e Harutit dhe Marutit[3] dhe mjaft e vlefshme për të shuar zjarrin e ferrit. Pra, nuk ka dyshim që një njeri që është blinduar me dashuri, nuk kërkon tjetër armë. Sigurisht, dashuria është mjaft e fortë për të ndaluar një plumb, madje, një gjyle topi.

Interesi ynë në kushtet tona dhe dashuria jonë për njerëzimin

[3] Haruti dhe Maruti për të cilët flitet në Kuran (Bakara, 102), janë dy engjëj që kanë pasur dije mbi magjinë.

- që është aftësia jonë për të përqafuar krijesat – është besimi në njohuritë dhe inteligjencën tonë për të njohur esencën, aftësia jonë për të zbuluar veten dhe për të ndjerë lidhje me Krijuesin tonë. Në paralel me aftësinë për të zbuluar dhe ndjerë thellësitë tona të brendshme dhe potencialin e fshehtë brenda esencës tonë, ne gjithashtu do të jemi në gjendje të çmojmë dhe të tjerët që zotërojnë të njëjtin potencial. Për më tepër, pikërisht sepse këto vlera të brendshme janë të lidhura drejtpërsëdrejti me Krijuesin dhe sepse është ushqyer respekti për gjërat e çmueshme të fshehura në çdo krijesë, ne do të fillojmë ta shohim çdo gjë të gjallë prej një perspektive tjetër dhe në një mënyrë tjetër. Në të vërtetë, niveli i inteligjencës tonë dhe vlerësimi për një tjetër varet nga njohja sa më e mirë e cilësive dhe pasurive që zotëron çdo njeri tjetër. Ne mund ta përmbledhim këtë koncept në një ide bazuar në një thënie të Profetit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, sipas së cilës, "Një besimtar është pasqyrim i besimtarit tjetër." Ne mund ta shprehim të përgjithësuar kështu këtë thënie: "Një njeri është pasqyrim i njeriut tjetër." Nëse jemi në gjendje t'ia dalim në krye kësaj si edhe të jemi të aftë të kuptojmë dhe të çmojmë pasuritë e fshehura brenda çdo njeriu tjetër, ne do të kuptojmë gjithashtu si janë lidhur këto pasuri me Zotin e tyre të vërtetë dhe në këtë mënyrë ne do të pëlqejmë çdo gjë në këtë gjithësi që është e bukur, e dashur, ose të dashurit që bëjnë pjesë tek Ai. Një shpirt që mund ta kuptojë këtë shprehje të thellë, do të bënte siç bëri Rumiu[4] që na rrëfeu prej gjuhës së zemrës: "Afrohuni, afrohuni dhe bashkohuni me ne, se ne jemi populli që jemi lidhur me dashuri pas Zotit! Afrohuni, afrohuni përmes derës së dashurisë dhe bashkohuni e qëndroni me ne! Afrohuni, le të flasim me njëri-tjetrin nëpërmjet zemrave tona! Le të flasim në heshtje, pa veshë e pa sy! Le të qeshim së bashku pa gojë ose pa zë, le të qeshim së bashku si trëndafila! Ja mendimi, le të shohim çdo njeri tjetër që nuk nxjerr asnjë fjalë apo

[4] Mevlana Xhelaledin Rumi (1207-1273), poet i madh. Kryevepra e tij poetike është poema lirike mistike, Mesnevi.

tingull. Më pas ne jemi të gjithë të njëjtë, le t'i thërrasim çdo tjetri prej zemrave tona, ne nuk do të përdorim buzët ose gjuhën tonë. Si janë bashkuar duart tona së bashku, po ashtu të flasim dhe ne me zemrat tona të bashkuara!

Me kulturën e ditëve tona, nuk është e lehtë të dëshmosh kësodore një inteligjencë të thellë për këto ndjenja dhe vlera njerëzore; ne nuk mund t'i gjejmë lehtësisht këto në mendimin grek apo latin ose në filozofinë perëndimore. Mendimi islam e shikon çdo njërin prej nesh si një tregues të ndryshëm për një mineral të veçantë, si një aspekt të ndryshëm për një realitet. Në të vërtetë, popujt që janë mbledhur rreth pikëpamjeve të përbashkëta, të tilla si Zoti është Një, Profeti dhe feja, u ngjasojnë gjymtyrëve të një trupi. Dora nuk mund të kërkojë të krahasohet me këmbën, gjuha nuk mund të kritikojë buzën, sytë nuk mund të shohin shkarjet e veshëve, zemra nuk mund të përleshet me mendjen.

Siç jemi të gjithë gjymtyrë të një trupi të njëjtë, duhet ta shuajmë këtë dualizëm që prish pikërisht harmoninë tonë. Ne duhet ta pastrojmë udhën për të bashkuar njerëzit dhe kjo është një prej rrugëve të mëdha në të cilën Zoti u dhuron sukses njerëzve në këtë botë dhe kjo është rruga me të cilën Ai e shndërroi këtë botë në një parajsë. Duke ecur në këtë rrugë, dera e parajsës do të jetë e hapur dhe gjerësisht në gjendje të na japë një mirëseardhje të ngrohtë. Tani e tutje ne duhet t'i largojmë të gjitha mendimet dhe ndjenjat që na ndajnë dhe të nxitojmë të përqafojmë njëri-tjetrin me ndjenjën e dashurisë dhe bashkimit!

HUMANIZMI DHE DASHURIA PËR NATYRËN NJERËZORE

Dashuria nuk është vetëm një nga temat më të frekuentuara në diskutimet e ditëve tona, ajo është gjithashtu një prej debateve më esenciale. Në të vërtetë, dashuria është një trëndafil në besimin tonë, një mbretëri për zemrat që kurrë nuk vyshken. Mbi çdo gjë tjetër, vetëm Zoti i paanshëm e thur universin si dantellën në avlëmendin e dashurisë, muzika më mahnitëse dhe më magjiplote në gjirin e jetës është gjithmonë dashuria. Marrëdhënia më e fortë midis individëve që i jep formë familjes, shoqërisë dhe kombit është dashuria. Dashuria universale shfaqet vetë kudo në kozmos, në faktin që çdo pjesëz ndihmon dhe mbështet një pjesëz tjetër.

Kjo është e vërtetë në një shkallë të tillë që faktori më kryesor në thelbin e ekzistencës është dashuria. Si një zë i veçantë në korin universal, pothuajse veprimi dhe sjellja e çdo krijese në mënyrën e njohur të tij, në harmoni me motivin magjik që e ka marrë prej Zotit, është një melodi për dashurinë. Nëse ky shkëmbim me dashuri prej ekzistencës te ndjenjat njerëzore dhe prej një krijese në një tjetër, ka zënë vend përtej dëshirave të tyre, kjo ndodh sepse Vullneti Hyjnor i zotëron tërësisht ata.

Prej kësaj perspektive, njerëzimi "në mënyrë të ndërgjegjshme" merr pjesë në këtë simfoni që po luhet në ekzistencë. Nga shfaqja e dashurisë në natyrën e vet të vërtetë, qeniet njerëzore hetojnë se si mund ta demonstrojnë atë në një rrugë njerëzore. Prandaj, pa shpërdorimin e dashurisë në mendjen e tyre dhe për hir të saj në karakterin e tyre, çdo njeri duhet të ofrojë ndihmën dhe

mbështetjen e vet të vërtetë për të tjerët. Njerëzit duhet ta mbrojnë harmoninë e përgjithshme që ka qenë vendosur në thelbin e ekzistencës duke marrë parasysh si ligjet e natyrës, ashtu dhe ligjet që janë bërë për të administruar jetën njerëzore.

Humanizmi është një doktrinë për dashurinë dhe ndjenjat njerëzore, artikuluar në mënyrë të pamatur këto kohë dhe që ka një potencial lehtësisht të manipulueshëm nëpërmjet interpretimeve të ndryshme. Disa qarqe provojnë të imponojnë një kuptim të turbullt dhe abstrakt të humanizmit për popujt e hutuar prej xhihadit në Islam dhe dyshimeve të lindura në zemrat e tyre. Duhet të jetë e vështirë të përputhësh me humanizmin qëndrimin e çuditshëm të kampionëve të "mëshirës dhe dhembshurisë", për ata që janë përzier në anarki dhe terror për të shkatërruar unitetin e një vendi, me ata që kanë vrarë pa mëshirë njerëz të pafajshëm si një pjesë e veprimtarive shumëshekullore që synojnë shkatërrimin e mirëqenies për një komb dhe akoma më keq, për ata që e bëjnë këtë në emër të vlerave fetare, për ata të krisur që akuzojnë Islamin për lidhje me aktet terroriste.

Çdo besimtar duhet të ndjekë të Dërguarin e Zotit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, në kumtimin e së vërtetës. Ata kurrë nuk duhet t'i braktisin njerëzit që përcjellin parimin e lumturisë në të dy botët. Bashkëpunëtorët dhe shokët e Profetit, të cilët si një bashkësi, janë një shembull i gjallë i mishërimit të së vërtetës prej Profetit, janë bërë shembulli i maturisë dhe ekuilibrit në çdo çështje.

Disa njerëz të veçantë prej gjeneratës fatbardhë që menjëherë ndoqën sahabët, shkuan te Kalifi për të mësuar se si do ndëshkoheshin nëse aksidentalisht do të shtypnin një karkalec. Kur vështrojmë në muret e jashtme të xhamive dhe minareve tona që rrezatojnë dritë, shikojmë gropëza që janë bërë për zogjtë për të zënë vend në to, kjo është shprehje e thellësisë së dashurisë të të parëve tanë. Historia është ndërthurur me shumë akte të tilla

humane: vepra që mbrojnë kafshët si edhe njerëzit.

Në strukturën e parimeve universale të Islamit, shqyrtimi dhe mendimi për dashurinë është shumë i ekuilibruar. Shtypësit dhe agresorët e kanë mohuar këtë dashuri, sepse pikërisht shfaqja si e dashurisë, po ashtu edhe e mëshirës, i ka bërë shtypësit më agresivë, gjithashtu i ka inkurajuar ata të shkelin të drejtat e të tjerëve. Për këtë arsye mëshira nuk duhet të shfaqet te popujt që kërcënojnë dashurinë universale. Shfaqja e mëshirës për një shtypës është veprimi më i pamëshirshëm ndaj të shtypurit. Kështu, ne duhet të shfaqim mëshirë për ata që gabojnë pa dashje ose që ndjejnë pendim për gabimet e tyre. Profeti ka thënë: *"Ndihmoni vëllezërit tuaj nëse ata janë shtypës ose viktima. Ju mund t'i ndihmoni shtypësit duke i bërë ata të ndalojnë shtypjen e tyre!"*[5]

[5] Buhari, *Medhalim*, 4; Tirmidhi, *Fiten*, 68.

DASHURIA PËR ZOTIN[6]

Në këto ditë të zymta dhe fatzeza, kur zemrat tona janë mposhtur nga armiqësia, kur shpirtrat tanë janë të sëmurë, kur urrejtja dhe antagonizmi janë jashtë kontrollit, është e qartë si kristali që ne kemi nevojë për dashuri dhe mëshirë ashtu siç kemi nevojë për ujë dhe ajër. Ne më ngjan se e kemi harruar dashurinë dhe, për më tepër, dhembshuria është një botë që pak e njohim. Ne nuk kemi as mëshirë për njëri-tjetrin, as dashuri për njerëzit. Ndjenja jonë e dhembshurisë është zvogëluar, zemrat tona janë të ngurta dhe horizonti ynë është sterrë i zi nga armiqësia, është kjo arsyeja që ne e shohim gjithçka dhe gjithsecilin me zymtësi. Kudo në botë janë të shumtë tiranët që e urrejnë tolerancën dhe numri i atyre që e mallkojnë dialogun nuk është fare i vogël. Ajo çfarë bëjnë shumë prej nesh, është të kërkojnë mënyra për të luftuar, të nxijnë emrin e njëri-tjetrit me shpifje të ndryshme dhe ne shfaqim veten me dhëmbët tona, me kthetrat tona, me fjalët tona që bien era gjak.

Është një përçarje e tmerrshme midis individëve si edhe midis popujve. Gjykimet tona fillojnë me fjalët "ne", ju", dhe "të tjerët". Ne kurrë nuk duhet të tregojmë dhe përhapim urrejtje. Ne i përfundojmë grindjet tona të pështira duke treguar që do të vazhdojmë përsëri, ende mbajmë mëri që do të zgjohen në acarimin e ardhshëm. Ne jemi të ftohtë me një njëri-tjetrin dhe kjo ftohtësi ose ndarje është reflektuar në çdo veprim të jetës tonë. Si një trëndafilishte që shkatërrohet, ne shpërndahemi sa andej-këndej. Njëri-tjetrit i shkaktojmë vuajtje më të pakrahasueshme nga ç'bëjnë jobesimtarët.

Si një çështje në fakt, ne kemi braktisur Zotin dhe kështu, Ai na

[6] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në Örnekleri Kendinden Bir Hareket.

ka shpërndarë ne. Sepse ne nuk e besojmë dhe nuk e duam Atë në shkallën e duhur, Ai ka larguar ndjenjën e dashurisë prej zemrave tona. Ajo çfarë po bëjmë ne tani, thellë në pafundësinë e zemrave tona, ku ne jemi detyruar të durojmë përmallimin për Atë, është se po përhapim absurditetet egoiste "unë," "ti," po quajmë njëri-tjetrin "reaksionar," "mosbesues fanatik" dhe po prodhojmë vazhdimisht skenarë për të shfronësuar njëri-tjetrin. Kjo është sikur të jemi mallkuar, madje sikur të jemi privuar nga dashuria dhe të qenit i dashuruar, ndërsa jemi të dëshiruar për mëshirë, dhembshuri dhe lumturi. Ne nuk e dashuruam Atë, prandaj Ai e dërgoi dashurinë larg prej nesh. Nuk ka rëndësi sa gjatë jemi në pritje, Ai do të na bëjë të dashur me njëri-tjetrin vetëm nëse ne kthehemi tek Ai dhe e dashurojmë Atë. Ndonëse, ne jemi larguar nga burimi i dashurisë. Në të kundërt, ato po na dërgojnë larg prej Tij. Shpirtrat tanë, të cilët janë përdorur për të mbajtur rrëketë e dashurisë, nuk mbajnë asgjë tani. Zemrat tona janë si shkretëtirat pa ujë, guvat e botës sonë të brendshme ngjasojnë me strofkat e kafshëve të egra. Dashuria për Zotin është i vetmi mjekim për gjithë të këqijat tona!

Dashuria për Zotin është thelbi i gjithçkaje dhe burimi më i kulluar dhe i pastër për të gjitha dashuritë. Mëshira dhe dashuria vërshojnë në zemrat tona prej Tij. Çdo lloj i bashkëpunimit njerëzor do të ndërtohet në përputhje me marrëdhëniet tona me Atë. Dashuria për Zotin është besimi ynë, bindja jonë dhe shpirtrat tanë në trupin tonë. Ai na bëri të gjallë kur ne u krijuam. Nëse ne jetojmë sot, është vetëm nëpërmjet Tij. Esenca e gjithë ekzistencës është dashuria e Tij dhe fundi është shtrirja e dashurisë hyjnore në formën e parajsës. Ai ka krijuar çdo gjë të kushtëzuar në dashuri dhe ka lidhur marrëdhëniet e Tij me njerëzimin nga kënaqësia e shenjtë për qeniet e dashura.

Vendi ku shfaqet dashuria është shpirti. Për çfarëdo udhëzimi ne mund t'i drejtohemi atij, ai gjithmonë është i kthyer nga Zoti. Vuajtjet, e merituara prej çorientimit dhe humbjes në larmi, më

saktë në Unitetin e Zotit, janë tonat. Nëse e lidhim dashurinë tonë për gjithçka me Zotin dhe kështu, nëse jemi të aftë ta fitojmë dashurinë në kuptimin e vërtetë të saj, atëherë do të jemi larg prej gjërave që e dërrmojnë dashurinë dhe do ta shmangim partneritetin me Zotin. Pra, ne do të qëndrojmë porsi ata që ecën në udhën e vërtetë, me dashurinë dhe marrëdhëniet tona me të gjithë ekzistencën.

Idhujtarët i kanë konsideruar idhujt si diçka për t'u adhuruar vetëm sepse idhujt janë adhuruar prej paraardhësve të tyre. Zoti, në njërën anë, është i dashur dhe i adhuruar sepse është Zot. Fisnikëria dhe Madhështia e Tij kërkojnë prej nesh të jemi shërbëtorët e Tij. Ne gjithmonë përpiqemi ta adhurojmë Atë, të shfaqim dashurinë tonë për Atë, ta falënderojmë Atë për arritjet tona dhe të tingëllojë afeksioni ynë për Atë, marrëdhënia jonë me Atë dhe lidhja jonë me Të.

Në dashurinë e kësaj bote, aspektet si bukuria, përsosmëria, forma, harmonia në paraqitje, madhështia, fama, forca, pozita, gjendja shoqërore, begatia, familja, prejardhja, etj., të gjitha janë vlerësuar si argumente për dashurinë. Herë pas here, prej këtej njerëzit kanë rënë në gabimet e partneritetit me Zotin; ky është shpërblimi për dashurinë e tepruar dhe afeksionin e tyre për këto fenomene, gjë që mund të shpjegojë pse ekziston idhujtaria. Njerëz të tillë rëndom janë të dhënë pas fytyrës ose trupit të bukur, pas luksit të ambientit ku jetojnë, ku miratojnë përsosjen, gjunjëzojnë vetveten përpara shkëlqimit dhe madhështisë, sakrifikojnë humanizmin dhe lirinë e tyre për hir të luksit dhe pushtetit, duke u mburrur me makutërinë e tyre për pozitë dhe gjendje shoqërore. Në këtë rrugë, duke shpërdoruar afeksionin dhe dashurinë e tyre për vepra të pavlera, ata jo vetëm çojnë dëm emocionet e tyre, të cilat janë synuar të konsumohen së pari në marrëdhëniet me Zotëruesin e Vërtetë të Pasurisë dhe Fuqiplotin Absolut, por edhe përjetojnë vdekjen nga dashuria e pashkëmbyer, ose nga indiferenca dhe pabesia për të dashurit e tyre.

Përsa u përket besimtarëve, në anën tjetër, ata e duan Zotin para çdo gjëje tjetër dhe ndjejnë dhembshuri për të tjerët përmes dashurisë për Atë. Për arsye të manifestimit dhe bekimit nga Një i Vetmi, ata mbajnë lidhje me çdo njeri dhe gjithçka tjetër, deklarojnë dashurinë e tyre dhe janë mirënjohës për gjithë të mirat në emër të Tij.

Sigurisht, pa marrë Zotin në konsideratë, çdo dashuri për këtë ose atë objekt është e kotë, e pashpresë, e pavendosur dhe e pafrytshme. Mbi gjithçka, një besimtar duhet të dashurojë Atë, dhe ka një qëndrim pozitiv ndaj të tjerëve vetëm sepse ata janë manifestime dhe pasqyrime plot ngjyra të Atributeve dhe Emrave Hyjnorë të Tij. Po ashtu, njeriu duhet t'i mirëpresë këto gjëra me një admirim të madh dhe çdo herë që një person vështron gjëra të tilla, duhet të mendojë se edhe ato janë prej Zotit, duke përjetuar, kështu, një periudhë tjetër bashkimi me të Dashurin. Për këtë, ne kemi nevojë për njerëz të pastër dhe të virtytshëm që mund të lexojnë argumentet dhe provat e Zotit në fytyrë të njerëzve. Vërtet, për ata që mund të analizojnë, çdo krijesë është një pasqyrë e shkëlqyer dhe një mburrje e shkruar në varg të madh, mbi gjithçka tjetër është pamja njerëzore, pasqyrim i sekretit të Mëshiruesit.

Zoti i vërtetë ju bëri ju pasqyrë të vetes së Tij / Një pasqyrë për Veten e Tij të Vetme! - Hakani

Sa kuptimplote vargjet më sipër. Jo vetëm për të na kujtuar pozicionin tonë, por edhe pse nxjerrin në pah të vërtetën. Nëse një qenie njerëzore është një pasqyrë e mistershme e Bukurisë së Fshehur (Zotit), që është në të vërtetë, pa asnjë dyshim, modeli, pra një njeri duhet të kthehet tek Ai me sytë dhe zemrën, mbështetur në pritje të shfaqjes së dëshmive dhe në kërkim të erërave që do ta marrin atë në banesën e dashurisë së thellë. Gjithashtu, me qëllim që të kënaqim Atë dhe kështu të bëhemi të vlerësuar prej Tij, njeriu duhet të përdorë çdo mjet në dispozicion në rrugën drejtuar nga intimiteti i Tij. Si një çelës në bravë për Thesarin e Fshehtë, zemra

e tij apo e saj duhet mbajtur në lëvizje gjatë gjithë kohës. Si e tillë, nëse dashuria është Solomon dhe zemra është froni i Solomonit, kuptohet pa fjalë që mbreti do të ngjitet në fron herët ose vonë.

Kur Solomoni ngjitet në fron, ose me fjalë të tjera, kur dashuria takohet me zemrën, njeriu gjithmonë mendon për Atë, flet me Atë në botën e tij të brendshme dhe shijon bekimin e Tij, hapur dhe qartë, në ujin që pi, në ushqimin që shijon dhe në ajrin që thith. Për më tepër, njerëzit ndjejnë ngrohtësinë e intimitetit të Tij në të gjithë veprimet e tyre. Marrëdhëniet ndërmjet dashurisë dhe tendencës për t'u mbyllur në vetvete thellohen dhe zemrat e tyre fillojnë të digjen si zjarr. Gjatë kësaj kohe, ata janë djegur prej zjarrit të dashurisë dhe ende asnjëri prej tyre nuk ka qarë dhe në këtë mënyrë, nuk kanë lodhur kurrë të tjerët me jargavitjet e tyre. Në kontrast me këtë, të tillë njerëz e konsiderojnë dashurinë të jetë një dhuratë nga Ai. Ata digjen si një furrë pa tym dhe flakë. Me pastërti, ata ruajnë gëzimin e tyre dhe dashurinë për Zotin dhe kurrë nuk i tregojnë sekretet siç bëjnë shumë njerëz të pamatur.

Kjo rrugë është e hapur për gjithsecilin. Megjithatë, është thelbësore që udhëtari të jetë i sinqertë dhe i përkushtuar. Nëse besimtarët zbulojnë që gjithçka që nga bukuria, përsosja, madhështia, epërsia, shkëlqimi, i përkasin Zotit, atëherë ata kthehen tek Zoti me të gjithë dëshirën, dashurinë dhe mëshirën që buron nga qëndrimi i tyre dhe e duan Zotin me një dashuri që është e përshtatshme për Lartësinë e Tij. Kjo dashuri, nëse nuk është pasion, është për Atë dhe është burimi për dashurinë dhe dëshirat njerëzore në një formë të njësuar. Më në fund, në një zemër që është kufizuar në uniformitetin dhe që mbështetet në parimet islame, asnjëherë nuk mund të vëzhgojë kurrë një deviacion, e jo më ndonjë çrregullim prej dashurisë. Besimtarët dashurojnë Zotin sepse Ai është Zot, dhe dashuria e tyre për Zotin nuk është marrëdhënie me çdo tokësor apo konsideratë e pashpjegueshme. Ata filtrojnë dhe provojnë rrëketë e burimeve të dashurisë dhe ujëvarat e dëshirave të tyre për Zotin me Kuranin

e Shenjtë dhe parimet e njeriut më të lartësuar[7]. Njerëzit e tillë e përdorin këtë si një pengesë për gabimet njerëzore në udhën që ata ndjekin. Madje, në kohën që janë djegur plotësisht nga zjarri i dashurisë, ata veprojnë me ndershmëri dhe drejtësi. Në dashurinë e tyre ndaj Zotit kurrë nuk ka vend për hamendje apo supozime. Përkundrazi, lidhur me Atë si Zot i Vërtetë dhe Mbrojtës për gjithçka, i cili është i njohur me emrat dhe atributet e tij hyjnore, ata e duan Zotin me gjithë zemër, me dashuri të pastër, të shenjtëruar dhe nderuese.

Besimtarët e duan Zotin më tepër se çdo gjë, si pararendësin dhe pasojën e gjithçkaje, si të Dashurin e Vërtetë, të Dëshiruarin e Vërtetë dhe të Adhuruarin e Vërtetë. Ata e dëshirojnë Zotin dhe gjatë çdo veprimi të mundshëm tregojnë që janë shërbëtorë të Zotit. Për hir të këtij devocioni, ata duan në radhë të parë profetin Muhamed, Krenarinë e Njerëzimit, i cili ishte pasuesi besnik, interpretuesi i vërtetë i esencës së Zotit, i emrave dhe i atributeve të Tij, fundi i vargut të profetëve dhe kryesori prej lajmëtarëve, paqja dhe bekimi qofshin mbi të! Duke e ndjekur atë, ata i duan të gjithë profetët dhe njerëzit e tjerë të shquar për shenjtërinë që treguan duke u bërë zëvendës të vërtetë, shembujt më të pastër dhe shërbëtorët më të sinqertë të Zotit të Plotfuqishëm, të cilët u ngarkuan me parashtrimin e qëllimeve hyjnore dhe mbikëqyrjen e projektimit, ndërtimit dhe sistemimit të kësaj bote. Mandej ata ju duan ju, për këtë janë këshilluar prej Zotit, si një besim i ofruar për njerëzimin në mënyrë që ata ta kuptojnë dhe vlerësojnë më mirë këtë botë të përkohshme. Pas kësaj, ata duan këtë botë sepse është toka ku mbillet e ardhmja e botës tjetër dhe gjithashtu një manifestim i Emrave të Tij të Bukur. Pastaj ata duan prindërit e tyre, heronjtë e dhembshurisë dhe mëshirës, për përgjegjësitë që ata marrin për të rritur dhe përgatitur fëmijët e tyre. Në fund ata duan fëmijët, sepse ata i mbrojnë me sinqeritet prindërit e tyre si dhe kanë një lidhje të ngushtë me ta. Të gjitha këto mund

[7] Profetit Muhamed, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të!

të vlerësohen si shenjë e ndjenjave të zemrës për Zotin dhe e dashurisë për hir të Zotit.

Jobesimtarët i duan njerëzit gjoja se ata janë të dashur pas Zotit, ndërsa besimtarët i duan njerëzit për hir të Zotit; këto janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra. Ky seleksionim për Zotin, orientuar prej dashurisë, i cili është provuar përmes besimit dhe lutjeve, është i vetmi për besimtarët e përsosur. Ndërsa dashuria fizike bazohet në kryeneçësinë dhe në mungesën e vetëpërmbajtjes që janë tregues të mëkatit dhe mosbindjes fshehur në natyrën e njeriut, dashuria për Zotin dhe shprehjet e të dashuruarve për Zotin janë si një bar i shenjtë që engjëjt dëshirojnë ta pinë. Në qoftë se kjo dashuri rritet në një shkallë të tillë që të dashuruarit braktisin çdo gjë, qoftë materiale ose shpirtërore, për hir të të Dashurit, duke mos lënë asgjë për veten e tyre, atëherë kjo dashuri është vetëm nderim për të Dashurin në zemër. Zemra e mbërthyer vetë me këtë nderim, rreh në përputhje me dashurinë, ndërsa sytë e shprehin këtë dashuri me lot. Zemra qorton sytë për nxjerrjen e sekretit dhe kraharorin, për qetësinë. Me lot në sy dhe i gjakosur përbrenda, ai nuk provon të lërë të tjerët të zbulojnë agoninë e tij dhe shprehet: *Ju kërkoj të jeni me dashuri, pastaj nuk pikëllohem për gjëmën nga dashuria / Mos i lini të tjerët në vuajtjet tuaja prej dashurisë.* - Anonim

Në të vërtetë, dashuria është një mbret, zemra është një fron dhe rënkimet prej shpresës, malli i shqiptuar në sexhde në skajet më të largëta të zemrës, janë zëri i këtij mbreti.

Kurrë një njeri nuk duhet t'i lejojë të tjerët të bëhen dëshmitarë të rënkimeve të veta prej skajeve më të largëta të zemrës, të cilat janë në fakt bazat e nisjes së afrimit me Zotin, si rrjedhim të padituritanë shmangen nga mundësia që të tjerët të dëfrejnë me ta. Nëse kjo dashuri e mahnitshme është për të Gjithëditurin, ajo duhet mbajtur sa më privatisht, jo të fluturojë larg nga çerdhja e saj.

Energjikë për dashuritë e tyre të rëndomta, të dashuruarit e

zakonshëm bredhin andej-këtej dhe, duke vepruar si të marrë, e deklarojnë dhe e bëjnë të qartë për të gjithë dashurinë e tyre. Të dashuruarit me Zotin, në njërin krah, janë të çiltër dhe të thjeshtë. Me kokat mbështetur tek pragu i Zotit, ata shfaqen thjesht tek Ai. Herë pas here ata zbehen, por kurrë nuk e zbulojnë sekretin e tyre. Ata janë në shërbim të Tij me duart dhe këmbët e tyre, me sytë dhe veshët, me gjuhën dhe gojën dhe enden në zonën e Atributeve të Tij Sublime. Të kredhur në Dritën e Tij për qeniet, ata shkrijnë dhe treten si një i vdekur në dashurinë e Tij. Aq sa e ndjejnë dhe e dëshirojnë Zotin, ata digjen dhe thërrasin: "Më shumë!" Thirrja i bën të ndjejnë deri në skaj të zemrave të tyre dhe vazhdojnë të qajnë, por duan "më shumë"! Ata kurrë nuk janë të kënaqur me dashuri megjithëse dashurojnë dhe janë të dashuruar. "Më shumë!" - vazhdojnë të përsërisin. Dhe pasi ata vazhdojnë të kërkojnë më shumë, i Dashuri i Ndritshëm zbulon botët për ta, drejton njohuritë e tyre drejt gjërave të pashfaqura kurrë më parë, dhe gjithashtu pështpërit për shpirtrat e tyre më tepër se një sekret. Më pas është kuptimplote ajo që ndjejnë ata, ajo që dashurojnë ata dhe ajo që ata mendojnë për atë ç'ka bërë Ai. Në çdo gjë kuptojnë që kanë gjetur shfaqjen e hijshme të Bukurisë së Tij. Duke lënë plotësisht fuqinë e tyre në vullnetin e Tij, në një kohë të caktuar ata bashkojnë dëshirat e tyre me forcën e Tij, shkrihen në kërkesat e Tij dhe e çmojnë këtë pozitë të lartë në raport me atë që sa dashurojnë dhe janë dashuruar, sa kuptojnë dhe sa janë kuptuar. Me besnikërinë dhe bindjen për Atë, ata shprehin dashurinë e tyre. Ata kanë mbyllur për të tjerët derën e zemrave të tyre me guxim dhe një guxim i tillë është një mënyrë e sigurt që asnjë i panjohur të mos futet kurrë, që shtëpia të jetë e pastër. Me gjithë qeniet e tyre, ata janë dëshmitarë të Zotit, lavdërimi dhe mirënjohja e tyre për Zotin është larg, përtej aftësive të tyre për të kuptuar!

Besimi i tyre, në krahun tjetër, në përgjigjen e Zotit lidhur me një besnikëri të tillë, është i patundur. Vendi i tyre në qëndrimin e Zotit është në përpjesëtim me praninë e Tij në zemrat e tyre,

prandaj bëjnë përpjekje për të qëndruar të ndershëm para Tij!

Kur ata e duan Atë thellësisht, nuk veprojnë kurrë si një kreditor, në të kundërt, ata janë si të zënë ngushtë, si një debitor. Siç tha Rabia Adevije[8], "Unë betohem në Qenien Tënde të Shenjtë që nuk kam adhuruar kërkesat e Tua për Parajsën. Më saktë, unë të dua Ty dhe bashkova robërinë me dashurinë time për Ty!" Në këtë mënyrë, ata ecin me dashurinë që derdhet në drejtim të Mbretërisë së Tij, duke pasur bekimin e Tij dhe mirësjellje në mendje. Me zemrat e tyre, ata vazhdimisht përpiqen të qëndrojnë plotësisht me Të, dhe me aftësitë dhe intelektin e tyre, ata vëzhgojnë fenomene në pasqyrat e Emrave Hyjnorë. Ata dëgjojnë zërin e dashurisë në çdo gjë, janë magjepsur prej aromës së luleve dhe e konsiderojnë çdo pamje të bukur si një pasqyrim të Bukurisë së Tij. Gjithçka dëgjojnë, ndjejnë ose mendojnë për Atë, nuk është asgjë tjetër veçse dashuri, si rezultat i së cilës ata e vështrojnë ekzistencën e tërë si një demonstrim të dashurisë dhe, përsëri, e kuptojnë atë si një harmoni për dashurinë.

Kur dashuria ka ngritur tendat luksoze të saj në luginat e zemrës, të gjitha kundërshtitë ngjajnë të jenë të njëjta, të tilla si paqetrazira, bekim-gjëmë, nxehtë-freskët, komoditet-varfëri, dhimbje-kënaqësi, të gjitha tingëllojnë njëlloj dhe vështrojnë në të njëjtën rrugë. Sigurisht, për zemrat e dashuruara, vuajtja nuk ka ndryshim nga kënaqësia. Tek ata, vuajtja është një mjekim i vërtetë, prandaj pinë nga dhembja dhe agonia siç pinë nga lumenjtë e Zotit. Nuk ka rëndësi se sa pa mëshirë ikin kohët dhe ndodhitë, ata qëndrojnë akoma me një ndjenjë të thellë devotshmërie. Me sytë mbërthyer tek dera në pritje që të hapet për të mirëpritur disa tregues dhe kënaqësi në dimensione të ndryshme. Ata kurorëzojnë dashurinë e Tij me vlerësimin e tyre dhe gjithashtu i binden Atij. Zemrat u rrahin me përulje dhe dridhen me të drejtë prej frikës se mos i Dashuri nuk i dëgjon. Që zemrat të mos u frigohen, për ironi,

[8] Rabia Adevije (703-805 e.r.), një zonjë e shquar nga Basra. Gjithë jetën ia pati kushtuar shërbimit për fenë. Megjithëse e pasur, pati parapëlqyer jetën e thjeshtë e të përkorë.

ata përsëri gjejnë strehë në Burimin e Vetëm të përkrahjes dhe ndihmës. Duke hulumtuar në këtë mënyrë për mirëkuptim dhe pranim te Zoti, ata bëhen të kërkuar për të gjithë si në këtë botë, ashtu edhe në botën e përtejme. Vëmendja e tyre është përqendruar tek Zoti dhe askund tjetër. Për ata, të presësh diçka si shkëmbim është një mënyrë për të mashtruar, prandaj ata gjykojnë se nuk është e pahijshme të pranosh bekimin e pakërkuar si shpërblim. Bekimi për ta është një vlerësim i lartë por, me maturi, secili prej tyre rënkon: "Unë gjeta strehë tek Ti prej tundimit të tyre!"

Një i dashuruar kulmon me një dëshirim përvëlues duke humbur në etjen dhe dëshirat e tij që janë më të paarritshmet. Dashuria është krijuar me parime elementare, të tilla si pendesa, gatishmëria dhe durimi, ndërsa më rrallë shfaqen gjakftohtësia, mirëbesimi, pasioni, përmallimi dhe principe të tjera të nevojshme që janë në gjendje të meritojnë këtë pozicion. Leksioni i parë në udhën e dashurisë është pastrimi, të heqësh dorë nga dëshirat personale, t'i lidhësh të gjitha mendimet dhe marrëdhëniet e tua me Të, të jesh i zënë me gjërat që udhëzohen prej Tij, të presësh me shpresë në rastet e shfaqjes së Tij dhe, gjithashtu, të qëndrosh i vendosur gjatë gjithë jetës se Ai do të kthehet te ti një ditë. Në këtë udhë, dashuria nënkupton që të jesh i marrë pas saj. Afshi bën të derdhet pasioni, entuziazmi dhe dëshira dhe kur afshi bëhet natyra e vërtetë e njerëzve, atëherë ky është përmallim. Mirëkuptimi është pikë takimi për çdo veprim që bëhet me kënaqësi për të Dashurin. Vetëpërmbajtja është bërë e kujdesshme kundrejt dehjes me bekimet për provën dhe prekjen e Pranisë së Tij ose të udhëzimit të drejtpërdrejtë të Tij.

Shumë njerëz zhvillojnë në vetvete një prej cilësive si më sipër dhe ndryshime më të mëdha mund të jenë dëshmuar në sjelljen e tyre. Herë pas here ata kërkojnë qetësisht hapësirat ku mund të besojnë në Atë. Nganjëherë, nën ndikimin për një larmi gjykimesh, ata flasin për Atë dhe shprehin ankesën e tyre lidhur me dallimet. Ata mbushen me gëzim duke pritur bashkimin dhe qetësohen me

lotët e lumturisë. Gjatë kësaj kohe, nuk shohin se ç'ndodh rreth tyre, për përvojën e tyre bashkimi është larmi dhe herë pas here, ata humbin në respektin dhe frikën nga paqja dhe nuk mund të përputhin dëgjimin me zërat e tyre.

Dashuria rritet dhe zhvillohet në gjirin e diturisë. Dituria është ushqyer prej dijeve hyjnore. Ata të cilët nuk janë të ditur, nuk mund të dashurojnë gjithçka. Dhe ata që për më tepër kanë një këndvështrim të dobët, nuk mund të arrijnë kurrë diturinë. Hera herës, vetë Zoti ngulit dashuri në zemra dhe aktivizon mekanizmat e fshehtë, një bekim veçanërisht për njerëzit larg nga Ai. Megjithatë, mbështetja në mrekulli përrallore dhe pritja e pafuqishme është njëra anë, një pritje aktive në lidhje të pafund është plotësisht diçka e ndryshme. Shërbëtorët besnikë në hyrjen për tek Një i Vetmi, vënë shpresën e tyre në veprim, zënë një pozicion dinamik dhe, për pasojë, ata përftojnë meqë në dukje pozicionet kanë ende mjaft energji të mjaftueshme për mbarë universin, materializimin e aktivitetit madhështor.

Këta njerëz janë të dashuruar besnikë, mishërim i sigurt i karakteristikave që duhen për një dashuri të tillë. Ata në çdo veprim takohen me të Dashurin, me kënaqësi dhe besnikëri të shfaqur gjatë gjithë kohës, si të ishin duke përsëritur Nesimin:[9] *Një dashnor i dëshpëruar, unë nuk dua, o i Dashur, të të braktis Ty / Unë nuk dua të ndodhë kështu edhe nëse e shqyen zemrën time me një kamë!*

Pavarësisht nga fakti që ata gjithmonë dëshirohen përnjëmend për Shoqërinë e Tij, kurrë ndonjëherë nuk ndodh që të qahen. Ata largojnë prej mendjes të gjitha parashikimet që nuk janë për Atë dhe mendojnë vetëm për Praninë e Tij. Kuvendimet e tyre bëhen për të Dashurin dhe, në këtë mënyrë, zërat e tyre fitojnë një thellësi engjëllore.

Për ata, dashuria është gjithçka. Ata mund të mbijetojnë pa

[9] Nesimi (vd. 1404 e.r.). Poet i famshëm mistik nga Bagdati; ndër mjeshtërit e parë të letërsisë së Divanit.

trupat e tyre, por pa shpirtrat, nuk munden. Në zemrat e tyre nuk ka dhomë për të tjerët, kështu besojnë ata, por vetëm për dashurinë për të Dashurin. Si të tillë, edhe nëse janë më të varfrit dhe më të pafuqishmit në botë, ata mbajnë një status të lakmueshëm edhe nga mbretërit. Ata janë të mëdhenj në vogëlsinë e tyre, të fuqishëm në pafuqinë e tyre, mjaft të pasur në varfërinë e tyre për të merituar mbarë universin. Ndonëse ngjajnë si një qiri i vockël, ata janë një burim i pasur energjie i mjaftueshëm për të ndriçuar yjet. Edhe nëse të gjithë kanë vrapuar në drejtim të të dashurve besnikë, janë ende larg nga vendi për të cilin të dashurit kanë rendur. Me pasuri për cilësitë e tyre të domosdoshme, ata kapërcejnë universin e tërë. Por kur kthehen në drejtim të Tij, ata bëhen një thërrime, madje më pak, bëhen asgjë sepse kanë harruar gjithçka që lidhet me ekzistencën e tyre.

Një jetë pa Atë ngjan e vogël për ata. Një jetë pa Atë nuk është jetë fare. E rëndësishme është që një jetë pa dashuri është një jetë e shkretuar dhe gëzimet dhe kënaqësitë që nuk janë lidhur me Atë, nuk janë asgjë veçse ilaçe të rremë. Ata bisedojnë pa pushim rreth dashurisë e mallit dhe kujdesit për ata të cilët nuk janë mësuar me këto nocione si qenie disi më ndryshe.

APEL PËR MËSHIRË [10]

Është haptazi e qartë që ata të cilët nuk bëjnë pjesë në të njëjtat vlera të trashëguara nga e kaluara, ose të cilët nuk mbështeten në të njëjtat burime ashtu si edhe ne, nuk janë të përshtatshëm për të çmuar dhimbjen tonë. Ne mund t'i ndihmojmë ata vetëm nëse janë vënë në mendime nga sjellja jonë në përgjithësi. Në fakt, për ata të cilët e vështrojnë të sotmen dhe të ardhmen vetëm nga pikëpamja materialiste dhe që e trajtojnë jetën thjesht sipas aspektit fizik të tyre, nuk është e mundur të ndjejnë ose të shijojnë gjë tjetër veç kënaqësive të përcipta dhe kalimtare të trupit. Dhe, përsëri, në lidhje me të njëjtin vështrim të zvetënuar, çështjet nuk kanë lidhje me realitetin fizik ose, e thënë ndryshe, trupi nuk ka asnjë kuptim. As e kaluara dhe as e ardhmja nuk përmbajnë ndonjë domethënie. E kaluara dhe e ardhmja janë thjesht strehë në të cilën ata që kanë humbur të sotmen, mund të gjejnë mbrojtje. Ajo që njerëz të tillë e konsiderojnë si thelbësore, është e sotmja, çfarë ekziston përtej saj, e shohin si djerrinë të kohës. Vërtet, këta njerëz, të burgosur në një perspektivë të tillë të kufizuar, nuk janë të gatshëm të kuptojnë thënie të tilla si, "*Nëse ju do të dinit ato* që di unë, do të qeshni*t rrallë dhe do të qanit shpesh.*"[11] Megjithatë, Mbreti i botëve, Profeti, e dinte mirë pse e kishte thënë, pikërisht për pjekurinë e mendjeve të tyre, i mbushur vetëm me besim, dije dhe dashuri hyjnore dhe i përgatitur me armatimin e tyre për amshim, gjithashtu në dijeni pse ata po qanin dhe çfarë po kërkonin. Janë shumë arsye që i bëjnë të tillë njerëz të qajnë.

Si besimi, ashtu edhe qetësia e gjetur - një problem për të cilin çdokush është i interesuar - apo rreziku për qeniet e mbytura në

[10] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *Isigin Göründügü Ufuk*.
[11] Buhari, *Kusf*, 2; Muslim, *Kusf*, 1; Tirmidhi, *Zuhd*, 9; Ibni Maxhe, *Zuhd*, 19.

mosbesim, janë një mizëri problemesh që kërkojnë zgjidhje sociale, ekonomike, politike, dhe kulturore. Janë çështje që padrejtësisht janë konsideruar të jenë burimi i turbullimit të shoqërisë. Janë të drejtat që kanë nevojë të rirespektohen dhe rishpërndahen në harmoni me vlerat humane dhe përgjatë parimeve të drejtësisë dhe ndërgjegjes. Janë shpresat dhe idealet tona të lidhura me amshimin dhe në kundërshtim me këto, janë pengesat antidemokratike që nuk mund të jenë duke soditur, si edhe propaganda e pushtetit. Në shumë vende, akoma emocionet dominojnë mbi arsyen dhe urdhrat jepen në përputhje me çmendurinë e pushtetit. Në shumë pjesë të botës, gabimet njerëzore dhe aktet që janë konsideruar të gabuara fshihen akoma me gjak dhe lot. Njerëzit, kohë pas kohe, tërhiqen me forcë nga drejtimi i parajsës, ose shtyhen me dhunë në drejtim të ferrit, nga forca e vullnetit të tyre dhe opinionet e shpërfillura. Kampe të reja ngrihen çdo ditë, çdo ekip lufton për perspektivën ose për urdhrat e tyre, çdo ideologji pasqyron një mënyrë jetese që u shkon për shtat parimeve të tyre. Për më tepër, njerëzit janë detyruar të përshtaten në këtë kornizë të ngushtë dhe të jetojnë në përputhje me të. Anembanë botës, në qindra vende, ndërgjegjjet personale janë akoma ndjesi të shtypura, dëshira për bashkësi është akoma krijesë e injoruar dhe sytë e ndërgjegjes janë akoma krijesa të verbuara.

Në fakt, rruga më e shkurtër për të lehtësuar dhimbjet e tyre dhe për t'i shpëtuar nga shtypja shoqërore dhe personale, është të ndërpresësh manipulimin me ndërgjegjen e tyre dhe t'u tregosh atyre si të jetojnë me vetëdijen dhe vullnetin e vet. Vërtet, vetëm kur mekanizmi i ndërgjegjes është mbajtur gjallë dhe forca e vullnetit dhe vetëdija janë respektuar në shoqëri, ka qenë e mundur që njerëzit të jenë mirëdashës dhe të jenë orientuar në drejtim të vlerave humane. Individët mund të vlerësohen si qytetarë të vërtetë vetëm kur jetojnë me ndërgjegjen dhe forcën e vullnetit të vet, kështu që rritja e maturuar është e mjaftueshme për të ndihmuar shpirtërisht të tjerët. Ndryshe, shoqëria është e

goditur pashmangshmërisht nga një larmi problemesh sociale, politike, administrative dhe ekonomike. Një komunitet, që është parapërgatitur në mënyrë të pamjaftueshme, i pathemeltë ose me modele të arnuara së bashku, nuk mund të quhet një komb. Gjithashtu, një popull që paraqitet si një komb, i cili megjithatë është zhvlerësuar përtej rimëkëmbjes, nuk mund të premtojë një të ardhme të ndritur. Nëse ne duam shërim si një shoqëri e tërë është thelbësore që të gjithë individët të jenë të gatshëm dhe të motivuar. Ylli i fatit të mbarë për shoqërinë tonë do të shfaqet çuditërisht në një formë lehtësuese nëse ne do të lutemi për shpëtimin e të tjerëve sup më sup, me duart tona hapur drejt qiellit.

Esenca e parimeve themelore, që na ndihmon të arrijmë pjekurinë e duhur, është kompozuar për qeniet tona të vetëdijshme për besimin me gjithë thellësitë e posaçme të tij, për nënshtrimin ndaj dhimbjeve dhe përpjekjeve në adhurimin tonë, për të qenë me etikë në të gjithë veprimtarinë tonë, për të qenë shpirtërisht, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe ndjeshmërisht të rivitalizuar dhe për të dërrmuar çdo gjë kundër drejtësisë së zemrës. Të ndriçuar, ne do të kapërcejmë kufijtë e individualitetit, do të pretendojmë në përputhje me këto parime dhe gjithashtu, do të jemi të vetëdijshëm për gjërat që kërkojmë. Duke shkuar një hap më përpara, ne do të jemi në gjendje të lidhim çdo gjë me amshimin dhe të vlerësojmë gjithçka me kriteret supreme. Kështu që, pjesëmarrës në të gjithë avantazhet e natyrës njerëzore, ne do të jemi të aftë edhe njëherë tjetër të shprehim përshtatshmërinë tonë "në formën dhe natyrën më të përsosur" siç jemi ne, njerëzit. Unë besoj që të bekuarit tanë që e kuptojnë këtë pikëpamje kryesore, nuk do të orvaten vetëm të drejtojnë të tjerët në udhën e drejtë, por gjithashtu do të garantojnë edhe të ardhmen e tyre.

Unë e ndjej për detyrim ta ripërsëris për shpjegim që projektet personale të cilat nuk janë të planifikuara të ndihmojnë komunitetin, janë të dënuara që të dështojnë. Përveç kësaj, nuk është e mundur të ringjallen vlerat që janë rrënuar në zemrat për

individualitet në shoqëri, në ndërgjegje ose në forcën e vullnetit. Pikërisht, planet dhe projektet për rrugëdalje personale që janë të shkëputura nga përpjekjet e shpëtimit për të tjerët, nuk janë gjë tjetër veçse një iluzion, prandaj edhe synimi për arritjen e suksesit të paralizuar tërësisht nga vetëdija individuale, është një fantazi.

Në këtë frymë, ne besojmë që, duke u qartësuar në vetëdijen dhe vullnetin tonë për faktin që gjithsecili e ka veten në duart e veta, por duart duhet të jenë të bashkuara, ne të mund t'i zgjidhim të gjitha problemet me një ndërgjegje dhe vullnet të përbashkët. Duke u sjellë në këtë mënyrë, ne shpresojmë të mbajmë dhe madje të shtojmë, shterpësinë e jetëve tona individuale ndërsa u tregojmë të tjerëve eliksirin e jetës dhe prandaj me siguri rriten vlerat tona fizike e shpirtërore. Për ne, plani më shumë se vetëmohues ose një përpjekje, është drejtuar në më të shumtën për ardhmërinë e të tjerëve, kështu ai është më i qëndrueshëm dhe më premtues. Kjo është e vërtetë sepse ajo çfarë e mban një njeri në jetë, është synimi për të lartësuar të tjerët. Në kundërshtim me këtë, është interesi vetjak që vret ose paralizon krijesat njerëzore. Ata që rrënojnë jetën e tyre në kërkim të interesave personale janë herët ose vonë të zvetënuar, ndonëse nuk janë përfshirë medoemos në veprimtari të ndyra. Ata që kanë qëndruar në jetë, të motivuar për zgjimin e të tjerëve, ecin të sigurt të pajisur me eliksirin e jetës, atje ku gjithë të tjerët janë hedhur përreth si krijesa të braktisura. Të tillë janë njerëzit që janë caktuar me "kënaqësi" në këtë maratonë për të fituar vend në këtë botë dhe në tjetrën.

Shoqëria, për politikanin i cili ngjan të ketë miratuar ekzistencën dhe të drejtat e jetës për të tjerët vetëm sepse ata i shërbejnë interesave personale të tij apo të saj, kurrë nuk mund të jetë e besuar, ose ndokush të jetë i pacenueshëm kur politikanë të tillë janë kundërshtarë. Njerëz të tillë mendojnë gjatë gjithë kohës për interesin e tyre personal. Kjo është arsyeja që i bën ata të lajkatojnë dhe t'i nënshtrohen vetvetes për tekat ndaj njerëzve të tjerë. Njerëz të tillë i shtypin, po të jetë nevoja edhe ata për të cilët kanë nevojë

edhe ata me të cilët kanë komplotuar vazhdimisht. Kur vijnë në pushtet, këta tiranë janë të pamëshirshëm, kurse kur bien nga fuqia, fillojnë të përulen dhe të lëpihen. Sepse janë vazhdimisht të pasinqertë, ata janë përgjithësisht të dërrmuar nga mashtrimet e veta, duke përgatitur të keqen e tyre dhe fundin e zi. Ata shtyjnë vetveten të besojnë që janë gënjyer dhe mashtruar nga çdokush dhe që po bëjnë më të mirën. Këta politikanë të gjorë, ndonëse e kanë vënë veten në një pozitë të jashtëzakonshme, shkatërrojnë reputacionin e tyre për hir të karrierës. Një intelekt i tillë i gënjeshtërt, dëshmuar në disa njerëz, është një çrregullim shumë serioz dhe një sëmundje psikologjike e pashërueshme. Njerëzit e këtij soji, përpiqen gjithmonë për interesat personale, pavarësisht nga fakti që nuk vlejnë për asgjë. Pavarësisht përpjekjeve, ata nuk mund të fitojnë një reputacion apo autoritet në karrierën e tyre, por përfundojnë të përulur, të rrahur e të shkelmuar.

Në anën tjetër, çfarë shtrihet në rrënjët e sjelljes së njerëzve për të ndihmuar të tjerët, është një kohë e gjatë me vuajtje të shumta, ndjekur prej një apeli për mëshirë, që ka si synim kërkimin e të drejtave njerëzore. Ky apel pothuajse gjithmonë shtrihet përtej përgjegjësive individuale, tejkalon kufijtë e dijeve për përgjegjësitë shoqërore me një sinqeritet të thellë dhe është një mision i përshtatshëm për zemrën e një njeriu. Njerëzit me zemër të madhe janë të parët në çdo akt humanitar, reflektojnë sjelljen e tyre në vendet e punës dhe janë të hapur e të ndershëm gjatë gjithë jetës. Edhe pse rrethanat mund të jenë jo të favorshme dhe të padurueshme, njerëzit e tillë janë të vendosur të mos shmangen nga rruga në të cilën janë drejtuar dhe mbështetur në parimet e tyre, ata nuk ndjehen të humbur. Me gjithë ndjenjat e tyre, ata janë programuar ta shikojnë dhe ta dëgjojnë Zotin në një drejtim të sigurt, ta njohin dhe të jenë me Zotin. Këta njerëz u përkasin të dy botëve, pasi duke bashkëpunuar me të tjerët, nga këndvështrimi i lartpërmendur, mund të konsiderohen se janë lidhur me Zotin. Me sa duket, është e mundur të vëzhgosh zenitin e botës së

përtejme nga kjo zgjedhje e interesave tokësore. Për më tepër, jeta e këtyre njerëzve, me gjithë peripecitë e saj, është mjaft e kthjellët dhe e pakufizuar për të shijuar një pamje kalimthi nga limani i qetë në botën tjetër. Sigurisht, këto vërtetësi për zemrat e pastra që kanë fituar tashmë lumturinë, janë përfundime që të tjerët vetëm kanë ëndërruar t'i arrijnë pas miliona e miliona vjet mundimesh. Ata janë konsideruar të kenë arritur shoqërinë e Zotit dhe të kenë qëndruar me banorët më të përzgjedhur gju më gju, sup më sup, duke vërtetuar që njerëzit e këtillë janë fitimtarë përjetësisht. Gjithmonë të sinqertë dhe të thelluar, këta njerëz vazhdimisht kërkojnë projekte të mëdha për zemrën e tyre. Duke menduar për mëshirën, flasin për mëshirën dhe kërkojnë rrugët për të shfaqur vetveten përmes mëshirës. Ata përpiqen me aq kënaqësi për të drejtuar gjithsecilin, pa dallim, në lumturinë e pafund, sakrifikojnë kënaqësitë dhe fuqitë shpirtërore për botën e ardhshme, pa zënë në gojë interesat materiale apo dëshirat për pozitë shoqërore. Manifestimi i një qëndrimi fisnik në marrëdhëniet me të tjerët dhe në gjendjen shpirtërore të tyre tregon faktin që ata janë në praninë e Pushtetit Absolut. Dhe siç të tjerët vdesin, ata rigjallërohen njëri pas tjetrit.

Në ndjekje të thënies "mos dëshironi për të tjerët çfarë nuk dëshironi për veten tuaj", ata pa pushim përpiqen më shumë për të tjerët. Prandaj të tjerët do të përfitojnë nga çfarë kanë krijuar të dobishme tashmë këta njerëz me zemër. Me pafundësinë e horizontit të tyre, ata janë në gjendje të ringjallin ndjenjën e mëshirës në zemrat e tiranëve. Në të njëjtën kohë, ata besojnë që edhe një qenie e shtypur është krijesë e Zotit dhe në këtë mënyrë e mbështesin atë.

Faktori më i rëndësishëm që përcakton sjelljen e heronjve të tillë është të jetuarit për të tjerët. Shqetësimi më i madh për ta është përshtatshmëria e tyre për një mision të tillë, ndërsa karakteristika më mbizotëruese është ambicia e skajshme e kërkimit të pranimit nga Zoti. Kur përpiqen të ndriçojnë të tjerët, ata nuk ndjejnë dhimbje dhe as pësojnë ndonjë tronditje

nga gëzimi që po i sqarojnë ata. Sukseset që arrijnë, vlerësohen si zbulime për ndihmën e shenjtë të Tij dhe heronjtë përulen me modesti, duke asgjësuar vetveten orë e çast, për çdo ditë. Në plotësim të të gjithë kësaj, ata dridhen me idenë që emocionet e tyre janë ndaluar të ndërhyjnë në veprat që kanë krijuar për të hyrë brenda ekzistencës, dhe rënkojnë: "Ju jeni gjithçka që unë kam nevojë!"

Për shumë kohë ne kemi pritur pa durim duar të tilla të bekuara për të transformuar çfarë mund të jetë përshkruar si "vendet e shkretuara, shtëpitë e rrënuara dhe shkretëtirat e largëta" në një botë të re. Dhe ne jemi të vendosur të presim edhe për shumë vite me besim, dëshirë dhe vendosmëri. Mundet që pritja për këto dëlirësi, për zemrat e dhembshura për këtë Mëshirë të Pafund, të mos mbetet pa përgjigje!

MIRËKUPTIMI, TOLERANCA DHE DIALOGU

MIRËKUPTIMI [12]

Njerëzit janë krijesa të lindura me atributet dhe dobësitë e tyre. Deri sa u shfaq njeriu i parë, nuk gjallonin krijesa që mbartnin kundërshti të tilla brenda natyrës së tyre. Në të njëjtën kohë që qeniet njerëzore përplasin flatrat në qiellin e parajsës, ata mund, me një shmangie të papritur, të bëhen përbindësha që lëshohen në guvën e ferrit. Është e kotë të vështrosh për ndonjë marrëdhënie midis këtyre ulje ngritjeve të frikshme, ato janë ekstreme sepse shkaku dhe efekti i tyre zënë vend në një plan shumë të ndryshëm.

Shpesh njerëzit janë si një fushë me grurë përulur nga era, në momente të tjera, ndonëse paraqiten plot dinjitet si një rrap i moçëm, ata mund të shemben përdhe, pa mundur të ngrihen përsëri. Ashtu siç nuk janë të pakta momentet kur engjëjt i kanë zili, po ashtu nuk janë të pakta dhe çastet kur djajtë shokohen nga sjellja e tyre.

Për njerëzit, natyra e të cilëve pëson shumë ulje e ngritje, kjo është e pashmangshme edhe nëse angazhimi i së keqes nuk është në natyrën e tyre. Edhe po qe se jeta e tyre njolloset aksidentalisht, është e papëlqyer. Për një krijesë e cila është nisur për të prishur emrin e mirë të saj, mirëkuptimi është diçka e pamundur.

Ndonëse është e çmueshme të kërkosh dhe të presësh mirëkuptim dhe të vajtosh për gjërat që na janë përvjedhur, të jesh i mëshirshëm është më shumë se një atribut dhe virtyt. Është e gabuar të mendosh se mirëkuptimi shfaqet tek njerëzit pa virtyte,

[12] Ky artikull është shkruar në vitin 1980 dhe origjinali i tij përmbahet në vëllimin Çag ve Nesil.

po ashtu siç është e gabuar të mendosh që virtytet bashkëjetojnë tek njerëzit pa mirëkuptim. Siç dihet fjala e urtë thotë: "Të gabosh është njerëzore, të falësh është hyjnore!" Dhe si mund të shprehej më bukur se kaq! Krijesa që fal, synon krijesën e korrigjuar, përmbahet në kthimin në esencën tonë dhe rigjetjen e vetes sonë përsëri. Për këtë arsye, veprimi më i pëlqyeshëm në sytë e Mëshirës së Pafund është çdo aktivitet i ndjekur në mes të drithërimave për këtë kthim dhe kërkim.

Gjithçka për krijesat, në jetë ose jo, është paraqitur me anë të mirëkuptimit përmes humanitetit. Pikërisht siç Zoti shfaq atributet e Tij me anë të mirëkuptimit përmes humanitetit, Ai gjithashtu ngulit bukurinë e mirëkuptimit në zemrat e njerëzve. Ndërsa njeriu i parë lëshoi një goditje në esencën e tij nga gabimi i kryer, diçka pothuajse e pashmangshme për natyrën e tij humane, mirëkuptimi i erdhi nga qiejt sepse ai e ndjeu pendimin në ndërgjegjen e tij dhe sepse lutjet e tij ishin të sinqerta.

Njerëzit kanë dhunti të ruajtura, të tilla si shpresa dhe ngushëllimi që i kanë trashëguar prej paraardhësve nëpër shekuj. Sa herë që njerëzit gabojnë, nga ngjitja në transportuesin magjik në kërkim të mirëkuptimit dhe prej mposhtjes së turpit të shkaktuar nga mëkatet e tyre dhe të dëshpërimit si pasojë e veprimeve të tyre, ata janë të aftë të fitojnë mëshirë pa kufi dhe kanë treguar fisnikërinë që është ngatërruar në perden e syve të tyre me mëkatet e të tjerëve.

Në sajë të shpresës së tyre për mirëkuptim, njerëzit mund të ngrihen mbi retë e errëta që kërcënojnë horizontin e tyre dhe të gjuajnë mundësinë për të parë me lehtësi botën e tyre. Këta fatbardhë që janë të vetëdijshëm për krahët e ngritura për mirëkuptim, kalojnë jetën në mes melodive që gëzojnë shpirtrat e tyre.

Për njerëzit që kanë dhënë zemrat e tyre në kërkim të mirëkuptimit është e pamundur të mos mendojnë për faljen e të tjerëve. Pikërisht siç dëshirojnë të jenë falur, ata gjithashtu

dëshirojnë të falin. A është e mundur që dikush të mos falë nëse e di që shpëtimi prej zjarrit të vuajtjeve shkaktuar prej gabimeve të tij ose asaj është i mundur duke pirë thellë në lumin e mirëkuptimit? Është e mundur për njerëzit të mos falin nëse ata e dinë që rruga për të qenë i falur kalon përmes aktit të faljes?

Ata që falin janë nderuar me mirëkuptim. Një njeri që nuk di të falë, nuk mund të shpresojë të jetë i falur. Ata që mbyllin rrugën e tolerancës, janë përbindësha që kanë humbur humanizmin e tyre. Këto monstra që nuk kanë qenë kurrë ndonjëherë të prirur të largojnë vetveten nga mëkatet e tyre, kurrë nuk do të ndjehen të lehtësuar për mirëkuptim.

Isai (a.s.) tregon për një turmë njerëzish që po prisnin duke mbajtur gurë në duar për të qëlluar një mëkatar. Ai u tha: "Nëse ndonjëri nga ju është i papërlyer me mëkat, le të qëllojë ai i pari me gurë."[13] A mundet që ndokush që ka një mëkat në ndërgjegjen e tij, të jetë akoma i prirur të qëllojë tjetrin nëse e ka kuptuar me të vërtetë këtë ide? Në qoftë se sot këta fatkeqë e kalojnë jetën e tyre duke goditur jetën e të tjerëve, testi i lakmuesit nuk ka për ta kuptuar këtë! Në fakt, nëse arsyeja për të qëlluar një person është urrejtja dhe ligësia jonë, nëse është ky shkaku pse ne kemi dhënë gjykimin për të tjerët, atëherë është e pamundur ta japim këtë dënim për ta. E vërteta është se, po qe se nuk shkatërrojmë idhujt në egon tonë me të njëjtën kurajë si profeti Ibrahim, ne nuk do të jemi kurrë në gjendje të marrim një vendim të drejtë në emër të vetes sonë ose në emër të të tjerëve.

Mirëkuptimi ngrihet dhe arrin përsosjen përmes natyrës njerëzore. Në këtë këndvështrim, ne mund të dëshmojmë mirëkuptimin më të madh dhe tolerancën më të paqortueshme në shembujt më të rëndësishëm të humanitetit.

Urrejtja dhe ligësia janë farërat për ferrin që janë hedhur midis njerëzve nga shpirtrat e këqij. Ndryshe nga ata që nxisin urrejtjen

[13] Ungjilli sipas Gjonit, kapitulli 8, sentenca 7.

dhe ligësinë dhe e kthejnë botën në një gropë ferri, ne duhet ta gjejmë këtë mirëkuptim dhe të nxitojmë të shpëtojmë njerëzit tanë që janë përballur me vështirësi të panumërta dhe që janë shtyrë vazhdimisht në drejtim të humnerës. Shekujt që sapo kemi kaluar, kanë qenë më të vështirët prej ekseseve të atyre që nuk njohin mirëkuptim dhe as pranojnë tolerancën. Është e pamundur të mos jesh ftohur nga mendimi që këta fatkeqë mund të drejtojnë të ardhmen.

Për këtë arsye, dhurata më e madhe që gjenerata e sotme mund t'u japë fëmijëve, nipërve e mbesave të tyre është t'u mësojë se si të falin, të falin edhe kur përballen me sjelljen më të keqe ose në rrethanat më shqetësuese. Ndonëse, duke menduar për faljen e monstrave, njerëzve të ligj që gëzohen me vuajtjet e të tjerëve, mund të mos respektohet vetë ideja e mirëkuptimit. Ne nuk kemi të drejtë t'i falim ata, falja e tyre mund të jetë mosrespekt për njerëzimin. Unë nuk besoj që ekziston mundësia që ndokush mund ta kuptojë aktin që është mosrespekt për mirëkuptimin si një zhvillim të pranueshëm.

Një gjeneratë e cila është rritur me një të kaluar kryesisht nën një ndikim armiqësor të vazhdueshëm, vështron pa ndërprerje tmerr dhe brutalitet në botën e errët në të cilën ajo gjendet. Ata shohin gjak dhe qelb jo vetëm në natën e errët, por dhe gjatë ditës me diell. Çfarë mund të jetë mësuar prej një shoqërie së cilës zëri, fryma, mendja, dhe buzëqeshja i janë molepsur prej gjakut? Gjithçka i është dhënë kësaj gjenerate është në kundërshtim të plotë me çfarë ne kemi nevojë dhe çfarë ne dëshirojmë. Ky brez jeton në një botë tjetër, nxitur prej vitesh nga mospërfillja dhe prej mendimeve të gabuara, pështjellimi dhe rebelimi shkaktuar prej tyre krijon një përmbytje. Nëse vetëm tani ne mund t'i kemi kuptuar ata. Sa keq! Ku ka qenë më parë mendjemprehtësia jonë?

Ne besojmë që mirëkuptimi dhe toleranca do të shërojnë shumë prej plagëve tona, vetëm nëse ky instrument hyjnor do të jetë në

duart e atyre që e kuptojnë gjuhën e tij. Në të kundërt, metodat e gabuara të sjelljes dhe trajtimit, siç ka ndodhur deri tani, do të shkaktojnë shumë ndërlikime dhe vetëm do të na e ngatërrojnë punën që tani.

Diagnostikoni sëmundjen, atëherë filloni ta trajtoni atë / A keni menduar ndonjë melhem që do të jetë shërim për çdo plagë?- Zija Pasha

TOLERANCA DHE BUJARIA

Hapja çdokujt zemrën sa mund t'ia hapësh, le të jetë si oqean! Tërhiqu me besim dhe për njeriun dashuri ndje, të mos mbetet zemër e dëshpëruar që s'u interesove për të e s'ia zgjate dorën!

Brohoriti të mirët për të mirat dhe ndaj zemrave që kanë besuar bëhu bujar! Mosbesuesve iu afro aq butë sa neveritë e urrejtjet e tyre t'u treten e në frymëmarrjet e tua gjithmonë një Mesih u bëj!..

Në marrëdhëniet me qiejt në më të shumëngjyrëshmen e rrugëve e me më të spikaturën e fjalëve, mos harro se ndodhesh pas Udhërrëfyesit të Lartë![14] Mos harro që edhe duke menduar për ata që nuk zotërojnë as dhe njërën prej këtyre veçorive, bëhu i matur!

Përgjigjiu të keqes me të mirë, sjelljeve të pahijshme ndaj teje mos ua var! Çdo njeri, me sjelljet e veta, me karakterin e vet reflekton. Ti zgjidh rrugën e tolerancës dhe mirëkuptimit dhe përballë atyre që s'dinë se çështë tradita dhe edukata, tregohu bujar!

Ta duash dashurinë dhe të jesh armik i armiqësisë, është karakteristika më e spikatur e një zemre që ngazëllen me besim. Kurse urrejtja për çdo njeri është ose lëshim i zemrës djallit, ose një vepër marrëzie. Ti duaje njeriun, mahnitu pas njerëzores!

Duhet të ruhesh që qoftë edhe një herë të vetme të mos biesh nën pushtetin e egos, sepse sipas saj, të gjithë njerëzit përveç teje janë mëkatarë dhe çdo individ është një i pafat! Dhe kjo, për atë më fjalëdrejtin do të thotë shkatërrim i personit! Ti ji mjaft i ashpër me egon tënde, kurse me të tjerët, më i buti i të butëve!

Tregohu i vëmendshëm ndaj sjelljeve e veprimeve që të bëjnë

[14] Është fjala për profetin Muhamed (a.s.).

t'i duash të tjerët e që i tregojnë ata të dashur para syve të tu! Mos harro se të njëjtat gjëra mund të bëhen pretekst që edhe ti të pëlqehesh e të duhesh nga të tjerët. Sillu gjithmonë si njeri dhe i mëshirshëm ji!

Duke pranuar si etalon trajtimin që të bën Zoti ty edhe ti ashtu duhet të sillesh ndaj popullit. Atëherë ke për të qenë bashkë me Zotin mes njerëzve dhe ke për të shpëtuar nga egërsia e të dy vetmive!

Se ç'je para Zotit, mund ta vlerësosh me anë të vendit që i ke veçuar Atij në zemër, kurse se ç'pozitë ke mes popullit, duke e peshuar dhe matur me qëndrimet e tua. Mos u shkëput nga Zoti qoftë edhe për një çast dhe mes njerëzve, njëri prej tyre bëhu!

Në qoftë se në shpirt të ka zënë vend mirë ideja se njerëzit që besojnë mund të të bëjnë keq, dije se kjo është një mungesë aftësie gjykimi dhe e rrjedhur prej mangësisë së mendjes, prej dobësisë ndaj një egoje, si dhe prej mjerimit shpirtëror! Dhe menjëherë iu drejto një hyjnori që do të ta ngrinte zemrën peshë e do të ta përlotte syrin!

Shkurt, për ta mbrojtur dashurinë dhe konsideratën tënde mes njerëzve, duaj për hir të Zotit, urrej për hir të Zotit dhe bëhu një njeri me zemrën të hapur ndaj Tij!

TOLERANCA [15]

Nëse një erë në drejtim të kundërt me ne nuk na ndalon dot, vitet që do vijnë do të jenë "vitet për përshtatshmërinë" tonë, ndonëse aty gjenden dallime në rrugët për rimëkëmbje dhe përtëritje. Ka qenë e vështirë në arritjen e një mirëkuptimi të ndërsjellë si për mënyrat që ne duhet të miratonim dhe ato që duhet të flaknim tutje lidhur me përtëritjen e jetës sonë intelektuale dhe kulturore duke lënë pas shekujt e kaluar. Gjithashtu ka ekzistuar një dallim në mënyrën dhe metodën e përdorur për të shfaqur një model të ri në shoqëri. Ngjyrimet që shfaqen në ndërtimin e një ure midis së kaluarës dhe së ardhmes na mbushin me shpresë, megjithatë në të njëjtën kohë duket që ditë të vështira na presin ne.

Në këtë mënyrë, ndërsa ecim drejt së ardhmes si një komb i tërë, toleranca është streha më e sigurt dhe fortesa jonë kundër pengesave që lindin prej përçarjes, fraksioneve dhe vështirësive të natyrshme në arritjen e një harmonie të ndërsjellë, vështirësi që na presin në çdo hap tonin.

Ne duhet të kemi një tolerancë të tillë që të jemi në gjendje të mbyllim sytë para dobësive të të tjerëve, të kemi respekt për idetë e ndryshme dhe të falim çdo gjë që është e falshme. Në fakt, edhe kur përballemi me shkeljen e të drejtave tona të patjetërsueshme, ne duhet të mbetemi të respektueshëm për vlerat njerëzore dhe të përpiqemi të vëmë drejtësi. Edhe përpara mendimeve më të ndyra dhe ideve më vulgare, ide në të cilat ne e kemi të pamundur të jemi pjesëmarrës, me përkujdesjen e një Profeti dhe pa humbur karakterin tonë, ne duhet të përgjigjemi me butësi. Kjo butësi

[15] Ky artikull është shkruar në vitin 1996 dhe origjinali i tij gjendet në *Yeseren Düsünceler*.

është paraqitur në Kuran si "fjalët e urta", ato do të prekin zemrat e të tjerëve. Kjo butësi është rrjedhojë e një zemre të dhembshur, e një fisnikërie të ofruar dhe e një qëndrimi të shtruar. Ne duhet të shfaqim më shumë tolerancë për të përfituar nga qëllimet e kundërta më shumë forcë që të mbajmë zemrën, shpirtin dhe ndërgjegjen tonë aktive dhe të vetëdijshme, edhe nëse këto ide direkt apo indirekt nuk na tregojnë ne asgjë.

Toleranca, një term që ne e përdorim herë pas here në vend të fjalëve respekt, mëshirë, bujari, ose vetëpërmbajtje, është elementi më esencial për sistemet morale, burimi më i rëndësishëm i disiplinës shpirtërore dhe një virtyt hyjnor për njerëzit e përkryer.

Nën lupën e tolerancës, cilësitë e besimtarëve arrijnë lartësi të reja dhe shtrihen në pafundësi, gabimet dhe të metat bëhen të parëndësishme dhe të largëta, ndërsa janë aq të pakonsiderueshme sa mund të zënë vend në një gishtëz. Në fakt, trajtimi i Tij është përtej kohës dhe hapësirës që kalon gjithmonë përmes prizmit të tolerancës dhe e presim atë të na përqafojë ne dhe gjithçka prej krijimit. Sepse për gjerësinë e këtij përqafimi, kur një femër e shthurur i ka dhënë ujë një qeni të etur, ka prekur dorezën e "Derës së Mëshirës," ajo e ka gjetur veten në një rruginë ku shtrihen dëlirësia dhe Parajsa. Gjithashtu për shkak të dashurisë së thellë që ndjente për Zotin dhe të Dërguarin e Tij, një i dehur e shkundi veten dhe arriti të bëhej bashkëpunëtor i Profetit. Në një shembull tjetër, me më të voglën e favoreve Hyjnore, një vrasës gjakësor u shpëtua nga psikozat monstruoze dhe u drejtua për në rangun më të lartë, një pozitë që gjendet larg aftësive të tij natyrore dhe ku më në fund ai arrin në të vërtetë.

Ne të gjithë duam që gjithsecili të na shikojë përmes kësaj lupe, të kërkojmë erërat e mirëkuptimit dhe ndjesë për dëmtimin e vazhdueshëm të mjedisit tonë. Të gjithë ne dëshirojmë t'i referohemi të kaluarës sonë dhe të tashmes për klimën e tolerancës dhe të durimit që shpërndan, shndërron, qartëson, dhe

pastron, atëherë ecim drejt së ardhmes me besim, pa asnjë ndjenjë ankthi. Ne nuk duam që e kaluara jonë të jetë e kritikueshme ose e ardhmja të jetë e errët për arsye të së tashmes sonë. Të gjithë kërkojmë dashuri dhe respekt për gjatë gjithë jetës, shpresojmë për tolerancë dhe mirëkuptim dhe duam të jemi të përfshirë nga ndjenjat e bujarisë dhe mëshirës. Ne presim tolerancë dhe mirëkuptim prej prindërve tanë në shtëpi në përgjigje të djallëzisë, prej mësuesve tanë në përgjigje të gabimeve tona në shkollë, prej atyre viktimave të pafajshme ndaj të cilëve ne kemi vepruar dhe i kemi dhunuar pa të drejtë, prej prokurorëve dhe gjykatësve në gjykatë, prej komandantëve tanë në ushtri, prej inspektorëve të policisë dhe prej Gjykuesit të Gjykimit në Gjykatën më të Lartë.

Ndërkaq, është shumë e rëndësishme që ta meritojmë atë që kërkojmë. Dikush që nuk fal, nuk mund të ketë të drejtë të kërkojë mirëkuptim. Gjithsecili do të përballet me mungesë respekti në atë shkallë sa ai ka qenë i parespekt ndaj të tjerëve. Ndokush që nuk dashuron, është i padenjë për të qenë i dashuruar. Ata të cilët nuk përqafojnë gjithçka për krijesat njerëzore me tolerancë dhe mirëkuptim kanë humbur vlerën e tyre për të pritur mirëkuptim dhe falje. Një fatkeq që ka mallkuar të tjerët, nuk ka të drejtë të kërkojë respekt prej tyre. Ata që mallkojnë, do të jenë të mallkuar dhe ata që godasin, do të jenë të mposhtur. Nëse myslimanët e vërtetë i vëzhgojnë parimet kuranore siç i ndjekin, shkojnë në rrugën e tyre dhe tolerojnë mallkimet thellë në zemrat e tyre, atëherë të tjerë do të shfaqen me qëllim që të zbatojnë drejtësinë e Paracaktimit Hyjnor për të cilën ata na kanë mallkuar ne.

(Robërit e Zotit janë) edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm, dhe kur kalojnë pranë së keqes, e ruajnë dinjitetin e vet. (Furkan, 72)

O ju që besuat vërtet! ...nëse i falni dhe nuk ua vini re fyerjet dhe i falni, padyshim Zoti është Falës dhe Mëshirues. (Tegabun, 14)

Në vendet ku mbizotëron korrupsioni, intoleranca dhe mungesa e mëshirës, nocione të tilla si liria e mendimit, kritika e qytetëruar,

shkëmbimi i ideve në përputhje me normat e drejtësisë dhe debati i paanshëm janë të përjashtuara, është e pakuptimtë të flasësh për përfundimet e logjikës dhe frymëzimit. Për opinionin tim, mund të jetë kjo arsyeja e vërtetë që nuk ka pasur përparim përgjatë viteve, pavarësisht nga bollëku i mburrjeve boshe.

Për vite me radhë, kanë qenë të panumërta rastet e imoralitetit. Cilësitë e mia nuk më lejojnë që të flas hapur për to, ndonëse këto veprime kanë marrë pjesën e tyre të tolerancës. Përpos kësaj, sabotatorët vazhdojnë të etiketojnë njerëzit e pafajshëm si "fanatikë të prapambetur që mbështesin regjimet teokratike." "Fondamentalizmi" është një term tjetër në modë me të cilën i përbaltin ata. Për më tepër, Islami ka qenë akuzuar se nuk ka përparuar në të njëjtin ritëm me kohën. Ne sot shpesh vëzhgojmë me pikëllim që ata nuk kanë bërë asgjë më shumë veç kanë shfaqur ndjenjat fetare të tyre që janë damkosur si reaksionare, fanatike dhe fundamentaliste. Fatkeqësisht disa njerëz nuk arrijnë të bëjnë dallimin midis fesë së vërtetë dhe fanatizmit të verbuar.

Është e pamundur të bisedosh rreth ideve të përbashkëta ose një ndjenje kolektive në komunitetet ku individët nuk i vështrojnë të tjerët me tolerancë ose në vendet ku shpirti i vetëpërmbajtjes nuk është i mbrojtur plotësisht. Në këto vende, idetë do të përpijnë njëra tjetrën në vorbullën e konflikteve. Puna e mendimtarëve do të jetë e padobishme dhe do të jetë e pamundur të ngresh zërin për lirinë e besimit ose të mendimit. Këto nocione nuk do të jenë pranuar as për fasadë. Në fakt, nuk mund të thuhet që në një vend të tillë aparati shtetëror përfaqëson një sistem apo drejtësi të vërtetë. Edhe nëse ky përfaqësim është i mbuluar, nuk është gjë tjetër veç një mashtrim. Të themi të drejtën, në një vend ku nuk ka tolerancë, është e pamundur të flasësh për zhvillimin e mjeteve të komunikimit masiv, për mendimin e përparuar ose, për më tepër, për aktivitetet kulturore që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Çfarë dallojmë ne kur vërejmë në gjërat që mbartin emërtime të tilla, janë vetëm ca kotësi, përpjekjet e njëanshme bëhen në

përputhje me njëfarë mendimi dhe njëfarë filozofie. Të presësh prej kësaj diçka të ëmbël, të dobishme dhe shpresëdhënëse për të ardhmen, është e kotë.

TOLERANCË NË JETËN INDIVIDUALE DHE SHOQËRORE [16]

Më së pari, dëshiroj t›ju them që toleranca nuk është diçka e zbuluar prej nesh. Toleranca u bë e njohur në këtë botë prej profetëve, të cilët ishin udhëzuar prej Zotit. Edhe nëse nuk është korrekte që t'ia atribuojmë tolerancën Zotit, Ai ka atributet që janë rrënjosur në tolerancë, si mirëkuptimi, mirëkuptimi për mëkatet, dhembshuria dhe mëshira për të gjitha krijesat dhe fshehja e mëkateve dhe gabimeve të të tjerëve. Më i Mëshirshmi, Më i Dhembshuri dhe Fshehësi më i Madh i Dobësive janë ndër lavdërimet më të shpeshta në emër të Zotit në Kuran.

Epoka më e artë kur toleranca u shfaq në kulmin e saj, është "Epoka e Lumturisë"[17], dhe unë dëshiroj t'ju jap disa shembuj të vërtetë prej asaj periudhe historike, ndodhi që shtrihen në një linjë prej "kohës së trëndafilave" deri në ditët e sotme.

Një shembull mirëkuptimi

Siç është e ditur, në ngjarjen e shpifjes, hipokritët bënë akuza të rreme kundër Aishes, gruas së dëlirë të Profetit dhe nënës shpirtërore për të gjithë besimtarët. Aishja ka një vend të veçantë ndër gratë e nderuara të Profetit, sepse Profeti ishte burri i parë që ajo kishte parë kur ishte ndjerë grua. Në një moshë kur u bë plotësisht e ndërgjegjshme për pjekurinë e saj femërore, Aishja bëhet një pjesëtare e shtëpisë së thjeshtë të Profetit dhe vetëm frymëzohej në atmosferën e pastër e të nderuar. Aishja, një

[16] Pjesë nga bisedat e zhvilluara nga autori në auditore të ndryshme në vitin 1996.
[17] Koha në të gjallë të profetit Muhamed.

shembull i dëlirësisë, bëhet objekt i një fushate me shpifje të qëllimshme gjatë kësaj periudhe. Ajo, familja e saj dhe Profeti, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, vuajtën shumë prej kësaj shpifjeje, ndonëse ajeti i zbritur një muaj më vonë shpallte pafajësinë dhe pastërtinë e plotë të Aishes. Megjithatë, babai i saj Ebu Bekri, i cili e kishte ndihmuar financiarisht njërin prej atyre që ishin përfshirë në këtë shpifje, u betua të mos e mbështeste më këtë person. Por, ajeti që zbriti bënte me dije që miku më besnik i Profetit, Mbretit të Tolerancës, duhej të ishte më zemërbutë[18]. Ajeti thoshte:

Të ndershmit dhe të pasurit nga ju të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të Allahut lanë vendlindjet e tyre, po le t'i falin dhe të mos ua marrin për keq. Vallë, a nuk doni ju që t'ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirplotë! (Nur, 22)

Unë dua të tërheq vëmendjen tuaj në mënyrë të veçantë lidhur me shprehjen e fundit të këtij ajeti: *A nuk dëshironi që Allahu t'u falë ju? Allahu fal dhe mëshiron shumë.* Në të vërtetë, Zoti i Plotmëshirshëm, mëshira e të cilit është e pashoqe dhe çdo mirësi tjetër në botë e krahasuar me të është një pikë uji në oqean, vazhdimisht e fsheh veten dhe me gjithë dobësitë tona, na mëshiron ne, mëshiron gjithçka, prej fjalëve të pahijshme që na hyjnë nga veshët dhe na errësojnë mendjen dhe shpirtin me ndyrësitë që vërshojnë prej universit dhe kundër shoqërisë që ne e kemi përdhosur. Pyetja e Tij, *A nuk dëshironi që Allahu t'u falë ju?* - u drejtohet njerëzve si ne që kanë nevojë gjithmonë për pastrim, është shumë e bukur, e sinqertë dhe e denjë për krijesat e dëshiruara. Me domethënien e këtij ajeti, Zoti ka treguar që vetëm Ai na mëshiron ne, prandaj gjithashtu ne duhet të falim njëri-tjetrin për gabimet tona dhe ky është ilustrim për ne i një virtyti kuranor në karakterin e Ebu Bekrit.

Mirëkuptimi dhe toleranca zënë një vend shumë të rëndësishëm në mesazhet për profetët, të cilat janë prej burimeve hyjnore.

[18] Buhari, *Shehade*, 15:30; Muslim, *Tevbe*, 56.

Një profet e ka për detyrë të mësojë dhe edukojë të tjerët. Në përputhje me vërtetësitë që ai është duke përçuar për të ndikuar në zemrat e të tjerëve, zemra e tij duhet të trokasë me mirëkuptim dhe tolerancë. Kur gabimet që janë rezultat i natyrës njerëzore, ndeshin në atmosferën tolerante të një njeriu me besim, ato davariten dhe treten si një meteor. Në vend që të shqyejmë kokën e ndonjërit, me burimin e ndriçimit, që ngjan me dritën e llambës në netët e kremtimit, do të qetësojmë sytë dhe sjellim gëzim në zemër. Siç e theksova më sipër, në të vërtetë një virtyt hyjnor i tillë propozohet në hadithin e Profetit tonë: "Mbrujeni moralin tuaj me moral hyjnor."[19] Nuk mund t'i mëshirojë Zoti gjithmonë ata që e mohojnë Atë! Në planin kozmik, ky krim është i pafalshëm, vrasës dhe rebelues. Por vështroni pafundësinë e mirëkuptimit dhe faljes së Zotit. Me gjithë mosmirënjohjen e shërbëtorëve të Tij, Ai thotë: "*Pa dyshim, mëshira ime i paraprin zemërimit tim!*"[20] dhe

Mëshira ime përfshin çdo gjë. (A'raf, 156)

Me atributin e Tij të mëshirës, pa shfaqur ndonjë parapëlqim, Zoti i edukon dhe mbron të gjitha qeniet humane, madje të gjitha krijesat e gjalla dhe vazhdon t'u japë ushqim edhe atyre që e mohojnë Atë.

Këtu është e mundur të vështrojmë të gjithë profetët me të njëjtën perspektivë dhe të japim disa shembuj prej të gjithë atyre, por po mjaftohemi duke treguar një pjesëz nga profeti Muhamed, thelbi i ekzistencës, paqja dhe bekimi qofshin mbi të!

Hamzai ishte njëri prej shokëve të Profetit, të cilin ai e deshi më shumë. Ai nuk ishte vetëm një bashkëpunëtor i zakonshëm, por ishte gjithashtu ungji i Profetit, dhe ata ishin ushqyer të dy nga e njëjta mëndeshë. Duke mposhtur krenarinë dhe privilegjet e tij, ky kolos me zemër luani hyri në atmosferën shpirtërore të Krenarisë së Njerëzimit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të! Duke mbështetur

[19] Mansur Ali Nasif, *et-Taxh*, 1:13.
[20] Buhari, *Tevhid*, 15, 22, 28, 55; *Bediu'l-Halk*, 1; Muslim, *Tevbe*, 14 (2751); Tirmidhi, *Davaat*, 109 (3537).

nipin e tij dhe duke deklaruar «unë jam me ty» në një kohë kritike kur myslimanët ishin të pakët në numër, lartësoi vlerat e tij të shumta. Në këtë mënyrë, nga demonstrimi i cilësive për natyrën e tij të mbyllur në planin shpirtëror si edhe në planin fizik, ai ishte në gjendje të arrinte në lartësitë që dukeshin më të paarritshme për nga madhështia. Sigurisht, devotshmëria e këtij heroi të madh u shpërblye nga Profeti. Ai u martirizua një ditë ndërsa ishte duke luftuar në Uhud, nga vrasësit e etur për gjak që ishin betuar të bastisnin Medinën dhe të vrisnin të gjithë burrat e gratë. Hamzai ishte gjendur në mes të të vrarëve; e kishin bërë copa-copa. Sytë i ishin nxjerrë jashtë, gjuha dhe veshët i ishin prerë, gjoksin ia kishin çarë dhe mëlçia i ishte shqyer. I Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, kraharori i të cilit ishte plot dhembshuri dhe mëshirë, vështronte këtë skenë tronditëse dhe sytë iu mbushën me lot si retë me shi. Shtatëdhjetë dëshmorë ranë në betejën e Uhudit - dyfish ishte numri i të plagosurve - gra që kishin mbetur të veja dhe fëmijë të mbetur jetimë. Kur ai vështronte këtë pamje me dhembshurinë e një profeti, ishte pothuajse e padurueshme. Fëmijët e Hamzait dhe të martirëve të tjerë u shfaqën para Profetit duke u dridhur si zogjtë që porsa kanë dalë nga veza. Siç tregohet në veprat biografike të tij, mendimi "për shpagimin e asaj që kishin bërë armiqtë" që i kishte përshkuar mendjen, u ndoq nga ajeti:

Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju e, nëse duroni, pa dyshim ajo është më e mirë për ata që durojnë. (Nahl, 126)

Ky ajet i adresohej Profetit në përputhje me nivelin e tij të të kuptuarit, me fjalë të tjera i ishte thënë, "Ti nuk duhet të kesh mendime të tilla." Ky diell i zemërbutësisë dhe tolerancës, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, groposi dhembjen në kraharorin e tij dhe zgjodhi rrugën e durimit.

Në të vërtetë, Profeti e ndërthuri tërësisht jetën e tij, jo vetëm për një moment, me tolerancë. Politeistët nuk kursyen torturë dhe

mundim pa provuar mbi të. Ata e dëbuan nga atdheu i tij, krijuan ushtri dhe e sulmuan atë. Por menjëherë pas pushtimit të Mekës, kur paganët po prisnin me padurim të shihnin si do të silleshin me ta, si një provë për dhembshurinë dhe mëshirën e pakufishme të tij, Profeti u tha: "*Po ju flas siç u foli Jusufi* vëllezërve të tij: Nuk ka qortim për ju sot (për aktet e mëparshme)! Zoti do t'ju falë! Ai është më i Mëshirshmi i të Mëshirshmëve! Shkoni, jeni të lirë!"[21]

Kurani është burimi për zemërbutësinë dhe tolerancën dhe sepse këto koncepte kanë vërshuar tek ne si një lumë prej Prurësit të Kuranit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ne nuk mund të kemi një mendim të ndryshëm në këtë kontekst. Çdo ide e kundërt synon që ne të mos e njohim Kuranin dhe të Dërguarin e Zotit. Nga kjo perspektivë, pse toleranca rrjedh nga Kurani dhe Suneti, është një virtyt i natyrshëm i myslimanëve dhe meqë rrjedh prej tyre, është e qëndrueshme. Marrëveshja[22] që i Dërguari i Zotit u propozoi të krishterëve dhe hebrenjve meriton me të vërtetë vëmendje. Krahasuar me parimet që ushtroi Profeti ynë, njerëzimi sot nuk e ka arritur nivelin e tij as me deklaratat për të drejtat e njeriut që nxirren në Hagë, Strasburg apo Helsinki. Ky njeri me vetëpërmbajtje të madhe jetoi së bashku me të krishterët dhe hebrenjtë në Medine. Në të vërtetë, ai ishte ende në gjendje të gjente aspekte për mirëkuptim me shpirtrat e errët që edhe pse deklaronin «ne jemi myslimanë,» vazhdimisht nxisnin ngado grindje dhe përpiqeshin të vinin në lojë njerëzit me ndërgjegje të pastër kundër të tjerëve. Ai komunikonte me ta me synimin për vetëpërmbajtje. Me vdekjen e Abdullah ibn Ubejit, i cili kishte qenë një kundërshtar i përjetshëm i tij, Profeti madje dha këmishën për t'u përdorur si qefin në varrimin e tij. Duke thënë, "për sa kohë nuk është zbuluar kërcënim për mua, unë do të kujdesem për funeralin e tij,"[23] ai shfaqi respektin e tij për të vdekurin. Nuk ka mesazh të ngjashëm apo të njëjtë me mesazhin e

[21] Ibni Ethir, *Usd el-Gabe*, I, 528-532.
[22] Teksti origjinal gjendet sot në Angli.
[23] Buhari, *Xhenaiz*, 85; *Tefsir*, el-Bakara, 12; Muslim, *Fedailu's-Sahabe*, 25.

dhënë nga Profeti Muhamed për njerëzimin. Në këtë mënyrë, nuk është e mundur për ata që përpiqen dhe ndjekin «Shembullin më të Bukur» të mendojnë ndryshe nga ç'ka menduar ai.

Në këtë vlerësim, është e pamundur të mendojmë për tolerancën si diçka që është e shkëputur nga ne, si një ngjyrë dhe ton i ndryshëm për ndjenjat dhe mendimet tona. Prej kësaj kohe duhet të jenë shfaqur platformat e tolerancës në shoqërinë tonë. Toleranca duhet të jetë shpërblyer, duke i dhënë përparësi në çdo rast, dhe ata që u sollën me mirëkuptim ndaj të tjerëve, duhet të kenë një mundësi të shfaqin veten.

Shpërblimet e tolerancës

Duke u tubuar rreth këtyre ndjenjave dhe ideve, Fondacioni i Gazetarëve dhe i Shkrimtarëve formoi një këshill dhe kohët e fundit u dha çmime për tolerancën njerëzve të cilët qenë dalluar duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për harmoninë shoqërore. Ky aksion pati mbështetjen e pothuajse çdo segmenti të shoqërisë, nga politikanët dhe artistët, nga akademikët dhe gazetarët, nga shkrimtarët dhe njerëzit në rrugë. Sigurisht, një pjesë e parëndësishme që nuk ishte renditur në krah të këtij aktiviteti, për arsye të botëkuptimit të tyre të ndryshëm, shprehu pakënaqësinë për të, ndërkohë që çdo njeri e kishte përkrahur atë. Ata bënë gabim duke akuzuar individët dhe institucionet që i thanë *po* këtij konsensusi. Por le t›i lëmë të thonë çfarë të duan. Në një kohë kur bota është bërë si një fshat i madh dhe në një moment kur shoqëria jonë është në prag të një ndryshimi dhe transformimi të rëndësishëm, nëse ne jemi duke biseduar rreth dialogut me popujt e tjerë, atëherë nuk do të jetë e mundur të shpjegojmë plotësisht mosmarrëveshjet me njëri-tjetrin. Në këtë këndvështrim, toleranca është virtyt që ka nevojë të shpërblehet dhe për këtë arsye, toleranca duhet të depërtojë në të gjithë shoqërinë. Aq shumë sa universitetet duhet të frymëzojnë

tolerancë, politikanët duhet të diskutojnë rreth tolerancës, popujt në muzikën botërore duhet të shkruajnë lirika për tolerancën dhe mjetet e komunikimit masiv duhet të japin mbështetje për zhvillimet pozitive lidhur me tolerancën.

Tolerancë nuk do të thotë të jesh i ndikuar ose i lidhur me të tjerët, por t'i pranosh të tjerët siç janë dhe të dish si të ecësh përpara me ta. Askush nuk ka të drejtë të shprehë diçka rreth këtij aspekti të tolerancës, gjithsecili në këtë vend ka këndvështrimin e tij. Njerëzit me mendime dhe qëllime të ndryshme ose do të kërkojnë rrugët për të ecur përpara me synimin për harmoni, ose do të luftojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin. Gjithmonë ka pasur njerëz që mendojnë ndryshe nga njëri-tjetri dhe kështu do të jetë përherë. Unë nuk mendoj se ata njerëz që janë zëdhënës të ca grupimeve të papërfillshme, që as pranojnë dërgimin e shkrimeve hyjnore të Zotit, as realitetin e sotëm, dhe që fillojnë të përleshen për diçka të parëndësishme, do të rishikojnë pozicionin e tyre edhe njëherë. A janë duke pretenduar ata për hir të vlerave humane, apo për hir të shkatërrimit të vlerave humane?

Sot, më tepër se për çdo gjë tjetër, shoqëria jonë ka nevojë për tolerancë. Në të vërtetë, populli ynë duhet të mbështetet tek kjo forcë lëvizëse duke i dhënë përparësi asaj, duhet të shfaqë tolerancën në botë sepse paraardhësit tanë të lavdishëm pushtuan zemrat e njerëzve me synimin për tolerancë dhe u bënë mbrojtësit e paqes së përgjithshme. Periudha më e gjatë e paqes në Ballkan dhe në Lindjen e Mesme, që kanë qenë gjithmonë arenë përleshjesh, u arrit me tolerancën e përhershme të të parëve tanë. Nga momenti që toleranca dhe përfaqësuesit e mëdhenj të saj e lëshuan historinë, ky rajon u zbraz nga paqja dhe kënaqësitë. Me mirënjohje për mirësitë e Zotit, pas disa shekujsh jete në harresë, ky komb i madh ka filluar të hedhë hapa drejt përtëritjes. Ky "rrap" i madh, gjethet e të cilit kanë filluar të bien në Anadoll, me dëshirën dhe zemërgjerësinë e Zotit, duhet edhe një herë tjetër të frymëzohet vetë me tolerancë dhe të mësojë të tjerët të thithin

tolerancë.

Në të njëjtën kohë, bashkëkombësit tanë në Evropë mund të jetojnë në harmoni në këto vende vetëm nëse ata i lënë një hapësirë të pakufishme tolerancës.

Këtu, unë dua të theksoj një moment. Të pranosh tolerancën, nuk do të thotë të anashkalosh traditat që burojnë nga feja jonë, nga populli ynë, nga historia jonë, toleranca është virtyt që ka ekzistuar gjithmonë. Otomanët ishin besnikë të fesë së tyre dhe të vlerave të tjera dhe, në të njëjtën kohë, ata ishin një komb i madh që mund të ecnin përpara së bashku me popujt e tjerë. Nëse njerëzit sot, që janë civilizuar, ndriçuar, dhe hapur ndaj botës, nuk e shohin me realizëm dhe thellësi periudhën e shkuar, do të thotë që ata nuk e kanë kuptuar këtë kohë. Në këtë vlerësim, si individë, si familjarë dhe si një shoqëri, ne do ta përshpejtojmë këtë proces që tashmë ka filluar. Unë personalisht besoj që njerëzit që nuk ndajnë të njëjtin mendim apo që nuk ndjejnë të njëjtën gjë si ne, do të ndryshojnë kur ne të kujdesemi për ta. Atëherë, në emër të dialogut ne mund të bashkohemi në tokën e përbashkët dhe të shtrëngojmë duart me të gjithë. Kjo është arsyeja pse gjërave që Zoti u dha më shumë vlera janë krijesat njerëzore, dashuria dhe mëshira.

Vlerat që i Dërguari i Zotit i dha njerëzimit

Më shumë se çdo gjë tjetër, me udhëzimet që kishte marrë nga Zoti i tij, profeti Muhamed, Krenaria e Njerëzimit, vlerësonte çdo krijesë njerëzore, pa asnjë paragjykim nëse personi ishte një mysliman, i krishterë ose hebre. Përpara se ta përfundoj këtë temë, do të ishte me interes të kuptonim se çfarë cilësish zotëronte ai për të qenë një njeri vizionar, largpamës. Ai ishte Krenaria e Njerëzimit, shpirti i tij ishte fillimi i librit të ekzistencës dhe mesazhi i tij ishte fundi. Kjo është e qartë për ata që e njohin misionin e Profetit. Ne e njohim atë si një prej atyre që mund të kenë vëzhguar ndriçimin

e universit dhe ta kenë studiuar si një libër. Ndonëse shumë njerëz, ndjekësit e Profetit në veçanti, ndjehen krenarë në jetën e tyre me Profetin e Mëshirës, kjo nuk është e mjaftueshme, sado që kush dashurohet me të shprehet se sa fat ka që është bashkuar me të. Në të vërtetë, lidhur me bekimin e lartë që ka marrë, i Dërguari i Zotit thotë: "*Gjëja e parë që Zoti krijoi - fara e parë që ishte mbjellë në gjirin e mosekzistencës - ishte drita ime!*"[24]

Kjo është e vërtetë sepse ai ishte fara, esenca dhe ngrohtësia e ekzistencës. Nëse ne shprehim të njëjtin ndjesi, por me termat e misticizmit, ekzistenca e Muhamedit ishte shkaku për krijim dhe qëllimi i tij final. Ekzistenca ishte krijuar për të që ai të ishte në gjendje të shfaqej në të si personifikim për të gjitha vlerat humane dhe si një teatër në të cilin të gjithë treguesit për emrat e Zotit do të ishin të qartë.

Siç e kam përmendur herë të tjera në kontekste të ndryshme, Krenaria e Njerëzimit, shkaku i krijimit dhe Prijësi i Profetëve, një ditë ishte çuar në këmbë ndërsa kalonte funerali i një hebrei. Një prej bashkëpunëtorëve që gjendej në krah të tij i pëshpëriti, "O i Dërguari i Zotit, është një hebre!" Me të njëjtin qëndrim dhe pa ndryshuar shprehjen e fytyrës, Prijësi i Profetëve dha këtë përgjigje: *"Por është një krijesë njerëzore!"*[25] Sa kuptimplotë është ky gjest i Profetit për ndjekësit e tij që nuk e njohin atë në këto dimensione dhe për avokatët e të drejtave të njeriut të cilët janë të painformuar për mesazhin universal që ai solli në emër të njerëzimit! Nuk kam asgjë për t'u shtuar këtyre fjalëve, por nëse jemi nxënësit e Profetit të lavdishëm që shqiptoi këtë frazë, është e pamundur që ne të mendojmë sadopak ndryshe. Kështu, ky shembull do të jetë në dobi të atyre që kundërshtojnë aktivitetet e fundit në emër të dialogut dhe tolerancës për të rishikuar pozicionin kontradiktor ose kryeneçësinë që ka depërtuar në personalitetin dhe shpirtin e tyre.

[24] Axhluni, Keshf'ul Hafa, I, 266.
[25] Buhari, *Xhenaiz*, 50; Muslim, *Xhenaiz*, 81; Nesai, *Xhenaiz*, 46.

Toleranca dhe demokracia

Demokracia është një sistem që i jep mundësinë çdokujt që gjendet në krahët e saj të jetojë dhe punojë duke shfaqur ndjenjat dhe mendimet e tij. Toleranca është një komponent i rëndësishëm i saj. Në fakt, nuk mund të flitet për demokraci në një vend ku toleranca nuk ekziston. Por le të shohim ata që në njërën anë flasin për demokraci dhe në anën tjetër duan që burimi i cili e frymëzon atë, të shterojë. Në një vend demokratik gjithsecili duhet të jetë në gjendje të marrë përgjegjësitë dhe të drejtat që i takojnë. Nëse një segment i shoqërisë bëhet pengesë për ekzistencën e një segmenti tjetër, atëherë është e qartë që ata të cilët përbëjnë rrezik për komunitetin nuk janë të sinqertë dhe kjo është më e pakta në pretendimin e tyre "ne jemi demokratë dhe e mbështesim demokracinë." Siç e theksova më sipër, nuk është e mundur që demokracia të zhvillohet në një vend ku mungon toleranca. Në të vërtetë, avokatët e demokracisë duhet të jenë të aftë t'i pranojnë edhe ata që nuk ndajnë të njëjtin vizion me ta dhe të hapin zemrat e tyre për të tjerët. Është e rëndësishme që ne ta theksojmë këtë moment. Duke i pranuar të gjithë njerëzit siç janë, pa pyetur cilët janë, nuk kemi qëllim të vëmë një shenjë barazimi mes besimtarëve dhe jobesimtarëve. Në përputhje me këndvështrimin tonë, pozicioni i besimtarëve dhe jobesimtarëve ka vlerat e veta specifike. Krenaria e Njerëzimit ka një vend të posaçëm në zemrat tona, përpara dhe të ndarë prej gjithë të tjerëve. Lidhur me këtë pikë, dëshiroj t'u tregoj për përjetimet e mia. Pasi u ktheva nga një vizitë në vendin ku prehet Profeti ynë, isha shumë i brengosur që nuk kisha vdekur atje. Unë mendoja që nëse e doja atë me të vërtetë, atëherë duhet të kacavirresha në kangjellat e hekurta dhe të vdisja në vend. Që nga ajo ditë, kam menduar që lidhja ime me Profetin ishte e fuqishme. Sigurisht, ai ka një vend shumë të madh në zemrat tona, dhe nuk dëshirojmë që ndokush ta dëmtojë këtë dashuri në ndonjë mënyrë, por unë ende mendoj që ndjenjat

e mia për të janë aq të forta, sa nuk mund të më ndalojnë për të dialoguar me dikë që nuk ka të njëjtin mendim dhe besim me mua.

Toleranca dhe e ardhmja

Edhe nëse kemi ide dhe mendime të ndryshme, jemi pjesëtarë të kësaj shoqërie. Akoma ne mendojmë që nuk mund të arrijmë në konkluzione të përbashkëta për shumë çështje, megjithëse të gjithë jetojmë në këtë botë dhe udhëtojmë në të njëjtën anije. Në këtë kontekst, ka shumë gjëra të përbashkëta që janë diskutuar dhe formuluar me njerëzit nga çdo pjesë e shoqërisë.

Pa dyshim, koha do ta qartësojë gjithçka dhe do të provojë që ata të cilët nisën të orientohen duke u bazuar në tolerancën, kishin të drejtë. Përsëri, koha do t'i asimilojë ndjenjat dhe mendimet ziliqare dhe hakmarrëse. Vetëm synimet që i ka pushtuar dashuria, mirëkuptimi, toleranca, dhe dialogu, do të përparojnë. Popujt me tolerancë do të ndërtojnë një botë të bazuar në tolerancën. Ata që nuk e njohin tolerancën, do të notojnë në ligësinë, urrejtjen, dhe zemërimin e tyre në të mirë të intolerancës. Unë dëshiroj që këta njerëz të hapin sytë për të mos u mbytur në moçalin ku kanë rënë. Ose përndryshe, ne do të lotojmë për fatkeqësinë e tyre. Unë tashmë po ndjej keqardhje dhe jam shumë i dëshpëruar për ta!

KRIJIMI I ATMOSFERËS SË NJË TOLERANCE TË QËNDRUESHME

Së bashku me "parajsën e humbur" ne kemi humbur edhe disa nga tiparet tona më ekzaltuese. Dituria, kërkimi, puna, metodat e punës, organizimi në vendin e punës, ndihma për të tjerët dhe studimi i librit të universit janë disa nga veçoritë prej të cilave ne jemi larguar. Nga të gjithë cilësitë që ne kemi humbur, ndoshta e para dhe më e rëndësishmja është toleranca. Prej këtej ne e kuptojmë se ç'do të thotë të përqafosh njerëzit pa pyetur për ndryshimet në mendim, këndvështrim, ideologji, etni, dhe fe. Kjo shpjegon gjithashtu pranimin për gjërat që nuk i dëshirojmë, nga forca e gjetur thellë në ndërgjegje, në besim dhe në zemrën bujare ose nga forca e emocioneve tona. Në një formë tjetër, mendimin e shpreh poeti i famshëm turk Junus Emre kur thotë, të duash krijesat vetëm për arsye të Krijuesit.

Të duash krijesat për hir të Krijuesit

Dashuria është arsye për ekzistencën dhe esencën e saj dhe lidhja më e fortë që i bashkon krijesat së bashku. Çdo gjë në univers është krijim i Zotit. Kështu, nëse ju nuk i aviteni natyrës njerëzore, një krijim i Zotit me dashuri, atëherë do të lëndoni ata që e duan Zotin dhe ata që Zoti i do. Për shembull, nëse ju jeni kundër veprave të një piktori si Pikaso, ju do të lëndoni atë dhe admiruesit e tij. Një shembull tjetër mund të jetë qëndrimi indiferent ndaj bukurisë së Alhambra Palas që përshkohet nga hijeshia tejembanë. Kjo do të thotë të shfaqësh mungesë respekti për këtë kryevepër dhe për autorin e saj. Me të njëjtin arsyetim, çdo aspekt i universit që ta

prish mendjen me bukurinë, shkëlqimin, dhe madhështinë e tij, është një shembull i mjeshtërisë artistike të Zotit. Në këtë kontekst, njerëzit, kafshët, të gjitha krijesat e gjalla, dhe, në fakt, të gjithë objektet e pajetë gjithashtu, janë krijuar me një natyrë të denjë për t'u pranuar prej nesh. Duke shfaqur indiferencë dhe mospërfillje ndaj tyre, synon të tregosh indiferencë dhe mospërfillje për Realizuesin. Në kundërshtim me këtë qëndrim, afrimi ynë me të gjithë krijesat humane ose jo duhet të bazohet në dashurinë për ta, për hir të Krijuesit të tyre. Nëse myslimanët bisedojnë rreth armëve, armatimit, duke vrarë e masakruar të tjerët, do të krijojnë një hendek të thellë mes popujve, atëherë ky qëndrim, pasojë e sjelljes sonë, është larg nga esenca jonë.

Por ne duhet të jemi mirënjohës që në një kohë kur kemi humbur shenjat e parajsës, ne kemi gjetur tolerancën përsëri. Kjo është një prej cilësive që kemi harruar. Ne kemi rizbuluar tolerancën, virtyt që është i pandarë nga shpirti islam dhe që na është treguar ne në Kuran dhe prej profetit Muhamed, paqja dhe bekimi qofshin mbi të. Duke iu përmbajtur tolerancës, populli ynë ka mirëpritur veprimtaritë që i përshkon toleranca dhe e ka përqafuar me ngrohtësi shpirtin e tolerancës, gjë që është me rëndësi vitale. Së bashku me institucionet që janë ngritur, shërbimi vullnetar i iniciuar nga populli ka ngjallur një interesim shumë të madh. Kurani shpall:

Nuk ka dyshim se atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t'u dhurojë dashuri! (Merjem, 96)

Me fjalë të tjera, banorët në qiell dhe banorët në tokë do t'i duan ata. Siç është shprehur në një hadith, Zoti u tregoi banorëve në qiell për njerëzit që Ai donte dhe i urdhëroi ata, gjithashtu, t'i donin këta të dashur. Kur një engjëll në qiell i dashuron ata, edhe njerëzit në tokë i duan.

Fara e mbjellë nga toleranca është rritur. Ajo do të lulëzojë kur koha të jetë e përshtatshme. Sigurisht, kjo varet në njëfarë mase

nga gazetat, televizioni, revistat dhe shoqatat që duhet të japin mbështetjen e duhur.

Nuk ka kthim prapa nga rruga e tolerancës

Pranimi në qiej gjithmonë sjell një përgjigje pozitive në tokë. Provat për këtë janë të qarta. Treguesit më të qartë janë dyert e hapura kudo gjerësisht në emër të pranimit të heronjve të dashurisë dhe tolerancës. Kjo do të thotë që toleranca është në rrugën e saj të rritjes dhe lulëzimit. Kjo është e vërtetë sepse pas periudhës së tolerancës gjenden konfliktet që lindin për ta ndaluar këtë evoluim. Por fraksionet që për vite janë vështruar dhe shfaqur të ndara, po reagojnë me një largpamësi të madhe dhe kështu një gjëmë është shmangur.

Unë mendoj se ekziston mundësia që në të ardhmen ngjarje të tjera intriguese do të shfaqen dhe do të përpiqen për ta prishur paqen e përgjithshme. Sidoqoftë, ne që e kemi nisur këtë aksion, duhet të jemi të prerë për ta çuar atë deri në fund. Ne do qëndrojmë dhe veprojmë të vendosur në përputhje me rrugën e treguar në Kuran:

(Robërit e Zotit janë) edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm, dhe kur kalojnë pranë së keqes, e ruajnë dinjitetin e vet. (Furkan, 72)

Gjithsecili tregon karakterin dhe dinjitetin e tij me veprimet që ndërmerr. Është detyrë e njerëzve që shkojnë në udhën e drejtë të jenë zemërbutë. Nëse dikush vë në lojë Kuranin dhe nuk i jep rëndësi namazit, agjërimit dhe pastërtisë morale, ky qëndrim duhet të konsiderohet si tregues i karakterit dhe sjelljes së tij. Por si besimtarë, ne nuk duhet të jemi njerëz agresivë apo tallës qoftë edhe ndaj atyre që veprojnë në mënyrë të pahijshme. Agresiviteti dhe vënia në lojë e të tjerëve nuk duhet të bëhen pjesë e jetës sonë. Një ajet tjetër thotë:

Thuaju atyre që besuan: le t'ua falin atyre që nuk presin ndëshkimet e Allahut, ashtu që Ai vetë ta dënojë një popull për

shkak të veprave që bën. (Xhathije, 14)

Kjo në të vërtetë është thirrje për ndërgjegjen tonë. Kur ju shihni një njeri të verbër, a e godisni dhe e rrëzoni përtokë atë, apo e zini për dore dhe i tregoni rrugën?

Nga ky këndvështrim, detyra që u bie realizuesve të ideve të së ardhmes është të sjellin harmoni për mospërputhjet shoqërore, të ruajnë ekuilibrin që ndjehet i kërcënuar dhe t'i vështrojnë incidentet e pakëndshme me largpamësi. Pikërisht siç thuhet në një shprehje turke, "merr çfarë është e kënaqshme dhe lër atë që të shkakton dhimbje," ne duhet të qëndrojmë indiferentë për gjërat e pahijshme dhe të mos shkaktojmë ndonjë shqetësim apo konflikt.

Nëse ne do të vazhdojmë në këtë rrugë, atëherë për një kohë të shkurtër do bëjmë shumë hapa përpara. Sigurisht, do të ndeshemi me shumë përpjekje, nga brenda dhe jashtë, për ta shkatërruar këtë ekuilibër. Por për hir të vazhdimësisë së tolerancës, ne do të biem herë pas here dhe do të ngrihemi përsëri në orvatjet për ta shmangur këtë shkatërrim. Lumi i tolerancës do të përmbysë gjithçka dhe nga sytë dhe zemrat e njerëzve do të rrjedhë dashuria. Të gjithë do të pushtojmë njëri-tjetrin me dashuri dhe me vullnetin e Zotit, shekulli XXI do të quhet shekulli i tolerancës. Unë jam i paduruar që kjo të realizohet sepse një apo dy vjet tolerancë janë të pamjaftueshme. Ne jemi të vendosur që shekullin në të cilin jetojmë, ta përjetojmë me tolerancë. Në të vërtetë, ne dëshirojmë tolerancë për të gjitha kohërat, ne duam ta ndjejmë epokën e tolerancës dhe synojmë të mos kthehemi prapa nga kjo rrugë.

DY TRËNDAFILA PËR MAJAT E SMERALDTA: TOLERANCA DHE DIALOGU

Dialog do të thotë takim i dy ose më shumë njerëzve për të diskutuar çështje të përcaktuara dhe kështu krijohet një lidhje mes tyre. Në këtë kontekst, ne mund të shprehemi që dialogu ka krijesat njerëzore në boshtin e tij. Pa dyshim, gjithsecili është shpërblyer në përputhje me synimet dhe sinqeritetin e tij. Nëse njerëzit e bazojnë veprimtarinë e tyre në sinqeritetin dhe rrugën e drejtë, atëherë ata mund të jenë të fituar edhe në qoftë se të tjerët i quajnë humbës. Profeti i Zotit thotë: *"Veprat gjykohen nga qëllimet."*[26], duke theksuar që synimi për besimtarët është më i rëndësishëm nga akti i tyre. Nëse vepra është gjendur mes qëllimeve të mira, ajo do të jetë e pëlqyeshme. Prandaj, në çdo veprim që mund të ndërmarrë një njeri, ai duhet të jetë i sinqertë në synimet e tij dhe të kërkojë pëlqimin e Zotit. Në këtë mënyrë askush nuk duhet të paragjykojë apo të shpifë rreth lidhjeve që janë vendosur mes grupimeve të ndryshme në emër të dashurisë, dialogut dhe tolerancës.

Shoqëria nuk mund të durojë më tronditje pas vuajtjeve të shumta nga plagët që ka marrë dhe pas pasigurisë që e ka pushtuar prej shumë kohësh. Nëse përqendrimi antidemokratik i pushtetit bëhet një refren i vazhdueshëm për këtë popull dhe logjika e gjykimi janë zëvendësuar me forcën dhe qëllimet e tij, atëherë nuk do të jetë e mundur që ky komb fisnik të gjejë vetveten përsëri. Si rezultat i kësaj fatkeqësie, ky vend që ngjante me parajsën mund të jetë kthyer pesëmbëdhjetë apo njëzet vjet prapa. Ka mundësi

[26] Buhari, *Bed'u'l Vahj*, 1; *Itk*, 6; Muslim, *Imarat*, 155; Ebu Davud, *Talak*, 11.

që ne të humbasim disa gjëra, për të cilat do të ndjehemi keq pasi i dëshirojmë ato edhe nëse janë mes atyre që po kritikojmë sot. Duke vijuar arsyetimin, nëse ne i nisim përpjekjet për dialog me bindjen që "pajtimi është më i dobishmi" (Nisa,128), atëherë duhet të demonstrojmë që jemi në krah të paqes në atdheun tonë dhe ngado. Në të vërtetë, paqja ka një rëndësi të madhe në Islam; betejat dhe lufta janë ngjarje të dorës së dytë, të lidhura me shkaqe dhe kushte të veçanta. Prandaj, mund të shprehemi që nëse një mjedis për paqen, ku të gjithë të jetojnë në qetësi dhe siguri, është i pamundur të gjendet në këtë vend, do të jetë e pamundur për ne që t'i bëjmë një shërbim të mirë shoqërisë dhe njerëzimit.

Konceptet e gabuara rreth Islamit

Nëse e vështrojmë problemin nga një kënd tjetër, myslimanët herë pas here janë keqkuptuar dhe si rezultat ata u janë nënshtruar presioneve dhe fyerjeve. Ne akoma kemi dëshmitë e myslimanëve që janë privuar nga të drejtat e tyre të ligjshme dhe thelbësore, për shembull nga e drejta e tyre për punë. Ky persekutim që besimtarët kanë provuar është bërë në emër të vlerave, si humanizmi, të drejtat njerëzore, bujaria, dashuria dhe toleranca që në fakt, janë cilësi të Islamit. Ndërkaq, veçoritë dhe virtytet që janë përdorur kundër njerëzve besimtarë, janë bërë të shfrytëzueshme. Gjithmonë ka qenë i njohur një qëndrim i tillë dinak dhe mashtrues, prej atyre që nuk dëshirojnë të japin asnjë rast që Islami dhe myslimanët të ekzistojnë, këtu apo në çdo vend tjetër. Gjërat që janë pretenduar nuk janë të vërteta. Një mysliman nuk mund të jetë kurrë një fanatik. Edhe nëse disa njerëz me karakteristika të tilla mund të shfaqen brenda bashkësisë islame, është e papërfytyrueshme të mendosh që të gjithë myslimanët janë krijesa të distancuara nga mirëkuptimi dhe toleranca. Në të vërtetë, në këto ditë çfarë kanë dëmtuar myslimanët dhe ç›të keqe kanë angazhuar dhe kundër kujt? Pavarësisht nga qëllimet e tyre të mira, disa njerëz kanë qenë

të ngurtë në qëndrimet e tyre dhe janë vlerësuar në mënyrë të gabuar, ata janë bërë tabelë qitjeje për akuza të ndryshme në emër të dashurisë, tolerancës, lirisë dhe demokracisë. Megjithëse i kanë dëgjuar deri në fund këto falsitete, myslimanët e vërtetë kurrë nuk kanë lënduar asnjeri dhe kanë përgëzuar vetveten thjesht sepse nuk janë në rrugën për të cilën i kanë fajësuar. Akoma më tej, një grupim i fuqishëm nuk ka reshtur duke i sulmuar ata. Vërtet, bukuria gjithmonë ka shpërthyer nga shpirtrat e pastër e të pafajshëm të myslimanëve dhe ka shenjtëruar e lartësuar burimet që gjenden në duart e tyre. Nuk mund të jetë ndonjë rrugë tjetër. Në Kuran, në Sunet dhe në interpretimin shkencor e të qartë të të Dërguarit të Madh, nuk ka gjurmë të ndonjë qëndrimi që është në kundërshtim me dashurinë, tolerancën ose dialogun në kuptimin për pikëpjekjet me të gjithë dhe në shfaqjen e emocioneve dhe mendimeve tona. Ne nuk mund ta përfytyrojmë një fe që dëshiron të mirën e përgjithshme dhe u tregon të gjithëve - pa përjashtim - rrugën e shpëtimit, si një zhvillim të ndryshëm. Të ndjekim ajetet në Kuranin e Ndritshëm që e shprehin në mënyrë perfekte këtë të vërtetë:

O ju që besuat vërtet! ...nëse i falni dhe nuk ua vini re fyerjet dhe i falni, padyshim Zoti është Falës dhe Mëshirplotë. (Tegabun, 14)

Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do të drejtët. (Mumtehine, 8)

Thuaju atyre që besuan: le t'ua falin atyre që nuk presin ndëshkimet e Allahut, ashtu që Ai vetë ta dënojë një popull për shkak të veprave që bën. (Xhathije, 14)

Vërtet, kur ne vështrojmë Kuranin, shohim që është stampuar në dashuri. Prandaj, zemrat e besimtarëve duhet t'i reklamojnë këto bukuri që tashmë janë tonat, duke ndryshuar imazhin negativ të myslimanëve. Ky imazh negativ ka qenë ushqyer në botë dhe ne tani duhet t›u shfaqim edhe njëherë faqen kryesore të Islamit

atyre që pandehin se janë civilizuar, duke shfrytëzuar parimet e "besimit njerëzor."

Të shprehim falënderimet e pakufishme për Zotin, që na ka ushqyer me zemërgjerësinë e Tij për devotshmërinë ndaj të vërtetës dhe për heronjtë e dashurisë që janë mbartësit e mesazhit të tolerancës, dialogut dhe dashurisë në të gjithë botën dhe po përpiqen të ndërtojnë «imazhin e ri të myslimanit" me zemrat plot me dashuri!

Në kërkim të pëlqimit të Zotit

Unë dëshiroj të theksoj faktin që myslimanët nuk do të humbasin asgjë duke iu përkushtuar dialogut, dashurisë dhe tolerancës. Myslimanët vazhdimisht kërkojnë pëlqimin e Zotit, kjo është arritja më e madhe për të gjithë ne. Nga kjo pikëpamje, gjërat që mund të duken si humbje për disa njerëz, janë vështruar si fitore nga myslimanët, ndërsa eventualitete të tjera mund të jenë në të vërtetë të dëmshme edhe kur ata duken si fitimprurëse. Për më tepër, ne nuk duhet të kemi dyshime lidhur me Islamin, librin e shenjtë të tij ose ndryshe, përfaqësuesin më të shkëlqyer që është Kurani dhe Krenaria e Njerëzimit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të! Ne e dimë që Islami do të vazhdojë me siguri në rrugën drejt së ardhmes pavarësisht nga të gjitha pengesat. Çdo çështje në Kuran ka gjetur një gjykim. Një libër që është në gjendje të zgjidhë të gjithë problemet e së ardhmes! Prijësi i Profetëve, për të cilin Bernard Shou ka thënë, "Ai i zgjidh të gjitha problemet me lehtësinë që mund të pish një kafe", iu dërgua njerëzimit me detyrën për t'u treguar njerëzve të gjitha zgjidhjet për problemet deri në Ditën e Gjykimit. Si në shekullin e kaluar, problemet e kohëve tona dhe të atyre që do të vijnë, të cilat ngjajnë të jenë larg nga zgjidhjet e zhurmshme, do të gjejnë përgjigje nga arkitektët e mendjes dhe të zemrës që i kanë bazuar zgjidhjet e tyre në këto burime të shenjta.

Sigurisht, nuk është e nevojshme që ne të ndihemi të shqetësuar, siç besojmë që duke shpjeguar shprehjet dhe thëniet e Kuranit të Shenjtë dhe të Profetit tonë, ofrojmë zgjidhjet më të qëndrueshme për një mori problemesh. Në opinionin tim, ata që janë pajisur me këta pishtarë, do të vuajnë por nuk do të humbasin. Me ndihmën dhe zemërgjerësinë e Zotit, do të mund të shkojnë kudo në botë dhe mund të dialogojnë me këdo. Në këtë mënyrë, kjo nuk është një kauzë për interesa personale. Rëndësi ka fakti që ne duhet të njohim burimet që zotërojmë dhe t'i përdorim ato kur të na nevojiten. Po ashtu, ne nuk duhet të abuzojmë nga lidhja e tyre me dobësitë tona, fizike apo dëshira tokësore. Me ndihmën dhe drejtimin e tyre ne do të kërkojmë vetëm pëlqimin e Zotit dhe jetën e përtejme.

Në të vërtetë, pikërisht siç nuk kemi edhe dyshimin më të vogël në lidhje me Kuranin dhe Profetin e Zotit dhe ashtu siç nuk kemi dyshim në drejtësinë e tyre, nuk ka arsye që ndokush të jetë mosbesues ndaj nesh. Por, nëse akoma disa njerëz ndjehen të tmerruar nga një frikë e pamotivuar, ata u përkasin atyre që janë të shqetësuar lidhur me besueshmërinë e forcave lëvizëse dhe burimeve në të cilat janë mbështetur.

PA DUAR KUNDËR ATYRE QË JU QËLLOJNË, PA FJALË KUNDER ATYRE QË JU MALLKOJNË [27]

Nga dita që Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve është themeluar e deri më sot, edhe nëse gjërat nuk kanë shkuar gjithmonë ashtu siç duam ne, mund të themi që Fondacioni ka organizuar gjithmonë veprimtari të rëndësishme. Por për disa shkaqe unë nuk kam qenë në gjendje të marr pjesë në ndonjë prej tyre. Për këtë arsye, unë nuk pretendoj të kem pjesë në këtë sukses.

Për shembull, Fondacioni ka sjellë futbollistët më të mirë të botës këtu, dhe të ardhurat e mbledhura prej tyre kanë shërbyer si ndihmë për Bosnjën. Për çdo vit ka mbledhur së bashku grupe të ndryshme, siç jemi mbledhur këtu sonte, për të diskutuar për tema të larmishme, që më së paku i shërbejnë shkëmbimit të ideve. Fondacioni ka sugjeruar për temat që do të diskutohen, pa u përqendruar në idetë dhe opinionet personale. Dhe si rezultat, ne e kemi parë me sytë tanë që këtu nuk ka asnjë motiv për të frikësuar njëri-tjetrin, dhe gjithsecili mund të takohet me këdo që dëshiron. Nëse ne nuk kemi qenë të aftë të mblidhemi më parë si këtu sonte, kjo ka ndodhur vetëm për shkak të hipotezave tona të gabuara, dhe si rezultat, kemi lënë pas dore këtë përgjegjësi të rëndësishme ndaj njëri-tjetrit.

Fondacioni i Gazetarëve dhe Shkrimtarëve është e njohur në Turqi më së shumti si një përfaqësues i tolerancës. Në fakt, ai e ka identifikuar veten me tolerancën. Kur Fondacioni është zënë në gojë, toleranca është fjala që e ka pasuar atë. Në të vërtetë, imazhi i

[27] Kjo bisedë është mbajtur nga autori në shkurt 1995 në një mbledhje organizuar nga Fondacioni i Gazetarëve dhe i Shkrimtarëve.

Fondacionit ka krijuar shumë xhelozi tek grupimet e tjera që janë formuar. Tani, për fat, gjithsecili është duke kënduar të njëjtën këngë. Për këtë arsye, unë besoj që toleranca do të përhapet shumë shpejt në masat e gjera, do të shpërndahet në të gjithë vendin dhe siç tha një artist, ne do të jemi të aftë të ecim së bashku krah për krah, me zemrat dhe duart të bashkuara drejt "një të ardhmeje të lumtur" me dëshirën e Zotit.

Kur Profeti po vdiste dhe ishte nisur për në botën tjetër, tha: *Unë po e lë në besën tuaj Popullin e Librit,* të *krishterët dhe hebrenjt*ë.[28]

Kur Omeri u qëllua me thikë dhe gjendej në shtratin e vdekjes, tha: *Unë po e lë Popullin e librit që gjendet midis nesh, në besën tuaj. Frikësojuni Zotit në lidhje me ta dhe silluni me drejtësi ndaj tyre.*[29]

Pasi shpartalloi armiqtë në Malazgirt, komandanti turk Sulltan Alparsllani priti drejtuesit ushtarakë dhe udhëheqësit e kampit kundërshtar në tendën e tij. Ai atëherë i përcolli ata duke u siguruar jetën për në kryeqytetin e tyre, Kostandinopojë (tani Stamboll), shoqëruar nga disa prej ushtarakëve të tij. Në Jerusalem, komandanti dhe udhëheqësi, Sulltan Salahadin Ejubi, vajti një natë në çadrën e Riçardit, udhëheqësit të kryqëzatës, të shprehte dhimbjen e tij, pavarësisht se trupat e Riçardit kishin vrarë mijëra myslimanë.

Ne jemi fëmijët e një kulture që ka lindur me njerëz të tillë. Ne jemi trashëgimtarët e një kulture që ka përfshirë botën, që është më e plota dhe më universalja tolerancë. Ky koncept është përhapur sot si valët e detit, duke u shtrirë në të katër anët e botës. Unë jam plotësisht i bindur që vitet e ardhshme do të jenë vitet e tolerancës dhe dashurisë. Ne dëshirojmë ta sjellim botën në këto struktura dhe do ta realizojmë atë. Ne jo vetëm që nuk do të luftojmë kundër njerëzve tanë, por as kundër popujve të tjerë me kulturë, qytetërim, besim dhe botëkuptim të ndryshëm. Burimet dhe argumentet e konflikteve nuk do të kenë asnjë hapësirë dhe duke

[28] Ebu Davud, *Imarat*, 33; Muttaki el-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, IV, 362.
[29] Jahja bin Adem, *Kitabu'l-Haraxh*, 54.

kuptuar edhe njëherë forcën e dashurisë, ne do të jemi në gjendje të hapim zemrat tona për të gjithë me dashuri dhe dhembshuri. Me ndihmën e Zotit, ne do të jemi në gjendje të koncentrohemi në çështjet e rëndësishme me dialog dhe tolerancë, çështje për të cilat bota e sotme ka shumë nevojë.

Kur e vështrova z. Izetin Dogan, m'u kujtua një ngjarje e rëndësishme në historinë islame. Duke përmendur harixhitë, grupimin që u rebelua kundër regjimit të ligjshëm dhe u tubua në Nahravan për ta sulmuar atë, Aliu i nderuar, asokohe kalif, tha: "Do të jetë e padrejtë nëse ne i sulmojmë përpara se ata të na sulmojnë ne!"

Ne jemi një shoqëri e edukuar me kulturën e udhëheqësve të tillë. Në një kohë që ne kemi nevojë më tepër se kurrë për tolerancë, me dëshirën e Zotit, çdo pjesë e shoqërisë duhet të hapë krahët për tolerancën dhe dashurinë, dhe çdo gjë e mirë që vjen prej tyre do të përhapet më shpejt se shpresat që ne kemi ushqyer në të gjitha drejtimet.

Ndoshta unë jam duke marrë shumë nga koha juaj, por nuk mund të qëndroj pa shprehur të gjitha shqetësimet që kam. Shoqëria turke, e cila ndjehet e pikëlluar nga konfliktet e brendshme në këto kohë, është duke pritur tolerancë. Pasi ta ketë gjetur atë, kur të jetë bërë një hap drejt saj, shoqëria do t'i përgjigjet duke hedhur tre hapa përpara. Por gjithashtu është e kuptueshme që ca persona të dobët dhe të parëndësishëm, me fjalët boshe dhe me tërbimin e shfaqur, kanë treguar paqëndrueshmërinë dhe karakterin e tyre si krijesa që synojnë vetëm shkatërrimin, mashtrues në pritë për të sulmuar tolerancën, duke u orvatur të hedhin në erë urat që na lidhin me dialogun. Ne dëshirojmë një faqe të re në historinë tonë tani. Shoqëria jonë, e cila ka kaluar përmes shumë sfidave, do ta përballojë këtë provë të së ardhmes me solidaritet mes individëve dhe do të kapërcejë çdo pengesë në udhën e harmonisë sociale.

Ajo që ne po kërkojmë është shumë e çmueshme. Synimi ynë

për tolerancë dhe dialog që dëshirojmë të arrijmë, do të jetë shumë i kushtueshëm. Ashtu siç nuk është e lehtë të sigurosh gjërat e çmuara e të veçanta, gjithashtu është e vështirë t'i mbrosh ato kur sapo ia ke arritur qëllimit. Arritja e harmonisë shoqërore përmes dialogut dhe tolerancës është një çështje për finalizimin e dy gjërave të çmueshme në radhë për të përmbushur një të tretë. Zoti po na vë në provë në rrugë të ndryshme me qëllim që vlerësimi ynë të jetë maksimal për to dhe në përputhje me qëndrimin tonë, të na nxisë për të qenë në shërbim të tyre. Ne do t'u qëndrojmë të gjitha provave duke qenë në të njëjtin mendim me poetin Junus Emre që thoshte: *Nëse ashpërsia vjen nga Zoti i Madhërishëm / ose bujaria nga Hiri i Tij, / të dyja janë gëzime për shpirtin. / Bekimi i Tij dhe zemërimi i Tij janë kënaqësi.*

Ne duhet të jemi si qenie "pa duar kundër atyre që na qëllojnë dhe pa gjuhë kundër atyre që na mallkojnë." Edhe sikur ata të na e bëjnë trupin copa-copa, ne përsëri do të qëndrojmë të pathyer dhe do ta shtrëngojmë gjithsecilin me dashuri dhe dhembshuri. Dhe, me dashuri për njëri-tjetrin, ne do të ecim drejt së ardhmes.

Unë dëshiroj që kjo mbrëmje e gëzuar të jetë një mundësi për të gjallëruar mëshirën dhe mirëkuptimin. Ju përshëndes të gjithëve me respektin tim më të thellë.

ISLAMI - NJË FE E TOLERANCËS

Fjala Islam është në arabisht, e të njëjtit burim me fjalët *paqtim* dhe *nënshtrim*. Domethëniet e tyre udhëzojnë paqen dhe gëzimin dhe sanksionojnë sigurinë dhe harmoninë.

Islami është një fe për sigurinë, qetësinë dhe paqen. Këto parime e përshkojnë jetën e myslimanëve. Kur myslimanët falin namazin, ata i presin lidhjet me këtë botë, kthehen te Zoti i tyre me besim e bindje, dhe qëndrojnë me vëmendje në praninë e Tij. Duke mbaruar faljen, si të jenë duke u kthyer në jetë, ata përshëndesin në të djathtë dhe në të majtë të tyre me urimin për paqe për të tjerët: "Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ju!" Me një urim për siguri dhe besim, paqe dhe gëzim, ata kthehen përsëri në jetën e përditshme.

Të përshëndesësh dhe të urosh të tjerët për siguri dhe besim është një prej akteve më të dobishme në Islam. Kur e pyetën Profetin se cila vepër ishte më e çmuar në Islam, ai u përgjigj, "*Të ushqesh të tjerët, dhe të përshëndesësh ata që i njeh si dhe ata që nuk i njeh.*"[30]

Islami i akuzuar për terrorizëm

Sa e papërshtatshme është që Islami, i cili është bazuar në këtë frymë dhe kuptim, është paraqitur nga disa qarqe si sinonim i terrorizmit. Ky është një gabim i madh historik. Duke mbuluar një sistem të bazuar në sigurinë dhe besimin me vellon e terrorizmit, s'bëhet tjetër vetëm se shfaqet padituria mbi frymën e Islamit. Nëse ndonjëri është në kërkim të pamjes së vërtetë të Islamit në

[30] Ebu Davud, *Edeb*, 142.

origjinën e tij, në histori dhe në të dërguarit e vërtetë, atëherë ai do të zbulojë që aty nuk përfshihen ashpërsia, egërsia ose fanatizmi. Islami është një fe për mirëkuptim, falje dhe tolerancë, shprehur aq bukur nga korifejtë e dashurisë dhe tolerancës si Xhelaledin Rumiu, Junus Emre, Ahmed Jesevi, Bediuzamani e nga shumë të tjerë. Ata ia kushtuan jetën e tyre predikimit të tolerancës dhe çdonjëri prej tyre u bë një legjendë në kohën e tij si një personifikim i dashurisë dhe tolerancës.

Xhihadi mund të jetë një lëvizje për vetëmbrojtje ose për të larguar pengesat mes Zotit dhe njerëzve me gjykim të pavarur. Historia jonë është e mbushur me shembuj që tregojnë se si janë zbatuar në jetë këto parime.

Sigurisht që ekzistojnë rastet kur lufta është e pashmangshme, ndonëse ajetet Kuranore mbi xhihadin që janë shpallur për kushtet e veçanta, janë përgjithësuar prej disa individëve dritëshkurtër. Ndërsa në të vërtetë lufta është një problem me rëndësi dytësore, këta miopë i kanë dhënë prioritet si një çështje thelbësore. Këta njerëz nuk e kuptojnë domethënien dhe frymën e vërtetë të Islamit. Paaftësia e tyre për të vënë në balancën e duhur çfarë është themelore dhe çfarë është dytësore, i shtyn të tjerët të arrijnë në konkluzionin që smira dhe urrejtja gjenden thellë në shpirtin e Islamit, ndërsa realisht myslimanët e vërtetë janë të mbushur me dashuri dhe mëshirë për të gjithë krijesat. Në lidhje me këtë, sa me vend janë vargjet në vazhdim:

Muhamedi ishte lindur pa dashuri; / Çfarë mund të jetë krijuar jashtë dashurisë për *Muhamedin?*

Dashuria është esenca e krijimit

Profeti Muhamed, Krenaria e Njerëzimit, ishte një njeri i dashurisë dhe mëshirës. Ai është mbiquajtur edhe *Habibullah,* i dashuri i Allahut, Zotit. Për ta nxjerrë sa më qartë domethënien e këtij atributi, le të shpjegojmë se *habib* do të thotë *i dashuruar*, kurse

për rastin e tij, *i dashuruar pas Allahut,* si dhe *i dashur*, kurse për rastin e tij, *i dashur nga Allahu*. Mendimtarët e shquar të tasavufit, si Imam Rabani, Mevlana Halidi dhe Shah Velijullah, deklaronin se dashuria është stacioni i fundit në udhëtimin shpirtëror.

Zoti e krijoi universin si një manifestim të dashurisë së Tij për krijesat e Tij, në veçanti për njerëzimin, dhe Islami u bë struktura mbi të cilën u thur kjo dashuri. Siç thoshte Bediuzamani, dashuria është esenca e krijimit. Ashtu si një nënë e dashur dhe e dhembshur është e detyruar të thërrasë kirurgun për të shpëtuar jetën e fëmijës së saj, xhihadi e pranon luftën, nëse është e nevojshme, për të mbrojtur të drejtat fondamentale njerëzore siç janë e drejta për jetën dhe liria e besimit. Synimi i xhihadit nuk është posaçërisht lufta.

Njëherë një mik po bisedonte me mua dhe po më thoshte: "Pa bërë përjashtime dhe duke mos marrë parasysh dallimet që ekzistojnë mes besimeve, ju mund të takoheni dhe të bisedoni me çdo njeri dhe kjo shmang tensionin mes myslimanëve dhe kundërshtarëve të mundshëm. Por është parim islam që duhet të duash ata njerëz apo gjëra që mund të jenë në rrugën e Zotit dhe të mos jesh i afërt me ata njerëz apo gjëra që mund të jenë larg nga rruga e Zotit.» Në të vërtetë ky parim është keqkuptuar shpesh, sepse në Islam të gjitha krijesat janë të dashura në përputhje me principet për të qenë i dashur me rrugën e Zotit.

"I papëlqyer në rrugën e Zotit" vlen vetëm për ndjenjat, mendimet dhe atributet. Në këtë mënyrë ne duhet të distancohemi nga fenomene të tilla si imoraliteti, mosbesimi dhe politeizmi, por jo nga njerëzit që janë angazhuar në këto aktivitete. Zoti e krijoi njeriun si qenien më të lartë dhe gjithsecili, në një farë mase, ka një pjesë në këtë fisnikëri. I Dërguari i Tij u ngrit në këmbë në shenjë respekti për natyrën njerëzore kur po kalonte funerali i një hebreu. Kur në ato momente iu përkujtua se kush ishte i ndjeri, Profeti u përgjigj: "Por është një njeri," duke shfaqur vlerat që Islami i ka dhënë krijesës njerëzore.

Ky veprim tregon për respektin e madh që Profeti kishte ndaj çdo njeriu. Nën dritën e këtij akti, pjesëmarrja e disa individëve apo organizatave të vetëquajtura islame në akte terroriste nuk është në rrugën e udhëzuar nga Islami. Shkaqet e këtij terrorizmi duhet të kërkohen në veprimet individuale, në interpretimin e shtrembër të besimit dhe në faktorë apo motive të tjera. Islami nuk e mbështet terrorizmin. Atëherë, si mundet që një mysliman që e ka kuptuar plotësisht Islamin, të jetë terrorist?

Nëse ne mund ta nxjerrim përmbajtjen e plotë të Islamit prej heronjve të dashurisë siç janë Nijazi Misrí, Junus Emre dhe Xhelaledin Rumiu, nëse mund t'i transmetojmë mesazhet e tyre të dashurisë, dialogut dhe tolerancës tek ata që janë të etur për to, atëherë gjithsecili do të vrapojë ta përqafojë dashurinë, paqen dhe tolerancën që ne përshkruam.

Përkufizimi i tolerancës në Islam është i tillë që Profeti nuk lejonte as përgojimin e mosbesimtarëve. Për shembull, Ebu Xhehli vdiq pa e përqafuar Islamin, megjithë përpjekjet e vazhdueshme të Profetit. Mosbesimi dhe armiqësia e tij ndaj Profetit ishte në atë shkallë që Ebu Xhehli e meritonte të etiketohej *si babai i injorancës dhe paturpësisë*. Angazhimi i tij i vazhdueshëm kundër Islamit ishte një problem për myslimanët.

Pavarësisht nga armiqësia e shfaqur prej Ebu Xhehlit kundër Profetit, në një kuvend të sahabëve ku merrte pjesë edhe Ikrime që ishte djali i Ebu Xhehlit, Profeti një ditë qortoi njërin prej tyre pse kishte fyer Ebu Xhehlin: *"Mos i lëndoni të tjerët duke kritikuar baballarët e tyre."*[31] Njëherë tjetër ai tha: *"Të mallkosh nënën dhe babain tënd është një mëkat i madh."* Bashkëpunëtorët e pyetën: "O i Dërguari i Zotit, a mundet ndonjëri të shajë apo mallkojë prindërit e tij?" Prijësi i Profetëve u përgjigj: *"Kur dikush shan apo mallkon prindërit e të tjerëve dhe ka marrë si përgjigje të njëjtën gjë, atëherë ai ka sharë apo mallkuar prindërit e tij!"*[32]

[31] Hakim, *el-Mustadrak*, III, 241; Muttaki el-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, XIII, 540.
[32] Muslim, *Iman*, 145; Tirmidhi, *Birr*, 4.

Ndërsa Profeti i Mëshirës ishte tepër i ndjeshëm ndaj respektit për të tjerët, disa myslimanë sot e justifikojnë qëndrimin e tyre që nuk është korrekt në bazë të fesë që ata përfaqësojnë. Kjo tregon që ata nuk e kanë kuptuar Islamin, një fe në të cilën smira dhe urrejtja nuk kanë vend.

Në Kuran spikasin mirëkuptimi dhe toleranca. Në një ajet thuhet kështu për njeriun e përshpirtshëm:

…Të cilët japin kur janë në kamje dhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin, dhe falin njerëzit; e Allahu i do bamirësit. (Al Imran, 134)

Me fjalë të tjera, myslimanët nuk duhet të jenë hakmarrës kur përgojohen apo sulmohen. Nëse është e mundur, siç është shprehur Junusi, ata duhet të veprojnë sikur janë pa duar për të goditur, apo pa gjuhë për t›u përgjigjur dhe pa zemër për t›u zemëruar. Ata duhet ta kapërdijnë inatin e tyre dhe të mbyllin sytë për gabimet e të tjerëve. Fjalët e përzgjedhura në ajet janë kuptimplote. *Kadhm* përkthehet *kapërdije, gëlltitje*, që fjalë për fjalë nënkupton kapërdimin e diçkaje si gjembi, që në të vërtetë është i papërtypshëm, në këtë mënyrë tregon se nuk ka gjë më të vështirë se kapërdimi i zemërimit. Në një tjetër ajet, ndërsa përmenden veçoritë e besimtarëve, thuhet:

(Robërit e Zotit janë) edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm, dhe kur kalojnë pranë së keqes, e ruajnë dinjitetin e vet. (Furkan, 72)

Kur vështrojmë jetën e lartësuar të të Dërguarit të Zotit, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, e kuptojmë se ai gjithmonë ka ndjekur parimet e shprehura në Kuran. Për shembull, një bashkëpunëtor njëherë u pendua për një mëkat dhe bëri të ditur: "Unë jam fajtor për imoralitet. Cilido që të jetë ndëshkimi, jepe atë pa mëdyshje dhe më pastro!" Prijësi i Profetëve i tha: "Kthehu pas dhe pendohu para Zotit që fal të gjitha mëkatet!"[33] Ky veprim u përsërit tri herë me radhë. Një herë tjetër, një bashkëpunëtor u ankua tek Profeti

[33] Muslim, *Hudud*, 17, 23; Buhari, *Hudud*, 28.

për një person që i kishte vjedhur sendet e tij. Ndërsa demaskimi i vjedhësit nuk ishte bërë akoma, bashkëpunëtori u shpreh: "Unë kam ndryshuar mendje dhe dëshiroj ta quaj të mbyllur këtë çështje, unë e kam falur këtë njeri. Profeti e pyeti: "Atëherë pse e bëre këtë çështje të njohur dhe nuk e fale që në fillim?"[34]

Kur shembuj të tillë janë studiuar në origjinën e tyre, është e qartë që sjelljet e atyre që veprojnë me armiqësi dhe urrejtje, që e vështrojnë çdo njeri me zemërim dhe që i etiketojnë të tjerët si të pafe, janë në kundërshtim të hapur me Islamin, fenë e tolerancës dhe dashurisë. Një mysliman është një njeri me dashuri dhe mëshirë, për të cilin është i papranueshëm çdo akt terrorist dhe gjithashtu çdo shfaqje e urrejtjes apo shpirtligësisë ndaj çdo njeriu dhe gjithçkaje tjetër.

[34] Ebu Davud, *Hudud*, 14 (4394); Nesai, *Sarih*, 4 (8, 68); Muvatta, *Hudud*, 28 (2, 834).

ISLAMI SI FE E MËSHIRËS UNIVERSALE

Kjo jetë është bekimi më i rëndësishëm dhe më i qartë i Zotit të Plotfuqishëm, kurse jeta e vërtetë dhe amshimi janë në botën e pasme. Meqë ne mund ta meritojmë këtë jetë vetëm për pëlqim të Zotit, Ai dërgoi profetët dhe shpalli shkrimet e shenjta si shprehje të Mëshirës së Tij për njerëzimin. Ndërsa përmendte bekimet e Tij për njerëzimin, Ai fillonte:

Mëshiruesi. Ia mësoi Kuranin. E krijoi njeriun, dhe ia mësoi atij të folurit. (Rahman, 1-4)

Të gjitha aspektet e kësaj jete janë provë për botën tjetër dhe asnjë krijesë nuk mund t'i shmanget kësaj rruge. Ky rregull është i dukshëm në çdo përpjekje dhe mëshira qëndron në çdo arritje. Disa ndodhi "natyrore" ose tronditje shoqërore mund të vështrohen si të pakëndshme në fillim, por ne nuk duhet t'i gjykojmë ato si ngjarje që nuk përputhen me mëshirën. Ata janë si re të zeza ose vetëtima dhe bubullima që, ndonëse janë të frikshme, na sjellin sihariqin për shiun. Në këtë mënyrë i tërë universi i thur lavde të Gjithëmëshirshmit.

Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, është si një burim me ujë të kthjellët në zemër të shkretëtirës, si një rreze drite në errësirën e paanë. Ata që janë përgjëruar për këtë burim mund të përdorin aq ujë sa t'u nevojitet për të shuar etjen, për të pastruar mëkatet dhe për t'u ndriçuar me dritën e besimit. Mëshira është si një çelës magjik në duart e Profetit, me të ai hap zemrat që janë ngurtësuar dhe ndryshkur kur ndonjë mendon që ato nuk mund të hapen kurrë. Por ai bën akoma më shumë: ndez një pishtar të besimit tek ato.

Mëshira e të Dërguarit të Zotit përfshin çdo krijesë. Ai dëshironte që gjithsecili të ishte i orientuar në rrugën e drejtë, domethënë, t'i besonte Allahut, misionit të tij profetik dhe Kuranit. Në fakt, kjo ishte çështja e tij më e madhe:

A mos vallë do ta shkatërrosh veten nga pikëllimi duke rendur pas tyre, nëse ata nuk besojnë në këtë fjalë (Kuran)? (Kehf, 6)

Por si mund t'i fuste ai në rrugë të drejtë ata që këmbëngulnin në shtypjen dhe persekutimin, ata që nuk e pranonin atë dhe ndjekësit e tij meqë adhuronin Zotin e Vetëm, ata që kishin ngritur armët për ta shkatërruar atë? Ai ka për të luftuar me këta njerëz, ndonëse mëshira e tij universale i ngërthen të gjitha krijesat. Për këtë arsye ndërsa ishte i plagosur rëndë në betejën e Uhudit, ai ngriti duart e tij dhe u lut: *O Zot, fali njerëzit e mi, ata nuk dinë ç'bëjnë!*[35]

Mekasit, populli i tij, i shkaktuan aq shumë vuajtje, sa, më së fundi, ai emigroi në Medine. Edhe pas kësaj, pesë vitet e ardhshme ishin larg nga paqja. Megjithatë, kur ai triumfoi mbi Mekën pa gjakderdhje në vitin e njëzet e një pas profetësisë, i pyeti mekasit e pafe: *"Si prisni që t'ju trajtoj ju?"* Ata iu përgjigjën të gjithë së bashku: "Ti je një njeri i lartësuar, bir i një ati të lartësuar!" Ai atëherë u tregoi atyre vendimin e tij: *"Ju mund të jetoni, nuk do të ketë fajësim për ju sot. Ndoshta Zoti do t'ju falë. Ai është më i Mëshirshmi!"*[36] Pas tetëqind e njëzet e pesë vjetësh, Fatih Sulltan Mehmeti II tha të njëjtën gjë me rënien e Bizantit pas marrjes së Kostandinopojës. Kjo është mëshira universale që përçon Islami.

I Dërguari shfaqi shkallën më të lartë të mëshirës kundrejt besimtarëve:

Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë, dhe është është i butë e i mëshirshëm për besimtarët. (Teube, 128)

[35] Kadi Ijad, *Shifa*, I, 78-79; Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, IV, 93.
[36] Ibni Hisham, *Siratu'l-Nebevijje*, IV, 55; Ibni Kethir, *el-Bidaje ve'n-Nihaje*, IV, 344.

Ai ishte i përulur e i butë ndaj besimtarëve… (Hixhr, 88)

Profeti është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetë vetes së tyre... (Ahzab, 6)

Kur një nga bashkëpunëtorët e tij vdiq, ai pyeti ata që merrnin pjesë në funeral nëse i ndjeri kishte lënë borxhe pas. Me njohuritë që zotëronte, Profeti përmendi ajetet e mësipërme dhe njoftoi që kreditorët duhej të shkonin tek ai për shlyerjen e borxheve.

Hipokritët dhe mosbesuesit ishin nën mëshirën e tij. Ai e dinte se kush ishin hipokritët, por kurrë nuk i identifikoi dhe demaskoi ata, përndryshe, do t'i kishte privuar nga të gjitha të drejtat qytetare që ata i kishin fituar duke deklaruar dhe ushtruar në opinion besimin e tyre. Më pas ata jetuan mes myslimanëve, mohimi i tyre mund të jetë reduktuar ose ka ndryshuar, por gjithmonë me një hije dyshimi, duke pakësuar kështu frikën e tyre nga vdekja dhe mundimin që i shoqëronte vazhdimisht shkaktuar nga pohimi i mosekzistencës pa fund pas vdekjes.

Zoti nuk i shkatërroi të gjithë mosbesuesit bashkërisht, ndonëse Ai kishte zhdukur shumë popuj të tillë në të kaluarën:

Po Allahu nuk do t'i dënojë ata derisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t'i dënojë derisa ata kërkojnë falje. (Enfal, 33)

Ky ajet u referohet mosbesuesve në kohë dhe vende të ndryshme. Zoti nuk do të shkatërrojë të gjithë popujt si dhe ata që ndjekin të Dërguarin. Përveç kësaj, Ai ka lënë të hapur derën e pendimit deri në ditën e fundit. Çdonjëri mund ta pranojë Islamin ose të kërkojë mirëkuptimin e Zotit, pavarësisht nëse ata e shohin veten të mbytur në mëkate.

Për këtë arsye, armiqësia e një myslimani ndaj jobesimtarëve është një sjellje për të ardhur keq. Kur Omeri vështroi një të moshuar rreth të tetëdhjetave, u ul në gjunjë dhe filloi të lotonte. Kur e pyetën pse po qante, ai u përgjigj: "Zoti i dha jetëgjatësi, por ai nuk ishte në gjendje të gjente udhën e vërtetë!" Omeri ishte një ndjekës i të Dërguarit të Zotit, Profetit, i cili kishte thënë:

Unë nuk kam zbritur si mallkim, por si mëshirë për njerëzit![37]

Unë jam Muhamedi, dhe Ahmedi (i lartësuari), dhe Mukaffi (Profeti i Fundit); Unë jam Hashiri (Profeti i fundit në praninë e të cilit njerëzit do të mblidhen); Profeti i Pendimit (Profeti për hir të të cilit dera e pendesës do të qëndrojë gjithmonë e hapur) dhe Profeti i Mëshirës.[38]

Xhebraili gjithashtu përfitoi nga mëshira e Kuranit. Njëherë, pasi Profeti e pyeti Xhebrailin nëse ai bënte pjesë në mëshirën që përfshihej në Kuran, Xhebraili u përgjigj se po dhe u shpjegua: "Unë nuk isha i qartë për fundin tim. Prandaj kur u shpall ajeti, "*… që është i respektuar atje (në mesin e engjëjve) dhe besnik*" (Tekuir, 21) unë u ndjeva i qetë!" [39]

I Dërguari i Zotit kishte një dhembshuri të veçantë për fëmijët. Kur ai shikonte një fëmijë që po qante, e pushtonte në krahët e tij dhe ndante së bashku me të brengën apo hidhërimin. Ai ndjente dhimbje për një fëmijë më tepër se sa mund të ndjente nëna e tij. Një herë ai tha: *Unë po falem dhe dëshiroj ta çoj sa më gjatë faljen. Por unë po dëgjoj një fëmijë duke qarë dhe po e shkurtoj faljen për t'ia larguar ankthin nënës.*[40]

Ai i merrte fëmijët në krahë dhe i përqafonte. Njëherë, ndërsa po përkëdhelte dhe puthte nipin e tij të madh, Hasanin, Akrah ibn Habisi i tha: "Unë kam dhjetë fëmijë, por asnjërin prej tyre nuk e kam puthur kurrë!" I Dërguari i Zotit iu kthye: *"Për atë që nuk ka mëshirë për të tjerët, nuk mund të ketë mëshirë!"*[41] Sipas një versioni tjetër, ai shtonte: *"Çfarë mund të bëj për ty nëse Zoti e ka larguar mëshirën prej teje?"*[42]

Ai thoshte: *"Mëshironi në tokë që ata në qiell t'ju mëshirojnë*

[37] Muslim, *Birr*, 87.
[38] Hanbel, *Musned*, IV, 395; Muslim, *Fedail*, 126.
[39] Kadi Ijad, *esh-Shifa*, I, 17.
[40] Buhari, *Edeb*, 65; Muslim, *Salat*, 192.
[41] Buhari, *Edeb*, 18.
[42] Buhari, *Edeb*, 18; Muslim, *Fedail*, 64.

ju!"[43] Kur Sad ibn Ubade u sëmur, i Dërguari i Zotit shkoi ta vizitonte në shtëpi. Duke vështruar bashkëpunëtorin e tij besnik që ishte në gjendje të rëndë, ai filloi të qante dhe duke treguar gjuhën, tha: *"Zoti nuk ndëshkon për lotët apo brengat, por Ai është ndëshkues për këtë!"*[44] Kur Osman ibn Maduni vdiq, ai qau pa pushim. Përgjatë funeralit, një grua tërhoqi vëmendjen duke thënë: "Osmani fluturoi si një zog në parajsë." Profeti nuk e humbi qetësinë dhe e qortoi gruan: *"Nga e di ti këtë? Akoma unë nuk e di këtë gjë, dhe unë jam Profet!"*[45]

Një anëtar i fisit Benu Mukarrin rrahu njëherë skllaven e tij. Ajo vuri në dijeni të Dërguarin e Zotit, i cili atëherë i dërgoi një mesazh pronarit të saj. Ai thoshte: *"Ti e ke rrahur atë pa asnjë të drejtë. Lëre të lirë!"*[46] Të linte të lirë një skllave ishte më e pakta që pronari mund të bënte në krahasim me ndëshkimin që e priste në botën e përtejme për shkak të sjelljes së gabuar. Edhe para profetësisë, i Dërguari i Zotit gjithmonë mbronte dhe mbështeste vejushat, jetimët, të varfrit dhe të pamundurit. Kur ai u kthye në shtëpi nga mali Hira pas shpalljes së parë, gruaja e tij Hatixhja i tha: "Unë shpresoj që ti do të jesh Profeti për këtë shoqëri, ti që thua gjithmonë të vërtetën, që përmbush besimin tënd, përkrah të afërmit, ndihmon të varfrit dhe të pafuqishmit dhe ushqen miqtë!"[47]

Dhembshuria e tij përfshinte edhe kafshët. Ne dëgjuam prej tij: "*Një grua e përdalë e drejtuar nga e vërteta e Zotit shkoi në parajsë sepse i kishte dhënë ujë një qeni të gjorë që po ngordhte nga etja... Kurse një tjetër grua ishte dërguar në ferr sepse kishte lënë një mace të ngordhte nga uria...*"[48]

Njëherë, ndërsa kthehej nga një fushatë ushtarake, disa nga

[43] Tirmidhi, *Birr*, 16.
[44] Buhari, *Xhenaiz*, 45.
[45] Buhari, *Xhenaiz*, 3.
[46] Muslim, Ejman, 31, 33; Ibn Hanbel, *Musned*, III, 447.
[47] Ibn Sa'd, *el-Tabakatu'l-Kubra*, I, 195.
[48] Buhari, *Enbija*, 54; Muslim, *Selam*, 153.

bashkëpunëtorët kishin marrë nga foletë e tyre ca zogj të vegjël për t'i përkëdhelur. Kur nëna e zogjve kthehet, nuk i gjen në fole zogjtë e saj dhe fillon të fluturojë përreth duke cicëruar në kërkim të tyre. Pasi i treguan për këtë, i Dërguari i Zotit u zemërua dhe urdhëroi që zogjtë të ktheheshin në foletë e tyre.[49]

Ndërsa në Mina, disa nga bashkëpunëtorët iu turrën një gjarpri për ta vrarë, por ai arriti të shpëtonte. Duke ndjekur këtë skenë nga larg, ai vuri në dukje: *"Ai shpëtoi nga ligësia juaj, aq sa ç'shpëtuat edhe ju nga ligësia e tij!"*[50] Ibn Abasi tregonte që i Dërguari i Zotit, pasi vërejti një njeri duke mprehur thikën e tij para syve të deles që do të therej, iu drejtua atij: *"Dëshiron ta therësh atë më shumë se një herë?"*[51]

Dashuria dhe dhembshuria e tij për krijesat ndryshonte prej dashurisë dhe dhembshurisë së atyre që sot vetëshpallen humanistë. Ai ishte i sinqertë dhe i matur në dashurinë dhe mëshirën e tij. Ai ishte një Profet i lartësuar nga Zoti, Krijuesi dhe Përkrahësi i të gjithë qenieve, për drejtimin dhe lumturinë e krijesave të ndërgjegjshme - njerëzit dhe xhindet - dhe harmoninë e ekzistencës. Si i tillë, ai nuk jetoi për vetveten por për të tjerët. Ai ishte një mirësi për të gjithë botët, një manifestim i mëshirës.

Ai çrrënjosi të gjitha dallimet për racat dhe ngjyrat. Njëherë Ebu Dherri u zemërua me Bilalin dhe e ofendoi atë: "Ti je biri i një zezakeje!" Bilali vajti tek i Dërguari dhe ia tregoi ngjarjen me lot në sy. I Dërguari e qortoi Ebu Dherrin: *"Tek ti ekzistojnë akoma shenja të injorancës!"* I penduar thellë, Ebu Dherri u shtri përdhe dhe tha: "Unë nuk do ta ngre më kokën nëse Bilali s'do t'i vinte këmbën mbi të. Bilali e fali dhe ata u pajtuan.[52] Të tilla ishin lidhjet farefisnore dhe njerëzore që Islami krijoi në mes të një populli të egër e të paqytetëruar!

---

[49] Ebu Davud, *Edeb*, 164; Ibn Hanbel, *Musned*, I, 404.
[50] Nesai, *Haxh*, 114; Ibni Hanbel, *Musned*, I, 385.
[51] Hakim, *Mustedrek*, IV, 231.
[52] Buhari, *Iman*, 22.

TOLERANCA DHE DIALOGU NË KURAN DHE SUNET

Kurani gjithmonë i ka miratuar mirëkuptimin dhe tolerancën si parime kryesore, aq shumë sa "shërbëtorët e të Gjithëmëshirshmit" janë paraqitur në mënyrën në vijim:

E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë e kur u drejtohen injorantët, ata thonë: "Paqe!" (Furkan, 63)

(Robërit e Zotit janë) edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm, dhe kur kalojnë pranë së keqes, e ruajnë dinjitetin e vet. (Furkan, 72)

Dhe kur dëgjojnë ndonjë marrëzi, i kthejnë shpinën dhe thonë: "Ne kemi veprat tona e ju tuajat…" (Kasas, 55)

Thelbi i këtyre ajeteve konsiston në faktin që ata që janë favorizuar si rob të vërtetë të Zotit, kur përballen me fjalë e shprehje të pakuptimta e të neveritshme, nuk thonë asgjë të pahijshme, por vazhdojnë në rrugën e tyre me një sjellje dinjitoze. Më shkurt, "secili vepron sipas rrugës së vet…" (Isra, 84) dhe kështu manifeston karakterin e tij apo të saj. Në karakterin e heronjve të tolerancës është mirësjellja, gjykimi dhe toleranca. Kur Zoti dërgoi Musain dhe Harunin te një njeri që pretendonte se ishte zot, siç ishte shprehur Faraoni, Ai i urdhëroi ata që të silleshin butë dhe të flisnin me qetësi (Ta-Ha, 44).

Jeta e Krenarisë së Njerëzimit, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, ishte drejtuar në orbitën e mirëkuptimit e të vetëpërmbajtjes. Të njëjtin qëndrim kishte mbajtur edhe ndaj Ebu Sufjanit, i cili e persekutoi atë gjatë gjithë jetës. Gjatë pushtimit të Mekës, megjithëse Ebu Sufjani shprehej se ende nuk ishte i bindur në lidhje

me Islamin, i Dërguari thoshte: "Ata që gjejnë strehë në shtëpinë e Ebu Sufjanit, janë të sigurt, ashtu siç janë të mbrojtur ata që gjejnë strehë në Qabe. Prandaj, në respekt të strehës dhe mbrojtjes së sigurt, shtëpia e Ebu Sufjanit ishte përmendur përkrah Qabes. Në opinionin tim modest, një tolerancë e tillë ishte më e çmueshme se tonelatat e arit që mund t'i ishin dhënë Ebu Sufjanit, një njeri rreth të shtatëdhjetave, në të cilin egoizmi dhe pasioni për të drejtuar fisin kishin zënë rrënjë thellë.

Përveç se ishte urdhëruar të mbështetej në tolerancën, dhe dialogu të ishte në themel të misionit të tij, Profeti u ishte drejtuar edhe atyre me të cilët kishte gjëra të përbashkëta siç ishin popujt e librit (hebrenjtë dhe të krishterët):

Thuaju: "O ithtarë të librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: Se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!"[...] (Al Imran, 64)

Në një tjetër ajet, ata të cilët i kanë zemrat e mbushura me besim dhe dashuri janë urdhëruar të sillen me mirëkuptim dhe tolerancë edhe ndaj atyre që nuk besojnë në jetën e përtejme:

Thuaju atyre që besuan: le t'ua falin atyre që nuk presin ndëshkimet e Allahut, ashtu që Ai vetë ta dënojë një popull për shkak të veprave që bën. (Xhathije, 14)

Ata që e konsiderojnë veten të drejtuar nga këto ajete, të gjithë adhuruesit e dashurisë që ëndërrojnë për t'u bërë shërbëtorë të vërtetë të Zotit thjesht sepse janë qenie njerëzore, ata që kanë shpallur besimin e tyre dhe prandaj bëhen myslimanë dhe kryejnë detyrimet e përcaktuara fetare, duhet të sillen me tolerancë dhe durim dhe të mos kundërshtojnë asgjë nga njerëzit e tjerë. Ata duhet të mbajnë qëndrimin e Junus Emresë: për të mos qëlluar mbi ata që i godasin, për të mos iu përgjigjur vrazhdë atyre që i mallkojnë dhe për të mos u mbajtur mëri atyre që i përgojojnë!

DIALOGU NË FRYMËN DHE KUPTIMIN MUHAMEDAN

Unë nuk dëshiroj të mburrem dhe kam një kujtesë të dobët, por sidoqoftë mund të them përmendësh njëri pas tjetrit dhjetë ajete që përshkohen nga mirëkuptimi, dialogu dhe e bëjnë gjithsecilin të hapë zemrën për të tjerët. Kjo tregon natyrën gjithëpërfshirëse ose universalitetin e Islamit.

Për shembull, Kurani shpall:

"Pajtimi është më i dobishmi!" (Nisa, 128).

Ajeti nuk është i domosdoshëm vetëm për ngjarje, kuptime dhe struktura të veçanta. Është normë për të gjithë. Për më tepër, a nuk e bëjnë të qartë rrënjët e emrit "Islam" qëndrueshmërinë, nënshtrimin, paqen, sigurinë dhe besimin? Atëherë a është e mundur për ne të jemi myslimanë të vërtetë nëse nuk i shfaqim dhe pranojmë plotësisht këto karakteristika. Përveç kësaj, domethënia e këtij emri të shenjtë është një esencë që i bashkon duke i përfshirë të gjithë dhe duke afruar çdo gjë me dashuri. Por nëse ne nuk e sjellim egon tonë në këtë frymë, atëherë nuk mund të konsiderojmë se e kemi kuptuar Islamin, se e kemi dëgjuar thirrjen e tij, apo ta kemi përfaqësuar atë.

Së bashku me normat që sigurojnë paqen dhe sigurinë, në Kuran janë gjithashtu ajetet që tregojnë qëndrimin në lidhje me kriminelët dhe njerëzit që nxisin anarkinë dhe dhunën. Për këta njerëz aty janë të ligjshme sanksionet, ndëshkimet dhe reprezaljet. Nëse në lidhje me ajetet dhe hadithet që trajtojnë këto çështje ose përfundimet e tyre, ne nuk marrim në konsideratë kushtet, nëse

ne nuk ndajmë esencën nga hollësitë dhe arritjet nga synimet, nëse nuk vlerësojmë ajetet në kontekst të situatës si para ashtu dhe pasi ata janë shpallur, atëherë gjithmonë do të arrijmë në një konkluzion të gabuar.

Unë mundem të them që paqja, dashuria, mirëkuptimi dhe toleranca janë fondamentale në Islam, të tjerat janë jothelbësore. Akoma, është e nevojshme t'u japim përparësi çështjeve kryesore të Islamit në përputhje me rëndësinë e tyre. Për shembull, nëse Zoti i jep rëndësi dashurisë, nëse Ai na ka treguar që Ai i do ata të cilët e duan Atë, dhe nëse i ka dhënë një personi të cilin Ai e do më shumë, emrin "Habibullah," pra një që dashuron Zotin dhe është i dashuruar prej Tij, atëherë ne kemi për ta marrë këtë si një parim themelor. Çështjet si xhihadi kundër hipokritëve apo mosbesuesve janë të dorës së dytë dhe të domosdoshme nga rrethanat. Normat janë të lidhura me shkaqe dhe kushte të ndryshme. Nëse nuk ekzistojnë arsyet, atëherë normat nuk do të jenë të detyrueshme.

Normat në lidhje me çështje të tilla si ekzekutimi, mërgimi dhe lufta varen nga shkaqe të ndryshme. Thelbësore është shpjegimi dhe bartja e Islamit me fjalë të ëmbla dhe sjellje njerëzore. Gjithashtu, paqja, drejtësia dhe stabiliteti janë esenciale në Islam, lufta bëhet nënprodukt i rrethanave dhe varet nga disa kushte. Për fat të keq, ata që injorojnë thelbin dhe nuk marrin në konsideratë motivet për normat dhe rregullat sekondare, ata që nga leximi i Kuranit në të njëjtën mënyrë si të pagdhendurit *dhahiri,* literalistë, i vënë theksin dhunës, këta njerëz nuk i kanë kuptuar normat, arsyet për ta ose burimet e tyre, ose ata nuk e kanë kuptuar Islamin.

Kur motivet përkatëse shfaqen, sigurisht rregullat e varura nga arsyet bëhen aktive. Për shembull, kur ushtritë armike të huaja sulmojnë vendin tonë, ne sigurisht nuk do të qëndrojmë të qetë në një qoshe dhe t'u themi atyre: "Sa mirë që erdhët!"

Ne vështrojmë botën në të cilën gjejmë vetveten! Duke iu referuar lajmeve të kohëve të fundit të botuara në një prej gazetave të

përditshme, "luftërat e përgjakshme" po vazhdojnë në pesëdhjetë e gjashtë vende të globit. Ende lotët shkaktojnë përmbytje dhe gjaku derdhet në shumë pjesë të botës. Në shumë prej këtyre luftërave, në disa prej vendeve që mbrojnë demokracinë dhe të drejtat e njeriut shfaqen të dy qëndrimet. Atëherë, duke kundërshtuar luftën synon të kundërshtosh një realitet njerëzor. Për këtë arsye, në momentin që dikush cenon të drejtat demokratike dhe liritë tona, ne sigurisht, do të mbrojmë vetveten dhe do të luftojmë po të jetë e nevojshme. Por siç e përmenda në fillim, këto janë gjëra dytësore. Në themel të Islamit është paqja dhe përqafimi i njerëzimit me dashuri.

Një thirrje për një fjalë të përbashkët

Një tjetër aspekt që i shërben vendosjes dhe ruajtjes së dialogut, është nevoja gjithnjë e në rritje për interesat e përbashkëta me popujt e tjerë. Në fakt, edhe nëse njerëzit me të cilët ne bisedojmë, janë hebrenj apo të krishterë, ky afrim përsëri duhet të jetë adoptuar dhe çështjet që mund të na ndajnë, duhet të shmangen plotësisht. Për shembull, kur Kurani i bëri thirrje popullit të librit, u shpreh: "O populli i librit! Ejani me një fjalë që është e përbashkët mes nesh dhe jush!" Cila është kjo fjalë? "Të mos adhurojmë tjetër veç Zotit." Sepse liria e vërtetë është arritur vetëm nëse nuk jeton në skllavërinë e një tjetri. Kur dikush bëhet rob i Zotit, ka shpëtuar nga skllavëria prej kujtdo tjetër. Prandaj të vijmë dhe të bashkohemi në këtë çështje. Kurani vazhdon:

Të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zotër. (Al Imran, 64)

Ajo që synohet këtu është që pika jonë e parë e përbashkët është besimi në një Zot, akoma nuk është përmendur fakti që Muhamedi është i Dërguari. Në një tjetër ajet:

"Thuaju atyre që besuan: T'i falin ata që nuk shpresojnë në botën tjetër."

Kjo konsiston në faktin që ata që nuk besojnë në botën e

përtejme dhe ringjalljen pas vdekjes të jenë falur,

"Në mënyrë që Ai vetë ta dënojë një popull për shkak të veprave që bën,» (Xhathije, 14),

pra, nëse dikush është për t'u ndëshkuar, atëherë Zoti do ta ndëshkojë atë dhe me këtë çështje nuk ka lidhje askush tjetër.

Një tjetër shembull i qartë për këtë çështje ka lidhje në veçanti me Profetin tonë i cili kishte marrë një paralajmërim të butë nga Zoti në kohën që po lutej kundër disa fajtorëve paganë. Siç është treguar, një fis beduinësh arabë kërkonte që i Dërguari t'u jepte mësues për Kuranin. I Dërguari dërgoi disa prej tyre, por ata u kishin zënë pritë dhe i masakruan në Biri Maune. Pas kësaj ndodhie, i Dërguari i Zotit u lut tek Zoti për ndëshkimin e tyre. Por Zoti zbriti ajetin në vijim:

Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranojë Ai pendimin apo do t'i dënojë, se ata janë vërtet keqbërës! (Al Imran, 128)

Sot kjo është në të mirë të feve anembanë botës. Në opinionin tim, shfaqja e besimit me të gjithë vlerat e tij të vërteta është bërë më e rëndësishme se kurrë më parë. Sot kjo është e nevojshme për njerëzit e virtytshëm, gjakftohtë, të matur, të sinqertë dhe me zemër të pastër, për njerëzit që nuk mendojnë ose veprojnë vetëm për vetveten, që preferojnë mirëqenien e të tjerëve përpara mirëqenies së tyre dhe që nuk mbahen me shpresat tokësore. Nëse shoqëria mund t'i edukojë njerëzit me këto cilësi, atëherë një e ardhme më e mirë do të na presë.

DIALOGU ME POPULLIN E LIBRIT

Qëndrimi dhe sjellja e besimtarëve është përcaktuar në përputhje me shkallën në të cilën gjendet besimi i tyre. Unë besoj që nëse mesazhi është drejtuar saktë, atëherë rrethanat e përcjella me dialog do të jenë në gjendje të gjejnë terrenin e përshtatshëm në vendin tonë dhe kudo në botë. Kështu, si në çdo subjekt, ne duhet t'i avitemi kësaj çështjeje siç është treguar në Kuran dhe nga Profeti, paqja dhe mëshira qofshin mbi të. Zoti thotë në Kuran:

Ky është libri në të cilin nuk ka dyshim; udhërrëfyes për të devotshmit. (Bekare, 2)

Më vonë, këta të devotshëm janë treguar si më poshtë:

Të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin prej asaj që Ne u kemi dhënë; dhe ata që besojnë në atë që të është shpallur ty, dhe në atë që është shpallur para Teje, dhe që janë të bindur plotësisht për jetën e ardhshme. (Bekare, 3-4)

Duke përdorur një stil shumë të butë dhe paksa të tërthortë, Kurani u bën thirrje njerëzve të pranojnë profetët e mëparshëm dhe librat e tyre. Fakti që një kusht i tillë ka gjetur vend në hapje të Kuranit, ngjan të jetë shumë domethënës për mua kur të fillojmë të bisedojmë rreth vendosjes së dialogut me hebrenjtë dhe të krishterët. Në një tjetër ajet Zoti urdhëron:

Diskutoni me ithtarët e librit vetëm me mënyrën më të mirë... (Ankebut, 46)

Në këtë ajet, Kurani përshkruan metodat dhe mënyrat që duhet të përdorim dhe sjelljen që duhet të manifestojmë. Bediuzamani shprehet në një mënyrë shumë domethënëse për ta sqaruar këtë:

"Ata që janë të lumtur për dështimin e kundërshtarëve të tyre në debat janë të pamëshirshëm." Ai shpjegon gjithashtu arsyet: "Ju nuk fitoni asgjë nga humbja e dikujt. Nëse ju jeni humbësi dhe një tjetër person është fituesi, atëherë ju do të korrigjoni gabimet tuaja."

Debati nuk duhet të jetë për hir të egos, por më saktë të mundësojë shfaqjen e të vërtetave. Në një debat politik në të cilin i vetmi qëllim është të mposhtësh një person tjetër, nuk mund të arrihet në përfundime pozitive dhe të dobishme për shoqërinë. Në një debat idesh ku të vërtetat dalin në dukje, principe të tilla si mirëkuptimi i ndërsjellë, respekti dhe përkushtimi ndaj drejtësisë nuk mund të jenë injoruar. Si një normë kuranore, debati mund të zhvillohet vetëm në rrethana që janë të përshtatshme për dialog.

Duke lexuar vazhdimin e ajetit të mësipërm, ne vërejmë që kushti " nëse nuk jeni me ata që nuk besojnë dhe janë keqbërës" është i saktë. Gabimet dhe shtrembërimet gjithashtu përmenden në një ajet tjetër:

Ata që besuan dhe besimin e tyre nuk e molepsën besimin e tyre me padrejtësi, pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar. (En'am, 82)

Në përputhje me interpretimin e ajetit të mësipërm nga Profeti, partneriteti në lidhje me Zotin është i njëjtë me mosbesimin në sensin që një njeri ka përbuzur universin. Tirania më e madhe është të bësh që të heshtin të gjithë zërat që shprehin Zotin në ndërgjegjen e një njeriu. Tirania gjithashtu synon të angazhojë një padrejtësi kundër të tjerëve, duke i shtypur ata dhe duke imponuar idetë mbi të tjerët. Në këtë këndvështrim, tirania përfshin politeizmin dhe mosbesimin dhe ky është mëkati më i madh. Çdo politeist ose jobesimtar nuk mund të jetë një keqbërës i rëndomtë në kuptimin që parashtruam më sipër. Ndonëse ata që shtypin të tjerët, që armatosin vetveten në emër të angazhimit të së keqes dhe që dhunojnë të drejtat e të tjerëve dhe drejtësinë e

Zotit, duhet të jenë përballur me strukturat e ligjit.

Kur shqyrtojmë popujt e librit që nuk janë shtypës, ne nuk kemi të drejtë të sillemi dhunshëm kundrejt tyre ose të mendojmë se si t'i shkatërrojmë ata. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me parimet dhe normat e Islamit, dhe mund të thuhet madje që është antiislam. Në Kuran është shpallur:

Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk ju luftuan për shkak të fesë dhe nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja. Vërtet, Allahu i do të drejtët. (Mumtehine, 8)

Ky ajet u shpall kur një emigrante që quhej Esma, e pyeti Profetin nëse duhej të takohej me nënën e saj që ishte politeiste dhe dëshironte të vinte nga Meka në Medine për ta parë vajzën. Ajeti sugjeronte që një takim i tillë ishte plotësisht i pranueshëm dhe që Esmaja gjithashtu mund të ishte e përzemërt me nënën e saj. Unë e lë në dorën tuaj të mendoni se çfarë qëndrimi duhet të jetë mbajtur për ata që besojnë në Zot, në Ditën e Gjykimit dhe në profetët.

Qindra ajete kuranore trajtojnë dialogun dhe tolerancën shoqërore. Por nuk duhet të mungojë kujdesi për të vënë tolerancën në balancën e saj. Të tregohesh i mëshirshëm me kobrën, do të thotë të jesh i padrejtë me njerëzit të cilët ajo ka kafshuar. Pretendimi që "humanizmi" është më i mëshirshëm se Mëshira Hyjnore është mungesë respekti ndaj mëshirës dhe dhunimit të drejtave të të tjerëve. Në të vërtetë, përveç rasteve të veçanta, Kurani dhe Suneti gjithmonë përkrahin tolerancën. Pëlhura që mbulon tolerancën shtrihet jo vetëm te populli i librit, por, në një sens, tek të gjithë popujt.

SPORTET DHE PROCESI I DIALOGUT

Është e vërtetë që konceptet për demokracinë, paqen, dialogun dhe tolerancën janë përhapur kudo në botë për shkak të zhvillimit të shpejtë që kanë marrë mjetet e komunikimit. E rëndësishme është që këto koncepte të shpalosen akoma më shumë dhe çdokush të përfitojë prej tyre dhe për këtë, përgjegjësitë, si ato personale po ashtu edhe ato shoqërore, bien mbi të gjithë njerëzit.

Në lidhje me këtë çështje, një nga fushat që mund të japë një kontribut të çmueshëm në transmetimin e këtyre koncepteve dhe që mund të ndikojë fuqishëm tek shoqëria, pa dyshim që është sporti. Të gjitha llojet e sporteve, në të vërtetë, gjithçka që ka lidhje me sportin, janë përçues të menjëhershëm nga njëra anë e globit në tjetrën. Sigurisht që ka mënyra të tjera më konvencionale për të përhapur idetë, por duke synuar në këtë drejtim, ne mund të ndihmojmë në përhapjen e ideve të dialogut dhe tolerancës, ide që ne besojmë se janë më thelbësoret për t'u njohur nga gjithsecili për hir të mirëqenies së popullit tonë dhe të mbarë njerëzimit.

Për shembull, një ndeshje futbolli mund të jetë një rast shumë i mirë për t'u shfrytëzuar. Ndeshja do të sjellë kënaqësi tek sportdashësit që e ndjekin dhe në të njëjtën kohë, pa ndonjë vështirësi, vlerat njerëzore mund të shfaqen lehtësisht. Është e rëndësishme që këtë 90 minutësh ta shfrytëzojmë në këtë drejtim. Për shembull, siç ndodh gjithmonë në një takim sportiv, fitimtarët dhe të humburit gjenden në të njëjtën fushë së bashku, duke shtrënguar duart dhe duke shfaqur sportivitetin për të gjithë të pranishmit. Sjellja e tyre reflekton qëndrimin e sportdashësve në terrenin sportiv. Ky mund të jetë një mësim i çmueshëm për tifozët

që herë pas here janë të prirur të djegin ndenjëset, të shajnë njëritjetrin ose edhe të sulmojnë kundërshtarët me armë. Për ta mund të jetë shumë e dobishme ta shohin dhe ta trajtojnë sportin në një këndvështrim që rrezaton ndjenjat dhe synimet më të mira. Edhe nëse spektatorët sot nuk respektojnë faktin që lojtarët shtrëngojnë duart para se të lënë fushën, do të jetë qëndrimi i futbollistëve që do të thyejë urrejtjen dhe shpirtin hakmarrës të tyre, ose më e pakta, do ta neutralizojë atë. Në këtë kohë, për këtë ka nevojë bota e dëshpëruar.

Si brenda, ashtu edhe jashtë terreneve sportive, ca njerëz kanë dëshirë të krijojnë përplasje dhe herë pas here, stadiumet përfshihen nga konfliktet, për pasojë, ata nuk dëshirojnë dialogun ose përmirësimin e marrëdhënieve njerëzore. Për këtë arsye, ne duhet të jemi shumë të matur. Çdo veprim i ndërmarrë duhet të ketë një kuptim të caktuar, të kërkohet sinqeritet dhe prioritet duhet të ketë arsyeja dhe gjykimi i shëndoshë. Për më tepër, çdo profesioni duhet t'i jepen meritat e tij dhe qëndrimi të jetë në përputhje me to. Një imam e vë në përdorim zërin e tij në xhami, por një yll kinemaje, një aktor, ose një autor nuk mund të veprojë në të njëjtën mënyrë. Aktori i jep përparësi gjuhës së trupit ose aktrimit, ndërsa autori, stilit të të shkruarit dhe shkrimit të ideve në një mënyrë letrare. Gjërat janë të ndara në këtë formë, ndryshe, ndikimi dhe efektet e mesazhit do të jenë zvogëluar dhe nuk do të sjellin përfitime. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për sportet. Një atlet duhet të tregojë aftësitë e veta përmes suksesit, sjelljes njerëzore dhe duke jetuar në mënyrë shembullore.

Fatkeqësisht, rëndësia e disa vlerave sot akoma nuk është perceptuar. Njerëzit kanë një nevojë të madhe për fenë ashtu siç kanë nevojë për bukë e ujë, për paqe dhe siguri të mbrojtur nga besimi dhe për garantimin e një jete të përtejme. Unë besoj që kur këto fakte të jenë shpjeguar saktë, atëherë nuk do të ketë dyshim në këtë çështje. Shumë njerëz anë e kënd botës duan të kontribuojnë në emër të Islamit. Por kur ky subjekt i rëndësishëm është ofruar

në një mënyrë të rëndomtë dhe aspak korrekte, urrejtja është thirrur në vend të dashurisë dhe hendeku i pakalueshëm është shfaqur midis njerëzve. Akoma, nga Islami është shpresuar dhe është e nevojshme të jetë një urë midis njerëzve si edhe një faktor që hap shtegun për të kaluar humnerën.

Nëse nuk u përgjigjemi atyre që kanë zgjatur duart për të shfaqur dashurinë dhe respektin e tyre, ne do të bëhemi të papëlqyeshëm. Në fakt, ne do të bëhemi shkaktarë për ngjarje të pahijshme më pas. Shkurt, mund të themi që sporti është një faktor i rëndësishëm në arritjen e dialogut dhe tolerancës shoqërore, nëse është zhvilluar në drejtimin e duhur.

NJERIU IDEAL

NJERIU I RI

Historia na ka sjellë në pragun e një shekulli të ri i cili ka filluar me manifestimin e mirësisë hyjnore. Pavarësisht, ose në të njëjtën kohë me përparimin e shkencës dhe të teknologjisë, dy ose tre shekujt e kaluar kanë dëshmuar një shkëputje nga vlerat tradicionale dhe në emër të përtëritjes, një lidhje me vlera të dyshimta dhe spekulative. Ne shpresojmë, duke u mbështetur në zhvillimet premtuese, që shekulli i ri do të jetë shekulli i besimit dhe vlerave morale që do të dëshmojë rilindjen dhe përtëritjen e besimtarëve.

Mes turmës së lëkundur që nuk ka asnjë zë mendimi ose arsyetimi, një model i ri njeriu do të shfaqet. Njerëzit e rinj do të mbështeten njëkohësisht në arsyen dhe përvojën, por do t'i japin më shumë rëndësi ndërgjegjes dhe frymëzimit, ndonëse kanë vepruar po ashtu edhe në të shkuarën. Ata do të kërkojnë përsosjen në çdo gjë, vënien në ekuilibër të kësaj bote dhe asaj që vjen më pas dhe do të bashkojnë zemrën me intelektin.

E ardhmja për këta njerëz nuk do të jetë e lehtë. Gjithë të porsalindurit janë të dhembshëm, por këta të bekuar do t'i japin botës një gjeneratë të re, të fuqishme dhe të ndritshme. Ashtu siç shiu fillon të bjerë nga retë e mbledhura ngadalë dhe uji buron nga nëntoka, po ashtu dhe "lulet" e gjeneratës së re do të shfaqen një ditë midis nesh.

Këta njerëz të rinj do të jenë të veçantë për nga ndershmëria, në mënyrë që, të çliruar nga influencat e jashtme, të mund të sillen të pavarur nga të tjerët. Asnjë forcë tokësore nuk do të jetë në gjendje

t'i detyrojë ata dhe asnjë modernizëm nuk do të mund t'i shtyjë të shmangen nga udha e tyre. Të pavarur me të vërtetë nga çdo forcë tokësore, ata do të mendojnë dhe veprojnë lirisht, ndërkaq që liria e tyre do të jetë në proporcion të drejtë me robërinë tek Zoti, domethënë, sa më të robëruar ndaj Zotit, sa më të lidhur pas Tij, aq më të fuqishëm në personalitet, për rrjedhojë, më të lirë. Më tepër se një imitim i të tjerëve, ata do të mbështeten në forcën e tyre lëvizëse të veçantë e cila ka lëshuar rrënjë thellë në histori, dhe do të përpiqen t'i pajisin aftësitë gjykuese me vlerat e tyre autentike.

Ata do të mendojnë, hetojnë, besojnë dhe mbushen me kënaqësi shpirtërore. Ndërsa përfitojnë nga kushtet lehtësuese të ditëve të sotme, ata nuk do të lënë pas dore vlerat shpirtërore dhe tradicionale në ndërtesën e botës së tyre.

Nëse ndryshimet dhe reformat mbështeten në vlerat universale të përjetshme, ato mund të mirëpriten me padurim. Ndryshe, do të jenë thjesht fantazi spekuluese por që do të jenë tërheqëse për shkak të modernizmit dhe risisë së tyre. Duke qëndruar i patundur në këto vlera të përjetshme, njeriu i ri dëshiron të vështrojë gjithmonë të ardhmen dhe të ndriçojë errësirën që ka mbuluar botën.

Ata do të jenë plotësisht të besueshëm dhe të dhënë pas së vërtetës dhe në mbështetje të saj do të gjenden gjithkund, gjithmonë të gatshëm të lënë familjet dhe shtëpitë e tyre kur të jetë e nevojshme. Duke mos u dhënë pas kënaqësive tokësore, komoditetit ose luksit, por pas Zotit, ata do të punojnë për të mirën e njerëzimit dhe do të mbjellin farën për një të ardhme të lumtur. Atëherë, duke kërkuar vazhdimisht ndihmë dhe mbarësi nga Zoti, ata do të mbrojnë farërat e tyre nga dëmtimi, ashtu si një pulë mbron vezët e saj. E tërë jeta e tyre do t'i kushtohet rrugës së vërtetësisë.

Për të qëndruar vazhdimisht pranë dhe në komunikim me

mendimet, zemrat dhe ndjenjat e popullit, njerëzit e rinj do të përdorin mjetet e komunikimit masiv dhe do të përpiqen të vënë një balancë të re për drejtësinë, dashurinë, respektin dhe barazinë mes njerëzve. Ata do ta bëjnë pushtetin të dobishëm për të drejtën dhe kurrë nuk do t'i diskriminojnë të tjerët për shkak të ngjyrës apo racës.

Njerëzit e rinj do të bashkojnë plotësisht vlerat morale dhe shpirtërore, dijet e ndryshme, gjykimet e shëndetshme, temperamentin shkencor dhe aktivizmin e matur. Kurrë nuk do të jenë të kënaqur me dijet e tyre, ata vazhdimisht do të jenë në kërkim të dijeve të reja, dije për veten, natyrën dhe për Zotin.

Të pajisur me virtytet dhe moralin që i ka bërë njerëz të vërtetë, njerëzit e rinj do të jenë vetëmohues që e pranojnë dhe e përfshijnë njerëzimin me dashuri dhe janë gati të sakrifikojnë vetveten për të mirën e të tjerëve kur është e nevojshme. Siç e kanë modeluar vetveten në formën e virtyteve universale, në të njëjtën kohë përpiqen të ndriçojnë udhën për të tjerët. Ata do të mbrojnë dhe mbështesin gjithçka që është e mirë dhe e këshillueshme për të tjerët, ndërsa do të kërkojnë të sfidojnë, të ndeshen dhe të çrrënjosin të gjitha të këqijat.

Këta njerëz të rinj do të besojnë që i Gjithëfuqishmi u dha atyre jetë që ata të mund ta njohin dhe ta adhurojnë Atë. Pa bërë dallime midis Librit të Universit dhe Shkrimeve Hyjnore, ata do ta shohin shkencën dhe fenë si dy manifestime të së njëjtës vërtetësi.

Ata nuk do të jenë kurrë reaksionarë. Ata nuk do të jenë në gjurmim të eventualiteteve, për ta do të jetë dinamizmi i historisë që i inicion dhe u jep trajtën eventualiteteve. Me një këndvështrim të drejtë për kohën në të cilën jetojnë dhe për kushtet që i rrethojnë, me përkushtimin ndaj vlerave esenciale të tyre dhe me besimin më të lartë tek Zoti, ata do të jenë në gjendje për të vazhduar vetëpërtëritjen.

Duke mposhtur veten e tyre, mendimet dhe zemrat e tyre si për

ta po ashtu edhe për të tjerët, ata do të zbulojnë të panjohurën. Ata do ta vlerësojnë çdo kohë të humbur gjatë së cilës nuk kanë bërë hapa të rinj në thellësi të vetes dhe universit, si një dobësi të tyren. Siç ata largojnë, përmes besimit dhe dijeve, velin që mbulon pamjen e realitetit, po ashtu do të bëhen edhe më të etur për të përparuar më tutje. Me mesazhet dhe përgjigjet e dërguara nga qiejt, toka dhe detet, ata do të vazhdojnë të udhëtojnë deri sa të kthehen tek Krijuesi i tyre.

PORTRETI I NJERIUT TË ZEMRËS

Me vizionin, besimin dhe veprat e tyre, njerëzit e zemrës janë heronjtë e bashkuar mendërisht dhe shpirtërisht. Thellësia e tyre mbështetet jo në dijet apo njohuritë e fituara, por në pasurinë e zemrave, në pastërtinë e shpirtrave dhe në afërsinë e tyre tek Zoti. Ata besojnë që parimet që i përcillen natyrës njerëzore në emër të dijeve janë të vlefshme vetëm nëse ata e drejtojnë njerëzimin tek e vërteta. Gjithashtu, ata vlerësojnë informacionin dhe veçanërisht njohuritë abstrakte që nuk kanë funksion praktik, sikur të jenë të parëndësishme, siç nuk mund t'i ndihmojnë njerëzit të kuptojnë të vërtetën e krijimit, subjektin dhe vetë krijesën njerëzore.

Njerëzit e zemrës janë përmendore të përvuajtjes dhe modestisë që i janë kushtuar jetës shpirtërore, të vendosur të qëndrojnë larg nga përbaltja shpirtërore dhe fizike, gjithmonë vigjilentë me dëshirat fizike të trupit dhe të gatshëm të përleshen me urrejtjen, zemërimin, lakminë, xhelozinë, egoizmin dhe epshin. Ata gjithmonë përpiqen të japin më të mirën dhe më të çmueshmen, t'u transmetojnë të tjerëve mendimet e tyre për këtë botë, si edhe për tjetrën, dhe janë përherë të duruar e të matur. Njerëzit me besim dhe veprim, që më shumë se të flasin dhe të bëjnë zhurmë, jetojnë sipas besimit të tyre, shfaqin një personalitet shembullor për të tjerët. Njerëzit e tillë nuk rreshtin së mësuari ata që janë duke ecur drejt Zotit se si ta bëjnë këtë më mirë. Në brendësi, ata kanë një zjarr që kurrë nuk mund të shuhet. Megjithëse të pafuqishëm për të larguar dhimbjen brenda vetes, këta njerëz kurrë nuk ankohen tek të tjerët përreth tyre. Si të tillë, janë vazhdimisht emetues të zjarrtë për shpirtrat e atyre që kërkuan strehë tek ata.

Një përmallim për botët transcendentale është i dukshëm në sytë e njerëzve të zemrës. Të përkushtuar për pëlqimin e Zotit, ata vrapojnë pa pushuar për asnjë çast në garë me largësitë përpara tyre, derisa arrijnë tek i Dashuri pa pritur dhe ndërkohë, gjithçka përsëritet pa pushim.

Njerëzit e zemrës janë aq të sinqertë në përkrahjen e së vërtetës, sa të gjithë mendojnë si të vendosin drejtësinë në tokë dhe janë të gatshëm kur të vijnë tek pranimi i Tij, të heqin dorë nga dëshirat dhe kërkesat e tyre. Ata hapin zemrën e tyre për çdo njeri, i mirëpresin me dhembshuri dhe duken si engjëj në mbrojtje të shoqërisë. Në lidhje me sjelljen dhe veprat e tyre, ata përpiqen që të jenë në pajtim me gjithsecilin, gjithashtu të shmangin rivalitetin e dëmshëm me të tjerët, duke shmangur në këtë mënyrë zemërimin dhe mërinë. Edhe po qe se herë pas here këta njerëz japin zgjidhje në favor të bindjes, besimit, metodave dhe rrugëve të tyre, përsëri ata nuk janë në garë me të tjerët. Përkundrazi, i duan të gjithë ata që shërbejnë në emër të fesë së tyre, duan vendin dhe idealet e tyre. Për më tepër, tregohen zemërgjerë me të tjerët në kërkim të veprimtarive frytdhënëse dhe përpiqen të shfaqin respektin më të madh për filozofinë dhe idetë e tyre.

Së bashku me këto përpjekje dhe aktivitete, njerëzit e zemrës që janë në kërkim të rrugëve për të marrë ndihmën e Tij, i japin një rëndësi të madhe përkrahjes dhe mbështetjes te Zoti. Ata i kushtojnë një vëmendje të posaçme bashkimit dhe solidaritetit që janë konsideruar një tregues i përkrahjes së Zotit. Ata janë gati, me gjithë zemër, të bashkëpunojnë me çdo njeri që është në udhë të drejtë, për më tepër, duke e kuptuar në këtë mënyrë bashkimin, ata ngulin këmbë në këtë udhë. Duke besuar që bashkimi sjell me vete edhe mëshirën dhe se mosmarrëveshjet dhe përçarja nuk të çojnë askund, njerëzit e tillë bëjnë gjithçka është e mundur për të fituar përkrahjen dhe miqësinë e të gjithëve, gjithmonë në pritje të mbështetjes Hyjnore.

Njerëzit e zemrës janë të dashuruar pas Zotit, kërkues të përkushtuar të pëlqimit të Zotit. Ata i bashkojnë veprat e tyre me dëshirën e Tij, të pavëmendshëm ndaj ceremonive. Ata shfaqin një ambicie të madhe për ta kënaqur Atë dhe janë të gatshëm për hir të këtij qëllimi të vënë në përdorim ose të braktisin gjithçka posedojnë - për këtë botë ose jo. Në mbretërinë e mendimeve të tyre kurrë nuk ka ndonjë qoshe për shprehje të pakëndshme, të tilla si "unë e bëra atë", "unë e zëvendësova", ose "unë e trajtova atë." Njerëzit e zemrës e gjejnë kënaqësinë në plotësimin e detyrave për të tjerët, sikur kanë ndërmarrë veprime jashtë vetvetes, ata marrin të njëjtën kënaqësi në arritje të tilla si të jenë të tyret dhe vijnë kokulur prapa njerëzve duke lënë gjithashtu nderimet dhe titujt për drejtimin e tyre. Për më tepër, siç i konsiderojnë të tjerët të jenë më të përshtatshëm dhe më të suksesshëm në shërbim të fesë dhe njerëzimit, ata u krijojnë njerëzve të tjera kushte lehtësuese dhe duke bërë një hap prapa, vazhdojnë punën e tyre si të jenë "njerëz të zakonshëm."

Njerëzit e zemrës janë gjithashtu të zënë duke luftuar me vetveten dhe me gabimet e tyre, për të qenë të interesuar për mbrapshtitë e të tjerëve. Në të kundërt, ata sjellin një shembull për të tjerët se si duhet të jetë një njeri shembullor, duke i drejtuar njerëzit të arrijnë horizontet më të larta. Ata bëjnë një sy qorr për gabimet e të tjerëve. Duke iu përgjigjur me buzëqeshje atyre që kanë shfaqur qëndrime negative, ata zëvendësojnë sjelljen e pahijshme me mirësjellje, pa menduar të lëndojnë ndokënd edhe kur kanë mbetur vetë të fyer.

Për njeriun e zemrës, një ushtar i së vërtetës që ka qenë i përkushtuar për të fituar pëlqimin e Zotit me ndjenjat, idetë dhe veprat e tij, e para përparësi është ta çojë jetën bazuar në një besim të plotë dhe të sinqertë. Kështu, është e pamundur që një person i tillë të jetë këshilluar keq nga arritja e qëllimit të tyre edhe nëse i kanë ofruar qiejt përveç botës.

Njerëzit e zemrës kurrë nuk bëhen ziliqarë apo konkurrojnë me ata që kanë të njëjtin ideal dhe që ecin në të njëjtën udhë. Në kundërshtim me këtë, ata plotësojnë boshllëqet e të tjerëve dhe kur bashkëpunojnë me ata, i trajtojnë sikur të jenë lidhur fort pas njëri-tjetrit, tamam si organet e një trupi. Me vizionin e tyre të qartë, ata tërhiqen vetë për të nxjerrë të tjerët në pah në çdo çështje tokësore ose jotokësore, ndërsa vetë kalojnë në plan të dytë. Ata veprojnë si zëdhënës të aftësive të të tjerëve, i mirëpresin dhe i duartrokasin sukseset e tyre me të njëjtën kënaqësi që ata ndjejnë në një festival.

Njerëzit e zemrës çdo veprim e ndërmarrin në përputhje me bindjet dhe natyrën e tyre. Ata përpiqen megjithatë, që të respektojnë mendimet dhe veprimet e të tjerëve. Ata janë në gjendje të jetojnë në harmoni dhe të marrin pjesë në projekte të përbashkëta dhe gjithashtu, të zëvendësojnë fjalën "unë" me fjalën "ne." Lumturia e tyre është sakrifikuar për të tjerët. Megjithatë, nuk presin ndonjë vlerësim apo respekt prej ndokujt. Duke menduar se një pritje e tillë është një formë e korruptimit moral, shmangin personifikimin, famën dhe fatin e tyre dhe më tepër se të dëshirojnë pickimin e një gjarpri apo akrepi, shpresojnë vetëm të jenë harruar sa më shpejt.

Hakmarrja dhe dhunimi i të drejtave të të tjerëve nuk janë pjesë e jetës së tyre. Edhe në kushtet më kritike, ata nuk e humbin toruan por qëndrojnë të qetë. Ndonëse janë njerëz me vlera të mëdha, duken të zakonshëm. Veprimeve të pakëndshme u përgjigjen gjithmonë me mirësjellje dhe duke e konsideruar të keqen një karakteristikë të të këqijve, i trajtojnë ata që janë dëmtuar prej tyre, si monumente të ndershmërisë.

Njerëzit e zemrës e kalojnë jetën të ndriçuar nga drita e Kuranit dhe e Sunetit dhe të udhëhequr nga devocioni, bekimi dhe virtytshmëria. Ata janë një mburojë e vazhdueshme kundër ndjenjave të egoizmit, mburrjes dhe famës, etj, ndjenja që e vrasin

zemrën. Lumturinë e tyre ata ia dedikojnë Zotit të Vërtetë, duke thënë "gjithçka është prej Tij." Me ndërgjegjen dhe bindjet e tyre në rrugë të drejtë, ata i shmangen shqiptimit të fjalës "unë" dhe në vend të saj kanë gjetur shpëtim tek fjala "ne."

Asgjë nuk mund t'i trembë njerëzit e zemrës. Ata nuk i pushton paniku për një ngjarje të vetme. Duke u mbështetur tek Zoti, ata punojnë me këmbëngulje, duke shpresuar në ndihmën e Tij, gjykojnë karakterin e tyre dhe kurrë nuk e thyejnë premtimin e dhënë.

Njerëzit e zemrës kurrë nuk e humbin gjakftohtësinë ndaj kujtdoqoftë edhe nëse janë fyer prej atyre që i kanë lidhur zemrat me Zotin. Kur shohin ndonjë nga vëllezërit apo motrat myslimane të gabojë, nuk e braktisin atë. Me qëllim që të shmangin problemet, gabimet nuk i bëjnë të njohura as për personin, as për publikun. Në të kundërt, ata hetojnë dhe fajësojnë vetveten pasi kanë dëshmuar një akt imoral.

Njerëzit e zemrës u shmangen komenteve për qëndrimet e besimtarëve që janë të prirura për t'u interpretuar ndryshe. Ata mendojnë pozitivisht për çdo gjë që shikojnë dhe dëgjojnë dhe kurrë nuk i shohin veprimet e tilla si zhvillime negative.

Në çdo veprim dhe vepër të tyre, njerëzit e zemrës e kanë plotësisht të qartë që kjo botë nuk është vendi i shpërblimit, por më saktë është vendi për të shërbyer. Prandaj ata zbatojnë detyrat për të cilat janë përgjegjës në një disiplinë të saktë, të shqetësuar për pasojat nëse janë të pasjellshëm ndaj Zotit. Për ta është shumë e rëndësishme të veprojnë në emër të Zotit dhe me pëlqimin e Zotit në gjendje t'i shërbejnë fesë, besimit dhe njerëzimit, dhe ndonëse arritjet e tyre mund të jenë të mëdha, ata ia atribuojnë të gjitha Zotit pa menduar që të marrin një pjesë të suksesit për vete.

Rrënimi për shkak të qëllimit të tyre nuk mund t'i çojë në dëshpërim ose në kundërvënie ndaj njerëzve të tjerë, duke i shqetësuar ata. Ata thonë, "kjo botë nuk është vendi i konflikteve

dhe grindjeve, por i qëndresës dhe durimit" dhe të përmbajtur shtrëngojnë dhëmbët të vendosur në durim. Ata kërkojnë rrugët për të dalë nga çdo situatë ku mund të gjenden, pa humbur shpresën edhe në momentet më kritike dhe janë vazhdimisht të patundur në krijim të strategjive të reja shumëplanëshe. Sot, kur shohim që vlerat njerëzore janë të dëmtuara, kur në mendimin fetar janë shfaqur të krisura, kur në çdo vend shpërthejnë trazirat nga indiferenca, ne kemi nevojë për njerëzit e zemrës po ashtu siç kemi nevojë për ajër dhe ujë.

BESIMTAR IDEAL, MYSLIMAN IDEAL

Myslimanë janë ata, prej duarve dhe gjuhëve të të cilëve *myslimanët* e tjerë janë të sigurt. Emigrantët mekas janë ata që i lanë mënjanë dhe i braktisën gjërat që Zoti i kishte ndaluar.[53]

Le të analizojmë shkurtimisht hadithin e mësipërm. Në origjinalin e hadithit përpara fjalës myslimanë është vënë nyja *al* që e bën atë të shquar. Argumenti qëndron në faktin që aty flitet për besimtarët idealë të cilët hyjnë në atmosferën e sigurisë dhe besimit, duke mos e zhytur veten në një atmosferë ku ata të mund të dëmtojnë ndokënd me gjuhët dhe duart e tyre. Hadithi u referohet vetëm myslimanëve të vërtetë dhe idealë që lanë gjurmët e tyre në të gjithë mendjet, jo atyre që u shfaqën ose pretenduan të jenë të tillë dhe as atyre që e kanë të shkruar "myslimanë" në kartën e identitetit apo në pasaportë. Ne e kuptojmë këtë nga varianti që përdoret në Arabi, në të cilin tregohet diçka specifike, e përcaktuar qartë. Kjo rrjedh nga rregullat gramatikore të gjuhës arabe: "Kur diçka është përshkruar me një nyje shquese, forma më e lartë dhe më e përsosur e fjalës ka dalë në dukje." Prandaj, kur dikush dëgjon "besimtari," e para gjë që i vjen në mendje është domethënia më perfekte e fjalës "besimtar," dhe synimi i këtij hadithi.

Përveç kësaj, një person nuk mund ta mësojë vetë një rregull gramatikor kaq të imët, për të është një çështje që i përket arsimit të detyrueshëm. Pra, nuk ishte e mundur për të Dërguarin e Zotit të kishte një arsimim të tillë, ai nuk dinte shkrim e këndim. Kështu, ai nuk ishte duke shprehur mendimet e tij, por ishte mbështetur në ato gjëra që Mësuesi i Amshuar e kishte mësuar të thoshte. Për

[53] Buhari, *Iman*, 4.

këtë arsye, shumë rregulla gramatikore të imëta gjenden në shprehjet dhe njoftimet e Profetit pa asnjë gabim në përdorimin e tyre.

Le të kthehemi në hadithin e mësipërm: myslimanët e vërtetë janë njerëzit te të cilët një person mund të ndjejë siguri dhe besim aq shumë sa edhe myslimanët e tjerë mund të kthehen tek ta pa asnjë mëdyshje. Një njeri mund t'u besojë atyre një pjesëtar të familjes pa pasur aspak frikë. Ky person nuk do të lëndohet dhe as do të ndjejë dhimbje nga gjuha dhe duart e myslimanëve. Nëse ndonjëri ka ndjekur me vëmendje një tubim me një mysliman të vërtetë, mund të largohet pa dyshuar se ndokush mund ta marrë nëpër gojë ose nuk mund të dëgjojë në mes tyre thashetheme për të tjerët. Myslimanët e tillë janë të ndjeshëm ndaj dinjitetit dhe nderit të njerëzve të tjerë, po aq sa janë për veten e tyre. Ata nuk mendojnë të ushqehen vetë, por të ushqejnë të tjerët. Ata nuk jetojnë për vetveten, por për t'u dhënë mundësi të tjerëve të jetojnë. Edhe kënaqësitë shpirtërore do t'i sakrifikojnë për të tjerët. Unë i përftoj të gjitha këto domethënie nga fakti që nyja shquese në arabisht gjithashtu ka kuptimin *hasr*, një frenues, një devocion me synim të posaçëm.

Siguria dhe myslimanët

Duke iu referuar etimologjisë, fjala *mysliman* dhe folja *selim* rrjedhin të dyja nga rrënja *silm.* Kjo do të thotë që për myslimanët, çdo subjekt gjendet në të njëjtën linjë me *silm* (garancinë), *selim* sigurinë dhe Islamin. Myslimanët janë mbërthyer nga një atraksion hyjnor i tillë sa që e gjithë veprimtaria e tyre sillet rreth kësaj qendre të fuqishme.

Ata i përshëndesin të gjithë me *selam, paqe,* prandaj dashurinë për veten e vënë në zemrën e gjithsecilit. Ata e përfundojnë faljen e tyre me *selam*. Të gjithë njerëzit, xhindet, engjëjt, të gjitha krijesat e vetëdijshme dëgjojnë *selamin, lutjen* e tyre për paqe dhe siguri për të tjerët. Prandaj ata kanë shkëmbyer përshëndetje gjithashtu

edhe me krijesat e padukshme. Deri më tani, asnjë popull tjetër nuk e ka shtrirë përshëndetjen në një hapësirë kaq të gjerë sa myslimanët. Islami bazohet në kryerjen e detyrimeve kryesore që janë agjërimi, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit, dhe ushtrimi i besimit. Kjo do të thotë që ata vendosin të lundrojnë në detin e sigurisë dhe garancisë duke iu bindur urdhrit:

O ju që keni besuar! Hyni të gjithë në paqe! (Bekare, 208)

Ata u hodhën në detin nga buron siguria dhe Islami, pavarësisht nga kushtet. Askush nuk mund të dallojë gjë tjetër veç mirësisë në veprimet dhe qëndrimet e njerëzve të tillë.

Përse gjuha dhe dora?

Si në të gjitha thëniet e Profetit tonë, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, çdo fjalë në hadith është zgjedhur me shumë kujdes. Përse ai ka zgjedhur gjuhën dhe dorën për të folur rreth tyre? Sigurisht një arsyetim tejet i hollë e ka përcaktuar këtë zgjedhje. Një person mund të dëmtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë. Duart përfaqësojnë aspektin fizik (të drejtpërdrejtë) dhe gjuha, aspektin shpirtëror (të tërthortë). Njerëzit i sulmojnë të tjerët drejtpërsëdrejti, fizikisht, ose tërthorazi, përmes thashethemeve dhe vënies në lojë. Myslimanët e vërtetë kurrë nuk përfshihen në veprimtari të tilla, sepse është pranuar që ata gjithmonë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, veprojnë me drejtësi dhe zemërgjerësi.

Profeti e përmend gjuhën përpara duarve sepse në Islam një person mund të hakmerret për atë që ka pësuar me duar, ndonëse nuk është gjithmonë e njëjta situatë kur dëmi është shkaktuar me anë të thashethemeve dhe shpifjeve. Në këtë mënyrë, veprime të tilla mund të shkaktojnë lehtësisht konflikte mes individëve, komuniteteve, madje dhe kombeve. Qëndrimi që duhet të mbahet ndaj kësaj mënyre për të dëmtuar të tjerët është më i vështirë në krahasim me dëmin që mund të shkaktohet me duar dhe është

kjo arsyeja që Profeti përmend gjuhën përpara duarve. Nga kjo pikëpamje, vlerat e myslimanëve para Zotit janë treguar sheshit. Të jesh mysliman ka një vlerë të tillë të madhe para Zotit, sa që myslimanët e tjerë duhet të kenë nën kontroll duart dhe gjuhët e tyre në çdo veprim ndaj tyre.

Një tjetër dimension moral i rëndësishëm i Islamit është që myslimanët duhet të mbajnë brenda tyre gjërat që do të dëmtonin të tjerët, qofshin fizike apo shpirtërore dhe të bëjnë të pamundurën që të mos u bëjnë keq atyre. Le të mos bëjmë të këqija, sepse çdo segment i shoqërisë islame duhet të shfaqë siguri dhe garanci. Myslimanët mund të jenë realisht të tillë nëse brenda tyre ekziston ndjenja e sigurisë dhe gjithashtu zemrat u janë mbushur me besim. Kudo ku ata jetojnë ose kudo ku mund të gjenden, është shfaqur kjo ndjenjë që rrjedh nga *selami*. Ata urojnë për siguri në largim, zbukurojnë faljen e tyre me përshëndetje dhe u dërgojnë besimtarëve të tjerë *selame, lutje dhe urim për paqe për ta* kur e përfundojnë namazin. Sipas të gjitha gjasave, është e pakonceptueshme që njerëzit që e kanë drejtuar tërë jetën e tyre në një orbitë të tillë për *selam*, mund t'i hyjnë një rruge që është në kundërshtim me parimet themelore të garancisë, besimit, drejtësisë, sigurisë së kësaj bote dhe botës tjetër dhe kështu të dëmtojnë vetveten apo të tjerët.

Mund të jetë shumë e dobishme nëse shqyrtojmë thelbin e kësaj thënieje: Myslimanët e vërtetë janë përfaqësuesit më të besueshëm të paqes universale. Ata shtegtojnë ngado me këtë ndjenjë sublime, ushqyer thellë në shpirtin e tyre. Duke mos provuar asnjëherë të shkaktojnë vuajtje dhe mjerim për të tjerët, ata janë kujtuar kudo si simbole të garancisë dhe sigurisë. Në sytë e tyre nuk gjendet asnjë ndryshim mes dhunimit fizik apo dhunimit shpirtëror të të drejtave të një personi tjetër. Në të vërtetë, në disa çështje gjyqësore që janë zhvilluar së fundi, dhunimi shpirtëror është trajtuar si një krim edhe më i rëndë se në të kaluarën.

SHPIRTRAT IDEALË DHE HERONJTË E DASHURISË

Vetëm ata që janë përmbytur nga dashuria do të jenë në gjendje të ndërtojnë lumturinë dhe të ndriçojnë botën për të ardhmen. Buzët e tyre buzëqeshin me dashuri, zemrat u mbushen me dashuri, sytë e tyre rrezatojnë dashurinë dhe ndjenjat më të thella njerëzore - të tillë janë heronjtë e dashurisë që vazhdojnë të marrin mesazhet e dashurisë nga lindja deri në perëndim të diellit dhe nga mbrëmja deri në agim.

Ata që orvaten të reformojnë botën, duhet së pari të reformojnë vetveten. Në përpjekjet për të bindur të tjerët që t'i ndjekin në udhën për një botë më të mirë, ata duhet të largojnë nga bota e tyre e brendshme urrejtjen, smirën, xhelozinë dhe të hijeshojnë botën jashtë tyre me të gjitha virtytet dhe cilësitë. Shfaqja e atyre që janë larg nga vetëpërmbajtja dhe vetëdisiplinimi, që kanë dështuar në pastrimin e ndjenjave të tyre, mund të duket joshëse dhe me një përmbajtje të thellë në fillim, por ata nuk do të jenë në gjendje t'i frymëzojnë të tjerët ose, nëse munden në të vërtetë, ndjenjat që zgjuan, do të shuhen shumë shpejt.

Mirësia, bukuria, çiltërsia dhe ndershmëria janë ngulitur në esencën e botës. Çfarëdo që të ndodhë, bota do ta gjejë një ditë këtë esencë dhe asnjë nuk është në gjendje ta ndalojë këtë gjë.

Ata që përpiqen të ndriçojnë të tjerët, që kërkojnë lumturinë për ta dhe që u shtrijnë dorën për t'i ndihmuar, me cilësitë që kanë shfaqur dhe me shpirtin e ndriçuar, ngjajnë me engjëjt mbrojtës. Ata luftojnë me rrënimin që ka pësuar shoqëria, i qëndrojnë pa lëkundur "shtrëngatës," shpejtojnë të shuajnë "zjarrin" dhe janë vigjilentë për çdo tronditje të mundshme.

Të flijuarit e dashurisë

Bediuzamani ka thënë: "Ne jemi të dashuruar pas dashurisë, ne nuk kemi kohë për armiqësi." Ky është një parim shumë i rëndësishëm për ne. Ndonëse nuk është e mjaftueshme vetëm ta themi këtë, por më e rëndësishme është që ne ta tregojmë këtë. Është një fakt i vërtetë që shumë thonë fjalë të bukura për dashurinë për njerëzimin dhe natyrisht që këto janë fjalë të këndshme për këdo. Por unë dua të di se sa prej këtyre që flasin fjalë të tilla janë në gjendje t'i vënë në zbatim dhe t'i shfaqin në vetvete, në cilësitë e tyre, gjithçka ata kanë shprehur? Unë mendoj se duhet të jetë e vështirë të gjesh një përgjigje të kënaqshme për këtë pyetje.

Predikimi i tij nxjerr në pah një nga virtytet më të çmuara të Profetit tonë. Gjithçka që ai thoshte dhe shprehte, e kishte zbatuar në jetën e tij. Fjalët që nuk vihen në jetë, pa pyetur se sa të bukura dhe të përsosura mund të jenë, janë të dënuara ta humbin vlerën e tyre dhe rëndësinë që ato kanë për kohën. Ndikimi që mund të ketë ushtruar predikimi i Bediuzamanit tek zemrat e fjetura, i ka bërë ata të kuptojnë se jo vetëm fjalët njerëzore, por edhe mesazhet hyjnore mund të bëhen të tilla nëse nuk zbatohen në praktikë. Vetëm Kurani nuk ka ndryshuar dhe ka ruajtur të njëjtin shkëlqim dhe origjinalitet si në momentin e parë kur është shpallur. Ai është libri më i shenjtë dhe më i famshëm, por ka qenë nëpërkëmbur nga krijesa që nuk shohin qartë përmes atmosferës së mjegulluar nga përfytyrimi i lëkundur dhe i boshatisur dhe për pasojë është subjekt i akuzave të thëna përçart dhe me tërbim për dobësitë dhe mungesat që në të vërtetë nuk janë karakteristikë e Kuranit, por më drejtë u atribuohen shoqërive që kanë dështuar ta vënë atë në jetë. Feja dhe Kurani duhet të jenë vital për jetën dhe vetëm një studim dhe kuptim i thellë i tyre mund të na bëjë që të qëndrojmë dinamikë. Kurani duhet të jetë analizuar në imtësi që ne të mund t'i zbatojmë të gjitha detyrimet që janë shfaqur aty. Më shkurt, ajo që unë dua të them këtu është kjo: nuk është e mjaftueshme që ju të deklaroni se jeni adhurues të dashurisë dhe përfaqësues të

paqes. Aty gjenden disa pengesa të cilat duhet të jenë kapërcyer. Thelbi i çështjes është që fjalët e shprehura bukur t'i vëmë në jetë.

Dashuria dhe mëshira janë në mes të parimeve më të rëndësishme të Islamit. Ne duhet që këto t'ia bëjmë të njohura të gjithë botës. Ndonëse disa ngjarje negative të shkëputura që kanë ndodhur së fundi, i kanë bërë njerëzit të mendojnë se ka një ndryshim mes Islamit teorik dhe Islamit që shfaqet në të vërtetë. Sigurisht, do të jetë plotësisht e gabuar nëse ia atribuojmë Islamit gabimet që kanë bërë disa njerëz. Është e vërtetë që një ndryshim serioz ka ndodhur në një vend fqinj, i cili veçanërisht i ka shkaktuar dëme botës islame, ndonëse shumë nga problemet mund të kishin gjetur zgjidhje me harmoni mes palëve. Kjo nuk do të thotë që divergjencat nuk ekzistojnë më, sepse ato nuk mund të tejkalohen vetëm me slogane. Për më tepër, ky nuk është i vetmi vend që ka dhënë një imazh të gabuar të Islamit në botë. Gjenden dhe shumë vende dhe udhëheqës të tjerë në botë që vazhdimisht e dëmtojnë imazhin e Islamit përmes qëndrimit dhe sjelljes së tyre, që natyrisht është në kundërshtim të hapur me Kuranin që sjell gjithmonë mirësi. Prandaj ne duhet të jemi plotësisht të vendosur në rrugën e tij dhe ta zbatojmë atë në çdo hap që bëjmë. Bota jonë e brendshme duhet të jetë e përmbytur nga dashuria dhe mëshira për njerëzimin, në zemrat tona nuk duhet të ketë vend për armiqësi. Dhe padyshim, dashuria dhe dialogu do të lulëzojnë në shekullin e ri. Antagonizmi do të jetë çrrënjosur dhe toleranca do të jetë përhapur kudo. Kjo nuk është mundësi e largët, veçanërisht në një kohë kur bota është duke përjetuar globalizmin. Me gatishmërinë e Zotit, kur të vijë koha, i shenjti do ta realizojë këtë mision.

Njeriu i dashurisë

Njerëzit e zemrës, si Xhelaledin Rumi, Junus Emre, Ahmet Jesevi dhe Bediuzaman Said Nursi, ishin dhënë pas Zotit shumë më tepër se ne dhe gabueshmëria e tyre ishte shumë më e vogël

se e jona. Për këtë arsye, ata u përpoqën tej mase për dashurinë, mëshirën dhe tolerancën, duke ndikuar fuqishëm tek njerëzit përreth tyre për këtë çështje. Por, nëse ne i vlerësojmë për kohën në të cilën jetuan, asnjëri nga ata nuk e shihte nivelin në të cilin e kanë çuar sot dialogun dhe tolerancën besimtarët si rezultat i përpjekjeve të tyre. Në fakt, secili prej tyre është përballur me qëndrime të pahijshme, në krahasim me vuajtjet e tyre, sjelljet me të cilat ne përballemi janë pothuajse asgjë. Bediuzamani tregon për vuajtjet e tij:

Mos vallë ata mendojnë se unë jam një egoist që mendon vetëm për vete? Me qëllim që të shpëtoj besimin e bashkësisë, unë kam sakrifikuar jetën time dhe nuk kam pasur kohë të mendoj për jetën time pas vdekjes. Gjatë tetëdhjetë viteve të jetës time, unë nuk kam shijuar kënaqësi tokësore, por e kam kaluar jetën në fushat e betejës ose i burgosur nga gjykatat e këtij vendi. Ata më kanë trajtuar si një kriminel duke më syrgjynosur nga një vend në tjetrin dhe duke më mbikëqyrur vazhdimisht. Më kanë *persekutuar* në çdo formë dhe nuk kanë lënë torturë pa më *provuar. Por nëse jam në gjendje ta shoh besimin e bashkësisë sime të siguruar, unë nuk mund të përkujdesem për çdo krijesë që digjet në zjarrin e ferrit. Për trupin tim po digjet zemra ime që do të lulëzojë si një trëndafilishte.* (*Bediuzaman Said Nursi, Tarihçe-i Hayati* - Biografia*)*

Me gjithë këto vështirësi, asnjëri nga këta banorë të dashurisë nuk arriti të shihte shkallën në të cilën ishin pranuar përpjekjet e tyre që janë marrë nga përfaqësuesit e sotshëm të dialogut dhe tolerancës. Mesazhet e tyre nuk kanë të njëjtin ndikim që kanë mesazhet e heronjve të tolerancës të ditëve tona. Unë mendoj se nëse ata do të jetonin në këtë shekull dhe do të shihnin tendencën e sotshme për dialog dhe tolerancë, do të shtronin pyetjen, "Si është e mundur që ju jeni të suksesshëm në dialog me mbarë botën? Cili është sekreti juaj?"

Një dallim i tillë nuk është i destinuar për këta korifej, sepse

kushtet e tyre nuk ishin të përshtatshme. Me qëllim që ky dallim të mos ekzistojë, është e nevojshme të vazhdojmë në këtë rrugë. Dje një njeri mjaft i njohur më tha: "Disa qarqe që deri dje kanë qenë kundërshtarë të betuar të besimtarëve, sot po i miratojnë dhe po i mbështesin fuqishëm ata." Në të vërtetë, janë të gjithë treguesit e ndjenjës së mirëseardhjes për këta adhurues të dashurisë që Zoti ka shtënë në zemrat e njerëzve të tjerë. Ta injorosh këtë, do të thotë të jesh mosmirënjohës dhe duke dëshmuar këtë, pra të mos shprehësh falënderimet për të, do të shfaqësh një tjetër dimension të mosbesimit.

Ç'DUHET TË KESH PËR TË QENË BESIMTAR

Sot, më tepër se për çdo gjë tjetër, ne kemi nevojë për një gjeneratë të ndërgjegjshme në përmbushjen e të gjitha detyrimeve ndaj Zotit dhe për njeriun ideal që mund të drejtojë shoqërinë, ne kemi nevojë për drejtuesin ideal që do ta shpëtojë njerëzimin nga humbëtira e mallkuar e ateizmit, injorancës, gabimit dhe anarkisë dhe që do t'i drejtojë ata me besim, njohuri, destinacion të saktë dhe paqe. Në çdo periudhë rënieje, gjenden mendjet që i ndriçojnë masat nga vuajtjet religjioze, intelektuale, sociale, financiare dhe depresioni moral. Ato mendje kanë riinterpretuar qeniet njerëzore, universin dhe ekzistencën në tërësinë e tyre dhe madje kanë riinterpretuar prejardhjen e ekzistencës, zhdukjen e pengesave në procesin e zhvillimit të mendimit tonë. Shpesh herë njerëzit kanë qepur një këmishë të re me qefinin e tyre. Ata i kanë riinterpretuar çështjet dhe fenomenet për shumë herë me radhë. Ata e kanë thënë përmendësh librin e ekzistencës, një libër i cili në perceptimin e mendjeve të cekëta ka humbur ngjyrën dhe shkëlqimin e tij dhe ka marrë një pamje të zbehtë sikur të ishte muzikë, me një ndjenjë dhe mendim shumë të thellë, duke e vëzhguar jo vetëm për t'u mburrur. Ata kanë nxjerrë në shesh të vërtetat e fshehura në zemër të universit duke i analizuar çështjet hap pas hapi, paragraf pas paragrafi.

Cilësitë më të çmueshme të njerëzve të tillë këmbëmbarë janë besimi i tyre dhe përpjekjet për të nxitur të tjerët që ta përjetojnë këtë besim. Me besimin dhe përpjekjet e tyre, ata besojnë që do të jenë në gjendje të mposhtin çdo gjë dhe të mbërrijnë tek Zoti, besojnë që mund të arrijnë paqen e vërtetë dhe besojnë se janë

të aftë ta kthejnë këtë botë në një parajsë dhe standardet e tyre të lartësohen në Parajsë. Kënaqësia për destinacionin e tyre i bën ata ta kuptojnë jetën dhe shërbimin ndaj veprave dinjitoze si një udhëtim në luginat e parajsës.

Në të vërtetë, me të gjithë veçoritë dhe ndërlikimet që mund të kenë, asnjë sistem tjetër, doktrinë, ose filozofi, nuk ka një ndikim të tillë pozitiv te njerëzimi, siç ka besimi. Kur besimi hyn në zemrat e njerëzve duke u bërë pjesë e qenies së tyre, mendimet që lidhen me universin, objektet dhe Zotin, ndryshojnë menjëherë dhe para tyre shtrihet pafundësia që i lejon ata ta vlerësojnë të gjithë ekzistencën sikur të jenë faqet e një libri të hapur. Të gjithë këta njerëz, që kanë vështruar përreth gjërat që deri më tani nuk kanë zgjuar interesin e tyre, gjithçka që ka qenë e pajetë dhe e pakuptimtë deri në këtë ditë, menjëherë gjallërohen dhe tani shfaqen si miq e bashkëpunëtorë dhe këto gjëra i përqafojnë ata. Në këtë atmosferë që të ngroh zemrën, njerëzit e shohin vetveten të jetë një masë për vlerat e tyre, ata kuptojnë që janë një pjesë e ndërgjegjshme dhe unike e ekzistencës, ata i pranojnë me dëshirë të fshehtat, udhët gjarpëruese mes fletëve dhe rreshtave të universit, ata e ndjejnë që janë pranë kuptimit të sekreteve që shtrihen poshtë velit që ka mbuluar gjithçka. Atëherë ata janë plotësisht të lirë nga qelia e ngushtë e kësaj bote tredimensionale, duke e gjetur vetveten në kërkim të amshimit.

Në të vërtetë, të gjithë besimtarët, përmes mendimeve që gjenden në thellësi të identitetit të tyre dhe në përputhje me shkallën e besimit të tyre, bëhen të pakufizueshëm brenda caqeve të tyre. Edhe nëse janë kufizuar në hapësirë dhe kohë, bëhen modele të krijesave të pakufizuara, ngjiten në rangun e qenieve që janë në kufijtë e hapësirës, duke ndjekur melodinë e engjëjve. Këto krijesa, krijuar nga uji, nga ç'duken të jenë një copë mishi pa formë - që ngjan të jetë një krijesë e pavlerë, por çfarë është në realitet, e vërteta e madhe - fitojnë një rëndësi të tillë që toka bëhet stacioni për zbulimin e frymës hyjnore që përmban shpirti i tij

apo i saj. Dhe, ata bëhen qenie të tilla që nuk janë larg përputhjes mes qiellit dhe tokës, krijesa transcendente që shtrihen në të dy polet.

Ata ecin krah për krah me ne, qëndrojnë me ne, ata vënë këmbët atje ku ne kemi shkelur dhe vënë kokën në të njëjtin vend me ne kur falen, por i drejtojnë të bashkuara këmbët dhe kokën e, kështu, bëhen një sferë. Ata shtrihen përpara Zotit, vënë vetveten karshi Zotit si një platformë në rrugën për të qenë i afërt me Atë dhe arrijnë horizontin për t'u bërë një nga të afërtit e Zotit në çdo hap. Ata përplasin flatrat në të njëjtin qiell si shpirtrat dhe jetojnë si krijesa qiellore në një gjendje njerëzore. Zemrat e tilla lënë mënjanë individualitetet me evoluimin dhe ekspansionin e ndjenjave njerëzore, ata bëhen, në një rrugë, një personalitet kolektiv dhe hapin krahët për të gjithë besimtarët, ata shtrëngojnë duart me çdo njeri dhe përshëndesin plotësisht krijimin me çiltërsinë e ndjenjave të tyre. Ata vështrojnë ngjyrat, ruajnë trajtat dhe janë të vetëdijshëm për tingujt e vizionit hyjnor në çdo gjë dhe në çdo njeri që kanë hasur, ata dëgjojnë tingujt qiellorë në çdo frekuencë të mundshme dhe ngjan sikur mund të ndjejnë përplasjen e krahëve të engjëjve. Ata shikojnë, ndjejnë dhe dëgjojnë me një ceremoni të tillë të madhe të bukurive: nga gjëmimet e lemerishme të rrufeve, te këngët e zogjve, nga dallgët shkatërrimtare të deteve, te zhurma e ëmbël e lumenjve e cila të ngjall ndjenjën e amshimit, nga jehona e magjishme e pyjeve të vetmuar, te madhështia e majave të thepisura që ngjan të kenë kapur qiejt, nga puhitë magjiplota që duket sikur përkëdhelin kodrinat e blerta, te kundërmimi magjepsës që shpërthen nga trëndafilishtet dhe përhapet ngado, ata shprehen "kjo duhet të jetë jeta". Ata përpiqen t'i japin frymës së tyre vlerat e merituara me anë të lutjeve dhe duke shprehur e soditur Emrat e Bukur të Zotit.

Ata hapin e mbyllin sytë, ballët e tyre janë gjithmonë duke prekur dyshemenë, duke parashikuar një vështrim të njohur nga pragu i derës që shpresojnë të hapet dhe vëzhgojnë të dëshiruar në

krahun tjetër të derës, në pritje të orës së lumtur kur çoroditja dhe përmallimi do të largohen dhe paqja e afërsia do të mbështjellin shpirtrat e tyre si një hajmali e shenjtë. Ata përpiqen të gjejnë burimin e kënaqësisë për dëshirën e ribashkimit në shpirtin e tyre. Ata vrapojnë drejt Zotit, herë pas here duke fluturuar, nganjëherë duke çaluar, të njësuar me gjithsecilin dhe me gjithçka. Ata provojnë gëzimin e një "nate dasme"[54] nën hijen e ribashkimit në çdo vendqëndrim, duke shuar zjarrin e përmallimit tek njëri-tjetri në çdo kthim dhe në çdo moment që ata kanë ndezur një zjarr të ri dhe fillojnë të digjen. Kushedi për sa kohë ata do ta shohin vetveten të rrethuar me frymën e "intimitetit hyjnor" dhe zemrat e tyre do të jenë plagosur nga mendimi për vetminë dhe tragjedinë e atyre që nuk mund ta ndjejnë këtë frymëzim.

Në të vërtetë, shpirtrat që kanë një horizont kaq të hapur, e ndjejnë vetveten të jetë gjithmonë në një trampolinë kërcimi drejt botëve të reja, gjithmonë të tendosur me një vendim dhe vendosmëri për të kapërcyer normat njerëzore. Ata mendojnë se cilat janë aftësitë ekstra që do të përfitojnë dhe çfarë suksesesh do të arrijnë me besimin dhe forcën që e mbështet atë. Ata kanë të njëjtin vrull pa ndjerë lodhje, me horizontin dhe perspektivën e tyre të hapur gjithmonë dhe me zemrat në paqe. Në çdo vendqëndrim, marrëdhënia e tyre me mjedisin bëhet më e fortë dhe më e thellë. Ata mund të jenë ose jo të vetëdijshëm për atë, por kur dëgjojnë shpirtrat e tyre, vështrojnë vetveten në një faqe mali të pambarim me paqe. Pavarësisht nga motivet e shumta për dëshirimin dhe vetminë që kanë dëshmuar në njerëzit e tjerë, ata kurrë nuk ndjejnë agoninë e rrugës apo të përmallimit sepse e dinë prej nga kanë ardhur, pse dhe për ku janë drejtuar dhe janë të ndërgjegjshëm për të gjitha korrjet dhe shpërndarjen në botë, gjithashtu të vetëdijshëm se vrapojnë në një udhë të veçantë me një synim dhe objektiv të pandryshueshëm. Ata as ndjejnë lodhjen e rrugës, as provojnë frikën, brengat, ose mundimet që njerëzit e

[54] Term që Rumi përdor për vdekjen.

tjerë kanë përjetuar. Ata besojnë në Zot, përparojnë me shpresë dhe provojnë gëzimin për arritjen e majës që mban ëndrrat e kaltra të së nesërmes.

Vërtet, përgjatë rrugëve në të cilat bota përparon, këta heronj kalorësiakë të besimit bëjnë udhën e tyre sipas shkallës së besimit, sikur janë endacakë buzë luginës së parajsës, nuk thithin asgjë veç paqes. Në anën tjetër, përmes pranimit të tyre tek Zoti, ata mund ta sfidojnë tërë universin, të mposhtin çdo vështirësi, dhe nuk bien në dëshpërim edhe nëse shohin shkatërrime kudo. Ata nuk tërhiqen të tmerruar edhe nëse mbrapshtitë shfaqen para tyre. Ata gjithmonë e mbajnë kokën lart dhe kurrë nuk përulen përveç para Zotit. Ata nuk pranojnë asgjë nga asnjeri, nuk kundërshtojnë asgjë prej ndokujt dhe as e bëjnë veten borxhli të askujt. Kur ata janë ngadhënjimtarë dhe arrijnë suksese njëri pas tjetrit, dridhen nga frika për mirëkuptimin që është në fakt një provë për devotshmërinë dhe nënshtrimin te Zoti, ndërsa në të njëjtën kohë ata janë të përulur me mirënjohje dhe lotët u rrjedhin nga gëzimi. Ata e dinë si të jenë të duruar kur humbasin dhe janë të tendosur me vendosmëri. Ata fillojnë udhëtimin e tyre përsëri me një dëshirë të papërmbajtur. Ata nuk bëhen arrogantë ose mosmirënjohës karshi zemërgjerësisë apo të bien në dëshpërim kur përjashtohen nga të drejtat e tyre.

Ata mbajnë një zemër profetike në shkëmbimet e tyre me njerëzit. Ata duan dhe përkrahin çdo njeri, mbyllin një sy për dobësitë e të tjerëve, ndërsa në të njëjtën kohë janë në gjendje të hetojnë të metat e tyre më të vogla. Gabimet e njerëzve përreth tyre i falin jo vetëm në kushte normale, por edhe kur janë të zemëruar. Ata dinë si të jetojnë në paqe edhe me shpirtrat më të irrituar. Në fakt, Islami i këshillon ndjekësit e tij të falin sa më shumë të jetë e mundur dhe të mos bien pre e ndjenjave të urrejtjes, mërisë ose hakmarrjes. Në çdo rast, është e pakonceptueshme që ata të cilët janë të ndërgjegjshëm se gjenden në udhën drejt Zotit, duhet ose mund të jenë në një rrugë tjetër. Të qëndrosh në ndonjë drejtim

tjetër ose të mendosh në ndonjë mënyrë tjetër, është jashtë çdo diskutimi. Përkundrazi, gjithë veprimtaria e tyre ka synuar t'u sjellë përfitim dhe dobi të tjerëve, ata dëshirojnë lumturinë e të tjerëve dhe përpiqen të mbajnë gjallë dashurinë në zemrat e tyre, duke vazhduar një betejë të pafundme kundër urrejtjes dhe smirës. Ata ndjejnë afshin e dobësive dhe mëkateve të tyre duke u djegur me pendesë dhe shtrëngojnë të keqen për gryke në pak kohë për çdo ditë. Ata e fillojnë punën e tyre me vullnet dhe bëjnë gati tokën për të mbjellë kudo fidanët e mirësisë dhe bukurisë. Në gjurmët e Rabia Adevijes, ata pranojnë gjithsecilin dhe gjithçka si një shurup të ëmbël, edhe po të jetë helm. Edhe kur janë afruar me urrejtje, mirëpresin me buzëqeshje dhe zmbrapsin ushtritë më të mëdha me armën e palodhur të dashurisë.

Zoti i do këta njerëz dhe ata e duan Zotin. Ata janë gjithmonë të zgjuar nga gjallëria e dashurisë dhe përjetimi i gëzimit verbues që buron nga ndjenja e të qenët i dashuruar. Krahët e tyre me përulësi qëndrojnë gjithmonë në tokë dhe ata nevojitet të bëhen ushqim pjellor me qëllim që të arrijë gëzimi kur trëndafilat të çelin. Aq sa janë të respektueshëm për të tjerët, po aq ata vlerësojnë respektin e tyre. Ata kurrë nuk lejojnë zemërbutësinë, mëshirën, fisnikërinë dhe përsosjen e tyre të jetë interpretuar si një dobësi. Ata kurrë nuk i kushtojnë vëmendje qortimit apo vlerësimit për njerëzit e tjerë. Siç jetojnë në përputhje me besimin e tyre, ata nuk kujdesen vetëm që atlasit të mendjes së tyre të mos i humbë shkëlqimi, për ata është e rëndësishme të jenë besimtarë të devotshëm!

SHPIRTRAT E DHËNË PAS ZOTIT

Tipari më i veçantë për ata që ia kanë kushtuar vetveten fitimit të pëlqimit të Zotit, idealit të dhembshurisë dhe të qenët i dashur prej Zotit, është që ata kurrë nuk presin asgjë - materiale apo shpirtërore – si kundërshpërblim. Gjërat si fitimi, pasuria, shpenzimet, komoditeti, etj., të cilave njerëzit e kësaj bote u kushtojnë një vëmendje shumë të madhe, nuk kanë shumë kuptim, ato nuk kanë vlera ose të jenë konsideruar si kritere.

Vlerat e idealeve të njerëzve të devotshëm, që i kapërcejnë cilësitë tokësore me një shtrirje të tillë është pothuajse e pamundur t›i shmangin ata nga çfarë kërkojnë - pëlqimin e falur të Zotit - dhe t'i drejtojnë ata në ndonjë ideal tjetër. Në fakt, duke hequr dorë plotësisht nga gjërat e përkohshme dhe të kufizuara, të devotshmit pësojnë një transformim të tillë në zemrat e tyre në kthimin tek Zoti, saqë ata kanë ndryshuar sepse nuk kanë njohur asnjë dëshirë tjetër veç idealeve të tyre. Qëkur ata iu përkushtuan plotësisht qëllimit për t›u bërë njerëz që e duan Zotin dhe janë të dashur prej Zotit, duke ia dedikuar jetët e tyre ndriçimit të të tjerëve, dhe përsëri, sepse i kanë trajtuar objektivat e tyre të orientuar në këtë drejtim të unifikuar, i cili në një sens kontribuon me cilësi për këtë ideal, ata shmangin shprehjet divergjente dhe kontradiktore, të tilla si «ata» dhe «ne,» «të tjerët» dhe «tanët.» Asnjëherë njerëzit e tillë nuk kanë probleme - të hapura apo të fshehura - me njerëzit e tjerë. Në kontrast me këtë, ata gjithmonë mendojnë se si mund të jenë të dobishëm dhe gjithashtu si mund të shmangin grindjet në shoqërinë, pjesëtarë të së cilës janë. Kur ata pikasin një problem në shoqëri, më tepër se si luftëtarë, ndërmarrin veprime si të jenë

udhëheqës shpirtërorë, duke drejtuar njerëzit me ndershmëri dhe përshpirtshmëri të lartë, duke shmangur të gjitha llojet e influencave politike apo mendimet për të sunduar.

Ato që i lartësojnë shpirtrat e devotshëm, përpos shumë faktorëve të tjerë, janë dijet që zotërojnë, vënia në jetë e tyre, një kuptim i gjerë dhe i thellë për dëlirësinë morale dhe aplikimin e saj në çdo fushë të jetës, ndershmëria e besimtarit dhe vetëdija për domosdoshmërinë e saj. Ata kërkojnë mbrojtje tek Zoti prej famës dhe interesave - bazuar në propagandën e akullt, në veprimet dhe veprat për mburrje, të cilat në të vërtetë nuk premtojnë asgjë në emër të së ardhmes së tyre, që do të thotë, për jetën e përtejme të tyre. Përveç kësaj, duke jetuar në përputhje me parimet e tyre, përpiqen pa ndërprerje të drejtojnë ata të cilët i ka pushtuar frika e lartësimit të vlerave njerëzore. Duke kryer këtë aktivitet, njerëzit e tillë kurrë nuk presin mirësjelljen apo ngjalljen e interesit të ndokujt dhe përpiqen me të gjitha mënyrat që t'u shmangen interesave ose përfitimeve personale, të cilave u shmangen siç mund t'i shmangeshin një gjarpri apo një akrepi. Më në fund, pasuria e tyre e brendshme ka një forcë centripetale që nuk mund të pranojë reklamën, mburrjen ose lëvdatën. Sjellja e tyre miqësore, gjithashtu e reflektuar në shpirtrat e tyre, është një cilësi magjepsëse që i bën njerëzit e shquar t'i ndjekin ata.

Pikërisht për këtë arsye, këta adhurues kurrë nuk dëshirojnë të mburren apo të bëjnë reklamë dhe propagandë për veten e tyre dhe as janë ambiciozë për të qenë të mirënjohur ose të shquar. Në vend të kësaj, ata përpiqen, me të gjitha forcat, të pasurojnë jetën shpirtërore dhe të gjithë veprimtarinë e tyre e kanë kushtëzuar me sinqeritet nga ky këndvështrim, duke kërkuar vetëm të kënaqin Zotin. Me fjalë të tjera, ata synojnë të marrin pëlqimin e Zotit në çdo veprim që kryejnë dhe përpiqen me vendosmëri ta arrijnë këtë, jo duke ndotur vendosmërinë profetike me shpresa apo ambicie tokësore ose me vlerësimin dhe dashurinë për të tjerët. Për arsye se besimi, Islami dhe Kurani janë kritikuar dhe mbi

ta janë hedhur hije dyshimi në botën e sotme, këta njerëz duhet të harxhojnë të gjithë energjitë e tyre për t'iu kundërpërgjigjur këtyre sulmeve. Është thelbësore që individët të jenë mbështetur shpirtërisht dhe mendërisht te Islami, që njerëzit të jenë shpëtuar nga kotësitë e jetës me qëllim që të jenë lidhur me disa ideale të larta. Ky bashkim ka nevojë për një shtrirje të tillë që njerëzit kurrë nuk do të ndjehen të obliguar të kërkojnë diçka tjetër dhe është e vetmja mundësi për rigjallërimin e besimit në zemra, për modelin dhe stilin e tyre të jetesës. Ndonjë mundet gjithashtu ta quajë këtë si një ndryshim kursi për njerëzit me një jetë shpirtërore. Një qëndrim i tillë është shumë i rëndësishëm, veçanërisht në një kohë kur disa njerëz i kanë besuar gjithçka ndryshimit dhe transformimit të jetës shoqërore, duke u përpjekur ta riformulojnë atë me modele të reja. Kur dikush përpiqet të riorientohet drejt një jete shpirtërore, do të gjejë gjithmonë konsensus, mirëkuptim dhe solidaritet, ndërsa, nëse dikush beson vetëm në ndryshimin, atëherë është e mundshme të dëshmojë kundërshtim, ndarje dhe madje, dëshirë për të luftuar.

Të devotshmit nuk provojnë zbrazëti në jetën e tyre intelektuale dhe arsyetojnë në sajë të këtij kuptimi për një drejtim të unifikuar. Në të kundërt, ata janë të hapur me arsyetim, aftësi dhe logjikë, në lidhje me këtë si një kusht i domosdoshëm për besimin e tyre. Duke qenë tretur në thellësi të tyre për afinitetin me Zotin, një afërsi që kushtëzohet nga meritat e çdonjërit dhe në oqeanin që është si një unitet hyjnor, dëshirat e tyre tokësore dhe pasioni fizik marrin një formë të re (kënaqësi shpirtërore si rrjedhim për pëlqimin e Zotit) me një model dhe stil të ri. Në këtë mënyrë, të devotshmit mund të thithin të njëjtin ajër si engjëjt në pikun e jetës shpirtërore ndërsa bisedojnë me tokësorët, duke plotësuar nevojat e ligjshme për jetën në tokë. Për këtë arsye, këta adhurues janë konsideruar si qenie që kanë lidhje me të dy botët, të tanishmen dhe të ardhshmen. Lidhja e tyre me botën e tanishme është e merituar për faktin që ata e vënë në përdorim dhe e përmbushin

me forcat fizike. Ajo që i lidh ata me botën tjetër është fakti që vlerësojnë çdo çështje nën dritën e jetës së tyre shpirtërore dhe për zemrën. Të gjitha pengesat që janë imponuar prej jetës shpirtërore nuk shkaktojnë medoemos një braktisje të plotë të jetës tokësore, është kjo arsyeja që këta njerëz nuk mund ta shpërfillin plotësisht botën. Në kontrast me këtë, ata gjithmonë qëndrojnë në qendër ose më saktë në periferi të botës dhe rregullave të saj. Ky pozicion, ndonëse nuk është për botën ose në emër të botës, është në emër të marrjes parasysh të faktorit trupor dhe përpjekjeve për të lidhur gjithçka me botën e përtejme.

Si një çështje në fakt, kjo është rruga për të mbajtur trupin në kornizën e tij dhe shpirtin në horizontin e tij, kjo është rruga për të drejtuar jetën nën udhëheqjen e zemrës dhe shpirtit. Jeta e kufizuar dhe e fundme trupore duhet të ketë një shtrirje që meriton natyra materiale e tij, ndërsa jeta shpirtërore që hapet me amshim, mund të kërkojë pafundësi. Nëse ndonjëri ka në mendje vetëm mendime të larta dhe transcendente, nëse dikush e drejton jetën siç janë kërkesat e Jetëdhënësit, nëse ndokush kujdeset për ndriçimin e të tjerëve siç janë parimet themelore për këtë jetë dhe nëse ndonjëri është gjithmonë në kërkim të zenitit, atëherë natyrshëm bëhet një profesionist për një program suprem dhe në këtë mënyrë, me një shtrirje të sigurt, u vë kufij dëshirave personale dhe pasioneve.

Sigurisht, është një sfidë që të drejtosh një jetë të tillë. Akoma ky mision i vështirë është plotësisht i thjeshtë për ata që e kanë lidhur vetveten me Zotin, për ata që synojnë ta lartësojnë emrin e Tij, për ata që zëvendësojnë fanatizmin dhe nga dera për tek Zoti përpiqen t›i bëjnë njerëzit të ndërgjegjshëm për Atë, me njërën dorë tek portat e zemrave për njerëzit dhe me tjetrën në portën e Tij. Në të vërtetë, nuk numërohen vuajtjet e atyre që ndjenë në kraharorin e tyre afshin për afërsi me Krijuesin dhe që provuan të ngulitin besimin nga zemrat e tyre te komuniteti, nganjëherë me druajtje dhe nganjëherë me dëshirë miqësore. Zoti i jep favoret e Tij në apostullin e zemrës, i cili në radhë të parë, kufizon vështrimin e tij

apo të saj tek Ai dhe mendon vetëm për Atë, në kërkim të rrugëve për ta gjetur Atë dhe përfiton epërsi në çdo mënyrë për ta arritur Atë. Duke e paraqitur këtë pozicion në Praninë e Tij të Shenjtë, Zoti, në kthim, i kujton gjithsecilit që ata duhet të respektojnë njerëzit e tillë dhe shpërblen këtë thërrime për devotshmërinë tokësore me një sasi të madhe për devotshmërinë hyjnore të Tij. Këtu gjendet çfarë është shtrydhur në një pikë prej oqeanit të paanë për komplimentin qiellor:

Dhe mos i përzë ata që adhurojnë Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje duke synuar vetëm pëlqimin e Tij. Ti nuk je aspak përgjegjës për ata e as ata nuk janë përgjegjës për ty. (En'am, 52)

Njerëzit e përmendur këtu, për të cilët Zoti e paralajmëroi Profetin e Tij të mos "kundërshtonte," janë pikërisht ata që frekuentonin tubimet e të Dërguarit të Zotit, njerëzit që ia kishin kushtuar vetveten pëlqimit të Zotit.

Pajisja me këtë devocion është e përzemërt dhe e sinqertë, gjithmonë është e mundshme që Zoti të japë bekimin e Tij në këtë kategori njerëzish. Sa më shumë njerëzit synojnë ta kënaqin Zotin dhe sa më përzemërsisht të jenë lidhur me Zotin, aq më e mundshme është që ata të jenë çmuar, shpërblyer dhe aq më e mundshme është që ata do të bëhen subjekt i kuvendimit suprem. Çdo mendim, fjalë dhe veprim për njerëzit e tillë do të bëhet një atmosferë e ndritshme në botën tjetër, një atmosferë e cila gjithashtu mund të quhet "faqja e buzëqeshur e fatit." Njerëz të tillë fatbardhë shtyjnë varkat me erën e bardhë të fatit të tyre, varkë me bekim special drejt Zotit, jo duke tërhequr veten gjetiu. Është me vlerë për t'u parë me kujdes se çfarë shfaq Kurani si një përshkrim për këta njerëz:

Njerëz të cilët tregtia nuk i pengon për të përmendur Allahun, për të falur namazin dhe për të dhënë zekatin. Ata i frikësohen një dite kur zemrat dhe shikimet do të tronditen; (ata shpresojnë) që Allahu t'i shpërblejë sipas veprave më të

mira që kanë bërë dhe t'ua shtojë dhuntinë e Tij. Allahu i jep kujt të dojë pa llogari. (Nur, 37-38)

Duke qenë të zhveshur nga të gjitha dëshpërimet dhe pikëllimet, gjithashtu të dorëzuar tek Zoti dhe për pasojë, qenie të lira nga të gjithë shqetësimet, ky lloj i shpirtit të lirë nuk ka asgjë më për të zbuluar. Në krahasim me një arritje të tillë, të gjitha bekimet tokësore, pasionet dhe kënaqësitë nuk kanë asnjë ndryshim nga pjatat boshe të hedhura në tavolinat e ndyra. Bota dhe kënaqësitë e saj as që mund të krahasohen me bukuritë që aspirojnë ata në botët e tyre shpirtërore. Në fund të fundit, çfarë lulëzon dhe gjelbëron në pranverë, rrjedhimisht zbehet në verë dhe nuk mund të përfytyrohet se ka ndonjë ndryshim për krijesat. Krijesa e vetëdijshme për këtë realitet, shpirtrat e orientuar në amshim shpërfillin gjithçka që nuk shpreh ndonjë kënaqësi të përjetshme dhe ecin përgjatë korridoreve në zemrat e tyre drejt kopshteve dhe lulishteve, kurrë ndonjëherë nuk bashkëngjisin zemrat e tyre me botën ose me të tjera banalitete tokësore.

TË DEVOTSHMIT E SOTSHËM

Idealet sublime, objektivat e rëndësishme, projektet universale dhe me influencë mund të jenë realizuar vetëm prej atyre që fluturojnë lart, që qëndrojnë të patundur, që vazhdojnë rrugën e tyre me siguri, që tregojnë një qëndrim të vendosur dhe që janë motivuar prej ekstazës qiellore. Ai për të cilin ne kemi nevojë tani, nuk është njeriu i rëndomtë, por më saktë, njeriu i lidhur me realitetin hyjnor, që gjykon me një mendim të lartë, njerëzit, që nga zbatimi në praktikë i mendimeve të tyre drejtuese, janë të parët nga i gjithë kombi i tyre, prandaj, të gjithë njerëzit, t'i ndriçojnë dhe ndihmojnë ata të gjejnë Zotin - me fjalë të tjera, shpirtrat e dedikuar, njerëzit që gjykojnë se çfarë është e nevojshme të jetë menduar, njerëzit që njohin çfarë është e nevojshme të jetë njohur, që pa hezitim zbatojnë ato për të cilat kanë dijeni dhe që shtegtojnë si Israfil, që gjenden në prag të rënies së borisë së fundit me qëllim që të përgatitin shpirtrat e vdekur për ditën e ringjalljes dhe që ngulisin shpresën tek gjithsecili. Këta janë njerëzit te të cilët zemrat rrahin me sinqeritet, që kërkojnë me lot në sy frymëzimin e zemrave të tyre nga fjalët nëse ata janë të aftë për t'i shprehur ato, nga shkrimet nëse ata munden, nga idetë e poezive magjike nëse ata janë poetë dhe me magjepsjen e muzikës nëse ata janë të dashuruar pas muzikës.

Kur vjen momenti për t'i treguar këta heronj në plate, ata udhëtojnë kudo nëpër botë, përfundimisht me frymën e emigrimit të shenjtë, pështpërisin me gjuhën e zemrave të atyre të cilët kanë vizituar, i japin nxitje dashurisë anembanë mjedisit të tyre, ngulisin dashurinë në shpirtrat e atyre që takojnë dhe vendosin fronin e dashurisë në kraharorët e tyre. Përmes këtyre njerëzve,

shpirtrat e tyre që digjen për dashurinë dhe miqësinë janë rivitalizuar dhe është kjo arsyeja që këta shpirtra të rigjallëruar janë të përshtatshëm për veshin e gjithkujt. Si ata që kanë emigruar me këtë lloj ndjenje dhe ata që i kanë mirëpritur janë të sinqertë dhe larg prej kryeneçësisë. Interesat personale nuk gjenden mes atij që flet dhe atyre që dëgjojnë, në mes të atij që shfaq esencën dhe domethënien e natyrës së tyre dhe vëzhguesve, mes atij që ka ndihmuar dhe atyre që u ndihmuan, në mes të atij që sjell kupën e jetës dhe atyre që janë zgjuar me realitetin. Askush nuk merr parasysh asgjë tjetër veç pëlqimit të Zotit. Këto lidhje të thella dhe të sinqerta burojnë krejtësisht nga vlerat njerëzore universale dhe prej respektit të vazhdueshëm që është ndjerë për ta.

Trëndafilat po lulëzojnë sot në të gjithë botën duke marrë ngjyrën e tyre prej pamjes plot dritë dhe mirëkuptimit në shpirtrat e këtyre njerëzve, gjeografia shoqërore është krijuar duke u qëndisur me mendimin e tyre dhe është për të gjithë njerëzimin si një melodi e gjallë dhe e përjetshme. Duke shqyrtuar zanafillat e tyre, këto ndjenja dhe mendime të kthjellëta ngjajnë sikur janë thjesht bulëza uji. Megjithëkëtë, për ata që mund ta kuptojnë, domethëniet që gjenden thellë brenda tyre janë si detet e paanë që shkumëzojnë me frymëzim.

Siç është kërkuar nga misioni vetë, kalorësit e ndriçimit, të cilët shfaqen të ndriçuar vetëm në mjedisin e tyre për një moment të shkurtër, janë tani duke u përpjekur, në të njëjtën rrugë ku retë e shiut po shkarkohen në lumturinë, gëzimin, dashurinë dhe shpresën tonë, të kthejnë zemrat e thara të atyre që dëshirojnë tolerancë dhe dashuri në kopshtet e parajsës. Mund të deklarohet që toka, nga njëri pol në tjetrin, është rënduar me farërat që ata kanë hedhur dhe është duke pritur me padurim një lindje të bekuar. Në të njëjtën mënyrë, të gjitha krijesat njerëzore janë gjallëruar për të vështruar shenjat e kësaj ngjarjeje të bekuar. Ndonëse zërat dhe këngët mund të ndryshojnë, ajo që është ndjerë thellë në zemra, është gjithmonë e njëjta. Dhe erërat e agimit janë duke sjellë një

zë prej lumit të jetës si profetit Ejub, dhe shpërndajnë aromën abrahamike të këmishës që Jusufi i dërgoi Jakubit.

Kjo mund të jetë si prova finale për ne, përparimi ynë në pozicionin e vërtetë, po ashtu shihet si një mesazh tjetër drejtuar njerëzimit për rigjallërimin e tij. Si një çështje në fakt, kombet e dëshpëruara nga krizat e ndryshme kanë qenë gjithashtu në pritje të një puhize të tillë shprese. Sa me fat janë kuadrot e bekuar, iniciatorët e një ngjarjeje të tillë. Dhe përsëri, sa me fat janë ata, zemrat e të cilëve e ndjejnë menjëherë këtë puhi.

Ne besojmë sinqerisht që pamja dhe qëllimet e kësaj bote janë duke ndryshuar dhe që njerëzimi do të shtendoset me këta heronj që i janë përkushtuar përkrahjes dhe glorifikimit të vlerave njerëzore. Në botën e ardhshme, mendimi njerëzor do të intensifikojë ndoshta më shumë dritën e tij përmes këtyre njerëzve, qëllimet njerëzore do të jenë arritur dhe shumë prej idealeve tona do të jenë realizuar përmes tyre. Këto ideale do të jenë përmbushur në një shkallë të tillë që do të kapërcejnë edhe ëndrrat tona më utopike. Në të vërtetë, të gjitha këto gjëra sigurisht që një ditë do të kenë gjetur vendin e tyre dhe kur të vijë kjo kohë, ata që i kanë zemrat e boshatisura dhe fatin e nxirë, do të pendohen, qajnë dhe kërkojnë falje prej këtyre shpirtrave të ndriçuar, ndonëse do të jetë shumë vonë për ta që të kompensojnë rastet e humbura. Vetëm nëse këta mëkatarë dhe shpirtra të ashpër mund të tregohen paksa më mirënjohës dhe të ndershëm përpara se dita të arrijë, një ditë kur do të ndjejnë dëshpërim dhe pendim, atëherë ata nuk do ta errësojnë të ardhmen e tyre.

Duke u përpjekur për të ndriçuar çdo pjesë të botës me një devocion që është i përshtatshëm për bashkëpunëtorët e Profetit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, me mospërfillje për dëshirat e tyre dhe duke vepruar me qëllim që të jetojnë për të tjerët pa u mburrur - në të kundërt, gjithmonë kokulur në veprime - këta heronj legjendarë janë duke u shfaqur sot, pavarësisht nga shumë faktorë

negativë, një bujari e rrallë po hyn në histori, ata kanë ardhur t'i shërbejnë njerëzimit. Ata janë duke pështpëritur diçka nga thellësia e zemrave të tyre, duke krijuar një parajsë në tokë, duke mbjellë fidanë të rinj kudo, duke u përpjekur të shfaqin vetveten dhe duke ftuar gjithsecilin në amshim, gjithmonë besimtarë, të vendosur, përcaktues, dhe shpresëdhënës për të ardhmen. Udha në të cilën ecin mund të jetë e rrezikshme. Megjithatë, janë të vetëdijshëm për këtë. Ata tashmë i kanë bërë llogaritë që rruga do të jetë e vështirë dhe e pasigurt, që urat do të jenë të pakalueshme dhe udhët e tyre do të jenë të bllokuara. Ata gjithashtu janë duke pritur trazira nga armiqësitë dhe urrejtja. Është e vërtetë që kanë një besim të patundur në rrugën që ndjekin. Akoma, ata janë gjithmonë të ndërgjegjshëm se ekziston mundësia që të ndeshin në pengesa por nuk mund ta imagjinojnë një kthim prapa. Pikërisht për këtë arsye, i vështrojnë këto vështirësi dhe vuajtje si gjëra kalimtare dhe të veçanta në udhën hyjnore dhe ruajnë qetësinë e tyre pa humbur kurrë entuziazmin. Kundër këtyre vështirësive, ata dorëzohen tek Zoti duke gjetur mbrojtje në kështjellën e pamposhtur të besimit, duke u përpjekur t'u përmbahen ngjarjeve dhe epokës në të cilën ata jetojnë dhe të ecin në horizontin e pëlqimit të Zotit duke besuar në premtimin e Tij për sukses.

Në fakt, është e dëmshme për ndonjërin që t'i këshillojë gabim këta njerëz të ndershëm që jetojnë në harmoni me zemrën dhe intelektin për të lartësuar vlerat në të cilat ata besojnë. Askush nuk mund të ndalojë veprimtarinë e tyre në përputhje me pëlqimin e Zotit dhe po ashtu përpjekjet për të rrënjosur kudo në botë ndjenjat e tyre dhe të Krijuesit. Me këtë ndjenjë përgjegjësie dhe respekti, ata kanë mundur të qëndrojnë të palëkundur si malet dhe të sfidojnë stuhitë dhe shtrëngatat, të përleshen me elementët e natyrës dhe duke zbuluar sekretin se si mund të piqen frutat në të gjitha stinët, të kujdesen për rritjen e trëndafilave dhe të këndojnë këngë për to.

Derisa veprimtaria e tyre të jetë aktive, ata sillen gjithmonë

me të njëjtën rregullsi si zembereku i orës, shembuj të përtëritjes, lulëzimit dhe drejtësisë. Në qëndrimet e tyre nuk shikon mungesë harmonie dhe po ashtu në pamjen e tyre nuk mund të shohësh hidhërim. Zemrat e tyre janë aq të pastra dhe të kthjellëta porsi zemrat e engjëjve dhe gjuhët e tyre janë interpretuese të pagabueshme për thellësitë e tyre të brendshme. Sakaq, qëndrimet dhe veprimet e tyre janë pothuajse gjithmonë objekt i smirës dhe zilisë dhe pamja e tyre po ashtu është ngacmuese. Çfarë mendojnë ata pa ndërprerje në botën e tyre të brendshme është konsiderata për Zotin, në fjalët e tyre shihet qartë dashuria e thellë për Zotin, një dashuri për ekzistencën dhe tolerancën, mëshirën, përkujdesjen dhe mirëkuptimin. Qëllimi i tyre i përbashkët është pëlqimi i Zotit. Pasioni i tyre i nevojshëm është të studiojnë dhe interpretojnë universin dhe fenomenet në mënyrë korrekte. Pamja e vërtetë e natyrës së tyre është dashuria dhe orientimi i zemrave tek njerëzit.

Në momentin që ata shprehin qëndrimin e tyre drejt Zotit me dashurinë më të thellë, ata treten dhe janë në gjendje të depërtojnë në zemrat më të ngurta dhe në karakteret më të ashpër me çelësin magjik të dashurisë, ata përpiqen të jetojnë me rëndësinë e bekimeve të Krijuesit Sublim. Ata dashurojnë dhe janë të dashuruar, me një ambicie profetike, qëndrojnë si malet ndaj sulmeve më të pamëshirshme. Kur shikojnë përreth, vështrojnë me sytë hyjnorë. Ata as nuk rrëzohen nga shtrëngatat e furishme dhe as tronditen nga tërmetet më të fuqishme. Dallgëve dhe rrebesheve u tregojnë gjoksin dhe gjithmonë tregojnë zemërgjerësinë e tyre karakteristike.

Këta trima janë të ndërgjegjshëm se çfarë është e nevojshme për të ndërmarrë këtë mision të stërmadh për të kërkuar arritjen e pëlqimit të Zotit dhe prandaj janë gati për ta përballuar këtë nismë, rrethanat nuk kanë rëndësi. Në përshkrimet e personaliteteve të tyre, ata janë të përpiktë dhe të thjeshtë si një qiri, projektuar të digjen dhe ndriçohen dhe megjithatë gjithmonë të motivuar dhe

gati për t›u krahasuar me të lartësuarit edhe nëse ata nuk shfaqen konkurrues. Edhe kur ata duken të heshtur, janë gjithmonë plot gjallëri, të vendosur dhe të ethshëm në aktivitetin e tyre të brendshëm. Gjatë kësaj periudhe, ata dëshirojnë detet, ujin dhe dallgët ose vendet e largëta dhe të ftohta me retë e krijuara me avujt e tyre. Afër apo larg, ata përgatisin eliksirin e jetës kudo dhe shtegtojnë duke frymëzuar përtëritjen në trupat e qullët që kanë vuajtur përgjatë viteve. Ata rrëfejnë pa u lodhur tregimet e zemrave të tyre për të tjerët dhe i mbajnë larg prej thashethemeve ose diskutimeve që mund të lindin prej urrejtjes në shoqëri.

Si gjithmonë, ata ëndërrojnë të jenë të dobishëm për njerëzit, e ndjejnë në mënyrë të sinqertë thellë në shpirtrat e tyre agoninë dhe depresionin e të tjerëve, mbajnë një qëndrim mikpritës me këdo që i viziton ata, duke dëgjuar problemet e tyre, dëshpërohen për ta, gjejnë të dërrmuarit nga pikëllimi dhe nxitojnë së bashku me njerëzit që kanë të njëjtin pasion të lehtësojnë dhimbjet e tyre. Gjatë kësaj kohe, ata sfidojnë me guxim vështirësitë, mbjellin trëndafila me vendosmëri edhe në mes të ferrave. Ata vazhdimisht këndojnë për trëndafilat.

Nganjëherë, nën ndikimin e një brenge dhe dhimbjeje të madhe, këta njerëz ndryshojnë ngjyrën e gjakut, si një trëndafil që është duke vajtuar farërat që ka lëshuar në tokë. Në momente të tjera, ata pothuajse egërsohen dhe melodité e tyre kthehen në vajtime. Pavarësisht nga e gjithë kjo, ata vënë duart mbi zemrat e tyre dhe pëshpërisin "gjithçka është prej Zotit" dhe ecin drejt qëllimit të tyre duke buzëqeshur dhe duke kthyer vendet të cilat i vizitojnë, në kopshte të gjelbëruara. Njerëzit të cilëve ata u kanë dhënë një dorë, i kanë përtëritur, ndjehen sikur të jenë dehur nga eliksiri i jetës. Duart e ndihmës së tyre janë të ndritshme, si duart e bardha dritëlëshuese të Musait. Përpjekjet e tyre i zgjidhin të gjitha magjitë e magjistarëve, duke i bërë të gjithë mendimet faraonike të kapitullojnë.

Ata kanë një frymëzim dhe pasuri të atillë sa që pasuria e Karunit është e papërfillshme në krahasim me të. Nëse bota dëshiron, ata mund ta mbajnë të tërën me këtë pasuri dhe ngrohtësi. Peshorja e mëshirës - në të cilën ata jetojnë - është gjithmonë e anuar në krahun e bujarisë, aq shumë sa ka tërbuar djajtë.

Ata e kanë të qartë ku duhet t'i investojnë jetët e tyre. Dhe si rezultat, ata janë mjaft të aftë në shkëmbimin e përkohshëm të gjërave, për amshimin. Kohën nuk e çojnë kurrë dëm dhe nuk pranojnë që kualiteti i shërbimit dhe detyrave e tyre të pësojnë rënie. Morali i tyre është i lartë, vullneti i tyre është për t'u admiruar dhe vendosmëria e tyre është e pandryshueshme. Besimi dhe veprimi janë një disiplinë e rëndësishme për zemrat dhe sjelljen e tyre. Ata nuk i druhen asnjeriu me përjashtim të Zotit dhe janë gjithmonë të ndershëm. Ata qëndrojnë të paanshëm dhe ecin kokulur drejt qëllimit të tyre për të ndriçuar tërë botën. Ata përhapin mendimet e tyre të shenjta porsi erërat që herë pas here hedhin farërat përreth tyre dhe më pas, duke lënë shiun të bjerë, shpërndajnë jetë në sipërfaqen e tokës. As pengesat në aktivitetin e tyre dhe as krizat e njëpasnjëshme nuk mund t'i trondisin. Ata përsërisin shpesh betimin e tyre dhe ia kushtojnë të gjitha bekimet e Zotit të bëra për ta, përforcimit të shpirtit të tyre monumental. Kudo mund të gjendet feja, fetaria dhe aprovimi i Zotit, është kjo arsyeja që ata përpiqen të qëndrojnë, ata vrapojnë drejt përmbushjes të kërkesave të Tij. Ata marrin ndëshkime aq të rënda në ndjekje të çështjeve tokësore, saqë njerëzit që i shikojnë këta trima, mendojnë se janë nga pjesëtarët e kësaj bote, që nuk kanë dijeni për botën e përtejme. Kur vështrojnë dashurinë tek ta, megjithatë, i mendojnë si krijesa të një rangu të lartë.

Neveria i pushton nga mendimi se jetët e tyre mund të jenë të boshatisura dhe të rrënuara. Ata janë gjithmonë aktivë në mëkëmbjen e jetës fetare, duke kompozuar apo shkruar diçka nëse janë të arsimuar, ose duke paraqitur një penë tek ata që janë shkolluar. Ata gjithmonë vazhdojnë të përpiqen për të dhënë

kontributin e tyre në karvanin e shërbimit. Ata duan dituritë, duke respektuar të diturit, zënë miqësi me njerëz të ndjeshëm dhe vazhdimisht lavdërojnë të Dashurin në kuvendimet e tyre.

Edhe nëse nuk ishin njerëzit e duhur të lënë në tokë, edhe nëse të gjithë horizontet ishin errësuar nga pluhuri, edhe nëse rrugët kanë qenë të pushtuara nga shthurja e përgjithshme, edhe nëse ferrat ishin më të shumta se trëndafilat, edhe nëse shëtitorja ishte populluar me laraska që mbysnin këngët e bilbilave, edhe nëse grerëzat ishin duke fluturuar rreth enëve me mjaltë, edhe nëse vetmia e një xhungle të frikshme po dominonte rrugët, edhe nëse nuk kishte mbetur respekt për dituritë, edhe nëse dijet ishin dëbuar nga çdo derë, edhe nëse njerëzimi kishte rënë viktimë e pabesisë, edhe nëse miqësia ishte harruar dhe shokët ishin kthyer në armiq, ata do të qëndrojnë akoma të patundur dhe thonë: "Unë qëndroj ndonëse të gjithë të tjerët janë rrëzuar! Gjithkund mund të kthehet në shkretëtirë. Por nuk ka ndonjë problem, për më pas kam lotët e mi për t›u njomur. Zoti më ka dhënë dy këmbë për të ecur dhe dy duar për të punuar. Unë besoj se kapitali dhe territori im është zemra ime e paanë. Mundësitë për të mëkëmbur botën janë duke më pritur mua. Me këto mundësi, unë mund ta kthej të tërë botën në një parajsë, me dëshirën e Zotit. Pse shqetësohemi për të ardhmen kur kjo tokë është kaq pjellore? Për më tepër, a nuk ka premtuar Zoti të vlerësojë një në një mijë në botën tjetër?» Dhe atëherë ata përparojnë, pavarësisht se urat janë të shkatërruara dhe rrugët të bllokuara. Si një lumë, ata sjellin jetë në çdo gjë, shuajnë zjarret që janë tek gjithsecili dhe gjenden ngado. Ose si zjarr, edhe nëse është nxjerrë jashtë vetes, ata mbrojnë njerëzit ndaj të ftohtit. Si qirinj, ata treten, për t'u dhënë dritë mijëra syve. Rruga e vërtetë nëpër të cilën ata ecin, është një drejtim i përbashkët për të shenjtët dhe kurrë nuk është vërtetuar që udhëtarët në këtë rrugë kanë dështuar për të arritur në destinacionin e tyre.

Ata janë vazhdimisht të sigurt dhe entuziastë, mjaft zemërgjerë, për të harxhuar pa hesap të gjithë pasurinë e tyre në emër të Zotit.

Ata i kalojnë jetët e tyre në festë për gjithçka kanë falur dhe dhuruar, duke shpresuar të gjejnë shumëfishin për atë që kanë dhënë në këtë botë. Në sytë e tyre, kjo nuk është gjithçka për të mbrojtur dhe shfaqur fenë në të gjithë botën. Ata e kuptojnë këtë qëllim si shkakun e ekzistencës së tyre dhe jetojnë në përputhje me të. Të gjithë ata janë të vetëdijshëm për këtë qëllim, prandaj vijnë së bashku me synimin për ta projektuar atë dhe për të thelluar këtë frymë kolektiviteti nga lidhja e tij me Zotin. Banorët më të lartë të qiejve gjithashtu i përshëndesin ata dhe lehtësojnë udhëtimin e tyre në rrugët për vërtetimin e misionit të shenjtë.

Kurrë nuk marrin në konsideratë mirëqenien e tyre dhe gjithmonë kanë Zotin në mendje. Ata mbajnë lart virtytin, përkrahin vlerat njerëzore, hapin zemrat e tyre për gjithsecilin me një mënyrë profetike dhe jetojnë për të tjerët. Në përgjigje për bujarinë e tyre, Zoti i shpërblen me privilegje të papritura në një ditë kur këmbët dhe duart tona nuk janë më në punë. Ai u dhuron atyre pendë nga krahët e engjëjve dhe u cakton atyre një takim me Prezencën e Tij të Shenjtë. Zoti gjithashtu i përfshin ata mes bekimesh, duke i trajtuar si të ftuarit e Tij të veçantë dhe i kurorëzon të gjitha këto bekime, me pëlqimin e Tij.

KRIJESAT NJERËZORË DHE NATYRA E TYRE

Njerëzit, reflektimi më i shkëlqyer i emrave, atributeve dhe veprave të Zotit, janë një pasqyrë e shndritshme, një fryt i mrekullueshëm për jetën, një burim për të gjithë universin, një det që ngjan të jetë një pikë e vockël, një diell formuar si një farë e thjeshtë, një melodi e bukur sido që nga pikëpamja fizike e parëndësishme dhe një burim për ekzistencën përfshirë i tëri brenda një trupi të vogël. Njerëzit mbajnë një sekret të shenjtë që i bën ata të njëjtë në mbarë universin me të gjithë pasurinë e tyre të karakterit, një pasuri që mund të ketë arritur në përsosmëri.

Njerëzit janë provat dhe interpretimet e më të Madhërishmit, sepse cilësitë e dhëna atyre në emër të Zotit në këtë botë të përkohshme, janë të hapura ndaj zhvillimit dhe në fakt, kanë evoluar tashmë. Njerëzit janë shëmbëlltyra më e përkryer e Mjeshtrit të tyre, që reflektojnë pamjet më domethënëse. E gjithë ekzistenca bëhet një libër i lexueshëm vetëm me inteligjencën dhe maturinë e tyre dhe këto janë cilësitë e vërteta të ekspozuara. Mund të thuhet që Zoti është vetëm burimi për të gjithë pasuritë e mbarë universit, njerëzit - së bashku me gjithçka në dhe përreth tyre - në anën tjetër, janë dëshmi të shkëlqyera të Mjeshtrit të tyre.

Njerëzit që kanë gjetur me të vërtetë rrugët për te Zoti nëpërmjet esencës së tyre dhe që janë gjithashtu udhërrëfyes për të tjerët, kanë fituar të drejtën për të qenë dëshmues të Zotit. Ju duhet të keni një mundësi për t'i takuar këta njerëz, me qëllim që të shmangni konfuzionin dhe mëkatet. Nëse ju keni një vizion, me fjalë të tjera, nëse ju jeni të ndërgjegjshëm për fshehtësinë e Tij të shenjtë, do të thotë që ju të jeni në gjendje të shfaqni gjithçka

në një dimension të ndryshëm. Sigurisht, njerëzit, mendimet e të cilëve janë të qarta siç është besimi i tyre dhe me qëndrimet dhe sjelljen e tyre synojnë të kënaqin Zotin, e bëjnë me dije çdo njeri për Zotin kurdo dhe kudo që të gjenden. Njerëzit e tillë zgjojnë, në mënyrë të pavetëdijshme, mendimin që ata janë "dëshmitarë për Zotin."

Profeti Muhamed, Krenaria e Njerëzimit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ka arritur horizontet përtej engjëjve me aftësitë e tij, të cilat më vonë ai i shfaqi në një shkallë më të lartë, ishte fara dhe fruti i pemës së ekzistencës. Ndonëse njerëzimi i është shumë mirënjohës Zotit për këtë pemë gjenealogjike dhe cilësinë e frutave të saj, kjo nuk është e mjaftueshme. Në mënyrë thelbësore, e para gjë që të vjen në mendje kur shqiptohet fjala "njerëzor" është i Dërguari i Zotit, sepse nuk ka njeri tjetër në një shkallë aq të lartë si ai. Dhe megjithatë, kjo krijesë e lartësuar ishte gjithashtu fruti i pemës së jetës. Shkurtimisht, ndërsa krijesa njerëzore është më e nderuara në këto krijime, Profeti është krenaria e njerëzimit.

Kur tërë universi i paanë, me të gjithë pasuritë, përbërësit dhe historinë e tij, është lidhur me natyrën njerëzore, është bërë e qartë pse vlerat e njerëzimit tejkalojnë gjithçka. Gjithashtu mund të thuhet që Zoti e krijoi jo vetëm këtë botë, por edhe tjetrën në emër të arritjes së përkryerjes njerëzore. I Dërguari i Zotit e konceptonte botën tjetër, në të njëjtën mënyrë siç e drejtoi jetën e tij në këtë botë, duke zbutur dhimbjet me shpresat e botës tjetër, duke përjetuar qiejt nëpërmjet gjerësisë së besimit edhe përpara se ai në të vërtetë t'i drejtohej parajsës, ndërsa gjithashtu ndante me bashkëpunëtorët e tij çfarëdo që ndjente. Edhe njëherë duhet theksuar që pavarësisht nga paanësia e tij, ai ishte një njeri, fruti më i magjishëm dhe më i ndritshëm i pemës së njerëzimit.

Njerëzit, megjithatë, janë larg nga një aftësi e tillë, një arritje e merituar e materialitetit dhe ndjeshmërisë së tyre. Për më tepër, gjithashtu mund të pretendohet që kur njerëzit janë të

paditur rreth vetvetes ose ekzistencës së tyre, atëherë ata janë më poshtë se krijesat e tjera. Akoma, njerëzit, me intelektet, bindjet, ndërgjegjjet, dhe shpirtrat e tyre janë vëzhgues dhe komentues për sekretet e shenjta që gjenden të fshehura mespërmes rrugëve të jetës. Prandaj, njerëzit, nuk ka rëndësi se si shfaqen, janë "modeli më i lartë," ata janë më të dashur nga çdo gjë tjetër. Islami nuk e vlerëson krijesën njerëzore pa shkuar në ekstremitet. Është e vetmja fe midis të gjithë sistemeve të besimit, e cila e shikon njeriun si krijesën më të lartë të adresuar në drejtim të një misioni të posaçëm, të pajisur me potencialet dhe dhuntitë më të larta. Sipas Islamit, njerëzit janë më superiorët, thjesht sepse ata janë njerëz. "Me të vërtetë Ne e krijuam njeriun si qenien më të respektueshme." Përmes dorëzimit të tyre tek Zoti dhe tek i Dërguari i Tij, njerëzit e sigurojnë në mënyrë të pakthyeshme këtë post. "Lavdia i përket Zotit, të Dërguarit të Tij, dhe në këtë mënyrë, myslimanëve.» Me përpjekjet dhe mundimet e tyre në tokë, ata bëhen gjithashtu të parapëlqyerit e Zotit. «Pa dyshim, Ne u tregojmë atyre që u përpoqën në udhën Tonë rrugën e suksesit dhe të kënaqësisë; Zoti është, sigurisht, me ata që e adhurojnë Atë, sikur të ishin duke e parë Atë." "Zoti i Gjithëmëshirshëm krijoi dashurinë në zemrat e njerëzve për ata që besojnë dhe veprojnë në përputhje." Kurani demonstron superioritetin e natyrës njerëzore në çdo aspekt të tij në një mënyrë tepër të përplotësuar dhe koncize. Çdo gjë që njerëzit kanë pranuar, domethënë besimin e tyre, veprat e vlefshme, krijimin, është mbështetur në vlerat njerëzore, si një punë e thurur me penjtë e natyrës njerëzore. Natyra njerëzore u është dhënë njerëzve si një dhuratë, asnjë çmim nuk është kërkuar dhe asgjë nuk është pritur në kthim.

Të gjitha marrëdhëniet njerëzore janë ndërtuar brenda kësaj domethënieje dhe në këtë kontekst këto lidhje janë gjithmonë të ndikuara prej saj. Një krijesë njerëzore, le të jetë burrë apo grua, i ri apo i vjetër, i bardhë apo i zi, është e respektuar, e mbrojtur dhe e pacenuar. Pasuria e tyre nuk mund të hidhet tutje dhe as dëlirësia

dhe pastërtia e tyre nuk mund të përgojohet. Ata nuk mund të përzënë prej vendlindjes dhe pavarësia e tyre nuk mund të jetë mohuar. Ata, për më tepër, nuk mund të ndalohen të jetojnë në përputhje me parimet e tyre. Përveç kësaj, ata gjithashtu nuk janë lejuar të angazhohen në krime të tilla kundër të tjerëve. Ata nuk kanë të drejtë të shkaktojnë konflikte në këtë dhuratë që u është dhënë prej Zotit, ata janë vetëm pronarë të përkohshëm të kësaj bujarie, Zoti është pronari i vërtetë për gjithçka. Njerëzit janë ngarkuar vetëm me mbrojtjen e kësaj përgjegjësie të përkohshme. Njerëzit janë për ta ruajtur dhe mbajtur të sigurt këtë dhuratë që është e shenjtë për ta. Ata nuk dëshirojnë ta cenojnë atë, ose të lejojnë që ajo të vijë e dëmtuar. Kur të jetë e nevojshme, ata do të luftojnë dhe vdesin për të. Duke nxjerrë në pah rëndësinë e të drejtave të patjetërsueshme të natyrës njerëzore dhe duke theksuar superioritetin e krijesës njerëzore, Mbreti i Fjalës, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, e paraqet atë kështu: *Ai që është vrarë në emër të mbrojtjes së pasurisë së tij është një martir. Ai që është vrarë në emër të mbrojtjes së jetës së tij është një martir. Ai që është vrarë në emër të mbrojtjes së të afërmve të tij është një martir. Dhe ai që është vrarë në emër të mbrojtjes së atdheut të tij është një martir.*[55]

Sa pranë gjendet sot njerëzimi me këtë nivel të kuptuari? Unë mendoj se për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet të dalësh nga kornizat e këtij shkrimi.

Në kushtet e besimit dhe lidhur me çështjet përkatëse të besimit, njerëzimi ka qenë i bekuar me diferencim. Me të vërtetë, kur krahasohet me universin e tërë, natyra njerëzore është superiore ndaj qiejve dhe ndaj engjëjve gjithashtu. Çdo gjë në tokë dhe në qiell është në shërbim të tij dhe ata kanë të drejtë të vënë në përdorim stimujt për këtë. Zoti e bëri këtë dhuratë për njerëzimin për arsye të pafuqisë dhe nevojave të tyre. Zoti i vlerësoi krijesat njerëzore si të ftuara në këtë botë. Vetëm ata që besuan mund

[55] Tirmidhi, *Dijet,* 22 (1418-1421); Ebu Davud, *Sunen*, 32 (4772); Nesai, *Tahrim*, 22 (7, 115, 116); Ibni Maxhe, *Hudud*, 21 (2580).

ta çmojnë një dhuratë të tillë. Besimtarët që janë të vetëdijshëm për domethënien e vërtetë të ekzistencës, do ta pranojnë me mirënjohje të gjithë universin si një pallat për ta dhe ata do t'i kenë të gjithë gjërat, të gjalla ose jo, si shërbëtorë të tyre.

Një hap më tutje, kur bisedohet rreth një njeriu që vepron me ndërgjegje dhe vullnet dhe gjithashtu rrëmon në thellësi të zemrës dhe shpirtit të tij, atëherë bëhet e vështirë për ta përshkruar një njeri të tillë. E vetmja rrugë për të lavdëruar një krijesë të tillë njerëzore, një person që ka shfrytëzuar vlerat e veta të mundshme dhe ka arritur majat, është të citosh Mehmet Akifin: *Ai është krijuar më i lartësuar edhe nga engjëjt, / Të gjithë botët fshihen brenda tij dhe mbretëritë janë përfshirë tek ai.*

Tani, pasi Zoti i ka falur të gjithë këto për ne, çfarë pritet prej nesh si njerëz? Kjo është me të vërtetë shumë e rëndësishme. Nëse ne e diskutojmë ose jo, ajo është një çështje që ekziston objektivisht. Vetëm nëse gjithsecili është i ndërgjegjshëm që një përgjegjësi e tillë e madhe ka rënë mbi ta.

THELLËSITË E BRENDSHME NJERËZORE

Krijesa njerëzore është esenca dhe elementi jetësor për ekzistencën, treguesi dhe bërthama e universit. Krijesat njerëzore janë në qendër të krijimit, të gjitha gjërat e tjera, të gjalla ose jo, formojnë rrathët koncentrikë përreth tyre. Mund të thuhet që Krijuesi i Lartë ka orientuar çdo krijesë në drejtim të qenieve njerëzore dhe ka orientuar krijesat njerëzore drejt Atraksionit të Tij Hyjnor, duke i bërë ata të vetëdijshëm për faktin që ky është një drejtim ku mund të gjenden mbështetja dhe ndihma. Duke gjykuar të gjitha privilegjet që i janë dhuruar njerëzimit, në krahasim me pjesën tjetër të krijimit, krijesa njerëzore mund të shohë dhe të dëgjojë si zërin që shpreh natyrën e gjërave, natyrën e ngjarjeve, dhe sigurisht, natyrën e të Gjithëfuqishmit që është prapa gjithçkaje, po ashtu edhe krijesën e kuptuar si një zemër që ngërthen të gjithë universin. Me krijesat njerëzore, krijimi ka gjetur interpretin e tij dhe përmbajtja ka nxjerrë thelbin nëpërmjet njohjes për njerëzit, duke zbuluar domethënien e tij shpirtërore. Leximi i gjërave është një aftësi e veçantë e krijesave njerëzore, aftësia e tyre për të kuptuar dhe interpretuar librin e universit është një privilegj dhe cilësimi i tyre për gjithçka me Krijuesin është një bekim i jashtëzakonshëm. Introspeksioni i tyre i qetë është soditje, ligjërata e tyre është urtësi dhe interpretimi përfundimtar për të gjithë gjërat është dashuri.

Njerëzit janë të vetmit të cilëve u janë dhënë privilegje për të drejtuar dhe për të vënë në funksionim krijimin dhe njerëzit janë të vetmit që zbulojnë të gjitha pamjet e vërteta prapa fenomeneve natyrore, duke i ofruar këto në lidhje me Krijuesin. Njerëzit

ndjejnë dhe dallojnë marrëdhënien në mes krijesës njerëzore, universit dhe Krijuesit - një marrëdhënie që i drejton ata tek dijet. Ata zbulojnë potencialet dhe thellësitë e tyre, duke lënë pas engjëjt, siç janë të sigurt në aftësitë për të pasqyruar madhështinë e oqeanit në një pikë uji të vetme dhe të reflektojnë të gjithë diejt brenda një atomi të vetëm. Të privilegjuar në tokë, pikat e dobëta të natyrës njerëzore bëhen kurora për ata që ishin krijuar para pak kohe dhe qenia e tyre e krijuar në tokë ka qenë krenaria për botën fizike në lidhje me krijesat e shpirtit në qiej. Nëse ne e mendojmë të tërë ekzistencën si një oqean të paanë, atëherë krijesa njerëzore është perla më e çmuar e tij. Nëse universi është një sallë ekspozimi, me të gjithë shkëlqimin e shfaqur, atëherë krijesa njerëzore është vizitori i saj i çmuar. Nëse gjërat dhe ngjarjet janë një harmoni magjepsëse e ekuilibrit, atëherë krijesa njerëzore është një spektator i ndjeshëm. Në dritën e besimit, mendimi i orientuar dhe vetëdija e shëndoshë njerëzore të cilat ngjajnë të qeta dhe rrethuar nga errësira, janë ndriçuar dhe kanë fituar bukuri, kurse zemrat tona ndjehen sikur ne të ishim në parajsë. Para kohës kur njerëzimi ngjitej në fronin e tij në tokë, engjëjt dhe qeniet e tjera shpirtërore mbanin flamurin që shpallte të vërtetën në horizontin e botës shpirtërore. Flamuri, nderuar nga arritja e njerëzimit, filloi të valëvitej në lartësitë e botës së vdekshme dhe ky rruzull tokësor - aq i vogël kur krahasohet me qiejt - u bë i njëjtë me ta për shkak të horizontit të botëve të përtejme. Krijesa njerëzore ka qenë gjithmonë kurora e krijimit. Kjo është e vërteta për sa kohë që besimi është burim gëzimi, për aq kohë sa Islami ka qenë dhe është kodi i jetës, për aq kohë sa njohuritë për Zotin dhe dashurinë kanë qenë dhe janë forcë lëvizëse e brendshme. Toka është e kushtëzuar nga drita që shpërndahet prej njerëzimit. Kjo dritë ka qenë dhuruar prej të Gjithëfuqishmit, nga favoret e Tij të veçanta. Ky favor special ka privilegjuar njerëzimin duke e bërë atë trëndafilin më të rrallë në këtë kopsht të bukurisë. Imam

Gazaliu[56] e përshkruan këtë hijeshi në këtë mënyrë: "Paraqitja e krijimit nuk mund të jetë më estetike, më e mrekullueshme ose më mahnitëse!" Njerëzimi mund të shihet si bilbili i vetëm në këtë botë, një botë e cila është një hije e parajsës.

Nuk do të jetë e tepruar të themi që këto ballkone - që gjenden njëri pas tjetrit - kanë qenë skicuar dhe sistemuar vetëm për njerëzimin. Nuk mund të jetë e zmadhuar nëse themi që kjo botë ka qenë krijuar si një kopsht për këta trëndafila të rrallë, ose që deti i ekzistencës ka qenë krijuar si një thellësi për këtë perlë, deri diku është një përshkrim modest për gjendjen e vërtetë të gjërave. Si një çështje në fakt, e tërë ekzistenca, në një drejtim, ka qenë interpretuar dhe shfaqur në të njëjtën ecuri me udhën e njerëzimit, për njerëzimin, dhe në shërbim të njerëzimit. Ajo është pothuajse e varur pas njerëzimit dhe në kushtet e njerëzimit, varësi pas Zotit, i cili ka dorëzuar gjithçka nën drejtimin e njerëzimit. Një marrëdhënie e tillë kaq e fortë është lidhur mes njerëzimit dhe Zotit. Qëllimi i të gjithë krijimit nuk mund të jetë asgjë tjetër veç njerëzimi dhe adhurimi i tij ndaj Zotit.

Në fakt, nevojat e natyrës njerëzore janë aq të mëdha, sa mbulojnë të gjithë krijimin, dhe janë aq të thella sa shtrihen deri në përjetësi. Mbi të gjitha, krijesat njerëzore kanë qenë krijuar për amshimin, dhe ata dëshirohen për atë. Dëshirat dhe kërkesat e qenieve njerëzore janë të pafundme dhe shpresat e tyre janë të pakufizuara. Edhe nëse e tërë bota do t'i ishte dhënë natyrës njerëzore, oreksi i saj nuk do të ishte plotësuar ose ambicia e saj nuk do të reshte. Shkoqur ose jo, shpirtrat njerëzorë presin banesën tjetër të përjetshme, duke mos zënë në gojë faktin që ata lakmojnë vazhdimin e botës së përkohshme. Kushdo që ka një zemër të hapur ndaj dëshirës për të parë parajsën – e cila nuk është më shumë se një hije e parëndësishme për Madhështinë e Tij - dëshiron ta shohë Krijuesin e Lartë me të gjithë shkëlqimin dhe bukurinë e Tij.

[56] Imam Gazaliu (1058-1111), mendimtar dhe jurist i shquar islam.

Njerëzit që mund ta ndjejnë dhe kuptojnë vërtetësinë në pamjen e gjërave dhe në ndodhitë dhe që janë të vetëdijshëm për pozicionin e tyre në univers, janë në këtë udhëtim. Në të njëjtën kohë, këta njerëz janë mirënjohës për veten dhe janë të hapur për të treguar respekt për Zotin e tyre. Për sa u përket atyre që janë në kundërvënie, ata nuk mund të thonë nëse ndjejnë respekt për veten apo për Zotin e tyre. Për më tepër, ata madje nuk mund ta vlerësojnë ashtu siç duhet Zotin e tyre. Edhe nëse atyre u është dhënë një mundësi e tillë, ata nuk janë në gjendje ta lartësojnë Atë siç e kërkon Madhështia e Tij. Arritjet e vërteta njerëzore kushtëzohen në mirënjohjen e lidhjes në mes Zotit dhe shërbëtorëve të Tij. Në mënyrë paradoksale, krijesat njerëzore, që janë konsideruar të jenë më të bekuara se engjëjt në kufijtë e mundshëm të tyre, janë më të përshtatshëm për t'u poshtëruar në krahasim me krijesat më të përbuzura nëse ata nuk e kuptojnë dhe vlerësojnë këtë lidhje. Këtu është përqendruar në ajet:

…Ata janë si bagëtitë, madje edhe më keq. (A'araf, 179)

Mirënjohja për këtë asociacion që është formuluar përgjithësisht si besim, është një pozicion përmes të cilit një krijesë njerëzore mund të arrijë natyrën njerëzore të vërtetë dhe prej këtej njerëzit mund të ngrihen mbi të gjitha krijesat e tjera. Ndërsa mosbesimi, një term tjetër që tregon për mungesën e një bashkëshoqërimi të tillë, i kthen krijesat njerëzore në kafshë. Shoqëritë e krijuara nga njerëz të tillë vuajnë nga zemërimi i papërmbajtur, tërbimi, lakmia, mashtrimi, hipokrizia, smira, gënjeshtrat dhe intriga, gjë që do të thotë se në shoqëritë e krijuara me mosbesim, gjithsecili mund të jetë në panik. Në çdo rast, njerëzit që u janë dorëzuar këtyre fenomeneve negative, kurrë nuk mund të jenë pranuar si anëtarë të një kombi apo shoqërie, ata thjesht mund të jenë përshkruar si pjesëtarë të turmave të pandërgjegjshme. Kur Diogjeni në mes të ditës, gjendej në rrugë në kërkim të një krijese njerëzore, me një fener në dorë, ka mundësi që ai po përpiqej të këshillonte apo të shfaqte reagimin e tij ndaj njerëzve të tillë.

Mark Aurelius, autori i veprës *Mendimet,* pasqyronte të njëjtën ide në një mënyrë të ndryshme, duke thënë: "Çdo mëngjes, kur unë shoqërohem me njerëz të tjerë, mendoj për veten time: sot unë do të takoj përsëri disa kafshë në trajtë njerëzore. Nëse do të arrija mbrëmjen pa ndonjë të papritur ose pa u kafshuar nga ndonjëra prej tyre, do ta konsideroja veten të lumtur!» Rabia Adevije e ka trajtuar këtë çështje më seriozisht duke reaguar më ashpër: "Unë thuajse kurrë nuk shoh një njeri në rrugë. Ajo që shoh, janë disa dhelpra përballë tregtoreve, disa ujqër dhe krijesa të tjera që i hungërojnë njëri-tjetrit… Për një moment, unë shoh një gjysmë njeri dhe mbulohem për ta shmangur këtë pamje!" Në mënyrë të dukshme, të lartpërmendurit nuk synojnë të penalizojnë të gjithë njerëzimin. Më saktë, ata janë duke u përpjekur të përshkruajnë botën e brendshme të atyre që i kanë kthyer vlerat e natyrshme njerëzore në egoizëm. Në qoftë se njerëzit nuk arrijnë të zotërojnë sjelljen në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre ose të drejtojnë botën e tyre të brendshme në respekt të pamjes së jashtme në përpjekje për të eliminuar mospërputhjet, atëherë ata janë plotësisht të përshtatshëm për t'u shfaqur siç i kanë përshkruar Mark Aurelius dhe Rabia Adevije.

Në mes të këtyre njerëzve ju herë pas here mund të ndeshni persona të cilët shfaqen të qeshur dhe gazmorë edhe nëse ata janë qenie të mjera brenda vetes së tyre ose thjesht janë të dëshpëruar. Ata gjithashtu, janë një ekzemplar tjetër. Një filozof i ka krahasuar ata me një ndërtesë me dy pamje të ndryshme. Fasada e saj është e pastër, e bukur dhe impresionuese, ndërsa faqja prapa është e pistë, e shëmtuar dhe e lënë pas dore. Kur ne vështrojmë një godinë të tillë në rrugë, themi "shumë e bukur," duke u nxituar në konkluzionin tonë. Kur ne vëzhgojmë edhe pamjen tjetër, e ndryshojmë plotësisht mendimin tonë për ndërtesën që me padurim pak minuta më parë e kishim mburrur. E njëjta gjë është edhe për njerëzit. Ne do të jemi gjithmonë të gabuar nëse i vlerësojmë ata vetëm në një aspekt. E rëndësishme është të

shohim se si janë ata në të vërtetë dhe të bëjmë disa orvatje për të përmirësuar pamjen e tyre të pasme, si edhe duke i marrë në konsideratë në përputhje me pamjet e tyre të padëmtuara.

Krijesat njerëzore janë si fëmijë në lidhje me atributet dhe qëndrimet e tyre. Ne mund të gjykojmë se cilat karakteristika ose atribute janë mbizotëruese tek një person në përputhje me sjelljen që demonstron, të mirë ose të keqe. Nganjëherë njerëzit mund të kthehen në monstra, të gatshëm për të kafshuar ata që janë të afërt me ta. Herë pas here njerëzit kthehen në "Jusufë,» pamjet e tyre shkëlqejnë si hëna duke ndriçuar burgun e nëndheshëm dhe duke e kthyer atë në një rruginë të parajsës. Hera herës ata bëhen aq të dëlirë dhe të thjeshtë sa edhe engjëjt t'i kenë zili. Dhe nganjëherë ata janë aq të këqij sa edhe djajtë ndjehen të turpëruar.

Krijesat njerëzore nganjëherë mund të bëhen aq të mrekullueshëm sa mund të ngrihen lart tek qiejt, megjithatë, nganjëherë ata janë aq të neveritshëm sa që bëhen më të këqij se gjarpërinjtë dhe insektet helmuese. Qeniet njerëzore janë krijesa që mund të demonstrojnë një qëndrim në një rreze aq të gjerë sa që ata mund të zotërojnë cilësitë e zvetënuara pranë meritave të tyre dhe mund të tundohen lehtë nga e keqja, sido që kanë në vetvete virtyte të larta. Besimi, dituritë, dashuria dhe kënaqësitë shpirtërore janë, në të njëjtën mënyrë si zemra, pjesa më e rëndësishme e jetës së tyre, dashuria për të tjerët, përkrahja e gjithsecilit, duke jetuar me ndjenjat e mirësjelljes dhe duke i mbajtur të tjerët në jetë në të njëjtën rrugë, ky është qëllimi i fundit i jetës së tyre. Mënjanimi i së keqes me mirësinë, etja për dashurinë dhe të qenët në një përpjekje të vazhdueshme kundër ndjenjave të armiqësisë, janë si ëmbëlsira për ata, si një pështpëritje për shpirtrat e tyre. Ndjenjat e së keqes, si lakmia, zemërimi, urrejtja, epshi, shpifja, gënjeshtra, hipokrizia, shthurja, oportunizmi, egoizmi, burracakëria dhe ambicia përparojnë drejt tyre vjedhurazi, në pritje të një momenti pasigurie. Ata mund të jenë pushtuar nga ndjenjat dhe pasionet e errëta, duke u robëruar prej tyre, duke u bërë të këqij në një shkallë

të pakrahasueshme, pavarësisht nga fakti që të njëjtët njerëz kanë potenciale për të qenë sundimtarët e universit nëpërmjet virtyteve dhe qëndrimit dinjitoz. Edhe nëse një person i tillë mund të duket i lirë dhe i pavarur, në të vërtetë ata janë më të robëruarit, liria mund të arrihet vetëm nga suksesi në luftën e brendshme - një luftë e etiketuar «xhihadi i madh» në Islam. Vlerësimi i potencialeve të natyrshme dhe përftimi i një natyre të dytë që është e hapur për një lidhje me të Gjithëfuqishmin, kushtëzojnë suksesin në këtë luftë, një luftë që e ka vendin thellë në shpirt. Në çdo rast ata i nënshtrohen luftës me mirënjohje për këtë fitore dhe në çdo rast ata përkulin kokat në një nivel me këmbët, duke formuar një rreth në modestinë dhe përulësinë e tyre.

Njerëzit me vullnet të dobët, që janë të paaftë të kapërcejnë cektësinë dhe të vështrojnë në thellësitë e brendshme të tyre, të shikojnë të çarat dhe të metat brenda natyrës së tyre si dhe vlerat në shpirtrat e tyre dhe që janë të paaftë të përtërijnë vetveten në çdo ditë të re, kurrë nuk mund të përparojnë në botën e tyre të brendshme. Edhe nëse vazhdojnë të flasin rreth progresit të tyre, ata kurrë nuk përpiqen të bëjnë hapa përpara, por rrëshqasin gjithmonë prapa. Njerëzit e tillë nuk mund të shpëtojnë sytë, veshët, gjuhët, buzët, duart, apo këmbët nga robëria e egos së tyre, ata jetojnë si skllevër gjatë gjithë jetës pa qenë madje të vetëdijshëm për këtë fakt tragjik. Të thuash të vërtetën, këta njerëz, skllevër të dëshirave të tyre trupore, janë në një gjendje për të ardhur keq.

Të duash dhe të kujdesesh për ata që ruajnë dhe përmirësojnë natyrën e tyre njerëzore, do të thotë t'u japësh meritat që u takojnë. Dhe për ta plotësuar, ata duhet të tregojnë një dashuri dhe simpati të tillë që të mund të shpëtojnë nga pushteti i ndjenjave dhe pasioneve të tyre të errëta. Një qëndrim i tillë është shprehje e kujdesit për krijesat njerëzore, të cilat Zoti i krijoi si të denjë për respekt… dhe krijesa njerëzore është një entitet i krijuar për të qenë një qenie e dashur.

NATYRA NJERËZORE DHE PËRGJEGJËSITË E SAJ

Nëse natyra njerëzore është zëvendësi i Zotit në tokë, i parapëlqyeri nga të gjithë krijimet e Tij, esenca dhe përmbajtja e ekzistencës në tërësinë e saj dhe pasqyra më e ndritshme e Krijuesit - dhe në këtë nuk ka dyshim - atëherë Qenia Hyjnore që e ka sjellë njerëzimin në këtë botë, na ka dhënë neve të drejtën, lejen dhe aftësinë për të zbuluar misteret e ngulitura në shpirtin e universit, për të zbuluar pushtetin e fshehtë, fuqinë dhe potencialin, për të vënë në përdorim gjithçka në kontekstin e vet dhe për të qenë përfaqësuesit e cilësive që lidhen me Atë, të tilla si dija, dëshira, vullneti dhe forca. Ndërsa njerëzit janë përfshirë në ekzistencë dhe përmbushin titullin e tyre të zëvendësit, ata nuk do të vrapojnë në çdo pengesë që nuk mund ta kapërcejnë, ata nuk do të përjetojnë kontradikta në marrëdhëniet e tyre me gjërat. Ata duhet të enden lirisht në korridoret e ngjarjeve, nuk duhet të ndjehen të tensionuar kur të zbulojnë aftësitë që janë rezervuar brenda natyrës së tyre dhe nuk duhet të mbeten prapa nga pengesat e pakapërcyera kur të realizojnë shpresat e tyre.

Është më se e qartë që me sukseset dhe përfundimet që kanë arritur deri më sot, njerëzit janë dërguar në tokë me instrumente dhe mundësi specifike. Në të vërtetë, pavarësisht nga të gjithë problemet e shkaktuara nga dobësia njerëzore, nëse konsiderojmë që ne, si njerëz, nga sukseset kemi arritur në majat më të larta, është e qartë që asgjë nuk mund të na ndalojë ne. Edhe pse ndonjëherë kemi gabuar, ne kemi arritur shumë suksese. Me forcën e vullnetit tonë jemi përpjekur ta shndërrojmë ekzistencën. Ne e kemi

ndryshuar botën duke e zhvilluar atë dhe me mendjemprehtësi ose jo, ne jemi pasqyra që reflekton kuadrin e ri të përshkruar kur i Larti dhe i Vetmi shpalli:

Unë po krijoj në tokë një mëkëmbës! (Bekare, 30)

Është e vërtetë që njeriu ka justifikuar gjatë kohërave frikën e engjëjve të cilët, në momentet kur u krijua qenia njerëzore, parashikonin gjakderdhje, por përkrah kësaj të keqeje të pjesshme, veprat e mira me gjerësinë, qëndrueshmërinë dhe shkëlqimin e tyre si rezultat i arritjeve të njerëzimit, për më tepër, nuk janë të parëndësishme. Në të vërtetë, duke i vënë në balancë me të keqen, veprat e mira dhe dinjitoze kanë qenë gjithmonë në avantazh dhe më të shumta. Subjekt i ligjshëm për Zotin janë hënat dhe diejt e njerëzimit. Me qëllim që të ndalojë të keqen dhe lëndimin, tek të përshpirtshmit dhe ata që përfundojnë tek Ai, tek të sinqertët dhe profetët, ka shpërndarë veprat e mira përreth tyre dhe këto vepra janë shfaqur kudo. E drejta për të mbajtur titullin e zëvendësit të Zotit- dhënë në ruajtje njerëzimit - ka qenë dhuruar për shkak të meritave, veçanërisht atyre që janë të ndërgjegjshëm për qëllimin e krijimit. Besimtarët që kanë arritur të kuptojnë shpirtin e krijimit që do të thotë, ata janë dërguar në këtë botë me pasurinë e një mënyre të ndryshme gjykimi dhe besimi dhe po ashtu me përgjegjësi të ndryshme, mund të përputhin qëndrimin dhe harmonizojnë sjelljen sipas kësaj mënyre. Këta besimtarë kanë një sjellje që është përvijuar nëpërmjet aftësive të hapura dhe të fshehta dhe gjithashtu përmes Kuranit që nxjerr në pah vazhdimisht lidhjen mes vlerave të merituara dhe sjelljes e qëndrimit të tyre. Në Kuran, Zoti i Gjithëfuqishëm thekson qëllimin më të rëndësishëm për qenien e krijuar në trajtë njerëzore, për të merituar statusin e zëvendësit dhe për t'i dhënë këto aftësi për të cilat Ai ka thënë:

Unë i krijova njerëzit dhe xhindet vetëm që të më adhurojnë Mua! (Dharijat, 56).

Kjo është themelore, sepse ky njoftim kaq i qartë është një

thirrje për përgjegjësi të përbashkëta dhe po ashtu një thirrje për të treguar mirënjohjen për gjërat që i janë dhuruar njerëzimit, si edhe një paralajmërim i rëndësishëm që vë në qendër të vëmendjes sonë detyrimet kryesore për të qenë zëvendës në tokë.

Paraqitja e qenies si subjekt për Zotin në tërë dimensionin e vet, është një titull hyjnor për krijesën në harmoni me ekzistencën dhe gjërat, për të qenë i mirëpërshtatur me botën dhe gjithçka që gjendet në të, për të ndërmarrë një rrugë përmes korridoreve misterioze të universit, pa u ndjerë i humbur, më shkurt, për të mbrojtur balancën në mes të harmonisë së brendshme dhe ekzistencës. Njeriu i ndershëm duhet t'i sjellë standardet e tij në pikën ku takohen parimet themelore të ekzistencës me qëllimin e normave të saj. Pa siguruar një balancë të tillë do të jetë e pamundur të vazhdohet në këtë rrugë, në respektimin dhe mbrojtjen e vlerave njerëzore.

Suksesi i njerëzimit në ruajtjen e lidhjes së tij me ekzistencën dhe botën fizike, mund të jetë përcaktuar nga shkalla e përputhjes së veprave me qëllimin e të gjithë krijimit. Në të kundërt, ata që nuk kanë vepruar në përputhje me këtë qëllim dhe ata që mund të kenë neglizhuar pjesërisht detyrimet e tyre, përveç vuajtjeve nga pavendosmëria dhe mungesa e kontrollit, gjithmonë ndeshen me sferat që sillen përqark dhe ruletat gërvishtëse në univers. Në këtë mënyrë, ata janë në gjendje ta shndërrojnë këtë botë, e cila është shtëpia e tyre dhe që mund të jetë si një pallat, në një ferr. Edhe sot, disa dridhen nga frika e një të ardhmeje të afërt, siç janë të ndërgjegjshëm që është e mundur ta kthejnë botën në një ferr të tillë.

Është fakt i padiskutueshëm që vetëm Zoti që e ka gatitur universin si të ishte një varg ballkonesh, si një libër, i Cili e vuri atë në interes të njerëzimit, mund të njohë natyrën e pajtueshmërisë mes ligjeve matematikore - ligje me të cilat ekzistenca vepron - dhe ligjeve të përgjithshme, që janë bërë me qëllim dhe në funksion të njerëzimit. Brenda kornizës së këtyre mesazheve që

rrjedhin nga burimi i dijeve, duke iu bindur rregullave që janë të lidhura me normat që e përshkojnë, është një rrugë e veçantë për të kuptuar sekretet e parimeve të ekzistencës, gjithashtu është një rrugë që siguron tërësisht harmoninë me këto parime. Në të vërtetë, vetëm në këtë rrugë njerëzimi mund të shpëtojë nga rënia në kundërshtim me këto ligje që zbatohen në të gjithë ekzistencën, pa e provuar shijen e humbjes, duke ndjerë qetësinë që të jep të qenët në shtëpi, të qenët në një pallat. Në anën tjetër të medaljes, shkëputja e njerëzve nga Krijuesi i tyre, ftohja e tyre ndaj Atij, do t'i drejtojë ata në një rreth vicioz për shkak të shkëputjes dhe ftohjes, ku do të gjenden në konflikt me ekzistencën dhe fenomenet. Nuk është e mundur që një person i tillë të përtërihet.

Për natyrën njerëzore, pozicioni i zëvendësit të Zotit, e ka vendin në një fushë jashtëzakonisht të gjerë që ngërthen të gjithë veprat e radhitura të besimtarëve në lidhje me Atë dhe adhurimin për Atë, të kuptuarit e mistereve brenda gjërave dhe shkaqet e fenomeneve natyrore dhe për pasojë, të qenët i aftë për të ndërhyrë në natyrë. Gjatë gjithë jetës së tyre, krijesat njerëzore të vërteta, së pari përshtasin ndjenjat dhe mendimet e tyre, disiplinojnë jetën personale dhe shoqërore përmes formave të ndryshme të adhurimit, ekuilibrojnë marrëdhëniet familjare dhe shoqërore nga veprimet e tyre dhe prej mbartjes së standardeve për specien që përfaqësojnë nga thellësitë e tokës në hapësirën e qiejve, duke bërë çfarë është e nevojshme për të qenë një pasues autentik. Në të njëjtën kohë, këto krijesa njerëzore të vërteta përpiqen të ushtrojnë vullnetet e tyre të lira në një mënyrë sa më konstruktive, duke punuar me botën dhe duke e zhvilluar atë, duke ruajtur harmoninë mes ekzistencës dhe njerëzimit, duke korrur zemërgjerësinë e tokës dhe të qiejve në të mirë të njerëzimit, duke u përpjekur të lartësojnë pamjen, formën dhe aromën e jetës në një nivel të njerëzishëm brenda strukturës së synimeve dhe rregullave të Krijuesit.

Kjo është natyra e vërtetë e një zëvendësi dhe në të njëjtën kohë këtu mund të gjendet se çfarë domethënie ka të jesh një shërbëtor

dhe i dashur për Zotin. Po ashtu, ne mund të gjejmë këtu pikën e takimit në mes veprave më të parëndësishme dhe dhuratave më bujare. Veprimi që do t'i drejtonte njerëzit në këtë pikë me një hap është adhurimi. Adhurimi nuk është thjesht ekzekutimi i një kategorie lëvizjesh të veçanta, siç besojnë disa, ai është nënshtrimi i plotë dhe miratimi që ne duhet të tregojmë për një përgjegjësi të rëndë dhe në krah me titullin e zëvendësit, është shfaqja më e qartë e lidhjes në mes njerëzve, universit dhe Zotit. Nëse adhurimi është dorëzim i vetëdijes për krijesën e drejtuar te Zoti në zemrën e vet, nëse është çlirimi i vetvetes nga të gjitha llojet e skllavërisë, nëse është një titull për ta vështruar, dëgjimi dhe ndijimi i bukurisë, rregulli dhe harmonia që janë të lidhura me Atë në çdo molekulë të ekzistencës - dhe për këtë nuk ka dyshim - atëherë adhurimi është rruga më e drejtpërdrejtë për të kthyer pamjen tonë nga Zoti, me gjithsecilin dhe me gjithçka, është rruga e menjëhershme dhe më e qëndrueshme për të bashkuar çdo gjë me Atë. Është një rrugë, gjithashtu, në të cilën ne mund të përtërijmë në çdo minutë të ditës këtë lidhje të vërtetë dhe të kuptueshme. Asnjeri prej atyre që ecin në këtë rrugë me ndërgjegje të plotë nuk do të dyshojë për asnjë moment që është një shërbëtor dhe detyra e tyre e vetme është t'i kushtohen përmbushjes së vlerave të merituara të zëvendësit. Njerëzit e tillë do të përpiqen të jetojnë dhe ta lënë jetën e përkohshme të kësaj bote për të jetuar në të pakufizuarën, ata do të përpiqen të shkruajnë emrat e tyre me bojën e përpjekjeve dhe sinqeritetit kudo që do të shkojnë. Ata do të përpiqen të frymëzojnë të njëjtat ndjenja në të gjitha vendet ku shtrihen duart dhe emrat e tyre. Ata do të përpiqen të arrijnë në një thellësi të tillë që do të zëvendësojë të gjithë botët, ndërsa gdhendin mendimet e tyre në çdo pjesëz të kohës dhe hapësirës - mendime që janë kufizuar tek Ai. Ata do të përpiqen të jetojnë me një qëllim madhështor që do të jetë mjaft i lartë për t›u mundësuar atyre të vlerësojnë amshimin dhe kështu t'i zhytë ata në një qetësi të brendshme që vjen nga të qenët i lidhur me përjetësinë. Ata do

të ecin me dalldinë më të madhe shpirtërore, duke kaluar kufijtë e ekzistencës dhe duke arritur në Parajsë.

Dhe nëse njerëzit e tillë e reflektojnë këtë detyrim me shërbimin dhe përgjegjësinë në punë dhe jashtë saj, nëse ata janë në gjendje të kërkojnë esencën e parimeve themelore të ekzistencës dhe t'u binden rregullave në lidhje me normat që i shoqërojnë, më mirë se të lidhin vetveten me pasojat e veprimeve të tyre, atëherë asnjë përfundim i papritur nuk do t'i bëjë ata të ndjehen të humbur ose të dobësojë entuziazmin e tyre. Në vazhdim, ata do të kryejnë të gjitha veprimet e funksionit të tyre me një gëzim për adhurimin dhe të vetëdijshëm për mirënjohjen, për pasurinë që ka arritur majat tek besimtarët e vërtetë, një majë e konsideruar të jetë niveli më i lartë i ekzistencës. Njerëzit e tillë kurrë nuk do të bien në dëshpërim, as paniku dhe as ndjenja e rraskapitjes së pritshme nuk do ta vështirësojë rrugën e tyre. Njerëzit e tillë janë larg nga dëshpërimi, paniku dhe rraskapitja. Ata vrapojnë përpara duke ndjerë aromën e fortë e të fshehtë në esencë të veprës, siç thuhet në jehonën e Rumiut: *Unë jam bërë një skllav, / Unë jam bërë një skllav, Unë jam bërë një skllav; / Skllevërit janë të gëzuar kur janë të lirë, / Por unë jam i nderuar dhe i lumtur të bëhem një skllav.*

Këta njerëz i krahasojnë dhe vlerësojnë punët dhe veprat jo nga rezultatet e arritura, por drejtpërsëdrejti nga mënyra se si detyra është zbatuar, nëse ka qenë kryer me një zemër të pastër dhe nëse përputhet me aprovimin e Zotit. Në këtë mënyrë, nuk i vënë kufi pafundësisë së nënshtrimit të tyre nga lidhja e saj me ndonjë çmim ose shpërblim, ata nuk përziejnë veprat e shenjta dhe hyjnore me veprat që janë kufizuar në tokë; këta njerëz i çmojnë veprat e tyre si të jenë asgjë përpara pushtetit të pakufishëm të të Gjithëfuqishmit dhe e drejtojnë jetën e tyre në këtë dimension të shtrenjtë që ata ndjejnë në zemrat e tyre.

Njerëzit që ndjejnë këtë gjerësi dhe thellësi me të gjitha emocionet dhe mendimet e tyre, dhe po ashtu e ndjejnë në tërë

thellësinë e zemrave të tyre, arrijnë kënaqësinë e të qenit një subjekt për të Gjithëmëshirshmin dhe janë të lirë nga presionet e ndryshme. Jo vetëm janë të lirë, por ata kanë shpëtuar natyrën njerëzore të tyre nëpërmjet të qenit të vetëdijshëm në ndërgjegje që janë shërbëtorë në një portë që nuk do të prishet dhe nuk do t'i pritet ndriçimi, gjë që do të thotë se ky është një person që ka arritur një liri të vërtetë. Ndërsa qëndrimi i një njeriu në drejtimin e mirënjohjes për bekimet e Zotit, bekime që arrijnë edhe nëse ndonjëri i mohon ato, është një detyrë dhe fakti që Zoti vazhdon t'i dërgojë dhuratat nëpërmjet gjatësi valësh të ndryshme, është një bekim i dytë.

Nëse krijesat njerëzore janë zëvendës të Zotit në tokë - ata janë të veçantë në faktin që kanë potencialin për të qenë kandidatë - atëherë ata do të punojnë për Zotin, do ta fillojnë çdo gjë duke përmendur Zotin, të fyer për Zotin, të dashur për Zotin dhe do të ndërhyjnë në ekzistencë vetëm brenda strukturës së pranuar prej Zotit, do të kryejnë çdo detyrë me aspiratën për të qenë përfaqësuesit e Tij. Kështu, njerëzit që nuk krenohen për sukseset e tyre, nuk do të bien në dëshpërimin e dështimit. Ata nuk do të mburren për aftësitë e tyre dhe as do të mohojnë dashamirësinë për Hirplotin, ata do ta kuptojnë që çdo gjë vjen prej Tij dhe do t'i konsiderojnë të gjitha veprat e përfunduara si detyrë të tyre. Besimi do të jetë përtëritur pas çdo suksesi dhe ata do të kthehen në drejtim të Zotit të tyre, të shprehin besimin dhe devotshmërinë për Të dhe dëshirojnë, me fjalët e Akifit, të përsërisin në vetvete në pak minuta për çdo ditë: *Besimi në Zot, mbajtur shtrënguar me përpjekje dhe bashkuar me dëshirën hyjnore, / Nëse është një udhë, kjo është ajo; Unë e di se nuk ka tjetër që të drejton atje.*

Ky do të jetë himni i tyre. Ata gjithmonë do të jenë të tendosur, gjithmonë të vendosur, gjithmonë të zellshëm dhe të përfshirë në detyrat e tyre, sepse lidhin qëndrimin dhe veprimet me synimin për të qenë një subjekt për Zotin, ata nuk do të bëhen arrogantë me fitoret dhe sukseset e tyre, as nuk do të ndjejnë dëshpërim për

dështimin. Ata do të kenë të njëjtin gjykim dhe vendosmëri nëse ecin përgjatë një rruge të drejtë, poshtë në pjerrtësi ose ngjiten shpatit të thepisur.

Në të vërtetë edhe pse njerëzit e tillë janë në gjendje të tregojnë një funksionim që frymëzon të gjitha aftësitë mendore, shpirtërore dhe emocionale për të ndërmarrë veprime, veprime që tejkalojnë imagjinatën, me qëllim që të përmbushin detyrën e zëvendësit, ata janë gjithashtu në pritje të menduar, të zhytur në nënshtrim, të mbushur me shpresa për alternativa dhe gjithmonë në pritje për të lidhur vetveten me Zotin.

Këtu është besimtari i vërtetë dhe modeli më i mirë për pasuesin e vërtetësisë. Sa herë që ne e kemi bërë këtë lidhje, kemi ardhur e shkuar dhe kemi transformuar udhët në të cilat kemi përshkruar korridoret e parajsës dhe akoma ecim në këto udhë drejt ditës së premtuar nga i Gjithëmëshirshmi. Ata që kanë ardhur dhe shkuar dhe ata që janë në ndjekje të gjurmëve të tyre, të gjithë kanë jetuar dhe janë duke jetuar si heronj, me këto cilësi që janë të posaçme vetëm për vetveten.

NJË SHOQËRI IDEALE

Grupimet e veçanta të formuara nga të mbrapshtët dhe mëkatarët (të pabindurit) janë thjesht turma pa asnjë vlerë morale dhe etike, njerëz që janë larg nga mendimi për të bërë mirë. Në krahun tjetër, ideal, ose të plotë, njerëzit mbajnë cilësitë e engjëjve dhe janë monumente të largpamësisë dhe mirëkuptimit njerëzor.

Ne i shohim këto cilësi në ajetin Kuranor që vijon më poshtë, si edhe në shumë të tjera:

Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur! (Tin, 4)

Njerëzit të cilët i referohen domethënies së këtij ajeti, kuptojnë që ata janë trajta më e hijshme dhe më e bukur e këtij krijimi, fizik ose shpirtëror. Ata shijojnë shkallën më të përsosur të krijimit dhe janë të ndërgjegjshëm për dhuratat e pafundme që kanë marrë.

Le të përpiqemi ta kuptojmë këtë ajet. Natyra njerëzore mori përsipër përgjegjësi që toka, qielli dhe malet i mohuan nga frika se nuk do të ishin në gjendje ta merrnin mbi supe këtë detyrë. Ata e ndjenë që natyra njerëzore ishte kandidati i vetëm për të arritur përjetësinë.

Njerëzit mund të konsiderohen si shtegtarë në udhën për t'u bërë një person i kompletuar për sa kohë që ata vazhdojnë të shfrytëzojnë dhuratat me të cilat janë zbukuruar dhe të jetojnë në përputhje me frymëzimin hyjnor.

Misteret, si kuptimi i jetës dhe vdekjes, shkaku i ekzistencës dhe përgjegjësitë tona, janë gjithmonë në mendjen e njerëzve të tillë. Ata mendojnë thellësisht lidhur me mëkatet, të bërit mirë dhe të qenët i përshpirtshëm. Domethënia e katastrofave që i

kanë sjellë dëme njerëzimit, i ka trazuar mendjet e tyre, drita e njohurive hyjnore ndriçon në zemrat e tyre, rrezet e kësaj drite janë reflektuar në shpirtrat e tyre.

Të gjitha këto i lejojnë ata të shohin prapa perdes. Habia dhe çudia e tyre i sjellin në dashuri dhe mëshirë dhe ata kthehen tek Krijuesi me shpirtrat e tyre dhe me ndjenjën e kënaqësisë. Shpirtrat që janë në këtë nivel nuk e lejojnë dashamirësinë hyjnore të shkojë nga kokat e tyre dhe as janë tronditur nga humbja e saj sepse ata e shohin mirëdashjen dhe humbjen si një të vetme dhe kuptojnë se shpërblimi dhe ndëshkimi janë gjithashtu të njëjtë. Ndërsa të tjerët janë të llastuar nga favore të tilla dhe bien në pesimizëm sapo shfaqen vështirësitë, njerëzit e përsosur fitojnë edhe kur ngjajnë të dënuar për të humbur. Ata arrijnë të rrisin trëndafila në shkretëtirë, të prodhojnë sheqer nga një kallam i thatë.

Njerëzit idealë e dinë që ata janë në provë të vazhdueshme dhe prandaj përsosen që të mund të arrijnë lumturinë. Edhe nëse ndeshin në katastrofa të pashmangshme dhe bien në vorbullat më të tmerrshme, madje nëse gjenden në momente pikëllimi dhe në braktisjen më të madhe, presin lehtësim dhe fjalë ngushëlluese prej botës tjetër, fjalë që dalin nga thellësia e shpirtit të tyre dhe ata përulen me mirënjohje dhe admirim.

Njerëzit e tillë kanë siguri dhe besim të plotë në Zot, sepse ata besojnë dhe shpresojnë në gjithëpraninë dhe në plotfuqinë e Pushtetit të Amshuar. Besimi i pastër jeton në thellësi të zemrave të tyre, këndvështrimi që u jep perspektiva të pabesueshme, së bashku me njohuritë dhe mendimet, i lartëson në një pikë nga ku ata pothuajse mund të dëgjojnë një zë që thotë: "As mos kini frikë dhe as mos u pikëlloni, por merrni lajme të mira për kopshtin që u ishte premtuar!" Dhe atëherë ata dëshmojnë kënaqësinë më të mrekullueshme për gjithçka.

Njerëzit e përsosur përpiqen të qëndrojnë larg nga mëkati, sepse ata e kanë ndërtuar jetën e tyre në përputhje me

Drejtësinë Hyjnore, në të cilën besojnë aq sinqerisht. Dhe sepse ata gjithmonë ndeshen me egon e tyre, nuk kanë kohë dhe energji për t'u dhënë pas argëtimeve boshe apo pas jetës boheme. Ata janë gjithmonë me vështrimin tek bukuritë e Shokut të tyre, mendjet e tyre janë në botën e përtejme, zemrat e tyre janë kopshte plot me drita dhe ngjyra të hapura për t'u vizituar nga krijesat shpirtërore dhe ata vetë janë udhëtarë dhe eksplorues në këtë atmosferë dhe vend mistik.

Njerëzit e kësaj bote që janë skllavëruar nga egoja e tyre, jetojnë vetëm për të përmbushur dëshirat fizike. Ata nuk gjejnë asnjë kënaqësi, ata nuk gjejnë qetësi. Por njerëzit idealë janë gjithmonë në paqe me veten e tyre. Ata janë të kënaqur dhe për më tepër, vënë njohuritë dhe dijet e tyre në shërbim të njerëzimit. Ata me kurajë ia kushtojnë vetveten shpëtimit të botës nga padrejtësia dhe tirania dhe nuk janë të frikësuar për të mbrojtur nderin dhe vendin e tyre. Dhe gjatë gjithë jetës, me hijeshi shtrijnë krahët e mirësisë mbi vëllezërit dhe motrat e tyre!

Duke e ditur që gjithçka prej Zotit është e vdekshme dhe do të shuhet, njerëzit e përsosur nuk përulen para askujt dhe asgjëje tjetër veç Zotit. Ata i rezistojnë joshjes së botës materiale, ata vlerësojnë dhe shfrytëzojnë rrugën e Zotit që u është kushtuar atyre, tamam si krijesa qiellore, ata shqyrtojnë gjithçka që ndodh si një shkencëtar në laborator, ata ia dedikojnë jetët e tyre njerëzimit dhe lënë një botë më të mirë për brezat e ardhshëm.

Njerëzit idealë vazhdimisht kërkojnë bekimin e Zotit dhe përpiqen të jenë besnikë. As pasionet fizike dhe as dëshirat shpirtërore nuk mund të hedhin dyshime mbi sinqeritetin e tyre. Ata i vlerësojnë të gjithë shërbëtorët e Zotit si krijesat më të larta njerëzore dhe po ashtu e vlerësojnë çdonjërin si shokun e tyre. Në zemrat e tyre ata zbusin ashpërsinë dhe çdo ndjenjë të errët që buron nga të tjerët, kështu tregojnë se si mirësjellja e mposht të gabuarën.

Në atmosferën e tyre të shndritshme, rrufetë veniten. Nemrudi, një perandor i pamëshirshëm, i cili urdhëroi që profeti Ibrahim të hidhej në zjarr, vështroi se si zjarri nën të u kthye në një kopsht të gjelbër që zbuti ashpërsinë në zemrat dhe shpirtrat e këqij.

Shumë prej nesh nuk kanë arritur akoma në këtë nivel. Ne nuk mund të përballojmë punët e mbrapshta me mirësjellje. Ne e përballojmë ashpërsinë me ashpërsi dhe urrejtjen me urrejtje. Ne bindim veten që mendimet dhe idetë tona janë objektive dhe dëshirat tona, jo egoiste. Kështu ne errësojmë luftën tonë në rrugën e Zotit dhe humbasim, ndonëse nisemi për të fituar. Nëse nuk do të ishin bukuria, aftësia tërheqëse dhe rrezet jetëdhënëse të Kuranit, konceptet e gabuara që kemi krijuar dhe shembujt negativë që kemi dhënë do të na ndalonin nga vështrimi i kësaj dite!

SUFIZMI
DHE
METAFIZIKA

KUPTIMI I JETËS

A janë të gjithë vuajtjet e jetës pasuri e përhershme? Përgjigjja kushtëzohet nga synimet tona në jetë. Në fakt, domethënia e qëllimit të jetës është një proces i ngadaltë dhe tërheqës. Ne ndjejmë misterin e saj gjatë reflektimit me ekzistencën tonë dhe me natyrën njerëzore. Prandaj, koncepti ynë për jetën zhvillohet gradualisht gjatë gjithë jetëve tona.

Qëllimi i krijimit tonë është i qartë: të arrijmë në skaj të synimeve tona për besimin, dituritë dhe përshpirtshmërinë, të reflektojmë universin, natyrën njerëzore dhe Zotin, e kështu të demonstrojmë vlerat tona si krijesa njerëzore. Përmbushja e këtij ideali është e mundur vetëm përmes mendimit dhe qëndrimit sistematik. Mendimi do të shkaktojë veprim dhe si rrjedhim, fillon një "cikël i mbarë". Ky cikël do të prodhojë cikle më komplekse, të cilat janë krijuar përmes përshpirtshmërisë për zemrën dhe njohurive për trurin, prandaj zhvillojnë përjetësisht idetë komplekse dhe prodhojnë më shumë projekte ambicioze.

Aktivizimi i një procesi të tillë tregon një besim të fortë, vetëdije dhe inteligjencë. Njerëzit me këto karakteristika mund të kuptojnë dhe analizojnë mënyrën e pamenduar të jetës së të tjerëve. Njerëz të tillë reflektojnë, bëjnë atë që besojnë se është e drejtë dhe për pasojë, vazhdimisht thellojnë mendimet e tyre dhe fitojnë ide të reja. Ata besojnë që vetëm ata që reflektojnë thellësisht janë prodhimtarë dhe që dhimbjet e vuajtjet i durojnë për ta bërë besimin më të fortë dhe më të pranueshëm.

Ata jetojnë një jetë të reflektuar nga vëzhgimi i krijimit për çdo ditë, nganjëherë duke e lexuar atë si një libër ose duke qëndisur

mendjet e tyre me njohuritë që fitojnë. Duke besuar dhe kuptuar që universi është krijuar për të qenë "gati", ata e shohin qëllimin e krijimit tonë si asgjë më pak nga kjo.

Në vetvete, ekzistenca është pikërisht bujaria që na drejton ne në një udhë të mbarë për zemërgjerësi. Prandaj, ne duhet të njohim vlerat e saj. Meqenëse jemi krijuar së bashku me një univers të tërë shpërblyes, ne atëherë duhet t'i shfrytëzojmë këto dhurata dhe të mira prej tyre.

Për të arritur këtë synim, ne duhet të shfrytëzojmë vullnetin tonë, një zë i lajmëruar dhe i kushtuar një vlere vetëm prej të Gjithëfuqishmit dhe të zhvillojmë aftësitë dhe zotësitë tona për shtrirjen shumë larg të tyre, kështu të provojmë veten për të qenë qenie të bindura. Detyra jonë është të reflektojmë vendin tonë në jetë, përgjegjësitë tona dhe lidhjen tonë me këtë univers të paanë. Ne duhet të shfrytëzojmë mendimet tona të brendshme për të zbuluar anën e fshehtë të krijimit. Pas kësaj, ne do të fillojmë të kemi një kuptim të thellë për veten tonë, t'i shohim gjërat ndryshe, gjë që dëshmon se ndodhitë dhe rrethanat nuk janë ashtu siç duken dhe të kuptojmë që ata janë duke u përpjekur të komunikojnë diçka me ne.

Unë besoj se ky duhet të jetë qëllimi i vërtetë i jetës. Ne jemi krijesat e gjalla më të rëndësishme në këtë univers. Në fakt, ne jemi më shumë si shpirti dhe esenca e tij, prej së cilëve zhvillohet pjesa tjetër e universit. Duke e marrë në konsideratë këtë, ne duhet të reflektojmë në univers dhe ta vëzhgojmë atë, kështu që të mund të realizojmë dhe përmbushim qëllimin e krijimit tonë. Detyra jonë është të gjurmojmë njohuritë dhe gëzimet hyjnore në zemrat dhe shpirtrat tanë, sepse vetëm kjo rrugë e jetës mund të na shpërngulë nga përpjekjet zhgënjyese për një jetë plotësisht materialiste dhe të dhimbshme.

Vlera që merr kjo jetë e dhimbshme duke e jetuar, është gëzimi që ne ndjejmë ndërsa ecim përgjatë udhës dhe marrim këto

dhurata. Ata që ecin në këtë rrugë, janë vazhdimisht të kënaqur me njohuritë e shumta. Ata vrapojnë të entuziazmuar drejt qëllimit të tyre final si një lumë që derdhet në det.

Ne nuk besojmë që lumturia vjen nga burimet e jashtme të përkohshme. Lumturia e vërtetë vjen nga brenda, përgjatë thellësive të lidhjes sonë me Zotin dhe kthehet në një jetë të amshuar në qiell… Po, ky është gëzimi ynë. Bota jonë e brendshme është si një mbretëri për njohuritë hyjnore dhe vetëdija jonë është si një ndjekës për këto njohuri. Siç ne bëjmë me shenjë dhe presim gjatë gjithë jetëve tona për një pamje të lehtë kalimthi, shpirtrat tanë këndojnë me kënaqësi të plotë: *Zemrat tona janë froni yt, O Mbret! Mirë se erdhe në zemrat tona!* - M. Lutfi

Gjenerata jonë është e nevojshme të na udhëzojë për të arritur një besim të tillë përmes proceseve dhe lumturisë. Udhëheqja e tyre do të pohojë freskinë tonë për ta gëzuar rininë dhe jetuar drejt jetën. Ata do të shfaqin ekzistencën dhe mosekzistencën si të njëjtën gjë, prapë ata ndjejnë pavdekësi në shpirtrat e tyre. Ata do të jenë të aftë të tregojnë që mund të bëjnë më shumë nga se ata mendojnë në një çift sekondash. Ata do të shohin jetën e përtejme të reflektuar në çdo gjë dhe për pasojë dëshmojnë jetën pa fund. Ata do të zbulojnë që jeta është e vlefshme kur e jeton. Ata do të dëshmojnë që i gjithë krijimi ngrihet dhe qëndron në shpirtrat e tyre. Dhe ata do të udhëtojnë përmes dimensioneve të shpirtrave të tyre, tamam si të ishin duke udhëtuar përmes galaktikave duke vëzhguar pafundësinë brenda dimensioneve që ata kanë arritur përgjatë kësaj jete të vdekshme.

BESIMI: NJË PERSPEKTIVË E VEÇANTË

Fjala "besim," në arabisht "*iman*", në strukturën e përshkrimeve ose nga këndvështrimi i shkencës dhe epistemologjisë, vjen nga rrënja "*emn u eman,*" që nënkupton të jesh i pacenuar nga frika, të besosh, të premtosh, të shpresosh, të sigurosh sigurinë për të tjerët. Të qenit i sigurt dhe i fuqishëm është domethënia e kësaj fjale. Besimtarët në Zot dëshmojnë ekzistencën e Tij duke e ndjerë këtë me zemër dhe duke e deklaruar edhe me gojë. Këto janë disa nga kuptimet e kësaj fjale nga pikëpamja e traditës linguistike.

Një person që beson në Zot është quajtur *mu'min, besimtar.* Një *mu'min* është dëshmuesi dhe përfaqësuesi, baras me përsosmërinë, i të gjithë karakteristikave të mësipërme. Këtu gjithashtu ne mund të flasim rreth lidhjes që ekziston në mes veprave dhe besimit, dhe nëse veprat janë përfshirë brenda përshkrimit të besimit, por për momentin nuk do të ndalemi në këtë pikë. *Besimtarët* janë në të vërtetë heronjtë e dëshmisë, kumtimit dhe përfaqësimit, me gjykimin e shëndoshë të tyre, me aftësitë për të vështruar, parë dhe kuptuar, me mendjen e kthjellët të ndriçuar nga shpalljet hyjnore, me mirëkuptimin e gjerë dhe objektiv, me vizionin e sigurt dhe gjithëpërfshirës, me delikatesën dhe ndjeshmërinë në çështjet me përgjegjësi, me vendosmërinë dhe qëndrimin ndaj së keqes, me kërkimin e madhështisë gjatë gjithë jetës dhe mbrojtjen e këtyre idealeve të larta, me aftësinë për të mbajtur gjallë ndjenjat e tyre, me vetëdijen dhe dëshirat, me kuriozitetin që i udhëheq për të depërtuar në domethënien esenciale të gjërave dhe analizën e thellë në interpretimin e fenomeneve, me besimin dhe mbështetjen tek Zoti dhe duke qenë të njohur në mes të njerëzve si njerëz me

besim, me vërtetimin e ekzistencës të të Vetmit dhe me aftësinë për të qëndruar gjithmonë të padyshimtë për Atë, me përshtypjet që kanë lënë si njerëz të besueshëm, ku mund të mbështetesh për gjithçka dhe ku çdokush mund të kërkojë ndihmë në çdo kohë, me aftësinë për t'u kujtuar dhe pranuar nga të gjithë në këtë model, me qenien e tyre si një mënyrë për të kujtuar Zotin dhe gjithashtu të nënkuptuar si njerëzit që drejtuan ata përreth tyre, drejt Atij. Ata në kuptimin e vërtetë të fjalës, janë heronjtë e dëshmisë, kumtimit dhe përfaqësimit.

Edhe nëse çdo besimtar nuk është një hero i besimit dhe Islamit në të njëjtën shkallë, është e qartë se sa domethënëse është ndjenja e besimit tek çdo individ. Si fillim, kjo ndjenjë është virtyti më i lartë në natyrën e krijesës njerëzore, në lidhje me krijimin. Edhe nëse ata që nuk besojnë përpiqen të jenë të kënaqur, të sigurt, ose më të saktë, përpiqen të gjejnë argëtim, veten e ndjejnë të jetë në një vakum. E gjithë koha dhe hapësira është një vakum për ta, e sotshmja dhe e nesërmja janë e njëjta gjë. Njerëzit e tillë e ndjejnë këtë vakum thellë në shpirtrat e tyre, ata i shprehin ndjenjat mbytëse që kthehen në përçartje të pakuptimta në këtë mënyrë: *Gjithçka është zbrazëtirë; toka është një boshllëk, / qiejt janë një boshllëk, zemra, ndërgjegjja është një boshllëk; / Unë dua të mbahem, por nuk shoh ku të kapem.* - Tevfik Fikret

Dhe një shpirt besimtar, duke dhënë pamjen e natyrës së acartë të mohimit të së vërtetës dhe të çdo përpjekjeje për ta fshehur atë dhe në të njëjtën kohë, duke treguar paqen që besimi premton, thjesht thërret kështu: *Një zemër e ndryshkur e cila nuk ka besim, është një barrë për kraharorin.* - Mehmet Akif

Në anën tjetër, një adhurues i zemrës që është i vendosur të ndalojë gërryerjen e zemrave të ndryshkura, do të thoshte: "Kënaqësia e vërtetë, dëfrimi pa dhimbje, lumturia pa pikëllim është e mundur vetëm brenda sferës së besimit dhe vërtetësive të tij». Prandaj, ata që duan të shijojnë kënaqësitë e jetës, duhet

ta gëzojnë atë me besim, duke e zbukuruar me veprat që Zoti ka urdhëruar për njerëzimin dhe duke e mbrojtur atë nga veprat e përjashtuara për të cilat Ai na ka njoftuar të mos angazhohemi, sepse, kur ndokush arrin ta drejtojë veten drejt udhës së jetës së amshuar, ndonëse jeta e tij mund të jetë e mjerueshme dhe e vështirë, me që kjo botë konsiderohet të jetë sallon pritje për parajsën, e pranon çdo gjë me kënaqësi dhe shpreh mirënjohje. Njerëzit e tillë do të ndriçojnë horizontet tona me fjalët e tyre shëruese dhe do të nxisin zemrat tona për të ndjerë magjinë e besimit.

Në lidhje me përmbajtjen dhe esencën e tij, besimi është një fryt që ka qenë vjelë prej mbretërisë së jetës dhe dhuruar për shpirtrat tanë, është lumi parajsor i *Keutherit*, prej të cilit zemrat tona janë bërë për t'u pirë në një kuptim, njomur nga buzët për zemrat tona, një monument i dritës hyjnore në zemrat tona, modeluar nga metri dhe kompasi i kuptimit, ndjenjës, ndërgjegjes dhe mirëkuptimit. Heronjtë e besimit që korrigjojnë dhe përtërijnë zemrat dhe ndjenjat e tyre me besim dhe mirëkuptim, kanë zbuluar tashmë sekretin për ta ndërruar në mendje botën e tyre me qiejt, ata kanë hyrë në rrugën e lumturisë së përjetshme dhe janë të lirë nga të gjitha gjurmimet e tjera. Meqenëse, "në jetë ka gjithmonë një parajsë shpirtërore që vjen nga besimi dhe një ferr shpirtëror nga blasfemia dhe mëkatet, atëherë sigurisht që, në të njëjtën mënyrë, besimi e mbjell farën shpirtërore për pemën e parajsës, po ashtu blasfemia e ruan farën shpirtërore për ferrin."

Në fakt, nëse një shpirt i ka fituar flatrat me anë të besimit, nuk do të vonohet në ndonjë hyrje tjetër dhe as do të përkulet aq poshtë sa të kërkojë lëmoshë nga ndonjë tjetër. Një person me një shpirt të tillë nuk do të përkulet para askujt tjetër. Ata do të sillen me trimëri ndaj gjithçkaje, në atë shkallë sa çështë i fortë besimi i tyre. Në të vërtetë, besimi është dritë dhe forcë. Ata që kanë arritur besimin e vërtetë, mund të sfidojnë universin dhe në përpjesëtim me forcën

e besimit të tyre, të jenë lehtësuar nga presioni i rrethanave.[57] Kjo është arsyeja pse besimi çon në dëshmimin e veçantisë së Zotit, kjo dëshmi çon në nënshtrim, nënshtrimi çon në vënien e vetes në duart e Zotit dhe kjo çon në lumturinë, këtu dhe në botën e përtejme. Monumentet e tilla të besimit i trajtojnë zemrat e tyre si shkallët spirale që të çojnë në botët përtej qiejve dhe kështu ata rrahin krahët në drejtim të lartësive engjëllore ku takohen engjëjt me shpirtrat. Gjatë kësaj kohe, engjëjt dhe shpirtrat pështpërisin në vesh për këta njerëz dhe në të njëjtën kohë, ata i njohin shpirtrat me tufat e luleve të mirëkuptimit dhe kështu bëhen njerëz të shquar në këtë botë. Dhe nëse njerëzit e tillë kanë qenë të aftë për të thelluar besimin e tyre me anë të njohurive të cilat i kanë zbukuruar me shembuj shpirtërorë, atëherë, sigurisht, ata do të fluturojnë në horizontet për të cilat edhe engjëjt dëshirohen. Ata janë gjithmonë në kërkim të vendmbërritjeve që Zoti do të aprovojë për ta, duke kaluar kohën e tyre me të merituarit në qiell dhe ëndërrojnë për qiellin më të lartë. Për të pasur një vlerësim të lartë është e mjaftueshme të jesh ngjitur në qiellin më të lartë me dritën e besimit dhe të arrish një vlerësim të hijshëm qiellor, është fat për ata që kanë besim, kurse të përkulesh poshtë në nivelin e mohimit të errët dhe të bëhesh një prej banorëve të ferrit, ky është fundi i pafat për blasfeminë. E mëvonshmja është një çështje më vete, por duhen shumë më tepër fletë për ta bërë këtë analizë këtu.

Ata që mund t'i shohin njerëzit me besim me thellësitë e tyre të veçanta, kujtojnë Zotin përmes tyre. Ata që ndjejnë frymën e tyre të fitojë jetë si të jenë vizituar nga Mesiu dhe ata që dëgjojnë zërat të vijnë nga zemrat e tyre, dehen me verën e botëve si të kenë arritur shoqërinë e Mbretit të Elokuencës. Në të vërtetë, një shpirt i cili e ka kompletuar gardërobën e tij me besim dhe me gjithçka besimi i ka premtuar, nuk ka nevojë për asgjë tjetër. Duke qenë i lartësuar drejt Zotit, një person i tillë është akoma i fuqishëm në dobësinë e dëshirave për Zotin, pasurohet përmes

[57] Nga Bediuzzaman Said Nursi, *Sözler*, Fjala e 23-të.

Atij në varfërinë e tij dhe pavarësisht të qenit i vogël, është një nga më të mëdhenjtë. Kjo ndodh për faktin se këta njerëz mbështeten në dëshirat e përjetshme për Zotin, kur fuqitë dhe vendosmëria e tyre nuk është e mjaftueshme. Ata besojnë në dëshirën e Zotit për çështjet që tejkalojnë aftësitë e tyre. Kur tronditen në kalvarin e kësaj jete, ata gjejnë mbrojtje në kopshtet e jetës së amshueshme. Kur frika e vdekjes pushton horizontin e tyre, ata e lëshojnë veten në atmosferën e ngrohtë të jetës së amshuar. Përballë çështjeve që nuk mund t'u japin përgjigje me inteligjencën dhe mirëkuptimin e tyre, ata mbështeten në klimën e shëndetshme të Kuranit, i cili finalizon zgjidhjen. Ata kurrë nuk provojnë dëshpërimin dhe as ndjejnë zbrazëtirë, ata kurrë nuk vihen ballë për ballë me errësirën e përhershme. Përjetimet dhe jeta e tyre është si një këngë e gëzuar dhe ata kthehen nga Krijuesi me mirënjohje, tamam si kallinjtë e mbushur me grurë.

Njerëzit e përsosur me besim nuk janë të kushtëzuar vetëm nga logjika e tyre apo nga qëndrimi personal, të pajisur me një vendosmëri profetike, ata janë të hapur ndaj gjithsecilit, duke shtrënguar krahët me të gjithë dhe duke bashkuar me ta jetën dhe lumturitë tokësore, do të shpërfillin vetveten dhe do të jetojnë si një shok i Profetit, duke ndriçuar gjithçka përreth tyre me dritën e brendshme që është si një qiri, mbajnë një drejtim që mund të jetë i kundërt me përfitimet personale. Sigurisht, njerëzit e tillë gjithmonë vështrojnë vendet e errëta si nata. Ata luftojnë me shtypjen dhe errësirën, gjithmonë digjen dhe si digjen, ata ndjejnë dhimbje brenda vetes dhe ndërsa kokat e tyre mund të jenë përulur, as nuk vazhdojnë të përflaken dhe as frymëmarrja nuk u përshpejtohet nga zjarri i ndezur për të ndriçuar të tjerët.

Të devotshmit e besimit që kanë mbajtur të ngritur flamujt e tyre në hyrje së rrugës të besimit, i bien përqark botës mbarë me një hap të vetëm. Ata arrijnë qiejt, kuvendojnë me yjet, janë në kontakt me diellin, zënë miqësi me hënën dhe ecin pa pushim në hapësirë drejt «Bashkëpunëtorit të Përkryer.» Ndërsa ata ecin,

vështrimi i tyre është gjithmonë përdhe në thjeshtësi dhe frymën e kanë të përvuajtur. Në të vërtetë, sikur të jenë zbukuruar me flatrat e engjëjve, ata fluturojnë në lartësi të pabesueshme, por as fluturimi në këto lartësi, dhe as fakti që janë të barabartë me një qenie shpirtërore, nuk e turbullon mendimin dhe vështrimin e tyre që është më i qartë se ç'ka qenë. Kokat e tyre janë gjithmonë të anuara nga kraharori, me ndjenjat për profetin Adem, me një pafundësi psherëtimash dhe shpresë në buzë, ata janë si një trëndafil thellësisht i kuq. Dhe shkëlqejnë me ngjyra ylberi kur kthehen drejt të Vetmit, sikur të jenë me pamje kundrejt diellit. Kur ata ndjejnë madhështinë e Tij, djersijnë si vesa në mëngjes. Është sikur të kenë dëgjuar tingujt e *Surit,* fanfarës në ditën e gjykimit.

Ata që i kanë vëzhguar këta njerëz, kanë gjetur një dritare përmes së cilës të vështrojnë të Gjithëmëshirshmin në të gjithë veprimtarinë e Tij, të kthehen në drejtim të amshimit dhe të transformojnë botët e tyre në çerdhe dashurie. Ata shpalosin një larmi ngjyrash në natën e errët, në netët ku dikush është në pritje të agimit dhe në kopshtet ku lulet janë vyshkur nga vjeshta. Ata u dhurojnë tufa me lule dhe trëndafila atyre përreth që janë bërë kruspull nga emocionet.

Njerëzit e tillë, herë pas here, i shprehin ndjenjat e tyre me madhështi dhe dashamirësi, dhe nganjëherë freskojnë gjokset e përcëlluara me lotët e tyre. Lotët u rrjedhin si të jenë duke bërë udhën më të mirëpritur për dëshirat dhe pritjet e tyre dhe ata e shfaqin lumturinë e afërt me shpresë dhe besim që aspiratat do të vijnë me të vërtetë shumë shpejt. Ata janë gjithmonë gati për të shkuar përtej largësive, në përputhje me paanësinë e besimit të tyre. Kohën e mbajnë me ritmin e zemrave të tyre, krahët e arsyes i zbukurojnë me stoli nga flatrat e zemrës. Ata kapërcejnë me një hap pengesat, në dukje të pakapërcyeshme, në të cilat gjykimi dhe mirëkuptimi tokësor janë ngatërruar dhe arrijnë në kulmin e domethënies së botës.

Ithtarët e besimit janë gjithmonë në paqe, edhe kur janë të rrethuar nga motivet e dhimbjes dhe të pikëllimit. Ata nuk vuajnë gjatë nga brenga ose janë familjarizuar me hidhërimet pa mbarim. Me lidhjen e tyre me Zotin dhe me intimitetin me Atë, ata janë në gjendje ta largojnë dhimbjen me lehtësi, hidhërimin e mbysin që në rrënjën e tij dhe nëse e kanë të vështirë, i zbukurojnë ato me "kthjelltësi hyjnore" dhe i ruajnë ngjyrat e kuqe të bukurisë shpirtërore pa u rraskapitur, bashkojnë ankthin me kënaqësinë dhe lëndohen me lumturinë që është premtuar nga vështirësitë. Ata janë në gjendje të shndërrojnë rënkimet e vuajtjeve në psherëtima të gëzuara dhe, edhe në momentet më pikëlluese janë në gjendje të recitojnë poemat e lumturisë për ata përreth me gjuhën e zemrave të tyre. Kur ata e pushtojnë esencën e kësaj udhe e kështu shenjtërojnë frymën e parë të tyre, me frymën e dytë bashkojnë zemrën me mendjen, duke e bërë intelektin të flasë me gjuhën e zemrës dhe duke i bërë zërat që të dëgjohen madje në yjet më të largët dhe akoma më tej dhe kështu, duke i bërë të gjithë ata që janë shpirtërorë, të dëgjojnë thirrjet për lutje, një këngë e padëgjuar më parë. Edhe besimtarët mund ta dëgjojnë dhe ta shijojnë atë për sa kohë që e mbajnë të pastër horizontin e tyre nga njollat e mëkatit.

HORIZONTET E BESIMIT

Ja dy anët e dashurisë për vërtetësinë: njëra përbëhet nga dijet, ndërsa tjetra nga besimi. Në të vërtetë, ndërsa në njërën anë të marrëdhënies është zbulimi dhe vendosmëria për vërtetësinë, për shembull, ngase krijohet lidhja në mes të njohurive njerëzore dhe vetëdijes, në anën tjetër është qëndrimi i adoptuar në lidhje me vërtetësinë. E para është kërkuar nga burimet e dijeve në fe dhe në shkencë. E dyta është përcaktuar nga feja vetë. Shkenca që nuk zotëron një dashuri apo qëllim të përcaktuar në analizimin dhe shpjegimin e ekzistencës dhe zbulimin e vërtetësisë, është e verbër dhe përfundimet e kërkimeve shkencore të këtij kallëpi janë të mbushura me kontradikta. Është gjithmonë e vërtetë që kërkimet shkencore të bazuara në gjykime personale, në rrethe të ngushta njerëzish apo në interesa shoqërore, do të kalojnë në disa pengesa dhe është e pashmangshme që çdo njohuri e fituar me një mentalitet, mendim dhe doktrinë të tillë, duhet të çojë në një shteg shumë të gabuar. Feja krijon një basen të përmasave të mëdha për shkencën me burimet e saj të njohurive, është një element thelbësor, një forcë lëvizëse e rëndësishme, një udhërrëfyes që ka një logjikë të qartë për çështjet që tejkalojnë horizontin e dijeve. Feja është një udhëzues që ka një mirëdashje të plotë që nuk mund të çojë në gabime.

Ekziston gjithmonë mundësia për ta kthyer shkencën në një ndëshkues, fantazmë dhe vampir të frikshëm të vendosur në udhën e vërtetësisë nga lënia e saj në gatishmëri për një mendim të veçantë, ngjarje të veçantë, doktrinë të veçantë dhe si rrjedhim, duke e kufizuar horizontin e saj. Gjithashtu, është e mundur që

feja, e cila është një vërtetësi hyjnore, të mund të jetë e paraqitur nga disa si zotëruese e ndjenjave të zemërimit, urrejtjes, tërbimit dhe hakmarrjes. Sa kontradiktë e madhe është që diçka të mund të jetë e shtrembër në paraqitje ndërsa e vërteta është krejt e kundërta!

Tani të përpiqemi të përfytyrojmë një shkencë - e cila në të vërtetë duhet të jetë konsideruar si një tempull i shenjtë - që ka një drejtim ose është bashkuar me një rrymë filozofike të veçantë dhe madje i është nënshtruar asaj. Kjo do të thotë që tashmë shkenca është skllave e një mendimi të ngurtë. Ajo nuk është më në rrugë të drejtë dhe prandaj është kaq e mallkuar, sa injorancën më të madhe e paraqet si favorin më të madh. Dhe përpiquni të imagjinoni një fe së cilës i është kërkuar të jetë një vegël për interesat e disa partive politike apo e grupimeve jopartiake! Kështu, tempulli bëhet kështjellë për këto parti dhe lutjet që e kanë vendin atje (në tempull), bëhen diçka pa vlerë në ritualet politike. Në këtë rast nuk ka dyshim që, si feja, ashtu dhe shenjtëria e fesë, janë sakrifikuar.

Në të vërtetë, nëse në një shoqëri disa njerëz flasin për "dije" dhe kështu e shfrytëzojnë vendbanimin e këtyre dijeve si të ishin vilat e tyre, si vitrinë për dëshirat, fantazitë dhe ideologjitë e tyre, atëherë tempujt e shkencës janë kthyer në një arenë ku dëshirat, ambiciet dhe urrejtja janë acaruar. Përsëri, nëse në një shoqëri disa njerëz flasin për "përkushtim fetar" dhe janë në gjendje të bashkëbisedojnë me ata që nuk kanë të njëjtin mendim me ta dhe që nuk ndajnë të njëjtat konsiderata politike "pagane", "ateiste", ose "skeptike" me ta, atëherë gabimi është i atyre që kanë marrë rolin e përfaqësuesit. Ata e kanë kthyer fenë në një fobi që i ftoh njerëzit nga Zoti, që u nxin zemrat dhe u mbyll dyert e shpresës në sy të tyre. Ky është një imazh në kundërshtim të plotë me fenë që u zbrit në nivelin e parë. Pikërisht si armiqësia në drejtim të fesë që buron nga deklamimet e tërbuara me zemërim dhe urrejtje dhe prej penave që nxijnë shpirtin fanatik dhe janë dhurata të

djallit, citimi i fesë dhe ngritja e grushteve lart në protestë për një mendim apo këndvështrim të veçantë është e njëjtë me fanatizmin dhe injorancën. Këto i trishtojnë banorët e qiejve.

Cilado që mund të jetë paraqitja e një personi, të konsiderosh si besimtar të vërtetë dikë që nuk di se çështë besimi i vërtetë, që nuk e di se me çfarë ndërgjegje flet, që nuk ka marrë dashuri dhe mëshirë hyjnore dhe që nuk i pranon gjërat që në konsideratën e Zotit janë të parëndësishme si të tilla, ose të rëndësishmet si të rëndësishme, është njëlloj si një person i përshpirtshëm të ketë treguar mungesën e plotë të respektit për natyrën hyjnore dhe universale të fesë. Dëmi më i madh që ne mund t'i sjellim fesë dhe shkencës, është të pranojmë fanatizmin, aspiratat dhe dëshirat tona si mendime të arsyeshme dhe t'i paraqesim këto si përkushtim fetar. Kjo është si një gropë shumë e thellë për çdo krijesë njerëzore dhe burimi i këtij boshllëku është dobësia e tyre. Një prej dobësive më të mëdha është dëshira për t'u dukur më të mirë se sa jemi dhe prirja për t'u vlerësuar më shumë se ç'janë aftësitë tona. Kjo dobësi është e nevojshme të shërohet me vlerat që janë pranuar nga ndërgjegjja kolektive si të përshpirtshme dhe që i përkasin shkencës dhe fesë. Me fjalë të tjera, disa njerëz duan ta shfrytëzojnë fenë si të ishte diçka për të mbushur boshllëqet e tyre. Arma më e fuqishme e ndërgjegjes - e cila është e pandarë nga drejtësia - kundër dobësive të tilla njerëzore, është dashuria për vërtetësinë dhe përpjekja në drejtim të dijeve. Nëse është me të vërtetë një eliksir që do të eliminojë korrozionin në mendjet e atyre që duken të ditur dhe ndryshkun në mendimet e atyre që ngjan të jenë shmangur nga feja, nuk ka dyshim që dashuria për Zotin dhe dashuria për ekzistencën dhe vërtetësinë, të gjitha janë për shkak të Tij. Kur zemrat janë mbushur me dashuri dhe shpirtrat veprojnë me mëshirë, të gjithë dobësitë dhe boshllëqet njerëzore eliminohen ose shndërrohen në një eliksir për jetën.

Bota u krijua për të njohur dhe pranuar dashurinë për vërtetësinë që i drejton njerëzit në dashurinë për Zotin, dhe i sjell ata në një

lidhje të fortë me ekzistencën përmes profetëve. Që nga dita e parë, çdo profet i ka drejtuar njerëzit në këtë rrugë si një prijës i dashurisë dhe e ka zbukuruar këtë lidhje me ta, me stolitë e dashurisë. Pastaj kjo dashuri hyjnore është tretur në basenin e vet duke arritur në vlerat e vërteta të saj. Mesihu i shenjtë shkroi një poemë, jashtë jetës së tij, që ishte bazuar në dashurinë për njerëzimin dhe ai e vazhdoi këtë mision duke e shprehur këtë ndjenjë në mënyra të ndryshme. Nëse ne e vëzhgojmë se si ishte shprehur përmes poezisë së Fuzuliut, Krenaria e Njerëzimit thoshte: "Fjala ime është një flamur i ngritur për ushtrinë e të dashuruarve", dhe kështu nderonte botën dhe vazhdonte si të ishte fryma dhe zëri i dashurisë. Kur kjo dashuri hyjnore arrin një transcendencë, sytë e saj transformohen, ajo ka ecur drejt amshimit. Kur Kurani lexohet me besim dhe përqendrim, veçmas nga vokaliteti dhe muzikaliteti magjepsës, ai shihet gjithashtu të jetë zëri dhe fryma e dashurisë, pika e takimit për mallin dhe ribashkimin. Pasioni për vërtetësinë, dashuria për dijet, përpjekjet për studim dhe hulumtim serioz dhe orvatjet për t'i bërë të njohura çështjet që janë theksuar në Kuran, shpesh herë kanë qëllim të tërheqin vëmendjen e zemrave të besimtarëve. Ajetet e Kuranit janë si gurë të çmuar ku shpirtrat e kujdesshëm zbulojnë embrione të reja sa herë që i vizitojnë. Çdo shtegtar i mendimit që e lexon me vëmendje Kuranin, do të gjejë patjetër vetveten në një arterie që do t'i dërgojë ata në një prej rezervave të brilanteve, për t'u bërë të ditur se çfarë pamje e këndshme do t'i presë aty shtegtarët, kur të arrijnë.

Por plotësisht me kureshtje, pastërtia e panjollosur e tij ka një hije të thurur mbi të dhe dyshimet janë hedhur në shpirtrat e lëkundur sepse ky libër, i cili është shpallur për të na lehtësuar ne nga të gjitha dhimbjet dhe për të përgatitur antidotin për plagët e vjetra, është shtrembëruar nga shpirtrat deficientë, njerëz tek të cilët pasioni dhe dashuria shtrihen në drejtime të kundërta. Kërkimi i tyre është sipërfaqësor, pra ata janë të gabuar në vlerësim. Investigimi i tyre është drejtuar gjithmonë te të tjerët, te ata që ndjenjat

janë të lidhura përjetësisht me ambicie dhe interesa, tek ata që intelekti dhe gjykimi pengojnë ndjenjat e tyre, tek ata që vlerësimi i nënshtrohet imagjinatës dhe që më mirë vërviten mes "vitrinës" dhe "vizionit", se të lidhin veten me thellësinë dhe kapacitetin e brendshëm. Ata kanë pjesërisht përgjegjësi për faktin që disa prej tyre, të cilët vështrojnë në këtë shkëlqim, e shikojnë atë me më pak lustër. Në të vërtetë, megjithëse duket sikur ata janë në një udhë që të çon në botën e përtejme dhe në luginat e metafizikës, përveç interesit material që ka pushtuar sytë e tyre, ata janë të paaftë për të kuptuar apo reflektuar një botë që është modeluar nga shpirti dhe kuptimi. Për më tepër, duke ekzaminuar botën e të tjerëve që është mbështetur në dobësitë njerëzore, ata bien në kurthin e armatosjes së vetes me të njëjtat armë, e përdorimit të të njëjtit material dhe me fjalë të tjera, për ndarjen e gjërave të njëjta me njerëzit të cilët ata i kanë quajtur "të tjerët." Në këtë mënyrë, ata dëshirojnë, si një çështje e ditës, imitimin e së keqes ta shfrytëzojnë për të qortuar rëndë të tjerët dhe t'i ndjekin ata hap pas hapi. Deri më sot, asnjë nuk ka përfituar kurrë nga një përpjekje e tillë e kotë dhe e pakuptimtë. Në të kundërt, në një përpjekje në të cilën të gjithë shprehin keqardhjen, është personaliteti ynë kolektiv i rrënuar që do të thotë se ne jemi dëmtuar.

Kurani zbriti në tokë me një domethënie të thellë për ekuilibrin. Ai ka ekuilibruar marrëdhëniet në mes individëve, në familje dhe në shoqëri, në të gjithë krijimin dhe u ka treguar ndjekësve të tij një udhë që i drejton në harmoninë universale. Megjithatë, ne e kemi kufizuar Kuranin në kufijtë e gjykimit tonë. Së pari, ne kemi kufizuar gjerësinë e paanë, duke lokalizuar universalitetin dhe atëherë ne e kemi trajtuar dashurinë e tij në një nivel të rëndomtë, duke e eklipsuar përmbajtjen dhe paraqitjen e tij brilante. Njerëzit me ideale të larta siç janë Said ibn Xhubejri, Ebu Hanife, Ahmed ibn Hanbeli, Imam Serahsi, kurrë nuk qenë pjesë e shtypjes dhe ndrydhjes, përkundrazi, ata nuk bënë asnjë lëshim, duke qenë gjithmonë të prerë në përputhje me zërin dhe ndërgjegjen e tyre

që ishin gjithmonë të hapura ndaj Zotit. Ata preferuan vuajtjet e vendeve të errëta - Zoti na faltë - në vend të kënaqësisë dhe rehatisë së pallateve dhe e gjetën të vërtetën thellë në adhurimin e të Gjithëditurit dhe kështu ata zgjodhën lirinë për mendimin dhe ndërgjegjen e tyre.

Në të vërtetë, ata që jetuan me një qëllim ose që vdiqën me një qëllim, jetojnë akoma. Kur ata vdiqën, varret e tyre rrihnin si zemrat, ose madje si një ndërgjegje kolektive, për amshimin. Në kundërshtim me këta shpirtra të lartë, janë të pafatët, skllevërit e interesave personale të tyre që e mendonin veten aq të shkathët dhe të fuqishëm sa të mos kishin nevojë për t'u mbështetur askund në këtë botë. Për më tepër, skllavëria e tyre qëndron e prangosur në dëshirat dhe fantazitë, kështu që jetët e tyre janë të skllavëruara, çfarë ata kanë jetuar është e mallkuar dhe gjithçka kanë arritur është katastrofë mbi katastrofa.

Nxënësit besnikë të Kuranit - ju mund t'i quani njerëz të përsosur - janë kalorës të amshimit, që i mbartin të tjerët në kuajt e tyre, për t'i dërguar në përjetësi. Ata janë të aftë të dalin mbi ashkun, aspiratat dhe pasionet e tyre. Nxënësit e Kuranit kalërojnë drejt horizontit, të idealizuar në përputhje me mendimet e botës së tyre të brendshme. Ata vrapojnë me galop përreth shumë vendeve që për të tjerët nuk janë realitet, ndërsa disa që kanë lënguar gjatë nga imagjinata e tyre dhe madje i kanë humbur këto perspektiva, mendojnë për ta se janë budallenj.

Në të vërtetë, qëllimi dhe vendosmëria jonë janë si katapultat që na hedhin në mes të mbretërisë së shpirtrave, një atmosferë metafizike përtej kësaj bote të rrethuar nga motive të cilat bllokojnë rrugën tonë dhe na mbajnë të lidhur me ndjenjat, interesat, përfitimet dhe famën tonë. Çdokush që ka zënë vend në këtë katapultë në një mënyrë ose në një tjetër, nëse jo sot, një ditë tjetër do të shkojë në orbitën përreth sferës së Zotit, ndërsa ata janë në pritje si një satelit në platformën e lëshimit.

Feja është plotësisht një burim i bollshëm në të cilin ushqehet ky ideal dhe Profeti është bashkëshoqëruesi i dashur i këtij burimi, përfaqësuesi dhe komentuesi i sinqertë që jep shpjegimet më të kuptueshme që janë në ruajtje në origjinën e tij hyjnore. Në këtë kontekst, ai është një novator, një kumtues dhe një transformues që rekomandon më të mirën, interpretimin më të shkëlqyer dhe më njerëzor, për ata që vijnë pas tij, i hapur edhe për të ardhmen më të largët me parimet që ai ka predikuar. Ata që nuk munden ta shohin Kuranin në thellësinë e tij të brendshme dhe ata që nuk e pranojnë personin e Profetit, si lundërtarin më të aftë për në thellësitë e Kuranit, janë fatkeqë që janë mbytur në thellësitë e tyre - nëse me të vërtetë ne mund ta quajmë këtë një thellësi. Ata, herë pas here kanë ndaluar të tronditur nga jehona e cektësisë së tyre siç pasqyrohet në Kuran dhe nganjëherë kërkojnë mbrojtje në pështpëritjen e historisë, duke shprehur zbrazëtinë e vetvetes. Në përfytyrimin dhe interpretimin e tyre, feja - më saktë teologjia islame - është ose një përçudnim që shpjegohet me përrallat me shtriga ose është një sistem jobashkëkohor që ka dështuar prej kohësh dhe që me mburrje akoma po përpiqet të luftojë kundër tij.

Në fakt, Kurani është burimi që ka një enigmë aq të thellë dhe një pastërti aq të madhe, një burim me një pasuri të tillë që të gjithë ata që i adresohen atij, mund të shohin që është përtej horizontit të sferës së inteligjencës së tyre dhe ata mund të provojnë sigurinë që të jep një burim i tillë. Pasi zbulojnë horizontin e aftësive të tyre për të kuptuar, ata e shohin si një ylber, si një hark ngadhënjimtar që është pikërisht gjithmonë pas pikës ku ndjekësit kanë arritur. Përkushtimi fetar është një interpretim tejpamës i burimit të dritës që derdhet në jetë përmes një prizmi të kristaltë, duke e konceptuar dhe modeluar atë, me qëllim që ata që e ndjejnë atë, të dëshmojnë në mënyrë të papërsëritshme një "shfaqje lehtësimi të patëmetë" edhe nëse mund ta shohin gjithmonë nivelin e paaftësisë së tyre për të kuptuar se çështë shprehur në Kuran.

HORIZONTET E SHPIRTIT: MENDIMI METAFIZIK [58]

Bota perëndimore moderne është mbështetur pothuajse plotësisht në nocionet materialiste që përjashtojnë dhe madje mohojnë dimensionet shpirtërore ose metafizike të ekzistencës. Kjo është një pikë e diskutueshme, por më e rëndësishmja është që shumë të ashtuquajtur intelektualë myslimanë, të cilët qorrazi imitojnë dhe importojnë gjithçka shohin në perëndim, përbuzin dhe mohojnë mënyrën tradicionale të të jetuarit dhe të të menduarit të shoqërisë së tyre. Kjo ndodh përgjithësisht sepse ata nuk janë të vetëdijshëm për dimensionin shpirtëror të ekzistencës dhe jetës. Në të vërtetë, ata që e reduktojnë ekzistencën në përmbajtje dhe që mendojnë vetëm për marrëdhëniet materiale, mezi mund ta perceptojnë dhe kuptojnë se çfarë është metafizike dhe shpirtërore. Për më tepër, meqenëse ata që vetëm mund të imitojnë, janë më radikalë në qëndrimin e tyre të huazuar se vetë ideatorët, dhe meqenëse imitimi shpeshherë e errëson realitetin, të vetëquajturit intelektualë bëhen më radikalë në mohimin e gjithçkaje që është shpirtërore dhe metafizike, ndërsa u mungojnë njohuritë e mjaftueshme për rëndësinë e gjithçkaje që është jetësore.

Meqenëse dimensioni shpirtëror dhe metafizik kërkon prej nesh që të kapërcejmë ndjenjat dhe instinktet tona për të shkuar në horizontet e pakufishme, materialistët as e kuptojnë dhe as e pëlqejnë këtë. Me fjalë të tjera, ata e kufizojnë hapësirën e të menduarit të tyre vetëm në çfarë provojnë dhe perceptojnë. Ata shfaqen si intelektualë të vërtetë duke gënjyer veten dhe të tjerët që ekzistenca përbëhet vetëm nga dimensioni material.

[58] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në" *Yeseren Düsünceler*".

Pavarësisht nga deklarimet dhe pohimet për kopjen e tyre perëndimore, është e vështirë për ta pranuar që mendimi shkencor perëndimor, ndonëse së pari është materialist, të ketë qenë gjithmonë i shkëputur nga mendimi spiritual dhe metafizik. Qytetërimi modern perëndimor është bazuar në trinitetin e mendimit grek, në të Drejtën Romake dhe në Krishtërim. Ky i fundit, të paktën teorikisht, i kontribuon një dimensioni shpirtëror. Perëndimi kurrë nuk e ka hedhur plotësisht poshtë mendimin platonik, ndonëse mbetet për t'u parë filozofia e tij pozitiviste dhe racionaliste. Gjithashtu nuk mund të pretendohet që mendimtarë të tillë si Paskali, Xheims Xhins (Jeams Jeans) nuk kanë ekzistuar kurrë apo të mohosh intuitivizmin e Bergsonit. Edingtoni (Arthur Stanley Eddington), Xh. Xhins, Bergsoni, Paskali, Bernhard Bavink dhe Hajzenbergu kanë të njëjtën rëndësi në mendimin perëndimor si Komti (Auguste Comte), Darvini, Moleskolti (Jacob Molescholt), Zolba (Henrich Czolba) dhe Lamarku. Në të vërtetë, është shumë e vështirë që të gjesh një filozof apo shkencëtar ateist para gjysmës së shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Në të kundërt, mendimi metafizik dhe spiritualiteti janë pothuajse plotësisht të hedhur poshtë nga shumë intelektualë myslimanë. Në emër të ca nocioneve që janë reduktuar thjesht në slogane siç janë «iluminizmi, qytetërimi perëndimor, qytetërimi, modernizimi dhe progresi," mendimi metafizik dhe jeta shpirtërore janë denigruar dhe degraduar. Gjithashtu këto nocione janë përdorur për të goditur vlerat tradicionale islame.

Ne e shfrytëzojmë "horizontin e shpresës" për udhëtimin përtej dimensionit të dukshëm të ekzistencës dhe e konsiderojmë ekzistencën si një ndërthurje të tërë në mungesë të së cilës gjërat dhe ngjarjet nuk mund të rroken siç janë realisht. Dhe po kështu, nuk mund të kuptohet esenca dhe lidhja e saj me Krijuesin, si edhe marrëdhënia në mes Tij dhe njerëzimit. Disiplinat shkencore që përshkohen nga natyra materialiste duke e ndarë ekzistencën nga jeta dhe që i japin përfundimet e tyre të shkëputura nga njëra-

tjetra, nuk mund të zbulojnë të vërtetën e gjërave, ekzistencës ose jetës.

Kur kërkime të tilla janë bërë në mjekësi, për shembull, njerëzit janë vështruar si qenie të krijuara nga shumë struktura të veçanta. Dhe konkluzionet mund të nxirren shumë thjesht: Ekzistenca është zhveshur nga kuptimi dhe logjika e saj dhe është treguar në formën e elementëve të veçantë që përbëhen vetëm nga materia, ndonëse e vetmja rrugë për të kuptuar dhe vlerësuar plotësisht jetën dhe ekzistencën, është ta vështrosh ekzistencën përmes prizmit të shpirtit dhe mendimit metafizik. Shpërfillja e kësaj rruge mundëson komentin e gjërave përtej limiteve të tyre dhe gjithashtu i kufizon përpjekjet intelektuale thjesht brenda kufijve të ndijimeve dhe perceptimeve. Por kur ne dëgjojmë zërin e ndërgjegjes ose të botës tonë të brendshme, kuptojmë që mendja kurrë nuk është bindur ose kënaqur me këto perceptime të thjeshta.

Mendimi më i saktë, më i qëndrueshëm dhe më i plotë arrihet duke u mbështetur në themelet e metafizikës dhe spiritualitetit. Bota e lashtë është ndërtuar siç tregohet në librat e shenjtë, siç janë Kurani, Bibla, Vedat dhe Upanishadat. Mohimi ose denigrimi i mendimtarëve, shkencëtarëve dhe filozofëve antimaterialistë perëndimorë siç janë Kanti, Dekarti, Paskali, Hegeli dhe Lajbnici, synon të injorojë një segment esencial të mendimit perëndimor.

Ne mund ta imagjinojmë një botë të re më të përparuar të bazuar në njohuritë dhe shkencën, vetëm nëse e vështrojmë konceptin e shkencës përmes prizmit të metafizikës. Myslimanët akoma nuk e kanë konceptuar shkencën në domethënien e vërtetë të saj që rrjedh nga Kurani dhe tradita islame, para së gjithash formuluar nga Kurani dhe hadithet. Aplikimi i shkencës ose teknologjisë në mënyrë të papërgjegjshme dhe egoiste ka sjellë më shumë dëme se sa të mira.

Nëse myslimanët duan t›i japin fund poshtërimit të gjatë të tyre

dhe të ndihmojnë në ngritjen e një bote të re dhe të lumtur, aspak të njëjtë me perëndimin, duhet t›u rikthehen modeleve të vjetra të teorive materialiste dhe pozitiviste, me idetë dhe frymëzimin e tyre. Të vetëdijshëm për të kaluarën e dhimbshme dhe të vështirë, ata duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për t›u dhënë zgjidhje këtyre problemeve.

Një koncept i vërtetë për shkencën do të bashkojë spiritualitetin dhe metafizikën në një kuptim ku afirmohet lidhja e plotë e brendshme dhe e pathyeshme në mes çdo disipline shkencore dhe ekzistencës. Vetëm një koncept që ka përfshirë gjithçka në tërësinë e saj mund të quhet me të vërtetë shkencor. Duke e vështruar ekzistencën në elementë të veçantë dhe duke u përpjekur të arrijmë tërësinë nga këto pozita, do të gjendemi të mbytur në shumëllojshmëri. Në të kundërt, duke i përfshirë në një të tërë këto elementë dhe duke studiuar pjesë të ekzistencës, në dritën e tërësisë, do të arrijmë në konkluzione të drejta rreth realitetit të ekzistencës.

Spiritualiteti dhe metafizika gjithashtu e pajisin artin me dimensionet e gjera të tyre. Në fakt, arti e arrin identitetin e vërtetë përmes spiritualitetit dhe metafizikës. Një artist zbulon botën e brendshme të krijesës njerëzore me të gjitha ndjenjat, gjallërinë, shpresat, zhgënjimet dhe ambiciet e veta dhe po ashtu zbulon se si ta lidhë atë me dimensionin e jashtëm të ekzistencës. Atëherë, artisti i shfaq këto në një mënyrë të volitshme në mjedisin e rrënuar. Arti shfaq esencën tonë të brendshme, e cila është vazhdimisht në lëvizje për t'u kthyer në origjinën e vet. Me fjalë të tjera, artistët bashkojnë frymëzimin që vërshon në shpirtrat e tyre nga gjërat dhe rrethanat nga çdo kënd i ekzistencës. Duke i sjellë së bashku të gjitha ligjet dhe fenomenet, atëherë ata i shfaqin gjërat për ne në tërësinë e tyre.

Dua të kujtoj që burimi më i rëndësishëm për shkencën, mendimin dhe artin, madje për virtytet dhe moralin, është

metafizika. E gjithë ekzistenca mund të jetë perceptuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë duke u bazuar në metafizikën e mirëfilltë. Kjo do të na lejojë të vështrojmë të gjithë ekzistencën si një të tërë dhe të udhëtojmë përmes dimensioneve të thella të saj. Pa spiritualitet dhe metafizikë, ne nuk mund të krijojmë një komunitet me themele të shëndosha, këto komunitete janë të shtrënguara të lypin vazhdimisht nga të tjerët. Komunitetet pa koncepte metafizike të shëndosha vuajnë krizën e identitetit.

Për të ndërtuar një botë të re dhe të lumtur në të cilën vlerave njerëzore u është dhënë rëndësia e duhur dhe janë të frytshme në konceptimin e synimeve dhe aspiratave, të gjithë njerëzit, pa dallime fetare, duhet të rizbulojnë dhe riafirmojnë treguesit spirituale dhe metafizikë në fetë e reveluara nga Zoti.

KAOSI DHE BOTA MISTIKE E BESIMIT [59]

Sot çdokush mbushet me zemërim, gëlltit urrejtje, mallkon gjithçka që e gjykon të jetë një kundërshtar, me një pasion të pandryshueshëm sikur të jetë i tërbuar. Boja që mbush faqet e gazetave, pamjet që transmetojnë televizionet, valët elektromagnetike që rezonojnë në radio, i gërvishtin veshët tanë si klithma fatzeza që emetohen nga vende të ndryshme, në male ose në ujë, në lugina apo lart në kodra, ata godasin sytë tanë si blicet e fotografëve që na bëjnë të dridhemi dhe hapin plagë në zemrat tona. Këto epika të urrejtjes që dëgjojmë gjatë gjithë ditës dhe natës dhe që na trondisin, këto klithma ogurzeza, na ligështojnë zemrat dhe për më tepër, njerëzit që kërkojnë shërim nga këto sëmundje, janë pak në të vërtetë. Mendimet e tyre shkojnë në drejtime të ndryshme, por gjithmonë arrijnë në të njëjtën pikë: para, prosperitet ekonomik dhe sukses.

... emocionet thjeshtohen, dëshira konsumohet, / Kuptimi që buron nga vështrimi, është plot mospërfillje për subjektin e Zotit.
- Mehmet Akif

Shumë pak janë përjashtuar nga një këndvështrim i tillë i turbulluar, nuk ka ndryshim nëse është i përbashkët apo jo, nëse është kapitalizëm, komunizëm apo liberalizëm. Largësia në karakter mes atyre që i kalojnë jetët duke menduar vetëm për të ngrënë e për të pirë, për të pushuar, për të fituar para, duke pasur në përgjithësi një jetë të këndshme dhe atyre që janë obliguar për shkak të karakterit të pandryshueshëm të natyrës së tyre, bëhet më e vogël nga dita në ditë. Dallimet themelore midis dy krahëve

[59] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *Isigin Göründügü Ufuk*.

zhduken në klimën e brishtë njëri pas tjetrit, dhe krijesat njerëzore kërkojnë drejtime të reja, pavarësisht nga natyra e tyre.

Feja, përkushtimi fetar, morali, mendimi i lirë, këndvështrimet tona për artin janë thuajse të parëndësishme. Forca është ulçeruar si të jetë e panjohshme, fantazia ka zënë vend në imazhin e ideve dhe këto ide të pakëndshme kanë dalë mbi të tjerat. Në të vërtetë, unë dua të them që në një kohë të vështirë kam kuptuar që një dramë e brendshme e tillë është një fanatizëm i tmerrshëm. Në ditët e sotme, kur sqarimi dhe ndriçimi i njerëzve është përgjithësuar, kur intelektualizmi është në kulmin e tij, fakti që shkenca dhe injoranca do të takohen në të njëjtën pikë, në kundërshtim me distancën që pritet të ekzistojë në mes tyre, lë për të nënkuptuar një bashkëpunim të errët dhe i krijon ekzistencës një problem serioz të dukshëm. Një kontradiktë e tillë na bën ne të besojmë se dëshira emocionale e disa njerëzve është shumë më përpara nga dëshira logjike dhe mendore e tyre.

Unë besoj që në një periudhë të tillë të errët, kur kundërshtitë janë gërshetuar, kur në pjesë të ndryshme të shoqërisë kaosi ka kaluar çdo lloj kufiri, kur veprimet e errëta me origjinë të ndryshme kanë errësuar pamjen e tokës, kur çfarë është poshtë, ka mbizotëruar mbi çfarë është lart, kur polemikat dhe dialektika janë bërë aq të shumta dhe popullore, kur thashethemet, veçanërisht përmes mjeteve të komunikimit masiv, janë mirëpritur, kur jetët e të tjerëve janë bërë si ushqim për ekzistencën tonë, kur shpirti i bashkimit është tronditur dhe grupimet e ndryshme janë thërrmuar ngado, kur shpresat janë thyer dhe dëshirat janë paralizuar, kur shpirtrat kanë braktisur luftën kundër dëshirave, është një nevojë e zjarrtë për t'u kthyer në drejtim të sferës sonë shpirtërore dhe për të dëgjuar botën tonë të brendshme, për të na shkëputur nga atmosfera e errët e botës materiale për të lundruar në atmosferën magjike e të ngrohtë të jetës shpirtërore. Ata që nuk do të bien në letargji dhe do kthehen tek vetvetja sa më shpejt të jetë e mundur, do të ndjejnë magjinë dhe bukurinë e botës së tyre

të brendshme. Fatkeqët që dështojnë për t'u kthyer dhe qëndrojnë në mes, ose në krahun tjetër, vazhdojnë të zemërohen, të urrejnë, të shpifin, të gënjejnë dhe të ndjejnë përbuzje, ata vazhdojnë në rrugën e mospërputhjeve të mëdha në të cilën kanë ecur deri në këtë ditë, madje dhe kur dielli shkëlqen, ata do të flenë në errësirë, do të pështpërisin mendime të errëta gjithmonë në kërkim të vendeve të fshehta dhe qosheve të errëta për të jetuar.

Ndokush shpreson që ata do të jenë në gjendje të ndjejnë gëzimin e ditëve dhe netëve të bekuara që ne kemi përjetuar, ku lumenjtë e dritës derdhen ngado. Dikush tjetër shpreson që ata gjithashtu do ta braktisin herezinë, ateizmin, përçarjen dhe rebelimin në zemrat e tyre dhe kështu do të jenë të aftë të respektojnë mirëkuptimin e parapëlqyer dhe qëndrimin e çdo shpirti të vetëm! Ndoshta një ditë këto dëshira do të jenë përmbushur, por duke u vetëshpallur kundërshtarë për Zotin, profetët, fenë dhe përkushtimin fetar, gjë që nuk është asgjë tjetër veçse materializëm që ka arritur kulmin duke mohuar hyjnoren, dhe duke u zhytur në baltovinën e anarkisë dhe nihilizmit, nuk do të jenë kurrë në gjendje të thithin këtë ajër të përtërirë. Zoti ynë i dashur, vetëm ti mund t'i bindësh ata për ekzistencën tënde dhe t'i çlirosh zemrat e tyre nga vargonjtë!

Në çdo komunitet dhe shoqëri gjenden njerëz që janë të prirur për të braktisur besimin e tyre dhe ka shumë kohë që ata kanë dalë jashtë kontrollit. Bashkësitë dhe shoqëritë e tjera nuk janë aq të fuqishme porsi ne për të kërkuar shpëtim kur përballen me këto abuzime dhe dobësi. Në të vërtetë, ne kemi mendimet me të cilat qetësohemi, besimin me të cilin paqtohemi, ditët dhe netët gjatë të cilave dridhemi nga gëzimi, festivalet dhe karnavalet, por këto ditë, këto net, këto festivale, këto karnavale janë të lira për çdo shenjtëri. Ato janë si fishekzjarrë, ndriçojnë për një moment dhe pastaj shuhen duke dhënë vetëm kënaqësi të çastit, ato janë kalimtare dhe materiale, duke mos premtuar asgjë në rrugën e kënaqësisë shpirtërore. Sigurisht që në botët e tyre ju nuk mund të ndjeni madhështinë e besimit te Zoti dhe as nuk mund të ndjeni

që shpirtrat janë të pakufizuar nga koha dhe hapësira, gjithçka fillon me një lumturi të gënjeshtërt dhe të përkohshme, me dëlirin për t›u majmur. Atëherë gjithçka është transformuar në kujtime të dhimbshme, në ëndrra të vajtueshme, në shpresa zhgënjyese dhe në fund, çdo gjë zhduket si të mos kishte qenë kurrë!

Në këtë atmosferë shpirtërore ku ne jemi pranë pragut të Zotit, çdo zë, çdo fjalë, çdo veprim është përjetuar si një vjershë për fëmijë dhe është dëgjuar si të jetë një melodi. Këto rrebeshe poshtë tek ne janë si shiu, ne njomim zemërgjerësinë me këto rrebeshe. Hëna ndryshon pamjen e saj çdo natë, si të jetë duke lajmëruar kohë të përpikta dhe orë të lumtura, dielli lëviz në një pikë të re në horizont për çdo agim, zgjimi i ndjenjave dhe mendimeve tona është në një moment të ri të kohës, duke nxitur ëndrrat tona ta ndjekin atë, duke treguar kujtimet për ne, që ngjajnë me lumin *Keuther*, premtuar për ne në parajsë. E shkuara bëhet si një mbulesë me shumë ngjyra që mbulon sytë tanë, kulmi i ëndrrave tona është e ardhmja e lumtur, në pritje me krahë të hapura dhe ne, që jemi të çliruar nga kufijtë kufizues të kohës, jetojmë larminë e së djeshmes, e së sotmes dhe e së nesërmes njëkohësisht, dhe si engjëjt, ndjejmë të gjitha gëzimet e kohëve të kaluara. Është e pamundur për ata që nuk janë ushqyer nga i njëjti burim si ne, që nuk ndajnë të njëjtat ndjenja dhe mendime me ne, të ndjejnë dhe kuptojnë thellësitë e shenjta në të cilat ne humbim veten, ku lumturia dhe gëzimi që ne përjetojmë janë si lumenjtë e parajsës.

Besimi ynë, horizontet tona të mendimit dhe sjellja jonë - karakteristika të mbarësisë, por në të njëjtën kohë që i përkasin një kombi paksa gabues, në këtë pjesë të botës - janë bërë, përmes formimit dhe riformimit në karakterin e personalitetit kolektiv, shumë të përsosura dhe të stolisura me vlera universale. Kjo është një situatë që nuk ekziston tek komunitetet e tjera. Kjo është aq shumë e qartë, sa ata që e kalojnë kohën me ne, nuk është e nevojshme të qëndrojnë gjatë për të qenë të ndërgjegjshëm për këtë ndryshim. E vërteta është që në këto ndryshime, trishtimi i

shenjtë në zemrat tona dhe entuziazmi në shpirtrat tanë, që rrjedh si ujë përmes shkëmbinjve, është ndjerë dhe dëgjuar. Sigurisht, ata që u vënë veshin fjalëve tona, gjithmonë do të dëgjojnë melodité e dhimbjeve të zërave të përzgjedhur me shpresë, do të dëgjojnë notat e ribashkimit, në kërkim të strehës së bukur dhe të përjetshme, në intonacionin dhe në sjelljen tonë. Në të vërtetë, ndërsa në njërin krah ne pëshpërisim "o kupëmbajtës, unë jam djegur në zjarrin e dashurisë, më jep një gotë me ujë," në krahun tjetër themi "unë ngjeva gishtat e mi në mjaltin e dashurisë dhe e shijova atë, më jep një gotë me ujë," dhe kështu jemi në gjendje të kthejmë dhimbjen tonë në buzëqeshje. Gjuhët tona nganjëherë flasin për dashurinë dhe nganjëherë për mërzinë. Ndonëse dashuria dhe lodhja shkaktojnë dhimbje për të tjerët, tek ata ne gjithmonë dëgjojmë, si Rumiu, poemën e dëshiruar për botën që kemi lënë për të ardhur këtu. Dashuria dhe mërzitja për ne janë si një argument për gjuhën e shpirtit, shkaktuar nga një dëshirë e brengosur për amshim. Meqë besimi dhe ndjenjat tona na dërgojnë në botët magjike të përtejme, ne pothuajse gjithmonë i ndjejmë të gërshetuara trishtimin dhe gëzimin, ne dëgjojmë zërat që qajnë dhe qeshin si notat e ndryshme të së njëjtës melodi. Ne u përgjigjemi kraharorëve që rënkojnë nga shqetësimi me buzëqeshje në faqet tona, siç sytë tanë mbyten nga lotët, ndërgjegjja jonë skuqet nga trëndafilat e kopshteve të *Iremit*.[60]

Edhe nëse kjo nuk është e thjeshtë për çdo individ, lidhja jonë me Zotin është qëndrimi më i natyrshëm që ne mund të marrim, marrëdhënia jonë me Atë është si një magji që transformon të gjithë momentet e jetës sonë në entuziazëm dhe gëzim. Zemrat tona që rrahin me ndjenjat për Të, mbushen dhe rimbushen me ëndrrën për këtë vështrim: ne jemi në gjendje të jetojmë me të ftohtin e hidhur të vjeshtës në zemrat tona sepse kemi gëzimin e pranverës. Shpirtrat tanë adoptojnë qëndrimet më të lakmueshme me instinktet e ndjenjave dhe gëzimit të veçantë që janë rezultat

[60] Përmendur në Kuran (Fexhr, 7-8). Shpesh identifikohen me kopshtet e varuratë Babilonisë.

i lidhjes sonë me Lavdiplotin. Në këtë mënyrë, ne shndërrohemi, ata na bëjnë të ndjejmë një entuziazëm të përtërirë, një hapje dhe revelim të ri edhe në momentet kur jemi të pikëlluar e të brengosur. Kënaqësi apo trishtim, revelim apo hidhërim, të gjitha këto emocione pësojnë metamorfozë në zemrat tona që rrahin me besim dhe flasin për ne me kënaqësinë më të natyrshme dhe me shpresat më realiste. Është një fakt, që ne gjithashtu provojmë si momente qetësie po ashtu dhe momente të vështira, javë të bukura dhe ditë të këqija, dritë dhe errësirë që vjen dhe shkon, si dita dhe nata. Megjithatë, ne marrim dashamirësi dhe gëzime të pakapërcyeshme nga duart e të gjitha këtyre vuajtjeve, sepse ne kemi besimin tonë, lidhjen tonë me të Vetmin dhe shpresat tona! Ata që nuk pranojnë që telashet dhe kënaqësitë janë produkt i së njëjtës dëshirë, përpëliten në agoninë e pafund, ndërsa në atmosferën tonë ne shohim qartë që gjithçka do të jetë shndërruar në dhembshuri të thellë. Shijimi i tërë jetës, me të këqijat dhe të mirat e saj si *Keuther,* në çdo gjë që ne hamë dhe pimë, në çdo vend që ne banojmë, me të gjitha bukuritë hyjnore të zbuluara në botën tonë të brendshme, me të gjitha gjatësitë e ndryshme të valëve të tyre, na bën që të ndjejmë hidhërimet tona të tkurren para lumturisë, të ndjejmë dhimbjet tona të treten në kënaqësi dhe të ndjejmë jetët tona të derdhen në rezervuarët e qelqta në një spektër ngjyrash. Vdekshmëria jonë është transformuar në përjetësi, ne buzëqeshim edhe kur qajmë.

Në botën tonë, besimet dhe shpresat që burojnë prej tyre janë aq të ndërthurura me jetët tona, sa që çdo kapitull i këtyre jetëve na jep krahë për në vendin e lutjeve dhe na drejton për tek hyrja e botës së përtejme. Na dërgon ne atje dhe i lë zemrat tona të shijojnë bukuritë e parajsës. Në këtë rrugë, ne ndjehemi sikur jemi duke thithur aromat e parajsës. Edhe nëse do ta lëmë veten të rrëmbehet nga jetët tona të përditshme, thirrjet për lutje, këngët që lartësojnë Zotin, zërat e larmishëm për falje, recitimet për emrat e Zotit, ata që i kushtohen mirënjohjes së Tij, duke thirrur Unitetin e Tij në

minaret e xhamive, na sjellin ne në atmosferën e tyre. Ato ngjyejnë shpirtrat tanë me ngjyrat e tyre, ato u dhurojnë zemrave tona një zë të qëndisur, psherëtimat na i kthejnë në një fyell duke na zgjuar me bukurinë e muzikës. Këto zëra i zgjojnë shpirtrat tanë dhe ne jemi të magjepsur nga misteret që i përkasin Zotit, magjia e këtyre mistereve që vijnë me shpejtësi nga thellësitë e botëve tona të brendshme dhe që përhapen në të gjithë gjykimet tona, kjo bukuri që zbukuron të gjitha kopshtet e parajsës në mendimet tona dhe që vërshon pas buzëve tona, është si ujëvarat e frymëzimit. Në këtë mënyrë mahnitemi dhe qëndrojmë të tronditur.

Kjo magji, kjo njohje me misteret që i përkasin Zotit, i shton ditët dhe netët e bekuara me begati dhe zemërgjerësi të pakufishme për ne. Kjo është aq e vërtetë, sa gjithçka përreth nesh shfaqet e gëzueshme, çdo kënd merr një pamje spirituale dhe stimulon shpirtrat tanë duke i drejtuar në destinacionet e metafizikës, dhe si arrijnë në kulmin e saj ose në termat mistike, shpirtrat tanë kanë arritur në pjekurinë më të lartë qiellore. Gjithashtu, për të matur shkallën në të cilën ne mund të dëgjojmë dhe kuptojmë çdo gjë që ndodhet rreth nesh, ngazëllehemi si fëmijët që ndjehen sikur janë në parqet e bukura të gëzimit. Kështu ne provojmë lumturinë dhe gëzimin e një dite feste.

Në një botë të tillë, agimi vjen në shtëpitë tona nga dyert e dritaret si një vizitor i pritur, mbrëmja vjen në dhomat tona personale si një e dashur dhe ulet pranë nesh, nata kacavirret tek ne me bashkëshoqërimin e saj për ribashkimin me Mikun dhe në çdo luginë duart janë ngritur në lutje drejt Tij, gati për të marrë dhuratat që do të vijnë prej Tij, duke tejkaluar gjendjen e tensionit metafizik me forcën e shpirtit, duke psherëtirë, duke thënë "Merri duart e mia i shtrenjti Mik, mbaji ato, sepse unë nuk mund të bëj pa Ty!"

Në një botë të tillë, lutja buçet si zërat kumbues të *lutjes korale*[61]

[61] Lutjet e përbashkëta që bëhen në xhami në pjesë të caktuara të faljes si dhe refreni "Amin!"

dhe jehona e saj është si zëri dhe fryma e thellësive hyjnore. Vetmia e ngrohtë e natës i mbështjell shpirtrat tanë si një pëlhurë e mëndafshtë, pulset tona rrahin me gjallëri për lajmet e mira që kanë marrë. Ndoshta disa prej nesh këndojnë himnet e lartësimit të Tij edhe nëse bie shi apo dielli shkëlqen, si një bilbil që e copëton zemrën në përpjekje për të gjetur ritmin ideal për emocionet e tij me tingujt më mallëngjyes. Me një fjalë, gjithsecili është duke kënduar nëpër dhëmbë një melodi me vuajtje dhe gëzim të pafund, me dashuri dhe gjallëri të pashuar, duke dëgjuar drithërimat e shpirtit të vet dhe duke i lënë të tjerët gjithashtu ta dëgjojnë atë. Çdokush psherëtin nga ethet e dashurisë dhe i bën dhe të tjerët t'i ndjejnë ato gjithashtu. Po, siç ata reflektojnë gjallërinë e shpirtit dhe frymëzimin e zemrave të tyre, duke shfaqur vetveten në një moment të fundit, po ashtu ata bëhen zëdhënës për ndjenjat e të gjithëve dhe janë në gjendje për të folur për domethëniet e fshehta ndërsa të tjerët duan, por nuk arrijnë të shprehen.

Horizonti i të jetuarit të së djeshmes, të së sotmes dhe të së nesërmes në të njëjtën kohë me një shkallë të tillë besimi dhe shprese, dashurie dhe mirënjohjeje për misteret që i përkasin Zotit, i jep një thellësi të tillë jetës, që çdo zemër në orbitën e jetës së përtejme e gjen veten të kredhur në harmoninë melodioze të emocioneve dhe ideve dhe është e çliruar nga kufizimet, që janë efektet mbytëse të lëndës. Unë besoj që baza më e fuqishme e marrëdhënieve njerëzore, zanafilla e të gjithë kënaqësive dhe burimi për të gjithë dashuritë, ashkun, atraksionin dhe gravitetin është ky besim dhe kjo shpresë. Çdo dishepull i zemrës që arrin tek ky besim dhe tek kjo shpresë, mund ta provojë dhe ta ndjejë gjendjen e të qenit jashtë kohës, me aftësinë për ta ndjerë të gjithë në thellësitë e tij.

Në të vërtetë, në shkallën ku mund të arrijë pamja, ekzistenca ndjehet në një mënyrë të ndryshme, gjërat vlerësohen në një rrugë të ndryshme dhe shkrihen në vetvete me ngjyrën, shijen, aromën dhe theksin e manifestimit nga amshimi. Këto atribute depërtojnë në gjithçka dhe njerëzit mund të arrijnë një ekzistencë të dytë me

një "lindje dhe vdekje" të re. Përgjatë këtyre orëve të gëzuara, kur vështrimi i përjetshëm është përqendruar në atë që shihet përtej pamjes së dukshme të ekzistencës, ndjehen të gjitha gëzimet e jetës. Ato ndjehen si po të kesh marrë dijet e duhura, ashtu edhe po të jesh çliruar nga pesha e të gjitha gjërave që janë të papranueshme. Qiejt e largët lëshojnë me rrebesh bekimet për këto zemra që janë të etura për dashuri dhe vrapojnë me përmallim dhe mëshirë. Të gjitha zemrat që jetojnë me frikën e shterimit janë të ndrydhura. Lulet qiellore lulëzojnë në këto ëndrra të zbukuruara!

Disa prej nesh mund të mos jenë në gjendje për të arritur në këtë stad - stad në të cilin bëhet një tejkalim i luftës (për të kapërcyer errësirën me të gjitha kuptimet e saj) dhe agimit - për njerëzit me besim dhe horizont, por të gjitha këto janë fenomene për zemrën, shpirtin dhe emocionet. Duke jetuar përmes revelimeve të panumërta të jetës, asnjë tjetër veç heronjve aktivë të lindjes dhe garave të mëdha nuk mund ta kuptojë këtë dashuri, entuziazëm, poezi dhe muzikë që vërshon në shpirtrat tanë nga i Përjetshmi. Ata që nuk janë në gjendje ta kuptojnë këtë, nuk do të jenë për më tepër në gjendje të na kuptojnë ne. Ata që qëndrojnë larg nga kjo jetë delikate dhe e bukur, jetojnë në errësirën e këtij hendeku, ndërsa aftësia për të kuptuar e atyre që kanë gjetur një pozicion prej nga mund ta vështrojnë vërtetësinë në një mënyrë të tillë që shfaqet qartë siç është në të vërtetë, është ndijimi i kësaj dhurate në të gjithë gjatësitë e valëve të saj dhe e gjerbin atë si lumenjtë e parajsës dhe jetojnë jetët e tyre tokësore si të jenë në qiell.

Kush e di dhe përsa kohë ne do të flasim për këtë kënaqësi dhe gëzim të pafund, me ëndjen e një festivali, për një ditë të gëzuar! Ndonëse do të vazhdojmë të shprehemi për të - të metat në shprehje nga oratorët i lëmë mënjanë - ne do të dëgjojmë akoma me kënaqësi dhe do të përpiqemi ta ndajmë atë me të tjerët!

HORIZONTET E QETËSISË [62]

Njerëzit kanë ëndërruar gjithmonë të arrijnë qetësinë mendore, që nga dita që njeriu i parë vuri këmbët në tokë. Njerëzit janë dëshiruar për paqen mendore, duke kërkuar dhe duke u përpjekur në një mijë mënyra për ta arritur atë. Nganjëherë njerëzit e kanë lidhur qetësinë me punën e vështirë dhe me fitimin e pasurive monetare, nganjëherë ata e synojnë atë për të jetuar me përmbajtjen e zemrave të tyre dhe në liri të pakufizuar, në kohë të tjera, qetësia mendore ka qenë vështruar si një pasuri për përparimin teknologjik dhe arritjen e komoditetit material ose ka qenë lidhur me ushqimin dhe kënaqësitë e dëshirave trupore. Njerëzit i kanë kufizuar jetët e tyre në arritjen dhe posedimin e këtyre synimeve. Në këtë rrugë të mjegulluar nga pluhuri, njerëzit kanë jetuar herë pas here me shpresë, nganjëherë kanë provuar zhgënjim dhe janë përpëlitur në dëshpërim, por kurrë nuk kanë arritur dëshirimin e pritur. Kjo udhë është e pamundur, sepse qetësia mendore që ne po kërkojmë, është fryt i virtyteve brenda besimit dhe mund të arrihet vetëm përmes besimit të përsosur. Kjo ka qenë gjithashtu esenca e thirrjeve të profetëve.

Thelbi i kësaj thirrje për paqe dhe qetësi mendore mund të institucionalizohet kur individët kthehen drejt Zotit dhe e nënshtrojnë veten tek Ai me të gjithë qenien e tyre: është e pamundur për një person me besim që ka arritur të nënshtrohet në këtë shkallë të vazhdojë të jetë një skllav i dëshirave trupore, ose nuk është e mundur që një person i tillë të ketë frikë gjë tjetër veç Zotit. Sepse tani, këta njerëz, siç kanë gjetur të Vetmin për

[62] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *Isigin Göründügü Ufuk*.

të cilin kanë qenë në kërkim, dhe siç kanë gjetur të Dashurin, drejt të cilit kanë drejtuar dashurinë e tyre, në të njëjtën mënyrë kanë gjetur paqen në vetvete, sepse ata kanë qenë në mbrojtjen e Plotfuqishmërisë së Përjetshme dhe gjithmonë do të ndjejnë druajtje dhe respekt. Ata janë në paqe, sepse e dinë që Hirësia dhe Plotfuqishmëria e Pafund kurrë nuk do t'i braktisë ata që kanë kthyer pamjen e tyre në drejtim të Tij, s'ka rëndësi se kush janë, dhe Ai kurrë nuk do t'i lërë ata në llumin e mjerimit.

Për këtë arsye, njerëzit me besim janë gjithmonë në paqe dhe gjithmonë ndjejnë siguri. Ata e dinë që do të arrijnë në destinacionin e dëshiruar nëse vazhdojnë të ecin duke lidhur gjithçka me Atë. Ata do të jenë të sigurt përgjatë gjithë rrugës dhe do të përjetojnë në distancë "natën e dasmës," për të qenë plotësisht në afërsi. Ata do të ecin drejt qëllimit të ekzistencës të drejtuar nga Kurani, me shpresën që besimi premton në zemër, me puhitë e nënshtrimit përhapur përmes emocioneve dhe ndërgjegjes së tyre dhe me mbikëqyrjen e Mjeshtrit Hyjnor. Me të gjitha këto, ata mund t'i kapërcejnë të gjitha gropat e ferrit të lidhjeve trupore dhe orekset e pangopura të dëshirave dhe fantazive të tyre. Sigurisht, ata që hyjnë në atmosferën e Kuranit dhe gjejnë strehë në drejtimin e Tij, gjithmonë ndjejnë një kënaqësi të thellë dhe një besim të patundur në zemrat e tyre, kur mbushen me siguri. Siç dëgjojnë ndërgjegjen e tyre, siç vështrojnë pas objekteve, siç parashikojnë të nesërmen e afërt dhe të ardhmen e largët, për shembull të ardhmen e shtrirë deri në përjetësi, siç marrin në konsideratë *Berzahun* (varrin ose vendin ku shpirtrat presin deri në Ditën e Gjykimit), *Mahsherin* (vendin ku njerëzit mblidhen në Ditën e Gjykimit), *Siratin* (urën shumë të ngushtë që të çon në parajsë), Xhehenemin dhe Xhenetin, po ashtu ata kanë një vetëdije të jashtëzakonshme për detyrimet e tyre dhe për ndjenjën e përgjegjësisë, dhe janë gjithashtu të mbushur me një ndjenjë të thellë shprese. Kjo ndjenjë shprese është në proporcion të drejtë me thellësinë e besimit në kraharorët e tyre. Ata vështrojnë pas

objekteve përmes dritares së veçantë të dashamirësisë, dhënë për ta si zemërgjerësi e përshtatshme për besimin e tyre, kaq duhet që qepeni i ekzistencës materiale të jetë hequr plotësisht dhe ata do t'i gjejnë gjërat që shohin dhe përjetojnë prapa dritares, të ngjashme me gjërat që ndjejnë dhe përjetojnë këtu. Për shkak të natyrës kufizuese tokësore, ata do të ndeshen ballë për ballë prapa kësaj dritareje, në detaje të imta, me çfarë kanë ndjerë shkurtimisht në tokë dhe do të buzëqeshin me fatin e lumtur të tyre.

Sigurisht që besimi është një çelës magjik për lumturinë në këtë botë dhe në botën e përtejme dhe premton një fund të drejtë për ata që kaluan jetët e tyre nën flamurin e tij. Besimi premton një periudhë të ndritshme në *Berzah,* duke dhënë lajme të gëzuara për një fisnik dhe ngrohtësi ringjalljeje, duke pështpëritur një oktavë të Shkallës Hyjnore që është një kënaqësi për shpirtrat tanë, duke i bërë zemrat tona të ndjejnë afrimin e aventurës në urën e *Siratit* me thellësinë e shpresës dhe të maturisë. Parajsa hap dyert e saj me kënaqësi dhe mirëkuptim, me surpriza që tejkalojnë të gjitha parashikimet dhe na njeh ne me bekimet nga pema e parajsës, bekime që na bëjnë të harrojmë edhe momentet më të vështira dhe më të dhimbshme të kësaj jete!

Në fakt, kur njerëzit me besim kthehen drejt Zotit me të gjithë qenien e tyre, çdo gjë tjetër zhduket nga vështrimi. Të gjithë fuqitë dhe dëshirat e gënjeshtërta shfryhen si balona të shpuara. Të gjitha dritat materiale që kanë shkaktuar verbimin e syve të tyre me shkëlqimin fals, janë dobësuar përballë dritës hyjnore të Tij, që ndriçon në zemrat tona. Gjithçka që dëgjojmë përreth, kumbon: «Sot të gjithë pasuritë dhe pronat i përkasin Zotit, Fitimtarit Absolut.» Një zemër që ka arritur në këtë nivel, është e çliruar nga premtimet mashtruese të të gjithë pushteteve, fuqive, mirësjelljeve dhe hijeshive joshëse dhe është kthyer drejt Zotit dhe pret ndihmë vetëm prej Tij. Kur njerëzit e tillë janë të shqetësuar apo të tronditur nga vështirësitë, ata shpresojnë dhe mbështeten tek Ai. Ata kërkojnë mbrojtje nga të gjitha kërcënimet dhe gjejnë

strehë në tempullin e hijeshisë, dashamirësisë dhe ndihmës së Tij.

Kur njerëzit e tillë ligështohen, ata lajmërojnë fuqinë transcendente të Tij. Kur ata janë njollosur nga mëkati, vrapojnë në basenin e Tij të mëshirimit për të pastruar vetveten, duke shpërndarë mjegullën dhe tymin që ka shkaktuar fshehjen e horizontit të tyre nga paraqitja e besimit për Atë dhe nënshtrimit të vetes tek Ai. Kështu ata ecin drejt së ardhmes pa u përulur para fenomeneve që mund të shfaqen në këtë rrugë. Ata zgjidhin të gjitha problemet e tyre personale, familjare dhe shoqërore nga lidhja me Atë dhe nuk kanë kurrë frikë, ose të ndjejnë vetminë që nuk mund të arrijë në shpirtrat e tyre. Në këtë kohë, ata mund të jenë kushtëzuar nga një vetmi e përkohshme në publik, por falë besimit dhe nënshtrimit të tyre, gjithmonë ndjejnë erën e "shoqërisë hyjnore." Çfarëdo që t›u ndodhë, ata e marrin si një shenjë paralajmëruese të fatit dhe e presin me qetësi dhe durim atë.

Besimi tek Zoti dhe karakteristikat e besimit të tyre u japin mundësi ta njohin veten me gjithçka, dhe kështu ata e shohin të gjithë ekzistencën - në jetë ose jo - si një familje. Ata lidhen me pjesën tjetër të krijimit, kanë një pjesë aktive në jetën e përgjithshme të gjërave dhe ndjejnë në ndërgjegjen e tyre gjerësinë e titullit të zëvendësit që ka qenë lënë trashëgim për ta. Ata i rrokin që të gjitha gjërat që janë krijuar në të mirë të tyre dhe përulen me mirënjohje, duke kuptuar që janë dorë për dore me këndvështrimin e engjëjve dhe shpirtrave në univers. Ata gjejnë tabanin mbi të cilin do të ecin, ultësirë dhe ferrishte, të ngrohtë si vendbanimet e të parëve, dhe ndjehen sikur të jenë në shtëpi, në krahët e nënës së tyre. Ekzistencën e vlerësojnë në një formë që nuk ngjan me mënyrën materialiste dhe me përshkrimin natyralist, por me sytë e një njeriu me besim që e lidh gjithçka me Zotin, dhe në përgjigje, marrin mirënjohje nga çdo gjë që është përreth tyre. Ata marrin mesazhe në konfidencë nga të gjitha gjërat me të cilat kanë krijuar lidhje dhe përgjigjen në atë mënyrë që shpreh të njëjtën konfidencë. Ata nuk tremben nga askush dhe po ashtu nuk

frikësojnë askënd, të gjithëve u hedhin krahët si të jenë vëllezërit e tyre. Ata dhurojnë buzëqeshje për të gjithë gjërat, pinë ujë, marrin frymë dhe i pranojnë të gjitha format që janë shfaqur si bekime prej Zotit. Ata thithin kundërmimin e tokës dhe të atyre që ajo ka lindur, si të jetë aroma më e këndshme. Përshëndesin kopshtet dhe pemishtet, malet dhe luginat, kullotat dhe pemët, trëndafilat dhe lulet me gjuhën e zemrave të tyre, sikur ato të kenë ndjenja. Përkëdhelin të gjitha krijesat me të cilat ndeshen, si të jenë shokët e ngarkuar për të mbajtur shoqërinë në këtë bujtinë. Me çdo akt ata demonstrojnë që janë sjellë në tokë si një shenjë e harmonisë dhe mirëkuptimit.

Kështu, njerëzit që me besimin e tyre të pakufishëm vështrojnë çdo njeri dhe çdo gjë përmes kësaj strukture, e ndjejnë veten në një atmosferë të plotë paqeje, aq sa mund t'i bëjnë njerëzit e tjerë xhelozë, nëse ata janë të vetëdijshëm për këtë. Këta njerëz janë të ngazëllyer me kënaqësitë e pashprehshme të jetës me besim. Sigurisht që nuk luftojnë dhe nuk grinden, ata i shpenzojnë të gjitha energjitë me qëllim që edhe njerëzit e tjerë të përjetojnë të njëjtën ndjenjë dhe të njëjtin gëzim, duke i ndarë këto ndjenja të sinqerta me gjithsecilin, ata përpiqen për të drejtuar çdo njeri nga kënga e gëzimit duke zbuluar horizontet në çfarëdo niveli që të munden. Ata janë gjithmonë një hap prapa jetës së përditshme për shkak të përpjekjeve për t'i nxitur të tjerët që t'i provojnë këto gëzime. Në të gjithë veprimtarinë e tyre, kanë një besim të përjetshëm te Zoti. Ata kurrë nuk kujdesen që ta vënë veten qëllimisht kundër njerëzve të tjerë. Sigurisht që në njërin krah ushqejnë veten me fuqi nga plotfuqishmëria e Zotit, kurse në krahun tjetër, gjithashtu përpiqen të arrijnë mbështetjen e njerëzve me të njëjtin besim. Ata transformojnë fuqitë që mund t'i kenë kundër, në një thellësi të re për aftësitë e tyre dhe kështu ecin drejt qëllimit të përcaktuar sikur të jenë duke fluturuar. Ata ecin drejt synimit për paqe me besim, ecin drejt qëllimit për t'i bërë edhe njerëzit e tjerë të besojnë, ecin drejt arritjes së kënaqësisë së Zotit.

Nëse vërtetësia është kuptuar, shoqëria ku individët kanë arritur në një shkallë të tillë shpërblimi ku ata duan dhe respektojnë njëri-tjetrin dhe janë bashkuar me një premtim në zemër, është një kandidate e përsosur për paqe. Është një kandidate perfekte sepse faktorët që mund t'i çojnë anëtarët e saj drejt krijimit të fraksioneve dhe trazirave, janë plotësisht të eliminuar. Në mes këtyre njerëzve, nuk ka konsiderata apo privilegje për shkak të fisnikërisë, prejardhjes, krahinës ose statusit shoqëror. Këta njerëz që i vështrojnë të gjithë njerëzit dhe gjërat si kërcejtë e së njëjtës rrënjë, janë vëllezër në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kurani tërheq vëmendjen për këtë vërtetësi të thellë kur thotë,

Besimtarët janë vëllezër... (Huxhurat, 10).

Kjo nuk është vetëm një afri fizike; me fjalët e Kuranit dhe porositë e Profetit, ata janë lidhur fort me çdo njeri tjetër, nga dashuria, mëshira dhe sinqeriteti, si organet e të njëjtit trup dhe gjithmonë ndjejnë dhimbjet e të tjerëve në zemrat e tyre dhe vuajnë agoninë, ndajnë gëzimet e tyre dhe provojnë të njëjtën lumturi së bashku.

Në të vërtetë, ata janë si sytë dhe veshët, gjuha dhe buzët, duart dhe këmbët e çdo njeriu tjetër. Në këtë shoqëri, çdo individ ia ka kushtuar vetveten lehtësimit të jetës së të tjerëve, për të bërë gjithçka që munden për lumturinë e tyre. Për pasojë, kjo nuk është braktisje apo zhytje në dëshpërim, në mes njerëzve të tillë. Kur njëri është i lënduar, gjithë të tjerët e ndjejnë këtë dhimbje në zemrat e tyre. Të gjithë bashkohen në festë kur dikush ka një gëzim. Përsëri, në këtë shoqëri, prindërit janë respektuar si të shenjtë, fëmijët janë rritur me kujdes, si të jenë lule. Bashkëshortët edhe kur kanë janë thinjur së bashku, janë të gëzuar si në ditën e parë, me mendimin për solidaritetin e përjetshëm në botën e përtejme. Ata përpiqen t'i jetojnë jetët e tyre duke ndjekur rrugën e zemrës dhe të mendjes, përtej kufijve të marrëdhënieve emocionale. Ata janë të sigurt për njëri-tjetrin në atë shkallë sa asnjë hije dyshimi

nuk është reflektuar në sytë e tyre. Siç është harmonia familjare, po ashtu është edhe harmonia e kombit, që konsiderohet të jetë një familje e madhe. Në një komb të formuar me familje të tilla, të gjithë do të duan dhe respektojnë njëri-tjetrin, të gjithë do të kujdesen për njëri-tjetrin me dhembshuri, të gjithë do të dëshirojnë mbarësi për të tjerët dhe do të përpiqen të largojnë të keqen me sa munden, me aftësitë e tyre. Askush nuk mendon keq për të tjerët dhe po ashtu askush nuk i vë të tjerët në dyshime. Askush nuk i përdor njerëzit si spiunë kundër njëri-tjetrit. Një pjesë e shoqërisë nuk e lidh ekzistencën e saj me shkatërrimin e pjesës tjetër. Absolutisht askush nuk bëhet pjesë e fenomeneve të tilla siç janë bashkëpunimi në krim, gënjeshtrat, mashtrimet dhe shpifjet, këto janë karakteristika të njerëzve të ulët. Në këtë shoqëri të paqes, çdo individ është në luftë me gjithçka negative. Kjo është sikur ata janë betuar për të mbrojtur vlerat njerëzore. Dhe si rezultat, kjo bëhet shoqëri e vetëdijes dhe paqes.

TASAVUFI DHE ORIGJINA E TIJ [63]

Tasavufi konsiderohet udha e ndjekur nga sufitë për të arritur tek e Vërteta: Zoti. Ndërsa ky term rëndom shpreh aspektin teorik dhe filozofik të këtij kërkimi, aspektit fizik ose praktik i referohet përgjithësisht «të qenët një dervish.»

Ç'është tasavufi?

Tasavufi ka qenë përkufizuar në shumë mënyra. Disa e shohin atë si asgjësim të egove personale për hir të Zotit dhe pastaj, rilindje shpirtërore me anë të dritës së esencës së Tij. Një transformim i tillë, rezultat i drejtimit të vullnetit personal tek Zoti, është në përputhje me dëshirën e Tij. Nga një këndvështrim tjetër, tasavufi është një përpjekje e vazhdueshme për të pastruar vetveten nga të gjitha të këqijat me qëllim fitimin e virtyteve.

Xhunejd Bagdadi, një mjeshtër i famshëm i tasavufit, e përkufizoi tasavufin si një metodë për bashkimin e "vetasgjësimit për Zotin" me "vazhdimësinë ose ekzistencën me Zotin." Shibliu e përmbledh atë si një zhvillim që është gjithmonë së bashku me Zotin ose me praninë e Tij, kështu që asnjë qëllim tokësor ose rreth kësaj bote nuk do të jetë madje i mirëpritur. Ebu Muhamed Xheriri e përshkruan atë si qëndresë ndaj tundimeve të vetë trupit dhe cilësive negative dhe sigurim të cilësive morale të lavdërueshme.

Disa e përshkruajnë tasavufin si vështrim prapa "objektit" ose pas pamjes së gjërave dhe eventualiteteve dhe interpretimin për çfarëdo gjë që ndodh në botë në lidhje me Zotin. Kjo do të

[63] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *Emerald Hills of the Heart; Key Concepts in the Practice of Sufism*, Vol. I.

thotë që njerëzit e lidhin çdo akt me Zotin, si një dritare përmes së cilës ata mund ta "shohin" Atë, mund të jetojnë jetët e tyre si një përpjekje e vazhdueshme për ta shquar ose "shikuar" Atë me një "vështrim" shpirtëror të thellë që është i papërshkrueshëm me terma fizike dhe me një vetëdije të thellë për të qenë vazhdimisht i vëzhguar nga Ai.

Të gjitha këto përkufizime mund të përmblidhen si më poshtë: Tasavufi është një udhë e ndjekur nga individët që kanë qenë të aftë ta çlirojnë vetveten nga veset dhe dobësitë njerëzore, me qëllim që të fitojnë cilësi engjëllore dhe t'i drejtojnë kënaqësitë për Zotin, të jetojnë në përputhje me nevojën për diturinë dhe dashurinë e Zotit dhe të përjetojnë, si rezultat, kënaqësi shpirtërore.

Tasavufi është bazuar në vëzhgimin edhe më të "parëndësishëm" të normave të sheriatit me qëllim që të depërtojnë në kuptimin e brendshëm të tyre. Një i pranuar ose udhëtar (*salik*) në udhën e tasavufit kurrë nuk e ndan vëzhgimin e jashtëm të sheriatit nga dimensioni i brendshëm i tij dhe prandaj vëzhgon gjithçka që nevojitet me dimensionin e jashtëm dhe të brendshëm të Islamit. Përmes një vëzhgimi të tillë, ky person udhëton drejt qëllimit me përulje dhe nënshtrim të plotë.

Duke qenë një udhë e vështirë që drejton te njohuritë për Zotin, tasavufi nuk lejon neglizhencë apo mendjelehtësi. Ai kërkon iniciativë për t'u përpjekur vazhdimisht, si një bletë punëtore që fluturon nga kosheret te lulet dhe nga lulet te kosheret, për t'i fituar këto njohuri. Iniciativa duhet ta pastrojë zemrën e tij ose të saj nga të gjithë lidhjet e tjera, t'u rezistojë të gjitha prirjeve, dëshirave, orekseve trupore dhe të jetojë në një mënyrë që reflekton njohuritë me të cilat Zoti ka përtërirë dhe ndriçuar zemrën, gjithmonë gati për të marrë bekime dhe frymëzime hyjnore, si edhe për ta ndjekur saktë shembullin e profetit Muhamed. Me bindjen që bashkimi dhe aderimi te Zoti është merita dhe respekti më i madh, iniciativa duhet të braktisë dëshirat e tij apo të saj për kërkesat e

Zotit, të Vërtetit.

Tasavufi kërkon respektimin me rreptësi të të gjitha detyrimeve fetare, një mënyrë jetese të thjeshtë dhe heqjen dorë nga dëshirat trupore. Përmes kësaj metode të vetëdisiplinimit shpirtëror, zemra e individit është pastruar dhe ndjenjat dhe aftësitë e tij ose të saj janë punësuar në rrugën e Zotit, çka nënkupton që tani udhëtari i rrugës shpirtërore të tasavufit mund të fillojë të jetojë në një nivel shpirtëror të caktuar.

Tasavufi gjithashtu i lejon individët, përmes adhurimit të vazhdueshëm për Zotin, të thellojnë dijet e tyre për vetveten si adhurues të Zotit. Përmes heqjes dorë nga kjo botë materiale dhe kalimtare, si edhe nga dëshirat dhe emocionet që ajo krijon, ata zgjohen me realitetin e një bote tjetër, e cila është kthyer drejt emrave të bukur hyjnorë të Zotit. Tasavufi lejon që individët të shfaqin dimensionin moral të ekzistencës së tyre dhe mundëson përftimin e një përvoje të fuqishme dhe bindëse që buron nga zemra për normat e besimit që ata më parë vetëm i kanë pranuar në mënyrë sipërfaqësore.

XHIHADI,
TERRORIZMI,
TË DREJTAT E NJERIUT

TË DREJTAT E NJERIUT NË ISLAM

Islami është i ekuilibruar, i hapur dhe universal, në fushën e të drejtave të njeriut. Përjashtuar ata që përpiqen të shkatërrojnë shtetin apo qeverisjen legjitime, ose që i kanë marrë jetën me pahir ndonjërit. Kurani na mëson ne se, që t'i marrësh padrejtësisht jetën një njeriu, është një krim kundër tërë njerëzimit (*shih:* Maide, 32). Një vlerësim i tillë nuk mund të gjendet në ndonjë fe tjetër ose në ndonjë sistem modern dhe po kështu, një vlerësim i tillë i lartë kurrë nuk është dhënë në jetën njerëzore nga ndonjë komision apo organizatë e të drejtave të njeriut. Islami e pranon vrasjen e një personi si vrasjen e të gjithë njerëzimit, sepse vrasja e një njeriu jep idenë që çdo person mund të vritet.

Biri i Ademit, Kabili, është personi i parë në historinë njerëzore që ka derdhur gjak. Megjithëse, emrat e tyre nuk janë përmendur në mënyrë specifike në Kuran apo në Sunet, ne mësojmë nga shkrimet e shenjta të kaluara që një keqkuptim zuri vend në mes dy vëllezërve, Kabilit dhe Habilit, dhe që Kabili padrejtësisht vrau Habilin thjesht për xhelozi, duke hapur, si rrjedhim, një epokë gjakderdhjeje në historinë njerëzore. Për këtë arsye, në një hadith, i Dërguari i Zotit thotë: "*Kur një person është vrarë pa të drejtë, pjesa e mëkatit për këtë vrasje i është kaluar Kabilit, sepse ai ishte i pari që hapi rrugën për vrasjen e padrejtë të krijesave njerëzore.*"[64]

Kjo ngjarje me rëndësi mësimdhënëse është shprehur kështu në Kuran:

Lexoju (Muhamed) atyre qartësisht ngjarjen e dy bijve të

[64] Buhari, *Dijet*, 2; *Enbija*, 1; Muslim, *Kasem*, 27.

Ademit kur të dy flijuan kurbane, nga të cilët njërit iu pranua, ndërsa tjetrit nuk iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) i tha tjetrit: "Unë do të të vras!" Ai (që iu pranua) tha: "Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve dhe nëse ti e zgjat te unë dorën tënde për të më vrarë, unë nuk e zgjas te ti dorën time për të të vrarë; unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve!" (Maide, 27-28)

Në vazhdim është dhënë gjykimi:

... kush e vret një njeri (pa të drejtë), që nuk ka vrarë njeri ose që nuk ka sjellë çrregullim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si të kishte vrarë gjithë njerëzit. E kush shpëton një jetë, është si të kishte shpëtuar jetën e të gjithë njerëzve. (Maide, 32)

Ky parim është universal dhe prandaj është i vlefshëm për të gjitha kohërat. Një tjetër ajet deklaron:

Kushdo që vret një besimtar me qëllim, dënimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i zemëruar me të, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh atij. (Nisa, 93)

Në një tjetër hadith, Profeti ynë shprehet: "*Kush është vrarë duke mbrojtur pronën e vet, është një martir. Kush është vrarë duke mbrojtur gjakun (jetën) e vet, është një martir. Kush është vrarë duke mbrojtur fenë e vet, është një martir. Kush është vrarë duke mbrojtur familjen e vet, është një martir.*"[65] Të gjitha vlerat e përmendura në këtë hadith janë mbrojtur si parime të veçanta në të gjithë sistemet juridike. Këtyre çështjeve u është dhënë rëndësi në librat themelorë që përmbledhin ligjet tona, si të jenë të "domosdoshme." Nga ky kontekst, liria e besimit, jeta, riprodhimi, shëndeti mendor dhe pasuria personale janë elementët më thelbësorë që mund të jenë ruajtur për të gjithë. Islami i sjell të drejtat njerëzore nga këndvështrimi i këtyre parimeve themelore.

Vetëm Islami i nderon krijesat njerëzore me titullin e "zëvendësit të Zotit." Asnjë sistem apo fe tjetër nuk e arrin këtë. Përveç kësaj,

[65] Tirmidhi, *Dijet*, 22; Ebu Davud, *Sunne*, 32.

Islami shpall që, nga ligjet e Zotit, çdo gjë në qiell dhe në tokë është e dobishme dhe në të mirë të njerëzimit nëse përdoret në një rrugë legjitime. Si mundet që një fe që u ka dhënë një rëndësi kaq të madhe të drejtave njerëzore t'i neglizhojë ato qoftë edhe për një njeri të vetëm? (shih gjithashtu: *Islami si fe e mëshirës universale* në këtë libër.)

XHIHADI I VOGËL DHE I MADH [66]

Ç'është xhihadi?

I rrjedhur nga rrënja *xh-h-d*, fjala *xhihad* do të thotë shkrirje e të gjithë forcave si edhe lëvizja drejt një objektivi me të gjitha aftësitë dhe fuqitë dhe qëndresa ndaj çdo vështirësie. Ky përkufizim i fundit për xhihadin është i afërt me kuptimin fetar.

Xhihadi fiton një cilësi të veçantë me ardhjen në Islam: luftë në udhën e Zotit. Ky është kuptimi që përgjithësisht vjen në mendje sot. Xhihadi gjendet në dy fronte: në frontin e brendshëm, domethënë, në vetveten e njeriut dhe në frontin e jashtëm. Lufta e brendshme (xhihadi i madh) është procesi i mundësimit të dikujt për të arritur esencën e tij ose të saj. I pari është bazuar në kapërcimin e pengesave ndërmjet vetvetes dhe esencës së saj, gjithashtu dhe arritjen e njohurive të shpirtit dhe në fund të fundit, të njohurive hyjnore, dashurisë hyjnore dhe lumturisë shpirtërore. I dyti është bazuar në zhdukjen e pengesave midis njerëzve dhe besimit me qëllim që njerëzit të mund të zgjedhin lirisht ndërmjet besimit dhe mosbesimit. Në një vlerësim, xhihadi është qëllimi për krijimin tonë dhe detyra jonë më e rëndësishme. Në të kundërt, Zoti nuk do të kishte dërguar profetë me këtë detyrë.

Është një hendek ndërmjet atyre që qëndrojnë prapa me një shfajësim të vlefshëm dhe atyre që vazhdimisht janë në xhihad:

Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që qëndrojnë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe me jetën e tyre. Allahu i ngre një shkallë më lartë ata që luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që

[66] Ky artikull mbështetet në veprat e autorit, *Cihad veya Ilayi Kelimetullah*.

ndenjën në shtëpitë e veta. Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi, por ka dalluar ata që luftuan ndaj atyre që ndenjën, me shpërblim të madh. (Nisa, 95)

Profeti Muhamed (s.a.s.) thotë: *Qëndrimi në roje një ditë për të mbrojtur kufirin për hir të Zotit është mbi gjithçka në këtë botë dhe çdo gjë në të. Vendi i vogël që ju mbani (në rrugën e Zotit) në qiell është mbi gjithçka në këtë botë dhe çdo gjë në të. Një mbrëmje ose një mëngjes patrullim në udhën e Zotit është mbi gjithçka në këtë botë dhe çdo gjë në të.*[67]

Llojet e xhihadit

Xhihadi i vogël nuk është kufizuar në frontin e luftës, sepse për këtë arsye horizonti i tij do të ishte shumë i ngushtë. Në fakt, xhihadi i vogël ka një kuptim dhe aplikim të tillë të gjerë që nganjëherë një fjalë apo heshtje, një buzëqeshje apo qëndrim i vrenjtur, largimi apo hyrja në tubim - më shkurt, gjithçka bëhet për hir të Zotit - dhe disiplinimi i dashurisë dhe zemërimit në përputhje me aprovimin e Tij është përfshirë në të. Në këtë mënyrë, të gjitha përpjekjet për të reformuar shoqërinë dhe njerëzit janë pjesë e xhihadit, siç është çdo përpjekje për familjen, të afërmit, fqinjët dhe fenë tuaj.

Nga një pikëpamje, xhihadi i vogël është material. Xhihadi i madh, ndonëse është drejtuar në frontin shpirtëror, është lufta jonë me botën tonë të brendshme dhe me frymën trupore (*nefs, ego).* Kur të dy xhihadet janë zbatuar me sukses, është vënë ekuilibri i dëshiruar. Nëse mungon njëri prej tyre, balanca është prishur.

Besimtarët gjejnë paqe dhe vitalitet në një xhihad të tillë të ekuilibruar. Ata e dinë që do të vdesin në momentin e mbarimit të xhihadit të tyre. Besimtarët, si pemët, mund të jetojnë vetëm për sa kohë ata japin fryte. Në fakt, kur një pemë nuk prodhon më fruta, ajo thahet. Vëzhgoni pesimistët dhe do të vini re që ata nuk përpiqen për të luftuar apo shpjeguar të Vërtetën për

[67] Buhari, *Xhihad*, 142; Tirmidhi, *Fedai'u'l-Xhihad*, 25.

të tjerët. Prandaj Zoti e ndërpret bekimin e Tij për ta, duke i lënë në të ftohtin dhe errësirën e tyre të brendshme. Por ata që vazhdojnë xhihadin, janë gjithmonë të rrethuar nga dashuria dhe entuziazmi. Botët e tyre të brendshme janë plot dritë, ndjenjat e tyre janë të pastra dhe ata janë në rrugën e përparimit. Çdo luftë stimulon mendimin edhe për një tjetër dhe kështu krijohet një rreth i ligjshëm. Siç ndodh që çdo vepër e mirë bëhet një mbartëse për një vepër të mirë të re, njerëzit e tillë notojnë në mes veprave të mira. Zemrat tona janë vënë në dijeni për këtë të vërtetë:

E ata që luftuan për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët. (Ankebut, 69)

Siç janë shumë rrugë për te Zoti, ashtu janë edhe krijesat. Zoti i drejton ata që luftuan për hir të Tij, të shpëtojnë në një apo më shumë prej këtyre rrugëve. Ai i hap çdokujt rrugët e mirësisë dhe e mbron atë nga rrugët e së keqes. Gjithsecili që gjen rrugën e Tij, Udhën e Drejtë, ka gjetur rrugën e mesme. Po ashtu siç këta njerëz ndjekin një rrugë të mesme në lidhje me zemërimin, inteligjencën dhe lakminë, gjithashtu ata ndjekin një rrugë të mesme në lidhje me xhihadin dhe adhurimin. Kjo do të thotë që Zoti e ka drejtuar njerëzimin në rrugën e shpëtimit.

Xhihadi i vogël është përmbushja jonë aktive e porosive dhe detyrave të Islamit. Xhihadi i madh është shpallja e luftës kundër egos sonë shkatërruese, emocioneve dhe mendimeve negative (shpirtligësisë, urrejtjes, zilisë, egoizmit, mburrjes, arrogancës dhe pompozitetit), të cilat na pengojnë për të arritur përsosmërinë. Ky xhihad shumë i vështirë dhe i mundimshëm është thirrje për xhihadin e madh.

Përgjatë Epokës së Lumtur, njerëzit luftonin si luanë në fushën e betejës dhe, kur binte nata, humbnin vetveten në devocionin për Zotin përmes adhurimit dhe *dhikrit* (përmendja dhe lutjet për Zotin). Këta luftëtarë trima i kaluan jetët e tyre në një qoshe, në adhurim dhe vetmi. Ata e mësuan këtë prej udhërrëfyesit të tyre,

Profetit, një njeri me zemër të madhe që ishte i pari në xhihadin material dhe shpirtëror. Ai i inkurajoi ndjekësit e tij të kërkonin pëlqimin e Zotit, dhe ishte gjithmonë i pari që e bënte këtë.

Ata që kanë sukses në xhihadin e madh do të kenë sukses në xhihadin e vogël. Ata që dështuan në xhihadin e madh do të dështojnë në xhihadin e vogël. Edhe nëse njerëzit e tillë kanë sukses deri në një farë shkalle, ata nuk mund të arrijnë suksesin e plotë.

Aishja tregon:

Një natë i Dërguari i Zotit më pyeti: "Aishe, a mundem ta kaloj këtë natë me Zotin tim?" (Ai ishte aq xhentil sa të kërkonte leje edhe për një gjë të tillë. Fisnikëria dhe përsosja ishin aspektet më të rëndësishme të thellësisë së tij). Unë u përgjigja: "O i Dërguari i Zotit, unë dëshiroj të jem me ty, por nuk e di çfarë të pëlqen më tepër!" Profeti mori abdes dhe filloi lutjen. Ai recitoi: Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt (Al-i Imran, 190). Pas këtij ajeti, ai derdhi lot deri në mëngjes!

Nganjëherë, me qëllim që të mos zgjonte gruan e tij, Profeti ngrihej pa e lajmëruar atë. Aishja tregon përsëri:

Një natë, kur u zgjova, nuk e gjeta të Dërguarin e Zotit. Kur fillova të ngrihem në errësirë, duart e mia prekën këmbët e tij. Ai ishte përkulur në sexhde dhe recitonte diçka. Unë e dëgjova lutjen e tij. Ai thoshte: "Zoti im, unë gjej mbrojtje në mëshirën Tënde nga zemërimi dhe mëria Jote. Unë gjej mbrojtje në faljen Tënde nga ndëshkimi Yt. Zoti im, unë gjej mbrojtje tek Ti nga Ti (mbrojtje në bekimet e Tua nga zemërimi Yt, mbrojtje në hijeshinë Tënde nga madhështia Jote, mbrojtje në mëshirën dhe dhembshurinë Tënde nga sundimi Yt). Unë nuk jam i aftë për lavdërimin Tënd (të merituar). Ti je siç e ke lartësuar Vetveten!"[68]

Kjo ngjarje shpreh qartë thellësinë e brendshme dhe gjerësinë e xhihadit të madh tek Profeti. Në një tjetër hadith, Profeti i

[68] Muslim, *Salat*, 22; Hajtemi, *Mexhmu'l-Zevaid*, 10:124; Tirmidhi, *Davaat*, 81.

përmend të dy xhihadet: *Aty janë dy llojet e syve që kurrë nuk do të shohin zjarrin e ferrit: ushtarët që u sollën si mbrojtës në fushën e betejës dhe ata që qajnë sepse kanë frikë Zotin.* [69]

Xhihadi i atyre që e braktisën gjumin dhe vepruan si roje në kohët më të vështira, është xhihadi material. Sytë e tyre nuk do të jenë subjekt i zjarrit të ferrit. Si dhe ata që bënë xhihadin e madh shpirtëror dhe qajnë nga frika e Zotit, gjithashtu nuk do të shohin torturat e ferrit. Në vend të përsëritjes për çfarë kanë bërë të tjerët, njerëzit duhet të kenë qëllime të mira dhe të ngulisin në zemrat dhe mendjet e tyre vetëdijen për të qenë të sinqertë.

Xhihadi është një balancë për mposhtjen e pengesave të brendshme dhe të jashtme. Arritja e përsosmërisë shpirtërore dhe ndihma për të tjerët, për të ardhur në të njëjtin nivel, kanë një rëndësi shumë të madhe. Arritja e përsosmërisë së brendshme është xhihadi i madh, kurse ndihma për të tjerët për ta arritur atë, është xhihadi i vogël. Kur ju i veçoni nga njëri-tjetri, xhihadi nuk është më xhihad. Plogështia lind nga njëra dhe anarkia nga tjetra. Prandaj, shpirti Muhamedan është rruga e vetme e kthjellimit. Dhe gjithmonë kjo është e mundur vetëm nga ndjekja dhe bindja për të Dërguarin e Zotit. Sa të lumtur janë ata që kërkojnë një rrugë për të shpëtuar të tjerët aq sa ç'kërkojnë për veten e vet! Dhe sa të lumtur janë ata që kujtohen për të shpëtuar veten ndërsa shpëtojnë të tjerët!

[69] Tirmidhi, *Fedaiu'l-Xhihad*, 12.

DASHURIA, TOLERANCA DHE XHIHADI NË JETËN E PROFETIT

Jeta e bekuar e profetit Muhamed, Krenarisë së Njerëzimit, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, ishte thurur me fillin e paqes dhe tolerancës, si të ishte një dantellë e bukur. Si fillim, paqja është fundamentale në Islam. Shumë ajete në Kuran i referohen kësaj çështje. Për shembull, në një prej tyre Profeti është udhëzuar:

Nëse shfaqin prirje për paqe, atëherë edhe ti ano kah ajo e mbështetu tek Allahu, sepse, vërtet Ai dëgjon dhe di gjithçka. (Enfal, 61)

Edhe në një atmosferë në të cilën dy ushtritë kanë luftuar kundër njëra-tjetrës dhe është derdhur gjak, nëse armiku e lë luftën dhe dëshiron marrëveshje, atëherë myslimanët janë urdhëruar të mos reagojnë emocionalisht, por të arrijnë në një kompromis, të tregojnë besimin e tyre te Zoti. Prandaj ka qenë sanksionuar një parim universal në lidhje me këtë çështje. Për pasojë, të flasësh rreth luftës ose konfliktit është plotësisht në kundërshtim me parimet morale të një feje që kërkon me forcë marrëveshje dhe pajtim, jo vetëm në kohë paqeje por, madje, edhe në kohë lufte.

Misioni i Profetit ishte të njoftonte besimin siç ishte urdhëruar prej Zotit. Ai e bëri këtë pa ndonjë paragjykim. Kjo ishte e vërtetë në një shkallë të tillë që, Profeti, ky njeri i dashurisë dhe paqes, bisedonte edhe me jobesimtarët më zemërgurë, siç ishin Ebu Xhehli dhe Ukbe ibn Ebu Mu'azhdi, për shumë kohë pa shfaqur ndonjë zemërim. Ai dëshironte që të gjithë njerëzit të ishin në gjendje të ndjenin parajsën në zemrat e tyre. Ai shpesh herë

thoshte: *Deklaroje që nuk ka hyjni por Zot dhe je i shpëtuar!*[70]

Ajo që synonte ai me këtë, ishte: "Për të arritur kënaqësinë në zemrat tuaja, ndihmoni farën e besimit që ka qenë mbjellë në to për t›u rritur në parajsë dhe siguroni botën tjetër." Njëherë Ebu Xhehli iu përgjigj kësaj ftese pa respekt dhe në mënyrë tallëse: "O Muhamed, nëse je duke e ndërmarrë këtë hap për të na bërë ne dëshmitarë të thirrjes tënde para Zotit, mos më grish në fe përsëri. Unë do të dëshmoj atje!" Ky mosbesimtar gjithmonë përgjigjej pa respekt. Por, me gjithë fyerjet e Ebu Xhehlit, Krenaria e Njerëzimit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, bisedonte rreth Islamit në çdo kohë që ata takoheshin dhe kurrë nuk e ndryshonte qëndrimin e tij shembullor. Fjalët dhe qëndrimet fyese kurrë nuk ndikuan tek ai.

Një ngjarje që tregon për dashurinë e gjerë, dhembshurinë dhe tolerancën e Krenarisë së Njerëzimit për njerëzit, mori jetë gjatë pushtimit të Mekës. Pasi u arrit pushtimi, të gjithë u mblodhën rreth Profetit dhe, duke vështruar në sytë e tij, prisnin që ai të merrte një vendim për fatin e tyre. Pak para momentit të fundit, një grup i vogël midis të cilëve dhe djali i Ebu Xhehlit, Ikrime, kishte kundërshtuar hyrjen e myslimanëve në Mekë. Edhe njëherë, ndjenjat e tyre të dhunës dhe hakmarrjes kishin nxjerrë krye. Në një moment kur atmosfera ishte acaruar së tepërmi, i Dërguari i Zotit i pyeti mekasit që po prisnin me shqetësim: "Çfarë po prisni që të bëj për ju?" Disa nga mekasit që e njihnin mirë se ç'njeri fisnik, i mëshirshëm dhe zemërgjerë ishte ai, nuk u përmbajtën për të shprehur ndjenja e tyre dhe thanë: "Ti je më bujari nga zemërgjerët, më fisniku nga fisnikët!" Qëllimi i Profetit nuk ishte as prona apo pasuria, as sovraniteti apo pushteti, ose pushtimi i vendit. Qëllimi i tij ishte të shpëtonte njerëzit dhe fitimi i zemrave të tyre. Ky njeri i dashurisë dhe mëshirës dha këtë vendim për armiqtë e tij, duke thënë: *Po ju flas si u foli Jusufi vëllezërve të tij. Nuk keni përgjegjësi për veprimet që keni ndërmarrë përpara. Zoti*

[70] Ibni Kethir, *el-Bidaje ve'n-Nihaje*, III, 62-63.

do t' ju falë! Ai është më i Mëshirshmi i të Mëshirshmëve! Shkoni, jeni të gjithë të lirë! [71]

Çfarë nënkuptohej me këtë, mund të shprehet si më poshtë: «Mos vuani nga ndonjë ndëshkim i brendshëm. Unë nuk kam qëllim të dënoj askënd. Qëndrimi i gjithsecilit shpreh karakterin e tij ose të saj. Kjo është mënyra me të cilën unë i trajtoj çështjet.»

Pas kthimit në Medine, Ikrime ibn Ebu Xhehli, i cili kishte derdhur gjak edhe gjatë pushtimit të Mekës, ishte bindur nga gruaja e tij Umu Hakimi të kthehej prej andej nga kishte shpëtuar, dhe ishte shpënë përpara Prijësit të Profetëve, paqja dhe bekimi qofshin mbi të. Përpara se të gjendej në praninë e Profetit, ata që ishin përreth i thanë se nëse do të kërkonte ndjesë, i Dërguari i Zotit do ta falte atë. Sipas të gjitha gjasave, përpara se Ikrime të vinte në prezencën e tij, Profeti i ka këshilluar ata përreth vetes, *"Ikrime është duke ardhur. Mos ia lëndoni ndjenjat duke thënë gjëra të pahijshme për babain e tij."* Sapo Ikrime u fut brenda, i Dërguari tha ngrohtësisht, "Mirë se erdhe, o i arratisuri me anije!" Duke mos i pritur kurrë këto fjalë të mbushura me dashuri dhe afeksion, Ikrime tha: "Për sa do të jetoj, nuk do ta harroj kurrë këtë qëndrim të Profetit!" Katër vjet pasi Ikrime u bë mysliman, u martirizua në Jermuk. Duke pëshpëritur fjalët, "O i Dërguari i Zotit, a e ke gjetur mirësinë që prisje si shpërblim për të këqijat e bëra nga një që emigroi me anije?", ai bashkohej me martirët e tjerë.[72]

Siç e theksova më sipër, thirrja e të Dërguarit ishte misioni i tij për të shfaqur të vërtetat që ai tregonte për të tjerët. Me fjalë të tjera, ishte detyra e tij të praktikonte në jetën e tij gjërat që ai thoshte. Ai gjithmonë e praktikonte një gjë përpara se t'u bënte thirrje të tjerëve për të bërë të njëjtën gjë. Çështjet që ne kemi shpjeguar deri më tani, përmbledhin karakterin e përgjithshëm të Prijësit të Profetëve, paqja dhe mëshira qofshin mbi të. Megjithëse disa përpiqen me të gjithë forcat e tyre ta keqinterpretojnë

[71] El-Iraki, *el-Mugni en Haml'el-Esfar*, III, 179.
[72] Ibni Athir, *Usd el-Xhebe*, III, 567-570; Muttaki el-Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, 13:540-541.

ekzistencën e xhihadit dhe nxitjen për xhihad në Kuranin e Shenjtë dhe në Sunet, ata bien në konflikt me dashurinë dhe mëshirën universale të Profetit tonë. Po, me xhihad mund të kuptohet një luftë e armatosur si një aksion që lidhet me kushte specifike, që nganjëherë është e nevojshme për t'u kryer me qëllim që të mbrohen vlerat e tilla si jeta, prona, feja, fëmijët, atdheu dhe nderi. Gjithashtu nganjëherë është e nevojshme për t'u mbështetur tek lufta, për të larguar pengesat nga udha që drejton në lartësimin e Fjalës së Zotit. Sot këto dy pozita janë vazhdimisht të mjegulluara, nganjëherë janë bërë me synimin për të injoruar dhe nganjëherë qëllimisht. Dashuria, mëshira dhe toleranca, në dimensionet e gjera të tyre, ishin shijuar gjatë Epokës së Lumtur, një periudhë e mbushur me paqe dhe lumturi, një kohë që me fjalët e Profetit ishte, "më i bukuri i shekujve." Si një çështje në fakt, kjo periudhë përfaqëson kulmin e qytetërimit Islam. Ishte një kohë e artë kur paqja, dashuria dhe mirëkuptimi kishin zënë pozitat e vërteta në shoqëri.

MYSLIMANËT E VËRTETË NUK MUND TË JENË TERRORISTË [73]

Islam, në kuptimin e mirëfilltë, do të thotë "nënshtrim." Islami është feja e kënaqësisë, sigurisë dhe paqes. Këto principe janë aq të zakonshme në jetën e myslimanëve sa, kur ata sapo fillojnë lutjet, shkëpusin të gjitha lidhjet me botën, përkulen dhe shtrihen para Zotit dhe atëherë qëndrojnë me duart e tyre shtrënguar në respekt. Kur ata lënë lutjen, është sikur kanë filluar një jetë të re. Ata e përfundojnë lutjen duke përshëndetur të tjerët në të majtë dhe në të djathtë të tyre dhe duke u uruar atyre shëndet, siguri dhe paqe, ngrihen, shkojnë dhe bashkohen me njerëzit e tjerë.

Përshëndetja e të tjerëve dhe urimi i tyre për paqe janë konsideruar të jenë mes akteve më të pëlqyeshme që mund të kryen në Islam. Në të vërtetë, kur Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ishte pyetur se "cili ishte veprimi më i pëlqyeshëm në Islam", ai përgjigjej: "Dhënia e ushqimit për të tjerët dhe përshëndetja e të gjithë atyre që njihni dhe nuk njihni."[74]

Akuzat për terrorizëm

Është e turpshme që Islami, i cili është bazuar në këto parime, është parë nga të tjerët si i njëjtë me terrorizmin. Ky është një gabim i madh historik. Siç treguam më sipër, nëse një sistem i bazuar në paqen dhe sigurinë njësohet me terrorizmin, kjo tregon vetëm që njerëzit akuzojnë pa e njohur thelbin e Islamit dhe janë të paaftë për ta zotëruar atë në shpirtrat e tyre. Islami duhet kërkuar përmes

[73] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *Turkish Daily News*, September, 19, 2001.
[74] Buhari, *Isti'zan*, 9, 19; Nesai, *Iman*, 13.

burimeve të tij dhe përfaqësuesve të vërtetë përgjatë historisë, jo përmes veprimeve të një minoriteti të vogël që e shtrembëron atë. E vërteta është që në Islam nuk ka fanatizëm apo detyrim. Islami është feja që përshkohet plotësisht nga mirëkuptimi dhe toleranca. Mbështetës të tillë të dashurisë dhe tolerancës siç janë Rumiu, Junus Emre, Ahmed Jesevi, Bediuzamani, dhe shumë figura të tjera, e kanë shfaqur këtë aspekt të Islamit në formën më të admirueshme dhe kanë mbetur në histori si shembuj të këtij afeksioni dhe tolerance.

Xhihadi në Islam

Xhihadi është një element i Islamit, i cili së pari përkufizohet si lufta e brendshme e një besimtari kundër gjithçkaje që qëndron midis tij dhe Zotit. Një aspekt i xhihadit, në njërin krah, është bazuar në ca parime specifike me synimin për të zhdukur të gjitha pengesat për të mbrojtur dhe lartësuar emrat e Zotit. Ne mund të citojmë shumë shembuj përgjatë historisë në lidhje me këtë çështje. Do të ketë gjithmonë luftë; ky është një realitet i pashmangshëm për jetën njerëzore. Ndonëse, ajetet në Kuran në lidhje me kushtet specifike të xhihadit janë keqinterpretuar nga të tjerët dhe janë kuptuar si qëllime fundamentale të Islamit. Në thelb, këta njerëz që kanë dështuar për të depërtuar në esencën e vërtetë të Islamit, janë të paaftë për të vendosur një balancë midis së përgjithshmes dhe çështjeve anësore dhe kjo lidhet me faktin që ata janë rrënuar nga urrejtja që i ka çuar në keqinterpretimin e Islamit. Zemra e një bashkësie të vërtetë Islame është e mbushur me dashuri dhe mëshirë për të gjithë krijimin.

Dashuria lidhet me ekzistencën

Profeti Muhamed, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ishte një njeri i mëshirshëm. Ai ishte gjithashtu i njohur si "habibullah," që vjen nga fjala "habib," kuptimi i së cilës është "ai që dashuron Zotin

dhe është i dashuruar prej Zotit." Mistikët e tillë si Imam Rabani, Mevlana Halid dhe Shah Velijullahu deklaronin që shkalla më e lartë është kjo dashuri.

Zoti e krijoi tërë qenien plotësisht me dashuri dhe Islami e ka qëndisur me delikatesë këtë dashuri. Me fjalët e një mistiku tjetër të madh, dashuria është shkaku i ekzistencës së krijimit. Sigurisht, që me gjithë këto, ne nuk mund të mohojmë që gjendet një element i dhunës në Islam; ai është në emër të frikësimit. Ndonëse disa njerëz i kanë gjuajtur këta elementë, të cilët duhet të jenë dytësorë, duke i konsideruar si të ishin fundamentalë për Islamin, Islami i vërtetë apelon për paqe. Një herë një miku im që kishte të njëjtat mendime, më tha mua, "Ju flisni me gjithsecilin pa imponuar ndonjë kufizim. Ky është një largim i tensionit metafizik që ne kemi, meqë kemi mësuar që në përputhje me Islamin, duhet të shfaqim armiqësinë tonë për ca njerëz, në emër të Zotit." Në të vërtetë, ky mendim buron nga interpretimi i gabuar i kësaj ideje. Sipas Islamit, gjithçka është krijuar për të qenë e dashur në emër të Zotit. Çfarë është për t'u urryer dhe për çfarë ne mund të tregohemi armiqësorë, janë mendimet, ndjenjat e ndyra dhe të pamoralshme dhe blasfemia. Zoti i solli njerëzit si qenie të dashura (*shih.* Isra, 70) dhe mund të thuhet që gjithsecili është i bekuar me këto cilësi në shkallë të ndryshme. Ndërsa kalonte funerali i një hebreu, Profeti i Zotit ndaloi për të treguar respektin e tij. Kur ia kujtuan se njeriu që po varrosej ishte një hebre, ai u përgjigj: "Megjithatë, ai është njeri!" Ai demonstronte vlerat që Islami i dha njerëzimit!

Po, ky ishte tregues i respektit të Profetit tonë për njerëzit. Arsyet që disa myslimanë apo institucione islame që e kuptojnë gabim Islamin, janë përfshirë në sulme terroriste anembanë botës, duhet të kërkohen jo në Islam, por brenda vetë njerëzve, në keqinterpretimin e tyre dhe në faktorë të tjerë. Ashtu siç Islami nuk është një fe e terrorizmit, çdo mysliman që e kupton drejt atë, nuk mund të jetë ose të bëhet një terrorist.

Edhe nëse këto janë natyrisht përjashtime, interpretimet e Islamit nga dijetarët turq janë tolerante. Nëse ne mund ta përhapim kuptimin e Islamit, të mbajtur nga shtyllat e mëshirës si Rumiu dhe Junus Emre, anembanë botës dhe, nëse ne mund ta sjellim mesazhin e tyre të dashurisë, dialogut dhe tolerancës, për njerëzit që janë të uritur për këtë mesazh, atëherë njerëzit nga e gjithë bota do të vijnë duke vrapuar në armatën e kësaj dashurie, paqeje dhe tolerance që ne përfaqësojmë.

Toleranca e Islamit është aq e gjerë, sa që Profeti i ndalonte veçanërisht njerëzit që të flisnin për gjërat që mund të ishin fyese. Pavarësisht nga përpjekjet sakrifikuese të Profetit Muhamed, Ebu Xhehli nuk arriti të bëhej mysliman dhe vdiq jashtë feje. Prej këtej, emri Xhehl nënkuptohet injorant. Ky njeri injorant dhe i vrazhdë e kaloi të gjithë jetën e tij si një armik i Profetit dhe tani, në mënyrë të trishtueshme, nofka e tij është bërë natyra e dytë e myslimanëve të sotëm. Pak pas pushtimit të Mekës, djali i Ebu Xhehlit, Ikrime, filloi të fliste në këshill kundër babait të tij dhe për këtë u qortua rëndë nga Profeti.

Respekti për njerëzit

Një tjetër hadith shpjegon pse ne nuk duhet të jemi jotolerantë me të tjerët. Profeti i këshillonte bashkëpunëtorët e tij të mos mallkonin prindërit e tyre. Bashkëpunëtorët e tij kureshtarë e pyetën pse ndokush nuk mund të shante prindërit e një tjetri. Profeti u përgjigj që, nëse dikush shan prindërit e një tjetri, atëherë ai person do të merrte hak në të njëjtën mënyrë, për pasojë, ky dikushi po shante prindërit e vet!

Ndërsa Profeti gjithmonë shfaqte respekt për të tjerët, fakti që sot njerëzit janë duke thënë që Islami është lëndues për të tjerët, do të thotë që ata nuk kanë kuptuar drejt Profetin. Nuk ka asnjë hapësirë për urrejtje ose armiqësi, si në Islam ashtu edhe në botën universale të përfaqësuesit të tij Muhamed, paqja dhe mëshira

qofshin mbi të!

Shërbëtorët e Zotit

Kurani është mbështetur plotësisht në mirëkuptimin dhe tolerancën.

…të cilët japin kur janë në kamje dhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllefin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit. (Al Imran, 134)

Është e nevojshme që ta vështrojmë këtë në imtësi. Ju mund të përfshiheni në një incident dhe për pasojë do t'ju vlojë gjaku. Për shembull, njerëzit mund t'ju mallkojnë dhe fyejnë ju. Por ju duhet të përpiqeni në mënyrë të skajshme të ruani gjakftohtësinë dhe të mos reagoni. Kurani e përshkruan në ajetin e mësipërm se si njerëzit me moral të shëndoshë duhet të sillen edhe në momentet kur ju dëshironi të humbni përmbajtjen tuaj. Fjalët arabisht nga ky pasazh kanë shumë domethënie. "*Kadhm*" do të thotë, gëlltisni çfarë nuk mund të jetë e gëlltitshme, ndërsa *Kadhim* nënkupton dikë që kapërdin zemërimin e tij. Në një tjetër pasazh, Zoti i urdhëron besimtarët t›i shmangen mendjemadhësisë:

(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur kalojnë pranë së keqes, e ruajnë dinjitetin e vet. (Furkan, 72)

Modeli islam

Profeti praktikonte gjithçka që ishte treguar në Kuran. Për shembull, dikush vinte dhe pranonte shkeljen e kurorës bashkëshortore duke kërkuar të pastrohej nga mëkatet e tij, cilido që të ishte ndëshkimi. Profeti i thoshte atij: *"Shko në shtëpi dhe pendohu. Nuk ka mëkat që Zoti nuk e fal."*[75] Një tjetër hadith tregon se si një person akuzoi një tjetër për vjedhje. Vetëm kur po afrohej momenti për të dhënë ndëshkimin, njeriu ndërroi mendje dhe e

[75] Muslim, *Hudud*, 17, 23; Buhari, *Hudud*, 28.

fali vjedhësin, vendim për të cilin Profeti i tha: *"Pse nuk e fale atë që në fillim?"*[76]

Prandaj, kur të gjithë këta shembuj janë parë në imtësi, mund të vështrohet që metoda e adoptuar nga ata që i trajtojnë të tjerët me urrejtje dhe armiqësi, nuk ka vend në Islam. Siç u tregua më sipër, Islami është një fe e dashurisë dhe tolerancës. Myslimanët janë adhuruesit e dashurisë dhe mëshirës, njerëz që u shmangen të gjitha akteve terroriste dhe kanë pastruar trupat e tyre nga të gjitha format e urrejtjes dhe armiqësisë.

[76] Ebu Davud, *Hudud*, 14 (4394); Nesai, *Sarik*, 4 (8, 68); Muvatta, *Hudud*, 28 (2, 834).

SULMET E FUNDIT TERRORISTE [77]

Myslimanët duhet të deklarojnë: «Në Islam nuk ka terror!»

Sot, më e pakta që mund të themi është se, Islami nuk njihet nga të gjithë. Myslimanët duhet të deklarojnë: «Në Islam nuk ka terror!» Në Islam, vrasja e një njeriu është një akt i barabartë me rrezikshmërinë për *kufr* (mosbesimi në Zot). Asnjë person nuk mund të vrasë një krijesë njerëzore. Asnjë person nuk mund ta ngacmojë një person tjetër të pafajshëm, madje edhe në kohë lufte. Asnjë nuk mund të japë një *fetva* në këtë fushë. Asnjë nuk mund të jetë një granatier vetëvrasës (kamikaz). Asnjë nuk mund të vrapojë në mes turmave me njerëz, me bomba lidhur në trupin e tij. Pakujdesia e treguar ndaj fesë së njerëzve në këto turma, nuk është nga ana fetare e lejueshme. Edhe në kohë lufte - gjatë së cilës është e vështirë të mbash balancat - kjo nuk është e lejuar në Islam. Islami deklaron: «Mos prekni fëmijët ose njerëzit që luten në kishë!» Kjo nuk është thënë vetëm një herë, por është përsëritur vazhdimisht gjatë gjithë historisë. Ç'thoshte mjeshtri ynë, Profeti Muhamed, ç'thoshte Ebu Bekri dhe ç'thoshte Omeri, është e njëjtë me çfarë kanë thënë gjithashtu në kohët e mëvonshme Salahadin Ejubi, Alparslani dhe Këllëçarslani. Pastaj të njëjtën gjë tha dhe Sulltan Mehmeti II, triumfuesi. Në këtë mënyrë, qyteti i Kostandinopojës, në të cilin sundonte kaosi dhe shthurja, u bë Stambolli. Në këtë qytet grekët nuk i dëmtuan armenët dhe po ashtu as armenët nuk u sollën të këqija grekëve. As myslimanët nuk dëmtuan asnjë njeri nga popullsitë e tjera. Pak pas pushtimit të Kostandinopojës, njerëzit e qytetit varën një portret të stërmadh të

[77] Ky tekst është nxjerrë nga intervista e Gylenit dhënë gazetares Nurije Akman, botuar në gazetën *Zaman* në datat 22 mars-1 prill 2004.

triumfuesit në murin që i përkiste Patriarkanës. Është e çuditshme që një qëndrim i tillë ishte shfaqur në atë kohë. Atëherë, siç tregohet në histori, Sulltani e thirri Patriarkun dhe i dha çelësat e qytetit. Edhe sot, patrikana e kujton këtë gjest me respekt. Por sot, Islami, si në çdo pikë tjetër, nuk është kuptuar saktë. Islami gjithmonë ka respektuar idetë e ndryshme dhe nëse është kuptuar kjo, atëherë kemi të bëjmë me një vlerësim të drejtë.

Me keqardhje po them që në vendet ku jetojnë myslimanët, disa udhëheqës fetarë dhe myslimanë të papjekur nuk kanë armë tjetër në duar veç interpretimit fundamentalist të tyre për Islamin. Ata e shfrytëzojnë këtë për të hedhur njerëzit në luftëra që u shërbejnë interesave të tyre. Në fakt, Islami është një besim i vërtetë, dhe duhet jetuar besnikërisht. Në rrugën për arritjen e besimit nuk mund të përdoren kurrë metoda të rreme. Në Islam, ashtu siç një qëllim mund të jetë i ligjshëm, po ashtu duhet të jenë të gjithë mjetet që përdoren për ta arritur atë. Nga kjo perspektivë, askush nuk mund ta fitojë parajsën duke vrarë një person tjetër. Një mysliman nuk mund të thotë, "Unë do të vras një njeri dhe atëherë do të shkoj në parajsë." Pëlqimi i Zotit nuk mund të fitohet duke vrarë njerëz. Një prej qëllimeve më të rëndësishme për një mysliman është të arrijë pëlqimin e Zotit, tjetri është për të bërë emrat e Zotit të Gjithëfuqishëm të njohur për universin.

Rregullat e Islamit janë të qarta. Individët nuk mund të shpallin luftë. Një grupim apo një organizatë nuk mund të deklarojë luftë. Lufta shpallet nga shteti. Lufta nuk mund të shpallet pa një president apo një ushtri, duke deklaruar së pari që jemi në luftë. Ndryshe, ky është një akt terrori. Një rast lufte i tillë është krijuar nga grumbullimi rreth vetes, më falni për gjuhën time, i pak banditëve. Një tjetër person duhet të mbledhë të tjerë rreth vetes së tij. Nëse njerëzit do të shpallnin luftë individualisht, atëherë kaosi do të mbizotëronte, sepse për dallime kaq të vogla, një front lufte mund të jetë krijuar edhe në mes njerëzve me mendim të shëndoshë. Disa njerëz mund të thonë: "Unë shpall luftë kundër

aksh personi." Një njeri që është tolerant me Krishtërimin mund të jetë akuzuar si në vijim: "Ky njeri ndihmon Krishtërimin dhe dobëson Islamin. Kundër tij duhet të shpallet luftë dhe ai duhet të vritet." Si rezultat është shpallur luftë. Për fat, shpallja e luftës nuk është kaq e thjeshtë. Nëse shteti nuk deklaron luftë, asnjë tjetër nuk mund ta nisë atë. Kushdo që nuk e kupton këtë, edhe nëse ata janë dijetarë, të cilët unë i admiroj, nuk mund të zhvillojë një luftë të vërtetë. Kjo është kundër frymës së Islamit. Normat e paqes dhe të luftës në Islam janë parashtruar qartë.

Nuk ekziston ndonjë botë islame

Sipas opinionit tim, një botë islame nuk ekziston realisht, por në botë ka vende ku jetojnë myslimanët. Në disa vende ka më shumë myslimanë dhe në disa të tjera, më pak. Islami është një mënyrë jete, një kulturë, nuk është ndjekur si një besim. Myslimanët e kanë ristrukturuar Islamin në përputhje me idetë e tyre. Unë nuk u referohem radikalëve, myslimanëve ekstremistë, por myslimanëve të thjeshtë që e jetojnë Islamin siç u përshtatet ai atyre. Kusht i domosdoshëm në Islam është besimi i «vërtetë» dhe jeta në përputhje me të. Myslimanët duhet të marrin përgjegjësi të natyrshme në Islam. Nuk mund të thuhet që ndonjë shoqëri e tillë me këtë koncept dhe filozofi ekziston brenda gjeografisë islame. Nëse ne themi që ata ekzistojnë, atëherë këto janë shpifje për Islamin. Nëse ne themi që Islami nuk ekziston, edhe kjo është shpifje. Unë nuk mendoj që myslimanët do të jenë në gjendje të kontribuojnë shumë për ekuilibrin e botës në të ardhmen e afërt. Unë nuk i shoh drejtuesit tanë që ta kenë këtë vizion. Bota islame është injorante, pavarësisht nga një ndriçim i ngadalshëm që po vjen në ditët e sotme. Ne mund ta vëzhgojmë këtë fenomen gjatë haxhit. Ne mund ta shohim këtë nëpër konferenca dhe tek drejtuesit e saj. Gjithashtu në parlamentet e tyre përmes televizionit. Është një parregullsi serioze në çështje të rëndësishme. Ata, myslimanët,

nuk mund të zgjidhin problemet e botës. Ndoshta mund ta arrijnë këtë gjë në të ardhmen!

Sot është Islami individual për disa myslimanë në vende të ndryshme të botës. Hap pas hapi ata janë ndarë nga njëri-tjetri. Unë personalisht nuk e shoh ndonjërin të jetë mysliman i përsosur. Nëse myslimanët nuk janë të aftë të kontaktojnë me njëri-tjetrin dhe të krijojnë një bashkim, të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet e përbashkëta, për të interpretuar universin, për ta kuptuar atë më mirë, për ta shqyrtuar universin me kujdes në përputhje me Kuranin, për ta interpretuar të ardhmen më drejt, për të krijuar projekte për të ardhmen, për të përcaktuar vendin e tyre në të ardhmen, atëherë unë nuk mendoj që ne mund të bisedojmë rreth një bote islame. Meqenëse nuk ka një botë islame, gjithsecili vepron individualisht. Madje mund të thuhet që disa myslimanë kanë bindjet e tyre personale. Nuk mund të deklarohet që ka një konceptim islam, i cili ka qenë sipas marrëveshjes i aprovuar nga studiues të kualifikuar, mbështetur me besimin në Kuran dhe i testuar në mënyrë të përsëritur. Më saktë, mund të thuhet që është mbizotëruese një kulturë myslimane, se sa një kulturë islame. Ajo ka ekzistuar që prej shek. XI. Ka filluar me periudhën abasite dhe shfaqjen e selçukëve. Është rritur pas pushtimit të Stambollit. Në periudhat në vazhdim, dyert për interpretime të reja janë mbyllur. Horizontet e mendimit janë kufizuar. Zemërgjerësia që ishte në shpirtin e Islamit është ngushtuar. Shumë njerëz të paskrupullt filluan të shfaqen në botën islame, njerëz që ishin të rrezikshëm, që nuk mund t'i pranonin të tjerët, që nuk mund ta hapnin vetveten për çdo njeri tjetër. Ky kufizim ishte hasur gjithashtu edhe në shkollat mistike. Është e trishtueshme që madje ishte i pranishëm edhe në *medresetë.* Dhe sigurisht, të gjithë këto dogma dhe interpretime kanë nevojë për rishikim dhe rinovim nga njerëzit e edukuar në fushat e tyre.

Rrjeti el-Kaide

Një prej njerëzve që unë urrej më shumë në botë, është Osama Bin Laden, sepse ai ka nxirë pamjen e ndritshme të Islamit. Ai ka krijuar një imazh të njollosur. Edhe nëse ne përpiqemi me më të mirën tonë për të rregulluar dëmin e tmerrshëm që ai ka sjellë, do të duhen shumë vite për ta korrigjuar.

Ne flasim rreth kësaj mbrapshtie kudo, në shumë tribuna të ndryshme. Ne shkruajmë libra për të. Ne themi, "ky nuk është Islam." Bin Ladin zëvendëson logjikën islame me ndjenjat dhe dëshirat e tij. Ai është një monstër, siç janë edhe njerëzit përreth tij. Nëse njerëzit ngado janë të ngjashëm me të, atëherë ata gjithashtu, nuk janë asgjë më shumë se monstra.

Ne e dënojmë këtë qëndrim të Ladenit. Ndonëse, rruga e vetme për të ndaluar këtë mënyrë të vepruari është që myslimanët duke jetuar në vendet që ngjajnë të jenë islamike - dhe në fillim unë deklarova që nuk perceptoj një botë islame, por janë vetëm vende në të cilat myslimanët jetojnë - të zgjidhin problemet e tyre.

A duhet të mendojnë ata në një mënyrë plotësisht të ndryshme kur zgjedhin udhëheqësit e tyre? Ose a duhet që ata të zbatojnë reforma fundamentale? Për rritjen e një brezi të ri të edukuar ashtu siç duhet, myslimanët duhet të punojnë për të zgjidhur problemet e tyre. Jo vetëm problemet e tyre për çështjen e terrorit, një instrument që sigurisht nuk aprovohet nga Zoti, por gjithashtu dhe për sa i përket drogës dhe duhanit, dy nga gjërat e ndaluara prej Zotit. Mosmarrëveshjet, trazirat civile, varfëria pa fund, turpi për të qenë i qeverisur nga të tjerët dhe të qenët i fyer pas formimit të qeverisë nga fuqitë e huaja, janë të gjitha probleme që mund t'i jenë shtuar listës.

Siç ka thënë Mehmet Akif Ersoj, skllavëria, mizoritë e vështirësive, narkomania, pranimi i gjërave jashtë karakterit dhe vënia në lojë e të tjerëve, janë të gjitha të pranishme midis nesh. Ato janë mallkime për Zotin dhe së pari kanë zënë vend në

kombin tonë. Kapërcimi i këtyre, në opinionin tim, varet në të qenit një krijesë njerëzore e vërtetë dhe e devotshme për Zotin.

Përgjegjësitë tona

Është dobësia jonë, është dobësia e kombit. Është dobësia e edukimit. Një mysliman i vërtetë që e ka kuptuar Islamin në çdo aspekt, nuk mund të jetë terrorist. Është e vështirë për një person që të mbetet një mysliman nëse ai është përfshirë në terrorizëm. Feja nuk e pranon vrasjen e njerëzve me qëllim arritjen e një objektivi.

Por, sigurisht, çfarë përpjekjesh duhet të bëjmë ne që këta njerëz t›i ngremë në nivelin e një krijese të përsosur? Me çfarë elementesh duhet t'i pajisim ata? Çfarë përgjegjësish marrim ne për edukimin e tyre dhe, kështu, tani të presim që ata të mos përfshihen në terror?

Njerëzit mund të jenë mbrojtur nga përfshirja në terrorizëm prej domethënieve të disa virtyteve që burojnë në besimin Islam, siç janë, frika për Zotin, frika për Ditën e Gjykimit dhe frika për kundërshtimin e parimeve të fesë. Ndonëse, ne nuk e kemi ndjeshmërinë e duhur për këtë çështje. Përpjekjet deri më sot kanë qenë të vogla për ta trajtuar këtë temë të harruar. Por, fatkeqësisht, janë disa pengesa të vëna në këtë rrugë nga bashkëkombësit tanë.

Disa tregojnë llojin e aktiviteteve që nuk duhen lejuar. Kjo do të thotë se nëpër shkolla dhe institucione edukative duhet të zbatohen metoda mësimore dhe edukative për kulturën dhe moralin. Në të njëjtën kohë, ne luftojmë që çdo kërkesë e jetës duhet të njihet në shkollë. Edukimi i shëndoshë duhet të jetë siguruar nga specialistët e edukimit. Klasifikimet në lidhje me jetën në përgjithësi dhe jetën në shtëpi duhet të bëhen të kuptueshme në shkollë.

Njerëzit duhet të udhëzohen se si ta kalojnë jetën në harmoni bashkëshortore dhe si të rrisin fëmijët e tyre. Por problemi nuk mbaron këtu. Turqia dhe vendet e tjera që kanë një popullsi të

madhe myslimane, vuajnë nga abuzimi me drogën, bixhozi dhe korrupsioni. Nuk gjendet pothuajse asnjeri në Turqi që të mos jetë përfshirë në ndonjë skandal. Disa qëllime që ishin menduar për t'u arritur, janë finalizuar. Akoma shumë objektiva të tjerë nuk janë konkretizuar. Ju nuk mund të hetoni asnjeri në lidhje me këtë. Ju nuk mund të akuzoni njeri për përfitime. Ata janë të mbrojtur dhe në këtë mënyrë janë lënë në punën e tyre.

Këta janë njerëzit që rriten midis nesh. Të gjithë ata janë fëmijët tanë. Pse disa prej tyre marrin rrugë të shtrembër? Pse disa rriten si tiranë? Pse ka disa nga ata që rebelohen kundër vlerave njerëzore? Pse vijnë në vendin e tyre dhe e hedhin veten në erë si kamikazë?

Të gjithë ata ishin madhuar në mes nesh. Prandaj, edukimi i tyre ka qenë i gabuar. Kjo do të thotë që sistemi edukativ mund të ketë disa mangësi, disa pika të dobëta që është e nevojshme të ekzaminohen. Është e domosdoshme që këto dobësi të eliminohen. Më shkurt, rritjes së krijesave njerëzore nuk i është dhënë prioritet. Ndërkaq, disa gjenerata kanë humbur dhe janë shkatërruar.

Rinia e pakënaqur ka humbur spiritualitetin. Disa njerëz kanë përfituar prej tyre duke i blerë me dollarë ose duke i kthyer në robotë. Ata i kanë droguar. Ky është lajmi i parë në të gjitha gazetat që mund të lexojmë këto ditë. Me këta të rinj është abuzuar në atë shkallë sa ata janë manipuluar. Ata janë shfrytëzuar si vrasës me pretekstin e disa idealeve apo qëllimeve të çmendura. Disa njerëz keqdashës kanë dashur të arrijnë ca synime duke abuzuar me këta të rinj.

Këta njerëz janë kthyer në robotë. Një kohë, shumë njerëz u vranë në Turqi. Grupet e ndryshme të formuara me qëllime dhe synime të ndryshme, vrisnin njëri-tjetrin. Më 12 mars të vitit 1971, gjithsecili ishte përfshirë në një luftë të përgjakshme. Forcat ushtarake erdhën dhe intervenuan. Më 12 shtator 1980 populli u përfshi në një tjetër gjakderdhje. Njerëzit vrisnin njëri-tjetrin.

Disa njerëz u përpoqën të arrijnë një qëllim duke vrarë të tjerët.

Gjithsecili ishte një terrorist. Njerëzit e njërit krah ishin terroristë, edhe ata në krahun tjetër ishin terroristë, ndërkaq që çdokush e etiketonte të njëjtin veprim ndryshe. Një person do të thoshte: "Unë po veproj në emër të Islamit." Një tjetër do të thoshte: "Unë jam duke luftuar për popullin dhe vendin tim!" Ndërsa një i tretë: "Unë jam ngritur kundër kapitalizmit dhe shfrytëzimit!" Të gjitha ishin vetëm fjalë. Kurani flet rreth këtyre "etiketimeve." Ato nuk kanë vlerë. Por njerëzit vazhduan me vrasje. Çdokush ishte vrarë në emër të një ideali.

Në emër të këtyre "idealeve" të përgjakura u vranë shumë njerëz. Kjo nuk ishte asgjë tjetër veçse terror. Çdo njeri, jo vetëm myslimanët, kishte bërë të njëjtin gabim. Më pas, këto vrasje u bënë një qëllim «i realizueshëm.» Vrasja u kthye në një zakon. Gjithsecili filloi të shfrytëzohej për të vrarë, edhe pse vrasja e një personi tjetër është një akt shumë i dënueshëm. Një herë, një nga miqtë e mi më të afërt, vrau një gjarpër. Ai ishte i diplomuar në teologji dhe tani është predikues. Në shenjë kundërshtimi për këtë veprim, unë nuk fola me të për një muaj. Unë i thashë: «Ky gjarpër ka të drejtë të jetojë në natyrë. Çfarë të drejte ke ti për ta vrarë?"

Por sot gjendemi në një moment të tillë që, nëse 10 apo 20 njerëz janë vrarë, ose nëse numri nuk është aq i lartë sa mendohej, atëherë ata thonë: "Nuk është aq keq, nuk kanë vdekur shumë njerëz!" Kjo dhunë e pabesueshme është e pranueshme për njerëzit në një nivel të tmerrshëm. Ata thonë: "Është pozitive që numri i të vdekurve nuk i kalon 20 apo 30!" Shkurt, e tërë shoqëria e pranon këtë si një pjesë të jetës sonë të përditshme.

Kjo situatë mund të ishte shmangur nëpërmjet edukimit. Ligjet dhe rregullat e shtetit mund ta parandalonin këtë. Disa grupime të parëndësishme që janë mbrojtur, dhe për pasojë nuk mund të jenë ndaluar, janë duke u zmadhuar dhe duke u dhënë rëndësi çështjeve të rëndomta dhe të pavlera. Ka një shërim nga kjo. Shërimi është të mësojmë drejtpërdrejt të vërtetën. Duhet të bëhet e qartë që

myslimanët nuk mund të jenë terroristë. Pse duhet të ndodhë kjo? Sepse njerëzit mund ta kuptojnë që nëse bëjnë diçka të keqe, edhe në qoftë se është e vockël sa një atom, ata do të paguajnë për atë në këtë botë dhe në botën tjetër!

Po, vrasja e një njeriu është diçka shumë domethënëse. Kurani thotë që vrasja e një personi është e njëjtë me vrasjen e të gjithë njerëzve. Ibn Abasi shprehet që një vrasës do të qëndrojë përjetësisht në ferr. Ky është i njëjti dënim që është dhënë edhe për mosbesimtarët. Kjo do të thotë që një vrasës i është nënshtruar të njëjtit dënim si një jobesimtar. Shkurt, në Islam, në momentet e ndëshkimit në Ditën e Gjykimit, një vrasës do të konsiderohet të jetë i ulët po aq sa dikush që ka mohuar Zotin dhe Profetin (një ateist). Nëse ky është një parim themelor i fesë, atëherë ai duhet të mësohet në shkollë.

EDUKIMI

SHËRBIMET EDUKATIVE JANË SHPËRNDARË NË MBARË BOTËN

Përse edukimi?

Shumë është folur dhe shkruar rreth edukimit. Ne do ta propozojmë këtë subjekt nga tre këndvështrime të ndërsjella: human-psikologjik, nacional-social dhe universal.

Ne jemi nën ndikimin serioz të mendimit perëndimor bashkëkohor i cili, pa dyshim, për disa shekuj është superior në shumë aspekte, ndonëse brenda këtij mendimi ka gjithashtu disa defekte që burojnë në veçanti nga periudhat historike përmes të cilave ka kaluar dhe nga kushtet specifike të krijuara prej tyre. Në mesjetë, kur Evropa ishte duke jetuar në një rend shoqëror teokratik të drejtuar nga kisha ose nga monarkët e emëruar nga kisha, mendimi perëndimor takohej me botën islame, veçanërisht përmes Andaluzisë dhe kryqëzatave. Ky ishte njëri prej faktorëve që hapi dyert për lëvizjet reformuese dhe periudhën e rilindjes. Disa nga faktorët e tjerë, siç janë mungesa e hapësirave, varfëria, rrugët për të plotësuar nevojat gjithmonë në rritje dhe fakti që disa vende, si Anglia, ishin natyrisht të prirura për udhëtime detare, kulmojnë në mendimin perëndimor duke u drejtuar në zbulimet përtej detit.

Stimuli i parë për të gjitha këto zhvillime ishte plotësimi i nevojave materiale. Këto zhvillime të shoqëruara me studime shkencore në kundërshtim me kishën dhe pedantizmin e krishterë mesjetar, krijuan një konflikt për evropianët, mes fesë dhe shkencës. Kjo shkaktoi përçarjen midis fesë dhe shkencës

dhe shkëputjen e lidhjeve mes shumë njerëzve dhe fesë. Ky zhvillim, në fund të fundit, çoi në evoluimin e materializmit dhe komunizmit. Në gjeografinë sociale, njerëzimi u përballua me elementët më dramatikë të historisë perëndimore: shfrytëzimin global, konfliktet pa fund bazuar në interesa, dy luftërat botërore dhe ndarjen e botës në blloqe politike apo ekonomike.

Perëndimi e ka mbajtur botën nën kontrollin ekonomik dhe ushtarak për disa shekuj. Në shekujt e fundit, konflikti midis fesë dhe shkencës ka pushtuar shumë qarqe intelektuale. Lëvizjet iluministe që filluan në shekullin e XVIII, i shihnin krijesat njerëzore vetëm nga pikëpamja materiale. Në ndjekje të saj, lëvizjet materialiste dhe pozitiviste i shihnin njerëzit vetëm si entitet material apo fizik. Dhe si rezultat, krizat shpirtërore ndiqnin njëra-tjetrën. Nuk e ekzagjerojmë nëse themi që këto kriza dhe mungesa e kënaqësisë shpirtërore ishin faktori kryesor prapa konfliktit të interesave që pushtoi dy shekujt e fundit dhe arriti kulmin e tij në dy luftërat botërore.

Si posedues të një sistemi besimi me një histori dhe esencë të ndryshme, ne kemi disa vlera dhe koncepte bazë që mund të jenë dhënë, jo vetëm për perëndimin, me të cilat ne kemi lidhje të thella ekonomike, shoqërore dhe ushtarake, por gjithashtu edhe me njerëzimin në një kuptim të gjerë. Në majë të listës është aftësia jonë njohëse dhe koncepti ynë për njerëzimin. Ky vështrim nuk është as ekskluziviteti ynë, por as është një vështrim subjektiv, më saktë, është një vështrim objektiv që nxjerr në pah çfarë janë njerëzit në të vërtetë.

Njerëzit janë krijesa të krijuara jo vetëm nga trupi dhe mendja, jo vetëm nga ndjenjat dhe shpirti. Më drejt, ne jemi një kompozim harmonik i të gjithë këtyre elementëve. Çdonjëri prej nesh është një trup që përpëlitet në një rrjet nevojash. Por kjo nuk është e gjitha. Ne gjithashtu posedojmë një mendje që ka nevoja më të fshehta dhe vitale se trupi dhe çdonjëri prej nesh është nxitur

nga shqetësimet rreth së kaluarës dhe të ardhmes në një kërkim për përgjigjet e pyetjeve të tilla, si «Ç'jam unë? Çështë kjo botë? Çështë synimi i jetës dhe vdekjes? Kush më solli mua në këtë botë dhe pse? Ku jam duke shkuar dhe cili është qëllimi i jetës? Kush është drejtuesi im në këtë udhëtim tokësor?»

Përveç kësaj, çdo person është një krijesë e parapërgatitur me ndjenjat që nuk mund të jenë përmbushur nga mendja dhe një krijesë me shpirt, përmes të cilit ne fitojmë identitetin esencial njerëzor. Çdo individ është një kombinim i të gjithë këtyre faktorëve. Kur një person rreth të cilit sillen të gjitha metodat dhe përpjekjet, është konsideruar dhe vlerësuar si një krijesë me të gjitha këto aspekte dhe kur të gjitha nevojat i janë përmbushur, atëherë ky person është në gjendje të arrijë lumturinë e vërtetë. Në këtë pikë, përparimi dhe zhvillimi i vërtetë njerëzor në lidhje me natyrën tonë esenciale është i mundur vetëm përmes edukimit.

Për ta kuptuar rëndësinë e edukimit, nevojitet që vetëm të vështrojmë një ndryshim midis nesh dhe kafshëve. Në fillim të udhëtimit nga bota e shpirtrave që shtrihet në përjetësi, në vendqëndrimin tokësor, ne jemi të pafuqishëm, në nevojë dhe në pozicion të mjerueshëm nga të qenët i varur në çdo gjë nga të tjerët.

Kafshët, megjithatë, vijnë në këtë botë si të kenë arritur perfeksionin në një botë tjetër. Brenda dy orëve, ose pas dy muajve nga lindja e tyre, ata kanë mësuar pothuajse gjithçka është e nevojshme për të ditur dhe kanë arritur një marrëdhënie të plotë me universin dhe ligjet e jetës. Fuqia për të jetuar dhe aftësia për të punuar që na merr ne 20 vjet për ta fituar, është arritur nga një zog ose bletë në 20 ditë. Më saktë, ata kanë lindur me këtë aftësi dhe forcë. Kjo do të thotë që detyra thelbësore për një kafshë nuk është të bëhet e përsosur përmes mësimit dhe evoluimit nga fitimi i njohurive apo nga kërkimi i ndihmës. Këto gjëra nënkuptojnë një dobësi që nuk është e natyrshme për natyrën e një kafshe. Më

drejt, detyra e një kafshe është të veprojë në përputhje me aftësitë natyrore dhe kjo është mënyra me të cilën i shërben aktivisht Krijuesit të saj.

Në anën tjetër, ne njerëzit duhet të mësojmë gjithçka kur vijmë në këtë botë, sepse jemi të paditur rreth rregullave të jetës. Në fakt, në 20 vjet, ose mbase gjatë gjithë jetës sonë, ne prapë nuk mund ta mësojmë plotësisht natyrën dhe domethënien e normave dhe kushteve të jetës ose nuk mund ta kuptojmë plotësisht lidhjen tonë me universin. Ne jemi sjellë në këtë botë të dobët dhe të pafuqishëm. Për shembull, ne mund të qëndrojmë në këmbët tona vetëm pas një viti. Përveç kësaj, tërë jeta jonë shkon për të mësuar se çfarë është vërtet në interesin tonë dhe çfarë nuk është. Vetëm me ndihmën e një jete shoqërore mund të kthehemi drejt interesave tona dhe të shmangim rrezikun.

Kjo do të thotë që detyra jonë esenciale, si një krijesë që ka ardhur në këtë bujtinë kalimtare me një natyrë të pastër, është të arrijmë qëndrueshmëri dhe qartësi në mendim, imagjinatë dhe besim, me qëllim që ne të mund të fitojmë një "natyrë të dytë" dhe të aftësohemi për të vazhduar jetën tonë në "tjetrën, në botët shumë më të lartësuara." Për më tepër, duke kryer detyrat tona si shërbëtorë, ne duhet të aktivizojmë zemrat, shpirtrat dhe të gjitha aftësitë tona të natyrshme. Nga përqafimi i botëve tona të brendshme dhe të jashtme, ku qëndrojnë misteret dhe enigmat e panumërta, ne duhet të kuptojmë sekretin e ekzistencës dhe kështu të ngrihemi në rangun e një krijese njerëzore të vërtetë.

Konflikti mes fesë dhe shkencës dhe produkti i tij, materializmi, e ka vështruar natyrën, si dhe krijesat njerëzore, si një akumulim material krijuar vetëm për të përmbushur nevojat fizike. Si rezultat, ne jemi duke përjetuar katastrofën e përgjithshme të mjedisit.

Le ta shqyrtojmë këtë pikë. Një libër është një manifestim material, në formën e fjalëve, i një ekzistence "shpirtërore" në mendjen e shkrimtarit. Nuk ka një konflikt midis këtyre dy

mënyrave për të shprehur të njëjtat vërtetësi dhe ide në dy "botë" të ndryshme. Gjithashtu, një ndërtesë ka një ekzistencë shpirtërore në mendjen e arkitektit, ajo ka "fatin" ose "paracaktimin" në formën e një plani, forma materiale është struktura fizike. Nuk ka një konflikt midis rrugëve për shprehjen e të njëjtës domethënie, kënaqësie, dhe të vërtetës për këto tre botë të ndryshme. Të vështrosh për konflikt këtu nuk është asgjë më shumë se një përpjekje e dështuar.

Në të njëjtën mënyrë, nuk ka një konflikt në mes Kuranit, shkrimeve hyjnore, (që vijnë nga atributi i të folurit i Zotit), universit (që vjen nga atributet e Tij për fuqi dhe vullnet), dhe shkencës që i ekzaminon ato. Universi është një libër i shenjtë (Kurani) madhështor që rrjedh nga atributet e Zotit për fuqi dhe vullnet. Me fjalë të tjera, nëse na lejohet të bëjmë një krahasim prozaik, universi është tamam si një Kuran i madh, krijuar nga Zoti në trajtë fizike për përgatitjen tonë. Si rrjedhojë, siç është një shprehje e ligjeve të universit në të njëjtën formë, Kurani është një univers që ka qenë kodifikuar dhe shkruar më parë. Në domethënien e saj të vërtetë, feja nuk kundërshton apo kufizon shkencën ose studimin shkencor.

Feja i orienton shkencat, përcakton qëllimin e tyre të vërtetë dhe vendos moralin dhe vlerat njerëzore universale para shkencës si udhërrëfyes. Nëse kjo e vërtetë ka qenë kuptuar në Perëndim dhe nëse kjo lidhje midis fesë dhe dijeve ka qenë zbuluar, gjërat nuk kanë shumë ndryshim. Shkenca nuk duhet të ketë bërë më shumë të këqija se të mira dhe as të ketë hapur rrugën për prodhimin e bombave dhe të armëve të tjera vdekjeprurëse.

Sot deklarohet që feja është përçarëse dhe hap rrugën për vrasjen e të tjerëve. Ndonëse nuk mund të mohohet që feja, posaçërisht Islami, nuk ka udhëhequr shfrytëzimin e pamëshirshëm të njeriut në shekujt e fundit: në veçanti luftërat dhe revolucionet e shekullit të njëzet që vranë miliona njerëz, që lanë prapa edhe më shumë

të pastrehë, të veja, jetimë dhe të gjymtuar. Materializmi shkencor është një pikëpamje mbi jetën dhe botën që e ka ndarë vetveten nga feja dhe, një përplasje interesash që shkaktuan këtë shfrytëzim.

Gjithashtu, është çështja e ndotjes mjedisore, nxitur nga materializmi shkencor, një tipar dallues i mendimit modern perëndimor. Në themel të kërcënimit global të ndotjes është koncepti, shkaktuar nga mosbesimi shkencor, që natyra është një akumulim i gjërave që nuk kanë vlera jashtë aftësive të tyre për të përmbushur nevojat fizike. Në fakt, natyra është më shumë se një grumbull material apo një akumulim objektesh: ajo ka një shenjtëri të caktuar, sepse është arena në të cilën janë manifestuar Emrat e Bukur të Zotit.

Natyra është një demonstrim i bukurisë dhe qëllimit që manifeston thellësinë dhe gjerësinë e domethënieve, pemët që zënë rrënjë, lulet që çelin, shija dhe aroma e frutave, shiu, burimet e ujit, ajri që thithim dhe nxjerrim dhe plehu që ushqen krijesat e panumërta. Prandaj, mendja dhe zemra e një njeriu bëhet si hojet, nektari i dhuruar është parapërgatitur me vlerësimet dhe aftësinë për të analizuar. Ky shtegtim në të gjithë botën është si pjalmi që sulmon veten me bletët punëtore. Mjalti i besimit, virtytit, dashurisë për njerëzimin dhe për të gjitha krijesat, për hir të Krijuesit, nektari i ndihmës për të tjerët, sakrifikimi i vetvetes në atë shkallë që i paraprin pasionit të jetës me qëllim që të tjerët të mund të jetojnë, dhe ushqimi i të gjithë krijesave - kjo është ajo që rrjedh nga kjo hoje.

Siç është shprehur Bediuzamani, është në domethënien e edukimit ta shohë ndriçimin e mendjes tek shkenca dhe dijet, dhe dritën e zemrës tek besimi dhe virtyti. Kjo domethënie, që i bën studiuesit të fluturojnë me dy krahë në qiejt e njerëzimit dhe ta kërkojnë pëlqimin e Zotit përmes shërbimit për të tjerët, ka shumë gjëra për të ofruar. Ajo çliron shkencën nga materializmi, duke e kthyer nga një faktor dëmprurës, në një faktor të dobishëm - nga

perspektivat materiale dhe shpirtërore - si edhe ndalon shkencën të kthehet në një armë vdekjeprurëse. Një domethënie e tillë, me fjalët e Ajnshtajnit, nuk do ta lejojë fenë të qëndrojë e paralizuar. Ose do ta pengojë fenë që të jetë parë dhe e kuptuar si diçka e shkëputur nga inteligjenca, jeta dhe të vërtetat shkencore, apo si një institucion fanatik që ndërton mure ndarës midis individëve dhe kombeve.

Duke i shërbyer njerëzimit përmes edukimit

Për shkak të zhvillimeve të shpejta në transport dhe komunikacion, bota është bërë si një fshat global. Kombet janë bërë si fqinj të afërt, ndonëse ne mund të kujtojmë që në një botë si kjo, ekzistenca e kombeve mund të jetë siguruar vetëm nga mbrojtja e karakteristikave specifike të tyre. Në një mozaik të unifikuar të kombeve dhe shteteve, ata që nuk do të mund t'i mbrojnë cilësitë e veçanta, do t'i humbin "motivet" ose "qëllimet" kombëtare dhe do të zhduken. Si në të gjithë kombet e tjerë, karakteristikat tona esenciale janë feja dhe gjuha, historia dhe mëmëdheu. Ajo që Jahja Kemal, një poet dhe shkrimtar i famshëm turk, shprehte me emocion të madh në *Lagje pa ezane*, ishte që kultura dhe qytetërimi ynë kanë ardhur nga Islami dhe Azia Qendrore dhe janë mbrojtur për shekuj në Anadoll, Evropë dhe madje në Afrikë.

Të gjithë popujt kanë nevojë për njëri-tjetrin. Siç u përmend edhe më sipër, ne kemi më shumë për t'i dhënë njerëzimit se ç'kemi për t'i marrë. Sot, organizatat vullnetare ose joqeveritare kanë krijuar kompani dhe fondacione dhe janë duke u shërbyer me entuziazëm të tjerëve, në emër të Islamit. Pranimi në shkallë të gjerë i institucioneve edukative që janë shpërndarë në të gjithë botën, pavarësisht nga vështirësitë e mëdha financiare me të cilat janë përballur, dhe faktit që ata janë konkurruese dhe shpesh lënë pas për një kohë shumë të shkurtër institucionet homologe në perëndim, duhet të vërtetojë që çfarë kemi thënë,

nuk mund të mohohet.

Populli turk ka akumuluar shumë probleme nga shekujt e kaluar. Në themel të këtyre problemeve qëndron gabimi ynë i përmbledhur në pamjen e jashtme të Islamit dhe në shpërfilljen e margaritarëve të tij të brendshëm. Pastaj ne filluam të imitojmë të tjerët dhe hamendësuam që ekzistonte një konflikt midis Islamit dhe shkencave të natyrës. Ne arritëm në këtë konkluzion pavarësisht nga fakti që tek e fundit, shkenca nuk është më shumë se zbulimi i ligjeve hyjnore që manifestojnë atributet e Zotit për fuqi dhe vullnet, nuk është asgjë tjetër veçse një shprehje e ndryshme e Kuranit që rrjedh nga atributi i të folurit i Zotit. Kjo shpërfillje, për pasojë, çon në despotizmin e dijeve, mendimit dhe qeverisjes, një gjendje pa rrugëdalje që çon në një çrregullim që përfshin të gjithë individët dhe institucionet, një konfuzion në punën tonë. Ne nuk tregojmë më kujdes për njerëzit e thjeshtë.

Më shkurt, tre armiqtë tanë më të mëdhenj janë injoranca, varfëria dhe përçarja e brendshme. Dijet, kapitali i punës dhe bashkimi mund të luftojnë kundër tyre. Paditurisë që është problemi më serioz, duhet t'i kundërvihemi me arsimim, kjo ka qenë gjithmonë rruga më e drejtë për t'i shërbyer vendit tonë. Tani që ne jetojmë në një botë globale, edukimi është mënyra më e mirë për t'i shërbyer njerëzimit dhe për të vendosur një dialog me qytetërimet e tjera.

Mbi çdo gjë tjetër, edukimi është një shërbim human. Ne jemi sjellë në këtë botë për të mësuar dhe për t'u përsosur përmes arsimimit. Bediuzamani tregon kujdes për përfundimet e mundshme dhe të ardhmen duke thënë: "Qëndrimi i vjetër ndaj çështjeve është i pamundur. Pa një qëndrim të ri, asgjësimi është i pashmangshëm." Duke thënë që "çështjet polemizuese nuk duhet të diskutohen me udhëheqësit shpirtërorë të krishterë," ai hapte dialogun me anëtarët e feve të tjera. Si Mevlana Xhelaledin Rumiu i cili pati thënë: "Një nga këmbët e mia është në qendër dhe tjetra

është në shtatëdhjetë e dy botët. Si një kompas, ai vizatonte një rreth të gjerë që përfshinte të gjithë besimtarët. Duke lënë të kuptohet se ditët e terrorit ishin lënë pas, Bediuzamani thoshte: "Fitorja me njerëz të qytetëruar është arritur me bindje", dhe në këtë mënyrë vinte në dukje që dialogu, bindja dhe diskutimi bazuar në prova janë thelbësore për ata që kërkojnë t'i shërbejnë fesë. Duke thënë që "në të ardhmen njerëzimi do t'i kthehet dijes dhe shkencës dhe do të qeverisin arsyeja dhe fjalët", ai inkurajonte njohuritë dhe dialogun. Përfundimisht, duke lënë mënjanë politikën dhe angazhimin e drejtpërdrejtë në politikë, ai piketoi linjat bazë për besimin e vërtetë dhe shërbimin kombëtar në këtë kohë dhe në të ardhmen.

Nën dritën e parimeve të tilla, unë i kam inkurajuar njerëzit t'i shërbejnë vendit në veçanti dhe njerëzimit në përgjithësi, përmes arsimimit. Unë u kam bërë thirrje atyre ta ndihmojnë popullin për t'u arsimuar dhe zhvilluar, duke hapur shkolla të reja. Padituria mund të mposhtet përmes arsimimit, varfëria përmes punës dhe kapitalit dhe përçarja e brendshme, përmes bashkimit, dialogut dhe tolerancës. Zgjidhja e çdo problemi në këtë jetë varet plotësisht nga krijesat njerëzore, dhe edukimi është mjeti më efektiv për këtë, pa u përqendruar në faktin nëse ne kemi një sistem politik dhe shoqëror të paralizuar apo që funksionon si zembereku i orës.

Shkollat

Pasi qeveria dha leje për hapjen e shkollave private, shumë njerëz zgjodhën vullnetarisht të harxhonin kursimet e tyre në shërbim të vendit, në vend të kalimit në botën tjetër, duke e çuar këtë jetë në kërkim të një ekzistence të zbrazët. Në fakt, njerëzit e kanë realizuar këtë me entuziazmin që normalisht karakterizon adhurimin. Është e pamundur për mua që t'i njoh të gjithë shkollat që janë hapur këtu dhe jashtë vendit. Meqenëse unë vetëm kam propozuar dhe nxitur aksione të tilla, nuk mund të di madje dhe emrat e shoqërive që hapën shkolla ose vendet ku janë hapur ato.

Megjithatë, unë e kam ndjekur këtë çështje që ka zënë një vend të caktuar në gazeta dhe në serinë e shkrimeve të shkruara nga gazetarë të shquar, si Ali Bajramogllu, Shahin Alpaj dhe Atëllgan Bajar. Shkollat janë hapur me radhë nga Azerbajxhani në Filipine, nga Shën Petërburgu në Moskë dhe, me ndihmën e bashkëqytetarit dhe biznesmenit të suksesshëm çifut Yzeir Garih, me kompetencën e dijeve të tij, në Jakutsk. Këto shkolla janë hapur pothuajse kudo, përjashtuar vendet si Irani, ku nuk është dhënë leje.

Shkrimtarët dhe dijetarët që kanë vizituar shkollat, konfirmojnë që ato janë financuar nga organizata vullnetare në Turqi. Në shumë ose në të gjitha ato, bursat e studentëve janë një pjesë e rëndësishme e këtij financimi. Administratorët lokalë japin një kontribut të rëndësishëm duke siguruar ndërtesat, drejtuesit dhe mësuesit kur është e nevojshme. Mësuesit, që i janë përkushtuar shërbimit për vendin, kombin e tyre dhe njerëzimin, duke gjetur kuptimin e jetës në shërbim të të tjerëve, punojnë me entuziazëm me një rrogë të vogël.

Në fillim, disa nga funksionarët tanë të marrëdhënieve me jashtë hezitonin për të dhënë mbështetjen e tyre, por ata nuk e kuptonin se çfarë ishin duke bërë. Sot, megjithatë, shumë prej tyre u japin mbështetje shkollave. Përveç kësaj, dy presidentët e fundit turq, të nderuarit Turgut Ozal dhe Sulejman Demirel, si edhe ish-kryetari i parlamentit, Mustafa Kalemli, dhe ish-ministri i jashtëm, Hikmet Çetin, kanë dhënë mbështetjen e tyre për këto përpjekje, duke vizituar posaçërisht shkollat.

Administratorët lokalë janë më të vetëdijshëm për laicizmin, ose madje më shumë se kaq, se qeveria turke. Kjo shpjegohet nga gazetarët Shahin Allpaj, Atëllgan Bajar dhe shumë të tjerë, në një mënyrë të përafërt me vëzhgimin e Ali Bajramoglu, që këto vende nuk kanë një interes të papërfillshëm, në lidhje me këto shkolla, për të ardhmen. Në fakt, duke folur në ceremoninë e hapjes së shkollës në Moskë, kryetari i zyrës për edukimin kombëtar tha:

"Dy janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë aktuale të Rusisë. Njëra, udhëtimi i Gagarinit në hënë dhe tjetra, hapja e shkollës turke këtu!" Ai e përshkroi këtë si një ngjarje historike.

Për disa, kjo jetë konsiston në pak ditë të kaluara në këtë bujtinë tokësore në kërkim të përmbushjes së dëshirave të egos. Njerëzit e tjerë kanë një pikëpamje të ndryshme dhe kështu i japin jetës një kuptim të ndryshëm. Për mua, kjo jetë përbëhet nga disa frymëmarrje në udhëtimin që fillon në botën e shpirtrave dhe vazhdon përjetësisht ose në parajsë, ose mos e dhëntë Zoti, në ferr.

Kjo jetë është shumë e rëndësishme, sipas saj përcaktohet jeta jonë e përtejme. Prandaj ne duhet ta përshkojmë atë në rrugët e përcaktuara për të fituar jetën e amshuar në parajsë dhe për të arritur pëlqimin e Dhuruesit të Jetës. Kjo udhë kalon përmes dimensionit të pashmangshëm të shërbëtorit të Zotit, me anë të shërbimit, para së gjithash, për familjet tona, të afërmit dhe fqinjët dhe më pastaj për vendin dhe kombin tonë dhe, në fund, për njerëzimin dhe krijesat që janë objekt i përpjekjeve tona. Ky shërbim është e drejta jonë, përçimi te të tjerët është përgjegjësia jonë.

EDUKIM NGA LINDJA GJER NË VDEKJE [78]

Detyra dhe qëllimi kryesor i jetës njerëzore është të kërkojë kuptimin e saj. Përpjekja për ta arritur këtë, e njohur si edukim, është një proces përsosje përmes të cilit ne fitojmë në dimensionet shpirtërore, intelektuale dhe fizike të qenies sonë, pozitën e caktuar për ne si modeli perfekt i krijimit. Në lindje, nisja e fazës tokësore të udhëtimit tonë prej botës së shpirtrave në përjetësi, ne jemi plotësisht të pafuqishëm dhe në mënyrë të skajshme nevojtarë. Në të kundërt, shumica e kafshëve vijnë në këtë botë si të maturuar ose sikur janë perfeksionuar më parë. Brenda pak orëve, ditëve ose muajve, ata mësojnë gjithçka të nevojshme për mbijetesën e tyre, ashtu edhe si të vendosin lidhje me mjedisin dhe me krijesat e tjera. Për shembull, zogjve ose bletëve për të fituar pjekurinë dhe të gjithë aftësitë fizike dhe sociale u nevojiten njëzet ditë. Ne na nevojiten njëzet vjet apo më shumë për të arritur një nivel të krahasueshëm pjekurie.

Ne kemi lindur të pafuqishëm si edhe të paditur për ligjet e jetës dhe duhet të këlthasim për të marrë ndihmën që na nevojitet. Pas një viti apo më shumë, ne mund të qëndrojmë në këmbët tona dhe të ecim nga pak. Kur ne jemi rreth të pesëmbëdhjetave, shpresojmë të kemi kuptuar ndryshimin midis të mirës dhe të keqes, të dobishmes dhe të dëmshmes. Megjithatë, e tërë jeta jonë do të shkojë në kërkim të përsosjes intelektuale dhe shpirtërore. Detyra jonë kryesore në jetë është të fitojmë përsosjen dhe pastërtinë në mendimin, këndvështrimin dhe besimin tonë. Nga përmbushja e detyrimit tonë si shërbëtorë të Krijuesit, Ushqyesit

[78] Ky artikull është nxjerrë nga shkrimet e Gylenit të publikuara në revistën *Sizinti,* mars 1981-qershor 1982, nr. 26-41.

dhe Kujdestarit, dhe nga depërtimi në të fshehtën e krijimit përmes mundësive dhe aftësive tona, ne kërkojmë të arrijmë në pozitën e krijesës njerëzore të vërtetë dhe të bëhemi të denjë për një lumturi, që është jeta e amshuar në botën tjetër të lartësuar.

Natyra jonë njerëzore është drejtpërsëdrejti në përpjesëtim me pastërtinë e emocioneve tona. Megjithëse, ata që janë plot me ndjenja negative dhe shpirtrat e të cilëve janë ndikuar nga egoizmi, shfaqen si krijesa njerëzore, është e dyshimtë nëse ata janë me të vërtetë njerëz. Pothuajse çdo njeri mund ta drejtojë trupin e tij, por pak mund t'i edukojnë mendjet dhe ndjenjat e tyre. E para krijon një trup të shëndoshë, ndërsa e dyta krijon njeriun spiritual.

Aftësitë tona të bashkëlindura dhe edukimi

Prej kohës së Ibn Miskavajhit[79], aftësitë njerëzore ose "energjitë" kanë qenë ndarë në tre kategori: arsyeja, zemërimi dhe lakmia. Arsyeja përfshin kapacitetet tona të perceptimit, kuptimit, imagjinatës, kalkulimit, kujtesës, mësimit e kështu me radhë. Zemërimi mbulon mundësinë tonë për vetëmbrojtje, të cilën jurisprudenca islame e përcakton si diçka të nevojshme për mbrojtjen e besimit dhe fesë tonë, urtësisë, pasurive, jetës, familjes dhe vlerave të tjera të shenjta. Kurse lakmia emërton forcën e orekseve tona kafshërore:

Njerëzve u është hijeshuar dashuria ndaj gjërave të dëshiruara, për gratë, për fëmijët, për grumbullimin e arit dhe të argjendit, për kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat. Këto janë kënaqësi të kësaj bote... (Al-i Imran, 14)

Këto dhunti gjenden tek çdo krijesë, ndonëse dëshirat, inteligjenca, vendosmëria për të mbrojtur jetën dhe territorin, janë dhunti të posaçme vetëm për qeniet njerëzore. Çdo njëri prej nesh është pajisur veçmas me vullnet të lirë dhe obligim konsekuent për të disiplinuar fuqitë e veta. Kjo luftë për disiplinim përcakton

[79] Ibn Miskavajh (930-1030), moralist, filozof dhe historian mysliman.

natyrën tonë njerëzore. Në bashkim me njëra-tjetrën dhe në përputhje me rrethanat, aftësitë tona janë shpesh të shprehura përmes xhelozisë, urrejtjes, armiqësisë, hipokrizisë dhe mburrjes. Gjithashtu këto duhet të jenë disiplinuara.

Krijesat njerëzore nuk përbëhen vetëm nga trupi dhe mendja. Çdo njëri prej nesh ka një shpirt që duhet të ndjejë kënaqësi. Pa këtë, ne nuk mund të gjejmë lumturinë e vërtetë ose të arrijmë përsosjen. Kënaqësia shpirtërore është e mundur vetëm përmes dijeve për Zotin dhe besimit tek Ai. Të kufizuar me botën fizike, vetja jonë trupore e veçantë, koha dhe hapësira mund të ndjehen si një burg. Ne mund t'i përvidhemi këtij burgimi përmes besimit dhe adhurimit të rregullt dhe duke u përmbajtur nga ekstremet ndërsa shfrytëzojmë aftësitë dhe kapacitetet tona. Ne nuk duhet të kërkojmë të shkatërrojmë dhuntitë tona, por, më saktë, të përdorim vullnetin tonë të lirë për t'i përmbajtur dhe pastruar ato, për t'i adresuar në drejtim të virtytit. Për shembull, ne nuk shpresojmë të eliminojmë epshin, por ta përmbushim atë në mënyrë të ligjshme nëpërmjet riprodhimit. Lumturia mbështetet në kufizimin e epshit tonë në kufijtë e ligjshëm të turpit dhe pastërtisë morale dhe jo në tërheqjen e shthurjes dhe çoroditjes.

Në të njëjtën mënyrë, xhelozia mund të jetë kanalizuar në rivalitetin e lirë të zilisë pozitive që na frymëzon ne për t'u matur me ata që shquhen për mirësi dhe vepra të lavdërueshme, duke vënë në zbatim disiplina të përshtatshme për të arsyetuar rezultatet tona në fitimin e njohurive dhe në fund fare, për mirëkuptimin dhe urtësinë. Pastrimi dhe trajnimi i zemërimit çon në bindje dhe vetëpërmbajtje. Disiplinimi i pasionit dhe i dëshirave tona i jep udhë pastërtisë morale.

Nëse çdo virtyt është menduar të jetë në qendër të një rrethi, dhe çdo veprim jashtë qendrës është menduar të jetë një ves, atëherë vesi bëhet i madh nëse ne lëvizim shumë larg prej qendrës. Çdo virtyt si pasojë ka vese të mundshme të panumërta meqë aty është

vetëm qendra e një rrethi, por me numër të pakufizuar pikash rreth tij. Është e parëndësishme në cilin drejtim ndodh shmangia, por shmangia nga qendra në çfarëdo drejtimi qoftë është një ves.

Dy janë ekstremet në lidhje me çdo virtyt moral: dobësia ose tepria. Dy ekstremet lidhur me urtësinë janë budallallëku dhe finokëria. Për guximin janë burracakëria dhe nxitimi dhe, për pastërtinë morale, janë plogështia dhe zilia e pakontrolluar. Prandaj përsosmëria e një personi, qëllimi themelor i ekzistencës sonë, mbështetet në mbajtjen e kushteve të balancës dhe maturisë në mes dy ekstremeve në lidhje me çdo virtyt. Ali ibn Ebu Talibi ka thënë:

Zoti i ka dalluar engjëjt nga intelekti pa dëshira seksuale, pasione apo zemërim, dhe kafshët me zemërim dhe dëshira pa intelekt. Ai i ka lartësuar krijesat njerëzore duke u falur atyre të gjitha këto cilësi. Prandaj, nëse intelekti i një personi mbizotëron dëshirat dhe egërsinë e tij, ai ngrihet në një pozitë mbi engjëjt, sepse kjo pozitë është arritur nga një krijesë njerëzore me gjithë ekzistencën e pengesave që nuk i shqetësojnë engjëjt.

Përparimi i një komuniteti është i mundur vetëm nga ngritja e gjeneratës së re në nivelin e natyrës njerëzore, jo nga asgjësimi i atyre që janë në udhë të gabuar. Përveç farës të krijuar me besim, traditë dhe vetëdije historike dhe të mbjellë anembanë vendit, atje ku nuk çrrënjoset e keqja, do të shfaqen dhe rriten edhe elementët e rinj të këqij.

Kuptimi dhe vlera e vërtetë e edukimit

Edukimi nëpërmjet mësimit dhe drejtimi në një rrugë të lavdërueshme të jetës është një detyrë sublime që është tregues i emrit hyjnor *Rabb* (Edukator dhe Kujdestar). Nga përmbushja e kësaj detyre, ne do të jemi të aftë për të arritur pozitën e natyrës njerëzore të vërtetë dhe të bëhemi një element i dobishëm për shoqërinë.

Edukimi është jetik për shoqërinë dhe individët. Së pari, natyra jonë njerëzore është në proporcion të drejtë me pastërtinë e emocioneve tona. Ndonëse ata që janë mbushur me ndjenja të këqija dhe shpirtrat e të cilëve janë ndikuar nga egoizmi ngjajnë të jenë krijesa njerëzore, është e diskutueshme nëse janë vërtet të tillë. Pothuajse çdo njeri mund ta trajnojë veten fizikisht, por pak mund ta edukojnë mendjen dhe ndjenjat e tyre. Së dyti, përparimi i një komuniteti është i mundur vetëm nga ngritja e brezave që vijnë, në rangun e natyrës njerëzore, jo nga zhdukja e të këqijve. Përveç farërave të fesë, vlerave tradicionale dhe vetëdijes historike që janë mbjellë anembanë vendit, elementët e rinj negativë do të rriten pashmangshmërisht atje ku nuk është çrrënjosur e keqja.

E ardhmja e një kombi varet në rininë e tij. Çdo popull që dëshiron të sigurojë të ardhmen e tij, ashtu siç përkushtohet ndaj fushave të tjera, duhet të harxhojë sa më shumë energji për të rritur brezin e ri. Një komb që lë pas dore rininë e tij, që i braktis ata për hir të ndikimeve kulturore të huaja, vë në rrezik identitetin dhe është subjekt i paqëndrueshmërisë politike dhe kulturore.

Arsyet pse ne jemi të aftë për të vëzhguar indulgjencën te gjenerata e sotme si edhe paaftësinë e disa administratorëve dhe konfliktet e ngjashme mbarëkombëtare, mund të gjenden në rrethanat mbizotëruese dhe në elitën qeverisëse të 25 vjetëve përpara. Gjithashtu, ata që janë kujdesur për edukimin e brezit të ri në ditët e sotme, do të jenë përgjegjës për veset dhe virtytet që do të shfaqen në 25 vitet e ardhshme. Ata që duan të parashikojnë të ardhmen e një kombi, mund ta arrijnë këtë gjë me përpikëri duke i dhënë arsimim dhe edukim të plotë brezit të ri. Jeta "e vërtetë" është e mundur vetëm nëpërmjet dijeve. Prandaj, ata që lënë pas dore arsimimin dhe dituritë, duhet të vlerësohen si krijesa të "vdekura," edhe nëse janë në jetë. Ne jemi krijuar për të mësuar dhe për të shprehur me të tjerët çfarë kemi përvetësuar.

Marrja e vendimeve të drejta është e kushtëzuar në zotërimin e një mendjeje të shëndoshë dhe në të qenët i aftë për mendimin e pakontestueshëm. Shkenca dhe njohuritë ndriçojnë dhe zhvillojnë mendjen. Për këtë arsye, një mendje e privuar nga shkenca dhe dijet nuk mund të marrë vendime të drejta. Ajo është gjithashtu e ekspozuar ndaj gabimit dhe subjekt për të qenë e mashtruar.

Ne jemi krijesa njerëzore të vërteta vetëm nëse mësojmë, edukohemi dhe frymëzojmë të tjerët. Është e vështirë që të vlerësosh ata që janë të paditur dhe nuk kanë dëshirë për të mësuar si njerëz të vërtetë. Gjithashtu është e diskutueshme nëse njerëzit e shkolluar që nuk përtërijnë dhe reformojnë veten me qëllim që të sjellin një shembull për të tjerët, të jenë krijesa njerëzore të vërteta. Statusi shoqëror dhe meritat e fituara përmes dijeve dhe shkencës lartësohen dhe bëhen më të qëndrueshme nga ato që arrihen nëpërmjet rrugëve të tjera.

Duke i dhënë një rëndësi të madhe mësimit dhe diturive, ne duhet të përcaktojmë se çfarë është për t'u mësuar dhe ditur, kur dhe si duhet ta bëjmë këtë. Ndonëse dituria është një vlerë në vetvete, qëllimi i të mësuarit është për t'i bërë dijet udhërrëfyese të jetës dhe, për të ndriçuar rrugën e përsosjes njerëzore. Prandaj, çdo njohuri që nuk përvetësohet është një përgjegjësi për atë që mëson dhe një shkencë që nuk e drejton njeriun drejt qëllimeve të larta, është një mashtrim.

Por dija e fituar për një qëllim legjitim është një burim i pashterueshëm bekimesh për atë që mëson. Ata që posedojnë një burim të tillë, zbulohen gjithmonë nga njerëzit si një burim me ujë të ëmbël, dhe janë të aftë ta drejtojnë popullin për mirë. Dija, e kufizuar me teori boshe dhe pjesë të papërvetësueshme nga ata që mësojnë, e cila zgjon dyshime në mendje dhe errëson zemrat, është një "grumbull plehrash" rreth së cilës zhgërryen shpirtrat e dëshpëruar dhe të çoroditur. Prandaj, shkenca dhe dijet duhen kërkuar për të zbuluar natyrën e krijesës njerëzore dhe të fshehtat

e krijimit. Çdo njohuri, edhe "shkencore," është e ligjshme vetëm nëse hedh dritë mbi misteret e natyrës njerëzore dhe ndriçon hapësirat e errëta të ekzistencës.

Familja, shkolla dhe mjedisi

Njerëzit që duan të garantojnë të ardhmen, nuk mund të jenë indiferentë për edukimin e fëmijëve të tyre. Familja, shkolla, mjedisi dhe mjetet e komunikimit masiv duhet të bashkëpunojnë të gjithë për të siguruar rezultatin e dëshiruar. Kundërshtimi i tendencave midis këtyre institucioneve jetike do t'i kushtëzojë të rinjtë në influencat kontradiktore, të cilat do t'i shpërqendrojnë dhe shpërhapin energjitë e tyre. Në veçanti, mjetet e komunikimit masiv duhet të kontribuojnë në edukimin e brezit të ri duke ndjekur edukimin politik të miratuar nga komuniteti. Shkolla duhet të jetë sa më e përsosur në respekt të programit mësimor të saj, të standardeve morale dhe shkencore të mësuesve dhe të kushteve të saj fizike. Një familje duhet të krijojë atmosferën dhe ngrohtësinë e nevojshme në të cilën rriten fëmijët.

Në shekujt e parë të Islamit, mendjet, zemrat dhe shpirtrat përpiqeshin të kuptonin se çfarë miratonte Zoti i qiejve dhe tokës. Çdo kuvendim, diskutim, marrëdhënie dhe eventualitet ishte drejtuar në këtë qëllim. Dhe si rezultat, kushdo që i përmbahej kësaj rruge, merrte vlerësime të drejta dhe energji nga mjedisi që e rrethonte. Dukej sikur gjithçka ishte si një mësues që duhej të përgatiste mendjet dhe shpirtrat e individëve dhe të zhvillonte aftësitë e tij ose të saj për të arritur një nivel të lartë në shkencën islame. Shkolla e parë në të cilën ne marrim edukimin e nevojshëm për të qenë të përsosur, është vatra familjare.

Vatra familjare ka një rëndësi jetike për rritjen e një gjenerate të shëndetshme dhe sigurimin e një sistemi shoqëror ose të një strukture të shëndoshë. Kjo përgjegjësi vazhdon gjatë gjithë jetës. Përshtypjet që marrim nga familjet tona nuk mund të fshihen

deri në fund të jetës sonë. Për më tepër, mbikëqyrja e familjes mbi fëmijën në shtëpi, lidhur me fëmijët e një barku tjetër dhe lodrat, vazhdon në shkollë në lidhje me shokët e fëmijës, librat dhe vendet e vizituara. Prindërit duhet t'i ushqejnë mendjet e fëmijëve të tyre me njohuri dhe shkencë përpara se ato t'u jenë pushtuar nga gjërat e padobishme, sepse shpirtrat pa të vërteta dhe dije janë fusha ku kultivohet dhe rritet e keqja.

Fëmijët mund të marrin një edukatë të mirë në shtëpi vetëm nëse jeta familjare është e shëndoshë. Prandaj, bashkëshortët duhet të marrin përsipër ndërtimin e një vatre familjare të ngrohtë dhe kështu t'i kontribuojnë, qëndrueshmërisë së kombit të tyre në veçanti dhe njerëzimit në përgjithësi. Paqja, lumturia dhe siguria në vatrën familjare vendosen me bashkëpunimin reciprok të bashkëshortëve në mendim, moral dhe besim. Çiftet që vendosin të martohen, duhet ta njohin mirë njëri-tjetrin dhe të respektojnë më shumë pastërtinë e ndjenjave, dëlirësinë, ndershmërinë dhe virtytet, se sa pasurinë dhe bukurinë fizike. Djallëzia dhe paturpësia e fëmijëve reflekton atmosferën në të cilën ata janë rritur. Jeta e një familjeje jofunksionale pasqyrohet gjithnjë e më shumë në shpirtrat e fëmijëve dhe, për pasojë, në shoqëri.

Në familje, anëtarët më të rritur duhet t'i trajtojnë më të vegjlit me dhembshuri dhe të rinjtë nga ana e tyre të tregojnë respekt për më të moshuarit. Prindërit duhet të duan dhe respektojnë njëri-tjetrin dhe të sillen ndaj fëmijëve të tyre me dhembshuri, duke marrë në konsideratë ndjenjat e tyre. Ata duhet t'i trajtojnë të gjithë fëmijët në të njëjtën mënyrë pa diskriminuar asnjërin prej tyre. Nëse prindërit i inkurajojnë fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të jenë të dobishëm për veten dhe komunitetin, atëherë ata i kanë dhënë kombit një mbështetje të re të fuqishme. Nëse ata nuk kultivojnë ndjenjat e duhura tek fëmijët e tyre, ata lëshojnë akrepa në komunitet.

Shkolla dhe mësuesi

Një shkollë mund të krahasohet me një laborator, ajo ofron një eliksir që mund të pengojë ose të shërojë sëmundjet e jetës. Ata që kanë njohuritë dhe mençurinë për të përgatitur dhe administruar këtë eliksir, janë mësuesit.

Shkolla është vendi për t'u arsimuar, ku mësohet gjithçka në lidhje me këtë botë dhe me tjetrën. Ajo mund të hedhë dritë mbi qëllimet e domosdoshme për jetën dhe eventualitetet, dhe u mundëson studentëve të kuptojnë natyrën e tyre dhe faktorin njerëzor. Një shkollë, gjithashtu, mund të hapë shpejt rrugën për të zbuluar domethënien e gjërave dhe të ngjarjeve, si rrjedhim e drejton studentin tek mendimi dhe shqyrtimi tërësor. Në thelb, një shkollë është një vend adhurimi; "drejtuesit e shenjtë" janë mësuesit.

Mësuesit e vërtetë mbjellin farën e pastër dhe e ruajnë atë. Ata e okupojnë veten me çfarë është e mirë dhe e moralshme, dhe i drejtojnë dhe udhëheqin fëmijët në jetë dhe në çdo ngjarje që mund të përfshihen. Që një shkollë të jetë një institucion i vërtetë edukimi, studentët duhet së pari të jenë të pajisur me një ideal, një dashuri për gjuhën e tyre dhe të dinë se si ta përdorin atë në mënyrë sa më efektive. Ata duhet të zotërojnë një moral të pastër dhe vlera njerëzore të përjetshme. Identiteti i tyre shoqëror duhet të ndërtohet në këto themele.

Edukimi është i ndryshëm nga shkollimi. Shumë njerëz mund të mësojnë, por vetëm shumë pak mund të edukohen. Komunitetet e krijuara me individë pa ideale të larta, sjellje të mirë dhe vlera njerëzore, janë si individët e paqytetëruar që nuk kanë besnikëri në miqësi ose qëndrueshmëri në armiqësi. Ata që u besojnë atyre janë gjithmonë të zhgënjyer dhe ata që mbështeten tek ta, herët ose vonë do të gjenden pa këtë mbështetje. Rruga më e mirë për ta pajisur veten me vlera të vërteta është një edukim fetar i

shëndoshë.

Mbijetesa e një komuniteti varet në idealizmin dhe moralin e pastër, si dhe në aftësinë për të arritur nivelin e nevojshëm në progresin shkencor dhe teknologjik. Për këtë arsye, duhet të përvetësohen mjeshtëria dhe profesioni, duke filluar së paku në nivelin elementar. Një shkollë e mirë nuk është një ndërtesë ku është dhënë vetëm teori, por një institucion ose laborator ku nxënësit janë përgatitur për jetën.

Durimi dhe këmbëngulja kanë një rëndësi të madhe në edukim. Edukimi i njerëzve është shumë i shenjtë por gjithashtu shumë i vështirë, një mision në jetë. Me qëllim që të japin një shembull të mirë personal, mësuesit duhet të jenë mjaft të duruar për të arritur rezultatet e dëshiruara. Ata duhet t'i njohin mirë studentët dhe t'i drejtojnë intelektet, zemrat, shpirtrat dhe ndjenjat e tyre. Rruga më e mirë për t'i edukuar njerëzit është të shfaqësh një lidhje të veçantë me çdo individ, duke mos harruar që çdo individ është një «botë» e ndryshme.

Shkolla i përgatit nxënësit që të mund të lexojnë, mendojnë dhe flasin si brenda, dhe jashtë saj. Për këtë arsye, ndonëse duket sikur ajo ka zënë vetëm një pjesë të jetës, në të vërtetë shkolla dominon të gjitha kohët dhe ngjarjet. Për pjesën tjetër të jetës së tyre, nxënësit ripërsërisin çfarë kanë mësuar në shkollë dhe vazhdojnë të ndikohen nga kjo eksperiencë. Mësuesit duhet të jenë të aftë të gjejnë një rrugë për zemrat e studentëve dhe të lënë gjurmë të pashlyeshme në mendjen e tyre. Ata duhet të verifikojnë informacionin që ka kaluar tek studentët nga përpunimi në mendjen e tyre dhe nga prizmi i zemrave të tyre. Një mësim i mirë është më shumë se një informacion i dobishëm apo një aftësi praktike. Ai duhet t'u jepet nxënësve në praninë e së panjohurës. Kjo u mundëson studentëve të fitojnë një vizion të thellë për realitetin e gjërave dhe ta shohin çdo ngjarje si një shenjë të botës së padukshme.

NJË LËVIZJE ME SHEMBUJT NGA VETJA

Në këtë artikull unë dëshiroj të diskutoj për një legjendë. Të flas për të, është një detyrim dhe, për pasojë, është e vështirë të gjej fjalët e duhura. Megjithatë, unë dua të di nëse është e mundur ta përshkruash me një artikull një lëvizje të rëndësishme rigjallëruese, një lëvizje që ka lulëzuar në çdo pjesë të botës, ka çelur sythe, duke nxjerrë filiza dhe fidanë. Unë mendoj se jo. Njohja ime është vetëm nga regjistrimet që kam parë në video. Dëshmitë e mia mbështeten vetëm në ato që kam dëgjuar. Kufijtë e penës sime janë aftësitë e mia për të kuptuar. Unë nuk e di se çfarë periudhe i përkasin ngjarjet e nënkuptuara. As nuk mund të shprehem se çfarë mund të jetë thënë në ato rrethana! Gjithçka unë mund të bëj për ta përshkruar këtë, do të jetë si dikush që orvatet të përshkruajë trëndafilat dhe lulet, siç janë në të vërtetë, vetëm pasi ka parë një tablo me to. Por misioni im i ngjan më shumë një përpjekjeje për të përshkruar modelin, formën dhe rëndësinë e veçantë të çdo luleje dhe trëndafili në një kopsht thjesht nga vështrimi në një pikturë i një luleje pa jetë. Kopshtet me lule dhe trëndafila nuk mund të përshkruhen në këtë mënyrë. Nëse është e mundur, unë besoj që dikush duhet të guxojë të flasë në emër të fenomenit të epokës, për të gjallëruar njerëzit në formë dhe në ndërgjegje. Nëse disa njerëz pranë Zotit do të frymëzohen nga ky artikull, unë atëherë mendoj se ia kam arritur qëllimit.

Pavarësisht se në ç'mënyrë kuptimplote dhe elegante, më e rëndësishme është që ky fenomen i rëndësishëm i epokës është treguar. Ajo duhet treguar në fund të fundit që ne të lëmë një gjurmë në histori dhe të tregojmë respektin tonë për ata njerëz

të devotshëm që kryen vepra të tilla heroike. Nëse, në njërën anë, ky fllad i lehtë, kjo atmosferë e ngrohtë, ky mendim i kthjellët, kjo dashuri dhe erërat njerëzore të ndjera anembanë globit do të përshkruheshin shumë shkurt, kjo do të ishte mungesë respekti në drejtim të cilësive fisnike, të tilla si zemërgjerësia dhe altruizmi.

Kjo lëvizje është një fenomen për t'u shkruar dhe nënvizuar. Një dyzinë njerëzish të pasionuar spikasin në të gjitha drejtimet, për hir të Zotit, pa u ndalur për të menduar rreth dëshirave ose ndjenjave të tyre për shkëputje dhe pa shqiptuar fjalët "vende të huaja" ose " vende të panjohura" në një kohë kur askush nuk mund të hulumtojë se çfarë shtrihet përpara. Ata ishin plot vendosmëri, me synim të sigurt dhe të mbështetur në forcat e tyre. Ata ndrydhnin dashurinë e tyre për vendin dhe atdheun, duke e zëvendësuar atë me një dashuri për misionin që kishin ndërmarrë. Ata ishin të vetëdijshëm për përpjekjet e tyre për kauzën e Zotit, sado të vogla që të ishin, jetonin si të tillë dhe ecnin nga lindja në perëndim duke thënë: *Ne kemi hyrë në udhën e dashurisë, / Ne jemi të djegur.* - Nigari

Në periudhën më me plot ngjyra të jetës së tyre, kur kënaqësitë tokësore dhe objektivat materialë i tërhiqnin të rinjtë me një joshje të papërballueshme dhe kur materialiteti mbyste zemrën dhe mendjen e një njeriu, ata fluturonin ngado virtualisht me një pasion që frenonte dëshirat dhe detyrimet e ndryshme, për të realizuar misionin: stimuli në radhë të parë gjendej në zemrat e tyre! Ky fluturim nuk ishte si nisja e lektisjes rinore që ndiqte një sirenë të rreme që kishte hyrë në jetët e tyre në një kohë të pavolitshme. Për ata të rinj që i kërkonin ëndrrat e tyre për një jetë, që treteshin nga dashuria, të pashpjegueshëm për natyrën e tyre, akoma të pafuqishëm për të arritur synimin e dëshiruar, misioni i këtyre të rinjve ishte nga zemra dhe bazohej në emocionet, në vetëdijen dhe vendosmërinë, ai kishte thellësinë e një besimi të pastër dhe të sinqertë. Ju mund të thoni që kjo ishte dinamika e zakonshme e besimit, kushtet e natyrshme të ambicies hyjnore,

idealet e adhuruesve, treguesit e Dritës së Pafund ose përpjekjet e atyre që kishin braktisur veten dhe të dashurit me qëllim që të shprehnin vetveten. Në të vërtetë, ata as nuk u ishin shmangur dobësive të tyre dhe as ishin dorëzuar para pengesave në rrugën që ndiqnin. Ata shkonin në skajet më të largëta të botës vetëm pse dashuria e pavenitur në zemrat e tyre bëhej favor i Zotit dhe ambicie për ta takuar Atë. Ata ecnin dhe rrugët krenoheshin me këtë, engjëjt gëzoheshin me ta dhe, natyrisht, djajtë u binin me grusht kraharorëve të vet! Ata ecnin, nuk kishin as kuaj, as makina, as armë, as municion. Burimi i tyre i energjisë ishte besimi i jashtëzakonshëm dhe stimuli në zemra që vlonte si magmë, në horizont ishte lumturia e natyrës njerëzore, harmonia dhe kënaqësia. Fati i tyre ishte i njëjtë me bashkëpunëtorët dhe ndjekësit. Menjëherë pas agimit ata fituan, me dëlirësinë dhe pastërtinë e tyre, në një mënyrë që ishte e njëjtë në ngjashmëri me engjëjt. Ata bëhen temë e legjendave dhe nuk shuhen kurrë nga kujtesa. Ata çuan lumenj drite nga përjetësia kudo ku shkuan. Ata ndezën një zjarr ngado, flaka, prushi dhe tymi i këtij zjarri ishte lumturia. Magjia e tiranisë dhe errësirës u zbulua. Diskutimeve pa besim u ishte prishur gjumi dhe errësira ankohej pareshtur. Gënjeshtrat, shpifja dhe intriga ishin ndaluar edhe një herë tjetër. Të gjitha këto, i bënë arrogantë mendimin e pagdhendur dhe fanatizmin e padurueshëm me dëshirën për të shkelur mbi idetë e tjera dhe për t'i ngritur kurthe besimit. Megjithatë, i gjithë kundërshtimi kishte dështuar: drita ndriçonte ngado. Drita që buronte nga përjetësia, shpërndahej në të tërë botën. Tani ishte koha dhe epoka e shpirtrave të ndritshëm, megjithëse mbizotëronte akoma situata e turbullt dhe horizontet ishin të mjegulluara, por magjia e errësirës dhe mendimi i pagdhendur ishin tashmë të rrënuar.

Tani ishin kthyer për të folur shpirtrat e ndritshëm. Natyra njerëzore duhet të zbulonte vetveten përmes tyre dhe të zinte vendin që i takonte në hierarkinë e krijesave. Prandaj ajo ishte një

gjeneratë që kishte pritur gjatë. Meqenëse njerëzit kishin qenë në pritje të tyre, kudo ku ata shkonin, gjithmonë pritja dyfishohej si pasojë e adhurimit të tyre për Zotin dhe respektit për njerëzimin, sytë e tyre fiksoheshin në rrugën e hyrjes për tek Hirploti, kokulur dhe të përvuajtur, duke pritur momentin kur do të lëshoheshin rrëketë e dritës, ndërsa kokat dhe këmbët e tyre preknin tokën. Pavarësisht se si e vlerësojnë sot njerëzit çështjen, ata janë fëmijët e së nesërmes, e ardhmja e ndritur zhbiron sekretet e tyre. Këta njerëz me fat, që ishin apostujt e ringjalljes, çdonjëri në rrugën e tij, mbajtën në duar lulet e miqësisë dhe ajetet për vëllezërit dhe motrat në buzët e tyre. Gjuhët e tyre, më të mprehta edhe se shpatat, ishin ushqyer nga ujëvarat kuranore dhe fjalët që shqiptonin kishin dimension hyjnor. Këta fjalë shkatërruan errësirën, por nuk dëmtuan askënd. Ata sollën kumbimin e lumenjve të parajsës brenda kufijve të dëgjimit, por nuk u drejtuan te një mall për parajsën. Në fakt, këta njerëz nuk kishin nevojë për duar dhe gjuhë. Fytyrat e tyre të pastra që përkujtonin Zotin kudo ku ishin parë, ishin më magjike, se fjalët çalamane, në praninë e domethënieve që buronin nga sjellja e tyre, dhe gjuhët heshtnin. Dhe hijet e tyre digjnin gojët e natës jo për të lavdëruar dritën e tyre, e cila verbonte këdo që afrohej. Ne me plot të drejtë themi: "Gjuhët dhe fjalët nuk kanë asgjë për të shprehur në prani të aksioneve. Kur flasin sjelljet, a ka nevojë për ligjërata?" Ata janë përfaqësuesit e kësaj të vërtete. Gjithmonë ka njerëz të mirë në tokë, megjithatë, qëndrimet dhe fjalët e këtij grupi të vonshëm janë krejtësisht të ndryshme. Unë me forcë mund të them që ata ishin të rrallë ose të veçantë, por nëse prisni që t'ju shpjegoj se si ishin, unë nuk jam në gjendje që të përgjigjem menjëherë. Unë mbase do të thoja: "Ata ngjanin me engjëjt"! Dhe asgjë më shumë se kaq!

Kudo ku shkojnë shpirtrat e ndritshëm, shkretëtirat kthehen në kopshte të Parajsës, në sajë të dritës që rrezatojnë. Thëngjijtë janë transformuar në diamante. Cilësitë e baltës dhe gurit janë ngjitur në nivelin e arit dhe argjendit. Dhe gjithsecili është duke

biseduar rreth tyre tani, në pritje të ditëve kur dashuria, vëllazëria dhe toleranca që ata premtuan, do të përmbushen. Sot, vetëm ata që ngatërrojnë errësirën me dritën dhe që i çojnë jetët e tyre në botën e materialitetit, po flasin kundër tyre. Diskutuesit janë në ankth. Ujqit dhe çakejtë kanë nxjerrë dhëmbët. Budallenjtë janë të shqetësuar. Për mua është diçka e natyrshme dhe prandaj shprehem: "Çdokush tregon natyrën e vërtetë të tij ose të saj!"

Çfarëdo që të ndodhë, pavarësisht atyre që shuan qirinjtë, këta njerëz kanë ndriçuar gjatë zemrat e etura për dritë, kudo ku ata shkuan, treguan natyrën e vërtetë të gjërave dhe ngjarjeve, dhe kumtuan vlerat njerëzore universale për shpirtrat e paprishur.

Unë pa asnjë lëkundje besoj që, tamam si pengesat ndërkontinentale ishin kapërcyer dikur në sajë të Kuranit, dhe po ashtu dashuria, respekti dhe dialogu ishin vendosur në mënyrë permanente, një truall i ri për harmoninë dhe mirëkuptimin ka qenë ose do të gjendet sot nga përpjekjet e këtyre njerëzve me fat. Natyra njerëzore shfrytëzohet për të njohur kombin tonë, me pamjen e tij të qeshur dhe fatin e mbarë. Pse duhet që pikërisht ky fakt të mos jetë i vërtetë sot? Një lumë dashurie në mes njerëzve ka filluar të vërshojë në pothuajse çdo vend ku kanë shkelur këta përfaqësues të misionit. Ata janë flladi i lumturisë dhe gëzimit dhe njëri pas tjetrit mund të jenë ndjerë ngado. Përveç kësaj, ishujt e paqes, që ne mund t'i quajmë kështjella të pacenueshme të harmonisë dhe stabilitetit, janë krijuar afër dhe larg.

Kush e di, mbase në një të ardhme të afërt, në sajë të këtyre vullnetarëve që nuk kursyen vetveten me qëllim që të tjerët të jetojnë, mendja dhe shpirti do të përqafojnë njëri-tjetrin përsëri. Ndërgjegjja dhe logjika do të plotësojnë thellësitë e njëra-tjetrës, fizika dhe metafizika do të pushojnë luftën dhe do të tërhiqen në botët e tyre dhe gjithçka do të gjejë mundësinë për të shprehur bukurinë që e karakterizon përmes gjuhës së saj, kompleksiteti i normave dhe parimeve ligjvënëse të krijimit do të jetë rizbuluar,

njerëzit do të pendohen që kanë luftuar njëri-tjetrin për asgjë, atmosfera e paqes që nuk ekzistonte më parë në treg, në shkollë dhe në vatrat familjare, do të jetë vendosur dhe erërat e lumturisë do të fryjnë, pastërtia morale nuk do të jetë dhunuar, ndershmëria nuk do të jetë nëpërkëmbur, zemrat gjithmonë do të rrahin me respekt dhe vlerësim, asnjëri nuk do t'i ketë zili të tjerët për pasurinë ose reputacionin e tyre, i fuqishmi do të sillet drejtësisht me të dobëtin, i varfri dhe i dobëti do të kenë mundësinë që të jetojnë njerëzisht, askush nuk do të jetë ndaluar me forcë vetëm për dyshime, banesat dhe vendet e punës nuk do të jenë sulmuar, gjaku i askujt nuk do të derdhet dhe i dobëti nuk do të qajë, çdokush do të adhurojë Zotin dhe do të dojë njerëzimin. Vetëm atëherë kjo botë, që është korridori i parajsës, do të bëhet një Eden, që është magjepsës për të jetuar në të!

PERSPEKTIVAT GLOBALE

JETA E VËRTETË DHE NATYRA E VËRTETË NJERËZORE

Meqë jeta e "vërtetë" është e mundur vetëm nëpërmjet dijeve, ata që kanë lënë pas dore arsimimin dhe njohuritë konsiderohen të "vdekur," edhe kur janë biologjikisht të gjallë. Ne jemi krijuar për të mësuar dhe për t'u treguar të tjerëve ato që kemi përvetësuar.

Jeta e vërtetë është jetuar në nivelin shpirtëror. Ata që jetojnë me zemër, ata që mposhtin të kaluarën dhe të ardhmen, kapërcejnë kufizimin e kohës. Njerëzit e tillë nuk janë kurrë tejet të brengosur nga e kaluara e dhimbshme ose shumë të shqetësuar për të ardhmen. Ata që nuk janë të aftë të përjetojnë plotësisht ekzistencën në zemrat e tyre, ata që e kalojnë jetën përciptazi dhe në mënyrë të rëndomtë, janë gjithmonë të trishtuar dhe të mbytur në dëshpërim. Ata e konsiderojnë të kaluarën si një tronditje të rëndë dhe e shohin të ardhmen si një pus pa fund. Ata jetojnë në agoni, në mëdyshje nëse do të jetojnë ose vdesin.

Ne jemi të gjithë udhëtarë, kurse kjo botë është një demonstrim shumëngjyrësh dhe një libër i pasur dhe i gjallë. Ne jemi sjellë për ta studiuar këtë libër, për të pasuruar njohuritë spirituale dhe për të frymëzuar të tjerët. Ky udhëtim plot ngjyra dhe i këndshëm është një ngjarje e dikurshme. Për ata që i kanë ndjenjat dhe zemrën të zgjuar, ky udhëtim është më se i mjaftueshëm për të provuar një parajsë - si kopshtet me trëndafila. Por për ata që i kanë sytë e zëna, ky rrugëtim është sikur gjithçka largohet me një frymëmarrje të vetme.

Të përvuajturit dhe modestët janë shumë të vlerësuar nga

krijimi dhe Krijuesi. Arrogantët dhe mendjemëdhenjtë, ata që përçmojnë të tjerët dhe marrin një pamje kryeneçi, janë gjithmonë të padëshiruar nga krijimi dhe të ndëshkuar nga Krijuesi.

Përulësia është shenjë e virtytit dhe e pjekurisë, ndërsa arroganca dhe mendjemadhësia tregojnë një shpirt të mangët dhe të ulët. Krijesat njerëzore më të përsosura janë ata që gjejnë qetësinë dhe intimitetin në shoqërinë e të tjerëve. Në të kundërt, ata që janë tepër të ngrefosur për t'u lidhur me të tjerët dhe për të krijuar një shoqëri të ngrohtë, nuk janë më shumë se përfaqësues të papërsosmërisë. Përulësia i jep njeriut natyrën e tij të vërtetë. Një shenjë e përulësisë është kur njerëzit nuk ndryshojnë pasi kanë arritur një pozitë shoqërore apo pasi kanë vënë pasuri, pasi janë arsimuar apo kanë fituar famë, ose çdo gjë tjetër që mund të jetë vlerësuar publikisht. Nëse ndonjë prej këtyre rrethanave i nxit njerëzit të tjetërsojnë idetë, sjelljet dhe qëndrimin, atëherë ata nuk mund të vlerësohen se kanë arritur natyrën njerëzore të vërtetë apo përulësinë e vërtetë.

Kur keni marrëdhënie të ndërsjella me të tjerët, i trajtoni ata si një masë për të kuptuar nëse keni gjetur kënaqësi apo mërziti. Dëshironi për të tjerët atë që dëshironi për veten tuaj dhe mos harroni që çfarëdo që ju çon ju në pakënaqësi, do t'i shpjerë gjithashtu dhe të tjerët në pakënaqësi. Nëse ju e arrini këtë, do të jeni të pacenuar nga gabimet dhe sjellja e pahijshme dhe nuk do të fyeni të tjerët.

Pjekuria dhe përsosja e shpirtit do të thotë që ju duhet të jeni të drejtë në trajtimin e të tjerëve, veçanërisht ndaj atyre që ju kanë bërë padrejtësi. I ktheni veprimet e tyre të këqija në mirësi. Mos pushoni së bëri mirë edhe për ata që ju kanë dëmtuar ju. Më saktë, i trajtoni ata me mirësjellje dhe fisnikëri, shpagimin për të dëmshmit e merr dikush tjetër. Shpërblimi i së keqes me të keqe tregon dobësi karakteri, e kundërta është fisnikëria.

Nuk ka kufij për mirësitë ndaj të tjerëve. Ata që ia kanë kushtuar

jetën synimit për t'i sjellë të mira njerëzimit, janë po aq vetëmohues sa edhe ata që mund të kenë sakrifikuar jetët e tyre për të tjerët. Megjithatë, një altruizëm i tillë është një virtyt i madh vetëm nëse origjina e tij është në sinqeritetin dhe pastërtinë e qëllimit, ajo duhet të jetë larguar nga paragjykimet raciale apo fisnore.

Ata që i vlerësojnë edhe favoret më të mëdha që kanë bërë për të tjerët si gjëra të parëndësishme, ndonëse çmojnë shumë edhe favorin më të vogël të bërë për vetveten, janë të përsosurit që kanë fituar standardet hyjnore të sjelljes dhe kanë gjetur paqe në ndërgjegjen e tyre. Individët e tillë kurrë nuk do t'u kujtojnë të tjerëve të mirat që kanë bërë për ta dhe kurrë nuk do të ankohen pasi të tjerët të tregohen indiferentë ndaj tyre.

NJË PERQASJE KRAHASUESE PËR ISLAMIN DHE DEMOKRACINË [80]

Feja, në veçanti Islami, është një nga temat më të vështira të debatuara në vitet e fundit. Kultura bashkëkohore, nëse propozohet nga perspektiva e antropologjisë, psikologjisë ose psikanalizës, e vlerëson fenë me metoda empirike. Në njërën anë, feja është përjetim në vetvete dhe fenomen i ndjerë, që për pjesën më të madhe, lidhet me aspektet permanente të jetës. Në anën tjetër, besimtarët mund ta shohin fenë e tyre si një filozofi, si një formë të parimeve racionale ose thjesht si misticizëm. Vështirësia e ngritjes së çështjes së Islamit qëndron në faktin që disa myslimanë dhe politikanë e konsiderojnë dhe e prezantojnë atë më shumë si një ideologji politike, sociologjike dhe ekonomike, sesa si një fe.

Nëse ne dëshirojmë të analizojmë saktë fenë, demokracinë apo çdo sistem ose filozofi tjetër, duhet të fokusohemi tek natyra njerëzore dhe jeta njerëzore. Nga kjo perspektivë, feja në përgjithësi dhe Islami në veçanti, nuk mund të krahasohen në të njëjtat baza me demokracinë apo me çdo sistem tjetër politik, social ose ekonomik. Feja fokusohet së pari në aspektet e pandryshueshme të jetës dhe ekzistencës, ndërsa sistemet apo ideologjitë politike, sociale dhe ekonomike interesohen vetëm për ca aspekte të paqëndrueshme shoqërore të jetës sonë tokësore.

Aspektet e jetës me të cilat është e lidhur së pari feja, janë sot po aq aktuale sa ishin me lindjen e njerëzimit dhe do të vazhdojnë të jenë të tilla edhe në të ardhmen. Sistemet tokësore ndryshojnë në përputhje me rrethanat dhe si rrjedhojë mund të vlerësohen

[80] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *SAIS Review*, 21:2 (Summer-Fall 2001):133-38.

vetëm në pajtim me kohën e tyre. Besimi në Zot, jeta e përtejme, profetët, librat e shenjtë, engjëjt dhe fati hyjnor mbeten të njëjtë, pavarësisht nga ndryshimi i kohërave. Gjithashtu, standardet universale dhe të pandryshueshme të adhurimit dhe moralit kanë të bëjnë pak me kohën dhe jetën tokësore.

Prandaj, kur krahasojmë fenë ose Islamin me demokracinë, ne duhet të kujtojmë që demokracia është një sistem që zhvillohet dhe revizionohet vazhdimisht. Ajo gjithashtu ndryshon në përputhje me vendet dhe rrethanat ku është ushtruar. Në njërën anë, feja ka vendosur principe të pandryshueshme në lidhje me besimin, adhurimin dhe moralin. Prandaj, vetëm aspektet temporale të Islamit duhet të jenë të krahasueshme me demokracinë.

Qëllimi madhor i Islamit dhe i dimensioneve të tij të pandryshueshme ka të bëjë me normat e tij duke përcaktuar aspektet e ndryshueshme të jetës sonë. Islami nuk parashtron një formë të sigurt të pandryshueshme të qeverisjes ose të përpjekjeve për ta modeluar atë. Në vend të kësaj, Islami vendos principet fondamentale që orientojnë një karakteristikë të përgjithshme të qeverisjes, duke i lënë njerëzit të zgjedhin modelin dhe formën e saj në përputhje me kohën dhe rrethanat. Nëse ne e shohim çështjen nga ky këndvështrim dhe e krahasojmë Islamin me demokracinë moderne liberale të ditëve të sotme, do të jemi edhe më të aftë për ta kuptuar pozicionin e Islamit dhe demokracisë në lidhje me respektin ndaj njëri-tjetrit.

Idetë demokratike vijnë nga kohët e hershme. Demokracia moderne liberale lindi në Amerikë (1776) dhe me revolucionin francez (1789-1799). Në shoqëritë demokratike, popujt qeverisin vetveten duke kundërshtuar të jenë të drejtuar nga dikush më lart. Individi ka përparësi mbi komunitetin në këtë model të sistemit politik, duke qenë i lirë për të vendosur si ta jetojë jetën e tij ose të saj. Megjithëse individualizmi nuk është absolut. Njerëzit jetojnë një jetë më të mirë duke ekzistuar brenda një shoqërie dhe kjo

kërkon që ata të korrigjojnë dhe kufizojnë liritë e tyre në përputhje me kriteret e jetës shoqërore.

Profeti thotë që të gjithë njerëzit janë të njëjtë, si dhëmbët e një krehri. Islami nuk bën dallime të bazuara në racën, ngjyrën, moshën, nacionalitetin apo në veçoritë fizike. Profeti deklaronte: *Ju jeni të gjithë nga Ademi dhe Ademi është nga dheu. O shërbëtorë të Zotit, jini vëllezër (dhe motra)!*[81]

Ata që kanë lindur më parë, që kanë më shumë pasuri ose pushtet se të tjerët, apo që bëjnë pjesë në familje ose në grupe etnike të sigurta, nuk kanë ndonjë privilegj të natyrshëm për të sunduar të tjerët.

Islami gjithashtu miraton parimet fondamentale në vijim:

1. Pushteti krijon përshtypjen e gabuar sikur e vërteta mbështetet te fuqia.

2. Drejtësia dhe normat e ligjit janë esenciale.

3. Liria e besimit dhe e drejta e jetës, pasuria personale, riprodhimi dhe shëndeti (mendor dhe fizik) nuk mund të dhunohen.

4. Jeta private dhe imuniteti individual duhet të jenë të paprekshëm.

4. Asnjë nuk mund të dënohet për një krim pa prova ose të akuzohet dhe ndëshkohet për krimet e dikujt tjetër.

5. Një sistem këshillimor i qeverisjes është esencial.

Të gjitha të drejtat kanë rëndësi të njëjtë dhe të drejtat e individëve nuk mund të sakrifikohen për hir të shoqërisë. Islami konsideron që një shoqëri të jetë ndërtuar me individë të ndërgjegjshëm të pajisur me vullnet të lirë dhe që kanë përgjegjësi për veten dhe të tjerët. Islami shkon një hap më tutje duke shtuar një dimension kozmik. Ai e vështron njerëzimin si "motorin" e historisë, në kundërshtim me mënyrat fataliste të disa filozofive

[81] Fragment nga hutbeja (ligjërata) e lamtumirës e profetit Muhamed.

perëndimore të historisë të shekullit XIX, siç janë materializmi dialektik dhe historik. Pikërisht si vullneti dhe qëndrimi i çdo individi përcakton pasojat për jetën e tij ose të saj në këtë botë dhe në botën e përtejme, progresi ose rënia e një shoqërie përcaktohet nga vullneti, botëkuptimi dhe mënyra e jetës së banorëve të saj. Kurani shprehet:

Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) nëse ata nuk e ndryshojnë veten e tyre (lidhur me besimin, botëkuptimin dhe mënyrën e jetës)… (Rra'd, 11)

Me fjalë të tjera, çdo shoqëri e ka fatin në duart e veta. Tradita profetike thekson këtë ide: "Ju do të keni atë qeverisje që meritoni."[82] Ky është tipari dhe fryma themelore e demokracisë, një ide që nuk bie në kundërshtim me asnjë parim islam.

Siç i vlerëson Islami individët dhe shoqëritë si përgjegjës të fateve të tyre, popujt duhet të jenë përgjegjës për qeverisjen e vetes. Kurani i drejtohet shoqërisë me fraza të tilla, si: "O njerëz!" dhe "O besimtarë!" Detyrimet që përmbajnë sistemet demokratike moderne janë ato që Islami ka ngarkuar dhe rezervuar për shoqërinë, sipas rëndësisë, si "absolutisht të nevojshme, relativisht të nevojshme dhe të lavdërueshme për t'u zbatuar." Teksti i shenjtë përmban pasazhet e mëposhtme:

Qëndroni, të gjithë ju, në paqe!(Bekare, 208)

Ecni në rrugën e Allahut me çfarë është e duhur nga të mirat që ju keni fituar dhe që Ne ju kemi dhënë nga toka…(Bekare, 267)

Nëse disa nga gratë tuaja janë akuzuar për imoralitet, ju duhet të keni katër dëshmitarë (për ta provuar atë)… (Nisa, 15)

Allahu ju urdhëron që amanetet t'ua ktheni atyre që u përkasin, dhe kur të gjykoni mes njerëzve, gjykoni drejtë... (Nisa, 58)

... zbatoni drejtësinë të palëkundur, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe nëse është kundër jush, kundër prindërve ose të afërmve tuaj... (Nisa, 135)

[82] el-Hindi, Kenzu'l-Ummal, 6:89.

Nëse shfaqin prirje për paqe, atëherë edhe ti ano kah ajo e mbështetu tek Allahu, sepse, vërtet Ai dëgjon dhe di gjithçka. Enfal, 61)

... nëse ndonjë i papërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje... (Huxhurat, 6)

Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet tyre, pajtojini ata… (Huxhurat, 9)

Më shkurt, Kurani u adresohet të tërë bashkësive dhe lë pothuajse të gjitha detyrat që janë vënë në sistemet demokratike moderne.

Njerëzit bashkëpunojnë me njëri-tjetrin duke i ndarë këto detyra dhe duke vënë themelet bazë për t'i zbatuar ato. Qeverisja është kompozuar nga të gjithë këto elemente esenciale. Prandaj Islami propozon një qeverisje të bazuar në një kontratë sociale. Popujt zgjedhin administruesit dhe vendosin një këshill për të diskutuar çështjet e përbashkëta. Përgjatë sundimit të katër kalifëve të parë, të të parit në veçanti (Ebu Bekr), parimet fundamentale të qeverisjes të përmendura më lart - duke përfshirë edhe zgjedhjet e lira - qenë respektuar plotësisht. Sistemi politik u transformua në një sulltanat pas vdekjes së Aliut, kalifit të katërt, për shkak të konflikteve të brendshme dhe të kushteve të përgjithshme në atë kohë. Ndryshe nga kalifati, pushteti i sulltanatit kalonte përmes familjes së sulltanit. Ndonëse zgjedhjet e lira nuk ishin mbajtur për një kohë të gjatë, shoqëria u përmbahej parimeve të tjera që gjenden sot në thelbin e demokracive liberale.

Islami është një fe përfshirëse e bazuar në besimin në një Zot si Krijuesi, Ushqyesi dhe Administruesi i universit. Islami është një fe për të tërë universin. Kjo do të thotë se mbarë universi i bindet ligjeve të vendosura nga Zoti. Gjithçka në univers është "Islame" dhe i bindet Zotit duke iu nënshtruar ligjeve të Tij. Edhe një person që refuzon të besojë në Zot ose që ndjek një tjetër fe,

ka për të qenë një mysliman me detyrim ngaqë ekzistenca fizike është e interesuar për këtë. E tërë jeta jonë, nga faza embrionale deri tek tretja dhe kthimi i trupit në hi pas vdekjes, çdo ind i muskujve dhe çdo gjymtyrë e trupit ndjek rrjedhën e caktuar nga ligjet e Zotit. Prandaj në Islam, Zoti, natyra dhe njerëzimi nuk janë as të veçuar dhe as të papranueshëm për njëri-tjetrin. Zoti e bën të njohur Veten për njerëzimin përmes natyrës dhe vetë krijesës njerëzore dhe, natyra dhe njerëzimi janë dy librat (e krijimit) përmes së cilëve çdo fjalë e Zotit është bërë e njohur. Kjo e drejton njerëzimin që ta shohë gjithçka si mall të të njëjtit Zot, të cilit ata vetë i përkasin dhe, për pasojë, duke mos vlerësuar asgjë në univers si të huaj. Pëlqimi, dashuria dhe thirrja e Tij nuk kufizohen në popujt e një race, ngjyre apo etnie të veçantë. Profeti e përmbledh këtë me porosinë: "O shërbëtorë të Zotit, jini vëllezër (dhe motra)!"

Një aspekt i veçantë por po aq i rëndësishëm është që Islami i njeh të gjitha fetë që kanë ardhur para tij. Ai i pranon që të gjithë profetët dhe librat e shenjtë që u dërguan për popuj të ndryshëm në epoka të ndryshme të historisë. Jo vetëm i pranon ato, por gjithashtu e vlerëson besimin tek ato si një princip esencial për të qenët mysliman. Në këtë mënyrë, Islami pohon unitetin thelbësor të të gjitha feve. Një mysliman është, në të njëjtën kohë, një ndjekës besnik i Ibrahimit, Musait dhe Davudit, i të gjithë profetëve të tjerë hebrenj dhe i Isait (Jezusit). Ky besim shpjegon pse të krishterët dhe hebrenjtë u gëzohen të drejtave të tyre fetare që burojnë nga sundimi i qeverisjeve Islame përgjatë historisë.

Sistemi shoqëror Islam kërkon të formojë një shoqëri të virtytshme dhe, si rrjedhim, të fitojë pëlqimin e Zotit. Ai njeh të drejtën dhe jo forcën në themel të jetës shoqërore. Armiqësia është e papranueshme. Marrëdhëniet duhet të bazohen në besim, dashuri, respekt reciprok, ndihmë dhe në mirëkuptim, në vend të konflikteve dhe kërkimit të interesave personale. Edukimi shoqëror i nxit njerëzit të jenë në kërkim të idealeve të larta dhe

të përpiqen për t'u përsosur, jo vetëm të vrapojnë pas dëshirave të tyre. Thirrjet e mbështetura në bashkimin dhe ndershmërinë sjellin ndihmë të ndërsjellët dhe solidaritet dhe besimi siguron vëllazërinë. Duke inkurajuar shpirtin të arrijë përsosmërinë, sjellim lumturinë në të dy botët.

Demokracia ka përparuar së bashku me kohën. Ashtu siç ajo ka përshkuar stade të ndryshme në të kaluarën, do të vazhdojë të evoluojë dhe përmirësohet në të ardhmen. Gjatë rrugës, ajo do të jetë shndërruar në një sistem më të drejtë dhe human, bazuar në drejtësinë dhe realitetin. Nëse krijesat njerëzore janë konsideruar si një e tërë, pa shpërfillur dimensionin dhe nevojat shpirtërore të ekzistencës së tyre dhe pa harruar që jeta njerëzore nuk është e kufizuar me këtë jetë të vdekshme dhe që të gjithë njerëzit lakmojnë amshimin, demokracia mund të arrijë kulmin e perfeksionit dhe të sjellë edhe më shumë lumturi për njerëzimin. Parimet Islame të barazisë, tolerancës dhe drejtësisë mund ta ndihmojnë atë për ta arritur këtë.

NË PRAG TË MIJËVJEÇARIT TË RI [83]

Pikërisht si çdo agim dhe çdo pranverë që vjen simbolizon një fillim dhe shpresë të re, edhe një shekull dhe mijëvjeçar i ri shprehin të njëjtën gjë. Në këtë kontekst, brenda ingranazheve të kohës, mbi të cilat ne nuk kemi kontroll, njerëzimi ka kërkuar gjithmonë një shkëndijë të re të jetës, një erë të freskët si flladi i agimit, dhe ka shpresuar dhe dëshiruar të hedhë një hap në dritë duke lënë pas errësirën, sikur të ishte duke kapërcyer një prag.

Ne vetëm mund të hamendësojmë rreth shfaqjes së burrit dhe gruas së parë në tokë. Toka është e barazvlerësuar me qiejt meqë qielli nxjerr në pah krijimet hyjnore dhe sepse ai përmban domethënien ontologjike. Vlera e tokës rrjedh para së gjithash nga anëtari i saj: njerëzimi. Në përputhje me kalendarin që ne përdorim sot, jemi në prag të mijëvjeçarit të tretë pas lindjes së Isait (Jezusit), paqja qoftë mbi të! Meqë koha vërtitet dhe ecën përpara me një relativitet helikoidal, ka kritere të ndryshme për matjen e saj në botë. Për shembull, në përputhje me matjen e kohës që rëndom ka një pranim të përgjithshëm, bota është në prag të kapërcimit të një mijëvjeçari të ri. Në përputhje me kalendarin hebre, ne jemi tashmë në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të tetë. Brenda sistemit kohor hindu, ne jemi duke jetuar në epokën e Kali Jugas. Nëse ndjekim kalendarin islam, ne jemi duke iu afruar fundit të gjysmës së parë të mijëvjeçarit të dytë.

Ne megjithatë duhet të kujtojmë se çdo matje e kohës është asgjë më shumë se një matje relative. Ndërsa një periudhë 100-vjeçare është pranuar të jetë masë për një shekull, ideja e shekullit

[83] Origjinali i këtij artikulli përmbahet në *The Fountain*, Issue No: 29 (January-March 2000) f. 4-9,

60-vjeçar, bazuar në gjatësinë e jetës së një personi të zakonshëm, gjithashtu ia vlen të përmendet. Nga kjo pikë vështrimi, ne jemi tashmë në mijëvjeçarin e katërt pas lindjes së Isait (Jezusit) paqja qoftë mbi të, dhe në mijëvjeçarin e tretë pas *hixhretit* (emigrimi i Profetit nga Meka në Medinë), momenti nga fillon kalendari islam. Unë e ngrita këtë çështje sepse njerëzit nuk po ndjehen të qetë shpirtërisht, veçanërisht në perëndim, për arsye të ogurit të tmerrshëm që besojnë se lidhet me ardhjen e mijëvjeçarit.

Njerëzit jetojnë me shpresë të vazhdueshme dhe prandaj ngjajnë fëmijë për të. Në çastin që ata e humbin shpresën, gjithashtu shuajnë "zjarrin" e jetës së tyre, nuk ka rëndësi nëse ekzistenca fizike vazhdon. Posedimi i shpresës është në proporcion të drejtë me posedimin e besimit. Ashtu si dimri vazhdon në një të katërtën e vitit, periudhat e jetës së një njeriu apo të një shoqërie që korrespondojnë me dimrin, janë relativisht të vogla. Mekanizmat e akteve hyjnore sillen rreth urtësive të kuptueshme dhe qëllimeve të mëshirshme. Këta na vënë ne në dijeni, tamam siç zhvendosjet e ditës dhe natës ndërtojnë shpresën dhe rilindin shpirtin e njeriut dhe çdo vit i ri vjen me mundësinë e pranverës dhe verës, që në jetën e një individi dhe në historinë e një kombi periudhat shkatërrimtare janë të shkurtra dhe të ndjekura nga kohë të gëzuara.

Ky cikël i "ditëve të Zotit" që është qendërzuar në Urtësinë Hyjnore, nuk është as i frikshëm dhe as tepër pesimist për ata që kanë besim, intuitë dhe perceptim të vërtetë. Më drejt, ai është një burim për refleksionet e vazhdueshme, kujtesën dhe lutjet e falënderimit për ata që kanë një zemër të zgjuar, një perceptim të brendshëm dhe aftësi për të dëgjuar. Në të njëjtën mënyrë si dita vjen nga zemra e natës dhe si dimri ushqen thellësitë e tokës me të cilat vjen pranvera, jeta e njeriut është pastruar, maturuar dhe jep frytet e saj të shpresuara brenda këtij cikli. Gjithashtu brenda këtij cikli, aftësitë njerëzore të dhëna nga Zoti bëhen prirje dhe talente, mendimi shkencor lulëzon si trëndafilat duke përparuar

teknologjinë në bankën e punës së kohës dhe njerëzimi gradualisht i afrohet fundit të paracaktuar.

Duke qëndruar në këtë vështrim të përgjithshëm, që nuk është as personal dhe as subjektiv, por i saktë në faktin objektiv të historisë njerëzore, nuk do të thotë që ne mirëpresim dimrin ose eventualitetet përkatëse që ngjajnë me të siç janë hidhërimet, sëmundjet dhe katastrofat. Pavarësisht prej faktit të përgjithshëm që sëmundja në fund të fundit rrit rezistencën e trupit, forcon sistemin imunitar dhe i jep shtytje progresit të mjekësisë, ajo është patologjike dhe e dëmshme. I njëjti gjykim vlen dhe për katastrofat tokësore dhe qiellore. Nga këndvështrimi teologjik dhe moral, ato janë rezultat i mëkateve dhe ndjenjave tona mbytëse që janë mjaft të mëdha për të tronditur tokën dhe qiejt, dhe prej përfshirjes në vepra që janë shpallur të ndaluara dhe përbuzjes ndaj ligjit dhe etikës (fetare ose laike). Edhe nëse këto sëmundje, i zgjojnë njerëzit që të kuptojnë gabimet dhe neglizhencën e tyre dhe, shkaktojnë zhvillimin e gjeologjisë, arkitekturës, inxhinierisë dhe treguesve që lidhen me ta, edhe nëse ato lartësojnë dashuritë e shkatërruara të besimtarëve në nivelin e dhembshurisë dhe vetë besimtarët në nivelin e flijimit, këto katastrofa i sjellin më shumë rrënim dhe dëme njerëzimit.

Në të njëjtën mënyrë, ne lexojmë në Kuran:

... Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat adhurohet Zoti.(Haxh, 40)

Me fjalë të tjera, Zoti do të jetë aq pak i njohur për meshkujt dhe femrat të cilët janë të prirur për të mos pohuar që gjithçka është superiore për vetë ata dhe që nuk besojnë që do të përgjigjen për veprat e tyre në botën e përtejme, për pasojë, do të shthuren plotësisht dhe do ta bëjnë tokën të papërshtatshme për jetën njerëzore. Gjithashtu është dhe dispozita hyjnore:

Ju mund të urreni diçka, ndërkohë që ajo është e mirë për ju,

dhe mund të dëshironi diçka, ndërkohë që ajo është e keqe për ju.(Bekare, 126)

Për shembull, lufta është e lejueshme. Ndonëse, luftërat e bazuara në parime specifike dhe në synimin për të përmirësuar situatat ekzistuese, mund të jenë të dobishme, ato sjellin dëme, lënë prapa shtëpi të rrënuara, familje të shkatërruara dhe vajtimin e jetimëve dhe grave të veja.

Përveç kësaj, realitetet e jetës nuk mund neglizhohen ose të injorohen. Krijesat njerëzore janë pasqyrim i Emrave dhe Atributeve të Zotit, dhe prandaj janë dalluar nga krijesat e tjera, duke qenë vlerësuar me përgjegjësinë për ta bërë tokën të begatë me emrat e Tij. Nëse ata nuk kuptojnë urtësinë dhe qëllimet prapa çdo të mire ose të keqeje që ka ardhur në udhën e tyre nga Krijuesi i tyre, atëherë nuk mund t'i shpëtojnë dëshpërimit apo pesimizmit. Për njerëzit e tillë, siç mund të jetë vështruar në literaturën ekzistencialiste, jeta kthehet në një proces të pakuptimtë, ekzistenca në një zbrazëti të paqëllimtë, absurditeti në kriterin e vetëm, vetëvrasja në një akt të denjë dhe vdekja bëhet një realitet i pashmangshëm.

Natyra e njeriut

Pasi paraqitëm, si një hyrje, çështjet që krijojnë bazat e kësaj teme, ne mund të ndryshojmë gjykimet në lidhje me mijëvjeçarin e tretë.

Historia njerëzore fillon me dy njerëz që përbëjnë esencën e njerëzimit dhe plotësuan njëri-tjetrin. Njeriu jetoi qetësisht gjatë kohës së nënës dhe babait të parë dhe familjeve që rridhnin prej tyre. Ata ishin një bashkësi që kishin të njëjtin vështrim dhe ndanin të njëjtën jetë dhe të njëjtin mjedis.

Që nga ajo ditë, esenca e njerëzimit ka qëndruar e pandryshuar dhe ashtu do të qëndrojë përsëri. Realitetet rreth jetëve të tyre, struktura fizike, karakteristikat kryesore, nevojat bazë, vendi dhe

koha e lindjes dhe vdekjes, seleksionimi i prindërve dhe fizikut të tyre, cilësitë e bashkëlindura, si edhe mjedisi natyror përreth, nuk kanë ndryshuar. Të gjitha këto kërkojnë disa realitete dhe vlera esenciale dhe vitale të pandryshueshme. Prandaj zhvillimi dhe ndryshimi i realitetit të dytë të jetës duhet të jetë bazuar në boshtin e këtyre realiteteve dhe vlerave themelore, kështu që jeta do të vazhdojë si një parajsë tokësore nën hijen e parajsës së vërtetë.

Ne përmendëm më sipër disa çështje që ngjajnë të jenë të dëmshme ose të pakëndshme. Gjithashtu, veçoritë njerëzore që duket të jenë të këqija, në fillim shkëlqejnë. Të tilla janë urrejtja, xhelozia, armiqësia, dëshira për të sunduar të tjerët, lakmia, zemërimi dhe egoizmi. Një krijesë njerëzore ka, gjithashtu, stimuj dhe nevoja të natyrshme që lejojnë vazhdimin e jetës tokësore të tij ose të saj, siç është nevoja për të ngrënë dhe për të pirë dhe stimujt e epshit dhe zemërimit. Të gjithë stimujt, nevojat dhe dëshirat njerëzore duhet të jenë drejtuar dhe edukuar në drejtim të vlerave të përjetshme, universale dhe të pandryshueshme që u kushtohen aspekteve fondamentale të njerëzimit. Në këtë kontekst, nevoja për të ngrënë dhe për të pirë, dhe dëshirat e bashkëshoqëruara me epsh dhe zemërim mund të jenë shfrytëzuar dhe transformuar në domethënien e së mirës absolute dhe relative.

Gjithashtu, egoizmi dhe urrejtja mund të bëhen burime të cilësive të bukura dhe të mirësisë. Xhelozia dhe rivaliteti mund të jenë shndërruar në një garë të veprave të mira dhe mirëbërëse. Ndjenja e armiqësisë mund të jetë transformuar në armiqësi kundër djallit, armikut më të madh të njerëzimit, dhe kundër ndjenjës së armiqësisë dhe urrejtjes për veten. Lakmia dhe pasioni mund të përdoren për të kryer vepra të mira pa u lodhur. Egoizmi mund të vërë në dukje aspektet e këqija të ndjenjave fizike, prandaj duhet të kërkojmë të edukojmë dhe të pastrojmë shpirtin dhe jo të shfajësojmë veprimet e këqija.

Të gjitha ndjenjat negative mund të jenë transformuar në burime të së mirës përmes përpjekjeve dhe edukimit. Në këtë mënyrë, njeriu arrin nivelin e "më të lartit ndër krijesat" duke udhëtuar në rrugën e transformimit nga një krijesë njerëzore potenciale në një krijesë njerëzore të vërtetë dhe të përsosur, në simbolin, modelin dhe përfaqësuesin personal më të mirë të krijimit dhe ekzistencës.

Pavarësisht nga ky fakt, realitetet e jetës njerëzore nuk ndjekin gjithmonë këto linja udhëzuese. Ndjenjat dhe veçoritë negative shpesh herë i thyejnë njerëzit duke dominuar me një shtrirje të tillë që edhe fetë që i drejtojnë njerëzit tek mirësia dhe mirësjellja, janë nëpërkëmbur, për të mos lavdëruar ndjenjat dhe cilësitë që janë burim i së mirës absolute. Jeta njerëzore, në nivelin individual dhe të njerëzimit si një të tërë, është thjesht përmbledhje e përpjekjeve personale të brendshme dhe manifestimit të tyre të jashtëm. Këto drejtime përbëjnë shoqërinë, historinë dhe botën personale të individit në fushën e betejës, përpjekjeve, luftës, shtypjes dhe tiranisë. Si rrjedhim, është përgjithësisht krijesa njerëzore që vuan pasojat.

Ne gjithmonë vjelim frytet e veprave tona. Në periudhën e parë të historisë së tij, njerëzimi jetoi në lumturi si një shoqëri e bashkuar, anëtarët e së cilës ndanin gëzimet dhe hidhërimet e tyre. Por pastaj ata lidhën grykët dhe këmbët e tyre me një zinxhir të ndryshkur të formuar me vargonjtë e shtypjes. Ky ishte rezultat i xhelozisë, makutërisë dhe lakmisë për të drejtat dhe pasurinë e të tjerëve. Pasoja ishte vrasja e Habilit nga Kabili. Si rrjedhim, njerëzimi hyri shkallë-shkallë në udhën e përçarjes. Pavarësisht se mijëvjeçarët rrjedhin njëri pas tjetrit, ashtu si ditët, stinët, dhe vitet, ky "cikël" vazhdon akoma.

Mijëvjeçari i dytë

Mijëvjeçari i dytë filloi me kryqëzatat dhe pastaj me pushtimin mongol në botën islame, që në atë kohë ishte zemra e botës dhe

historisë. Pavarësisht nga luftërat dhe shkatërrimet, pavarësisht nga krimet e kryera, nganjëherë në emër të fesë dhe nganjëherë në emër të epërsisë ekonomike, politike dhe ushtarake, ky mijëvjeçar shihet si kulmi i qytetërimit oriental, një qytetërim i bazuar në vlerat shpirtërore, metafizike, universale dhe të përjetshme, ndërsa qytetërimi perëndimor bazohet në shkencat fizike. Shumë zbulime gjeografike dhe shkencore ndodhën gjatë këtij mijëvjeçari.

Megjithatë, qytetërimi oriental dhe perëndimor ekzistonin të ndarë nga njëri-tjetri. Kjo ndarje, që nuk duhej të kishte ndodhur, ishte bazuar në faktin që i pari distancohej nga përpjekjet e inteligjencës dhe shkencës, ndërsa i dyti distancohej nga bota shpirtërore, metafizika dhe vlerat e përjetshme dhe të pandryshueshme. Si rrjedhim, shekujt e fundit të mijëvjeçarit të dytë dëshmuan katastrofa që për ne janë të vështira për t'u kuptuar. Për shkak të rritjes së arrogancës dhe egoizmit njerëzor, të nxitur nga aftësitë e tij, popujt do të përjetonin kolonializmin, masakrat e egra, revolucionet që flijuan miliona jetë njerëzore, gjakderdhjet e paimagjinueshme dhe luftërat shkatërrimtare, diskriminimin racial, padrejtësitë e pafundme shoqërore dhe ekonomike dhe perdet e hekurta ndërtuar nga regjimet që me ideologjinë dhe filozofinë e tyre kërkonin të mohonin esencën, lirinë, vlerën dhe nderin e natyrës njerëzore. Gjithçka përmendëm më sipër dhe po ashtu disa shenja nga Bibla janë arsyet e frikës që ka pushtuar Perëndimin që bota përsëri do të përmbytet nga lumenjtë e gjakut dhe shkatërrimet. Ata janë plotësisht pesimistë dhe të shqetësuar për faktin se si do të rrjedhë ky mijëvjeçar i ri.

Shpresat tona

Mjetet moderne të komunikimit dhe transportit e kanë transformuar botën në një fshat të madh global. Kështu, ata që besojnë dhe qëndrojnë të kufizuar në pikëpamjen që çdo ndryshim radikal në një vend përcaktohet për shkak të situatave

të brendshme dhe jo nga influencat jashtë tij, janë jashtë realitetit të sotëm. Kjo është koha e marrëdhënieve ndëraktive. Kombet dhe popujt janë më shumë në nevojë dhe kushtëzohen nga njëri-tjetri, një situatë që shkakton afërsi në marrëdhëniet e ndërsjella.

Ky rrjet i marrëdhënieve që ka lënë pas periudhën e shëmtuar të kolonializmit dhe ekziston në bazë të interesit të ndërsjellët, siguron përfitime edhe për pjesën e prapambetur. Përveç kësaj, në sajë të përparimit të teknologjisë, veçanërisht asaj elektronike dixhitale, grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit gradualisht po vjen duke u rritur. Si rezultat, individët dalin në ballë duke e bërë të pashmangshëm zëvendësimin e regjimeve shtypëse me qeveritë demokratike që respektojnë të drejtat e njeriut.

Ashtu siç çdo njeri, ndryshe nga kafshët, simbolizon të gjithë njerëzimin, të drejtat e individit nuk mund të jenë sakrifikuar për shoqërinë, dhe të drejtat shoqërore duhet të jenë të kushtëzuara nga të drejtat e individit. Kjo është arsyeja pse të drejtat dhe liritë themelore njerëzore që gjenden në fetë e reveluara ishin marrë në bordin e një Perëndimi të sfilitur nga lufta. Këtyre të drejtave u është dhënë përparësi në të gjitha marrëdhëniet. E drejta e parë është ajo për jetën, e cila është dhënë nga Zoti dhe mund të merret vetëm prej Tij. Për të nxjerrë në pah rëndësinë e kësaj të drejte në Islam, ka një parim themelor në Kuran:

... kush e vret një njeri (pa të drejtë), që nuk ka vrarë njeri ose që nuk ka sjellë çrregullim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si të kishte vrarë gjithë njerëzit. E kush shpëton një jetë, është si të kishte shpëtuar jetën e të gjithë njerëzve.(Maide, 32)

Të drejta të tjera janë liria e fesë dhe e besimit, liria e mendimit dhe e shprehjes, e drejta e pasurisë dhe shenjtëria e familjes, e drejta për t'u martuar dhe për të pasur fëmijë, për të komunikuar dhe udhëtuar, dhe e drejta e arsimimit të lirë. Parimet e jurisprudencës islame janë bazuar në këto dhe në të drejta të tjera, të cilat tani, të gjitha, janë pranuar nga sistemet e ligjshme moderne, të tilla

si mbrojtja e jetës, fesë, pasurisë, riprodhimit, intelektit si edhe kuptimi thelbësor i barazisë së popujve, që është bazuar në faktin që të gjithë popujt janë krijesa njerëzore dhe prandaj nuk pranohet diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës dhe gjuhës. Të gjitha këto do të jenë - dhe duhet të jenë - bazat e domosdoshme të mijëvjeçarit të ri.

Unë shpresoj dhe besoj që bota e mijëvjeçarit të ri do të sjellë lumturi, do të jetë më e drejtë dhe më e mëshirshme, në kundërshtim me frikën e disa popujve. Islami, krishterimi dhe judaizmi, rrjedhin të gjitha nga e njëjta rrënjë, të gjitha kanë në mënyrë thelbësore të njëjtën bazë besimi dhe janë ushqyer nga i njëjti burim. Megjithëse ata kanë jetuar si fe rivale për shekuj me radhë, pikat e përbashkëta dhe ndarja e përgjegjësive për të ndërtuar një botë të lumtur për të gjithë krijesat e Zotit e bën të nevojshëm dialogun ndërfetar në mes tyre. Ky dialog tani është shpalosur për të përfshirë dhe fetë aziatike dhe të zonave të tjera. Rezultatet janë pozitive.

Siç u theksua më sipër, ky dialog do të zhvillohet si një proces i nevojshëm dhe ndjekësit e të gjitha feve do të gjejnë rrugët për t'u bërë të afërt dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin.

Gjeneratat e shkuara dëshmojnë një përleshje të ashpër që kurrë nuk duhet të zërë vend: shkenca kundër fesë. Ky konflikt që i jep krah ateizmit dhe materializmit, ka ndikuar më shumë se në çdo fe tjetër te krishterimi. Shkenca nuk mund të kundërshtojë fenë, qëllimi i saj është të kuptojë natyrën dhe njerëzimin, që janë secili një kompozim i manifestimeve të Atributeve të Zotit të vullnetit dhe fuqisë. Feja e ka burimin e saj në Atributin Hyjnor të shprehjes, të manifestuar në rrjedhën e historisë njerëzore në shkrimet e shenjta, siç janë Kurani, ungjijtë, Dhiata e Vjetër dhe e Re dhe të tjera që kanë qenë reveluar nga profetët e vërtetë duke filluar nga Ademi. Në sajë të përpjekjeve të studiuesve dhe teologëve krishterë dhe myslimanë, duket që konflikti midis fesë

dhe shkencës që ka vazhduar për pak shekuj, do të vijë në një fund, ose më e pakta absurditeti i tij do të jetë më në fund i pranuar.

Fundi i këtij konflikti dhe një formë e re e edukimit që i bashkëngjit njohuritë fetare dhe shkencore me moralin dhe spiritualitetin, do të krijojë njerëz vërtet pa paragjykime me zemrat e ndriçuara nga shkencat fetare dhe shpirtërore, me mendjet e ndriçuara nga shkencat pozitiviste, të karakterizuar nga të gjitha llojet e meritave njerëzore dhe vlerat morale, kompetentë për kushtet social-ekonomike dhe politike të kohës së tyre. Bota jonë e vjetër do të përjetojë një "pranverë" të çuditshme përpara vdekjes së saj. Kjo pranverë do të shohë hendekun e ngushtuar midis të pasurve dhe të varfërve, pasuritë e botës do të shpërndahen më me drejtësi, në përputhje me punën, kapitalin dhe nevojat, nuk do të ketë diskriminim të bazuar në racën, ngjyrën, gjuhën dhe botëkuptimin, liritë dhe të drejtat themelore njerëzore do të jenë të mbrojtura. Individët do të dalin në krye dhe duke mësuar se si të shfrytëzojnë mundësitë e tyre, do të fluturojnë në udhën për t'u bërë "krijesa njerëzore më e lartësuar" me krahët e dashurisë, dijeve dhe besimit.

Në këtë pranverë të re, kur progresi shkencor dhe teknologjik është marrë në konsideratë, njerëzit do të kuptojnë që nivelet e sotme të shkencës dhe teknologjisë i ngjasojnë stadit të jetës së një foshnjeje që është mësuar të ecë këmbadoras. Njerëzit do të organizojnë udhëtime në hapësirë thjesht sikur të ishin duke shkuar në një vend tjetër. Udhëtarët në rrugën e Zotit, të devotshmit e dashurisë që nuk kanë kohë për armiqësi, do të mbajnë brenda shpirtit të tyre frymëzimin për botët e tjera.

Po, kjo pranverë do të lulëzojë në themelet e dashurisë, dhembshurisë, mëshirës, dialogut, pranimit të të tjerëve, respektit të ndërsjellët, drejtësisë dhe të drejtave. Ajo do të jetë koha kur njerëzimi do të zbulojë esencën e tij të vërtetë. Mirësia dhe mirësjellja, drejtësia dhe virtyti do të formojnë bazën esenciale të

botës. Nuk ka rëndësi se çfarë ndodh, bota do të vijë herët ose vonë në këtë udhë dhe asnjë nuk mund ta ndalojë këtë.

Ne lutemi që Mëshira e Pafundme nuk do t'i lërë shpresat dhe pritjet tona pa përgjigje!

DUKE U NDËRTUAR NJË BOTË E RE [84]

Jeta dhe fryma e shpresës

Nëse jeta është vështruar përmes dritares së Atij që ka dhuruar jetën, atëherë shpresa është dinamika e veprimit që nuk shuhet. Ajo është ushqim për ata që nuk mendojnë vazhdimisht për vete por më shumë për të tjerët, për ata që gjejnë lumturinë e vërtetë në lumturinë e të tjerëve dhe për ata që marrin jetë nga mbarësia e jetëve të të tjerëve. Ajo është gjithashtu një burim energjie që kurrë nuk shteron për ata që ia kanë kushtuar vetveten një ideali të bekuar, për ta shpënë jetën në nivelin e zemrës dhe shpirtit, duke e çliruar veten nga prangat e kohës, hapësirës, materies, fizikës dhe interesit vetjak. Si rrjedhim, në një kohë kur gjithë të tjerët besojnë që "gjithçka po mbaron", në një kohë kur figura më e madhe e një kombi është nënshtruar në pikën e fundit, në një kohë kur vendosmëria dhe vullneti nuk dinë nga të shkojnë nga tërmetet, stuhitë dhe përmbytjet, dhe shuhen, në një kohë që ata që ndjehen të kapur pas punës, pozitës shoqërore, pasurisë, prosperitetit dhe forcës që nuk rrjedhin nga poseduesit e vërtetë të fuqisë dhe pushtetit, dhe ata që, për shkak të paaftësisë për të zbuluar të vërtetën, i kanë lidhur zemrat e tyre me yjet, hënën dhe diellin, objekte që veniten nga qielli, fillon të shfaqet dëshpërimi, shpresat e njerëzve të idealeve, të këtyre njerëzve që ne i përshkruam në fillim të paragrafit, marrin një cilësi të tillë epike që në të gjithë rrethanat ata mund të sfidojnë universin. Ata vazhdojnë të patundur në rrugën e tyre, edhe nëse llogaritjet dhe planet e tyre duan mijëra vjet për t›u realizuar, duke reflektuar begati edhe

[84] Marrë nga libri i gazetares Nevval Sevindi me *titull New York Conversation with Fethullah Gülen and Global Tolerance.*

përballë varfërisë. Ata bëhen jetë për shpirtrat e vdekur dhe fuqi për ata që janë përthyer në gjunjë.

Një person i njohur në Perëndim shprehet, "Kur të gjithë e braktisin shpresën, edhe shpresën për mbrojtje, atëherë fillon sulmi i kombit turk." Goditjet e reja që u dhanë pas pushtimit mongol dhe ndarjes së Anadollit, ripërqendrimi i forcës dhe rritja e vitalitetit pas disfatës në luginën e Çubukllusë, në Galipoli dhe në vijim, lufta e pavarësisë, në të gjithë betejat ku ishte luftuar deri në pikën e fundit të gjakut, në histori ato ishin epike dhe të pashembullta, dhanë përshtypjen që detyra thelbësore e kombit tonë në histori është të shkruajë dhe të rishkruajë epikat e rigjallërimit, ndërtuar mbi themelet e shpresës dhe besimit.

Sot, me mirënjohje, unë jam duke u përpjekur të jem i duruar përballë problemeve serioze shëndetësore. Unë jam duke përjetuar mallin për atdheun, shkaktuar nga qëndrimi larg tij, një vend të cilin e dua më shumë se vetë jetën. Larg nga uji, ajri, shkrepat, toka, qielli dhe njerëzit me faqet e trëndafilta - të gjitha më mungojnë tmerrësisht. Ky mall për atdheun është reflektuar në shpirtin tim sikur të ishte një pus pa fund. Unë ndjek me vëmendje dhe me ankth, por në të njëjtën kohë dhe me shpresë, çfarë po ndodh në vendin tim - edhe nëse mund të shoh vetëm kalimthi ose jam në gjendje të vështroj çfarë është në sipërfaqe - një vend që shumë njerëz e konsiderojnë të pamundur për të jetuar në të. Unë po orvatem të shoh se çfarë drejtimi do të marrin përpjekjet e fundit të Amerikës, dhe akoma, jam duke mbajtur gjallë shpresën për botën dhe njerëzimin, të freskët si gjethet e bulëzuara dhe vazhdoj të vështroj pas së nesërmes me buzëqeshje.

Natyra njerëzore është zanafilla për gjithçka

Natyra njerëzore, me të gjitha atributet e saj, është një krijesë e vështirë për t'u kuptuar. Ashtu si në të gjithë botët, esenca e të gjitha gjërave të krijuara është treguar tek krijesat njerëzore, dhe

në një mënyrë, me karakteristikat e tyre, në një kontekst është e mundur ta kuptojmë ekzistencën duke njohur natyrën njerëzore, ndërsa, nga një kontekst tjetër, njohja e natyrës njerëzore është e mundur nga kuptimi i ekzistencës. Në të vërtetë, kuptimi i natyrës njerëzore është misioni kryesor i njerëzimit, meqë natyra njerëzore është gjithashtu dritarja që hapet për kuptimin e Krijuesit. Për këtë arsye, detyra e parë dhe kryesore e krijesave njerëzore është të zbulojnë dhe njohin vetveten dhe atëherë të kthejnë vështrimet nga Zoti, me lupën e natyrës së tyre të ndriçuar. Është fakt i hidhur që ajo ndaj së cilës ne kemi neglizhuar më shumë, është pikërisht kjo. Në të vërtetë, sa njerëz e ushtrojnë shpeshherë autokritikën? Sa njerëz e rizbulojnë për çdo ditë rishtas vetveten, një rizbulim i dobësive të tyre, aftësive të tyre, mangësive të tyre, burimeve të fuqisë të tyre, së bashku me gjërat që kanë fituar dhe humbur? Sa njerëz mund të enden përmes botëve të tyre të brendshme? Sa njerëz përpiqen të shqyrtojnë qenien e tyre - ose me një druajtje kalimtare ose me një kureshtje të rastësishme, dhe jo duke vështruar thellë në të metat dhe veten zvetënuese - si në një panair, si një doktor profesionist dhe i arsyeshëm, duke e ulur veten në një stol për t'u ekzaminuar, duke dashur të hetojnë dhe të njihen me botët e tyre të vërteta, duke u përpjekur të studiojnë vetveten me realizëm, me qëllim që të diagnostikojnë sëmundjen? Përgjigja është e thjeshtë sepse kjo punë nuk është kryer meqë njerëzimi nuk mund të gjejë lumturinë në këtë kërkim të dëshpëruar në këtë "parajsë të humbur," më saktë, njerëzimi nuk mund të gjejë parajsën e humbur.

Patenta e të drejtave të një pakice të vogël

Është e pamundur të mos vlerësojmë rezultatet e kërkimeve shkencore, mrekullitë e qytetërimit, prodhimet e teknologjisë. Por a jemi ne të suksesshëm në vënien në zbatim të kësaj shkence dhe teknologjie - produkt i të gjithë këtyre përpjekjeve dhe punës

mendore - me ritmin dhe globalizimin që ato sjellin, në shërbim të qëllimeve më të larta? Kështu, hapësira e cila është duke u rrudhur çdo ditë e më shumë derisa të mos jetë më e madhe se një fshat, dhe koha, të cilën njerëzit janë duke u përpjekur ta shkurtojnë në minimum, a i shërbejnë një qëllimi prapa vetvetes? Ose kështu ata, që pavarësisht prej shumicës dërrmuese, a i shërbejnë begatisë tokësore të një pakice të vogël që mban "patentën" e të gjitha këtyre? Duke arritur në qoshet më të largëta të universit, duke hetuar çdo gjë ekzistuese, duke u familjarizuar me botën në të njëjtën mënyrë si me fshatin apo me rajonin tonë, duke zbuluar të dhëna edhe rreth aspekteve më të fshehta të gjërave - nëse e gjitha kjo është vlerësuar mbi nevojat dhe dëshirat njerëzore, nëse respekti për intimitetin dhe vlerat njerëzore është çrrënjosur dhe është lënë pas rrjedhës, atëherë ka ardhur koha për të shqyrtuar nëse është e parapëlqyeshme të jetojmë në këtë botë me të gjitha këto produkte moderne ose, nëse është më mirë të jetojmë pa ato, në një botë të periudhës së shkuar kur krijesat njerëzore ishin të lumtura dhe kur jeta personale dhe shoqërore dhe marrëdhëniet ishin të mbështetura në vlerat humane.

Deri më tani, shkenca, teknologjia dhe shpejtësia nuk kanë qenë kurrë nevojat kryesore të njerëzimit. Por do të ishte e gabuar të kundërshtosh shkencën dhe teknologjinë me mendime "idealiste," një kundërshtim i tillë është vetëm një formë utopie. Asnjë e mirë nuk i vjen njerëzimit nga fjalët bombastike pranë makinerive ose nga mallkimi i fabrikave. Makineritë do të vazhdojnë të punojnë, fabrikat do të vazhdojnë të nxjerrin tym, edhe nëse ne hedhim mallkime mbi ta. Për këtë arsye, mund të thuhet që ajo që ka rëndësi nuk është teknologjia por, më saktë, mbikëqyrja e shkencës dhe teknologjisë dhe çfarë qëllimi i shërbejnë ato. Shkenca dhe teknologjia mund të kthehen në një ferr në duart e një pakice të papërgjegjshme. Nëse të njëjtat mjete do të ishin në duart e engjëjve askush nuk do të vuante. Njerëzimi ka vuajtur shumë nga ata që e shohin të drejtën si plaçkë të atyre që kanë pushtet dhe

ambicie të shfrenuar. Shkenca, teknologjia dhe shpejtësia me të cilën ato na lejojnë të punojmë janë të shenjta dhe të denja për respekt vetëm në proporcion me, sa ato i drejtojnë njerëzit nga qëllimet humane, lehtësinë e plotësimit të këtyre qëllimeve, sjelljen e paqes dhe lumturisë, shuarjen e mallit dhe dhimbjen e ndarjes, shkëputjen nga shumica e të këqijave përpara se koha të mbarojë, shërbimin ndaj harmonisë së përgjithshme në tokë, sigurimin e balancës midis shteteve, pjesëmarrjen në zgjidhjen e problemeve tokësore dhe shpirtërore, dhënien e vrullit për të hulumtuar dhe vërtetuar faktin që nxjerr në pah domethënien tonë. Kur shkenca dhe teknologjia janë larguar nga qëllimet e përmendura më sipër dhe kur ato bëhen vlera në dhe për vetveten, kur është kuptuar që ato do t›i shërbejnë vetëm vetes ose vetëm interesave të një pakice të vogël, atëherë largimi është më i mirë se prania e tyre.

Teknologjia dhe shkenca në shërbim të njerëzimit

Unë besoj që shkenca dhe teknologjia duhet të jenë vështruar pikërisht nga kjo perspektivë. Ne kemi për t'u informuar rreth funksionit të shkencës dhe teknologjisë në ditët e sotme. A u shërbejnë ato marrëdhënieve midis individëve, midis individit dhe shoqërisë, midis shoqërisë dhe shtetit, a i shërbejnë ato dashurisë së ndërsjellët, respektit dhe mbështetjes për njëritjetrin në të gjithë gjërat e mira, tolerancës, pranimit të gjithsecilit në kontekstin e tyre, të vërtetës, devotshmërisë, respektit për të drejtat, ose a i shërbejnë ato gënjeshtrës, mashtrimit, hipotezave dashakeqe, shpifjes dhe një interesi të panatyrshëm për mëkatet dhe dobësitë e njerëzve të tjerë, dhunimit të intimitetit dhe ndërhyrjes në jetët e të tjerëve? A i shërbejnë ato respektit, nga zemra, për të drejtat e të gjithëve, diçka që duhet të jetë mbrojtur, për shembull, të drejtës së besimit, të jetës, pasurive personale, riprodhimit dhe shëndetit mendor dhe fizik? A i shërbejnë ato qëllimit të mirë, mirëkuptimit të ndërsjellët, a i shërbejnë marrëdhënieve midis

shteteve dhe kombeve, a i shërbejnë së drejtës, së vërtetës? A e inkurajojnë ato ndarjen, heqjen dorë nga shfrytëzimi, respektin për të drejtat dhe liritë themelore njerëzore ose a i shërbejnë sovranitetit të kapitalistëve dhe dhunës çnjerëzore? Nëse shkenca dhe teknologjia theksojnë elementët negativë të mësipërm, atëherë ky është një skenar i frikshëm për të ardhmen. Në të vërtetë, nëse vlerat që janë përgjithësisht të vlefshme sot dhe mbi të cilat është mbështetur globalizimi janë ato negativet të renditura më sipër, atëherë fakti që në kohët e sotme gjysma e botës po jeton me dy dollarë në ditë, me një bilion njerëz që mbijetojnë në minimumin jetik, fakti që një e katërta e botës nuk ka mundësi të përdorë ujë të pijshëm, që sëmundjet më të tmerrshme, si SIDA, kanë një tendencë për t'u përhapur me të shpejtë dhe kështu kërcënojnë njerëzimin, fakti që shëndeti, që është nevoja më jetike e natyrës njerëzore është bërë një industri me shërbim shumë të shtrenjtë, fakti i rritjes së ngrohjes globale dhe të ndotjes që është përhapur ngado, fakti që një pjesë e madhe e popullsisë së botës është duke jetuar pa të drejta demokratike, fakti që dhunimi i të drejtave njerëzore është bërë normë, që kushtet e jetës në shumë vende të botës janë skandaloze dhe që aktet e pashmangshme terroriste mbizotërojnë në nivel lokal dhe ndërkombëtar, do të thotë që ky është realitet i frikshëm për mbarë njerëzimin.

Një mysliman nuk mund të jetë terrorist

Së pari, unë dua të vë në dukje që fetë që ka sjellë Zoti, nëse janë quajtur Judaizëm, Krishtërim ose Islam, nuk mund të mendohen si përkrahëse të terrorizmit e jo më ta kenë urdhëruar atë. E para nga të gjitha, në vlerësimin e Zotit, jeta ka një rëndësi madhore. E gjithë ekzistenca ka qenë programuar për t'i dhënë udhë jetës. Jeta është emri i të fshehtave hyjnore që lënë një gjë dhe mbajnë gjithë të tjerat. Një send pa jetë është jetim, edhe nëse është i lartë sa një mal, dhe marrëdhëniet e tij me çfarë e rrethon janë të kufizuara në

vendin ku banon. Në njërën anë, diçka që ka jetë, edhe nëse mund të jetë e lehtë si një bletë punëtore, mund ta quajë mbarë universin "kopshti im" dhe mund t'i vështrojë të gjitha lulet si shokë. Kjo bletë ka shumë lidhje dhe marrëdhënie me të gjithë gjinitë e ndryshme të ekzistencës, nga dielli tek ajri, nga ajri tek njerëzit. Prandaj, jeta është pika e përqendrimit të emrave të Shkëlqimit të Vërtetë, një pikë e vatrës së manifestimeve të njëkohshme të të gjithë këtyre atributeve. Zoti, duke i dhënë një rëndësi të tillë jetës, e ka vlerësuar atë të jetë një nga pesë vlerat esenciale që duhen mbrojtur nga fetë që Ai ka sjellë. Islami e ka vlerësuar vrasjen e një personi të vetëm të barabartë me vrasjen e tërë njerëzimit, ashtu si një jetë simbolizon jetën e të gjithëve, prandaj, shpëtimi i jetës së një personi të vetëm është i njëjtë me shpëtimin e jetës së të gjithëve. Përveç kësaj, nga që të drejtat janë të lidhura, është thënë, «nuk ka të drejta dytësore ose parësore», për shembull, vihet re që të drejtat individuale dhe të drejtat shoqërore janë të barabarta. Një njeri nuk mund të sakrifikohet për të tjerët, dhe për gjerësinë që ka kjo ide është urdhëruar, "nëse një barkë është duke transportuar nëntë vrasës dhe një shpirt të pafajshëm, kjo barkë nuk mund të fundoset për të ndëshkuar nëntë vrasësit."

Terrori nuk mund të jetë një mjet për qëllimin islam

Së dyti, ashtu siç Islami urdhëron që qëllimi i të gjitha akteve të myslimanëve të jenë i ligjshëm, po ashtu ka theksuar, në mënyrë të veçantë, që mjetet e përdorura për arritjen e këtij qëllimi, të jenë të ligjshme, duke u kujtuar atyre që përpiqen të arrijnë një qëllim të ligjshëm me mjete të paligjshme, se në fund do të gjenden ballë për ballë me të kundërtën diametrike të objektivit të tyre. Si rrjedhojë, ne mund të themi që terrorizmi nuk mund të jetë një mjet për të realizuar ndonjë qëllim islam. Përveç kësaj, Islami kurrë nuk e ka miratuar luftën, ndonëse ajo është një realitet dhe një prej elementëve më të spikatur në historinë e njerëzimit. Islami

e ka kufizuar luftën para së gjithash me rrethanat e mbrojtjes, dhe atëherë, brenda kornizës së parimit «provokimi i divergjencave është më i keq se vrasja,» që gjendet në Kuran, e ka vlerësuar luftën të ligjshme vetëm për ta ndaluar luftën dhe grindjet që çojnë tek ajo, për të ndaluar kaosin, shtypjen dhe nënshtrimin. Këto janë kushtet që Islami i gjykon të nevojshme për t'u përfshirë në luftë. Për herë të parë në historinë njerëzore, Islami paraqiti kufizimet dhe parimet e përgjegjshme në lidhje me këtë çështje. Rregullat ashtu si pasuesit kanë hyrë në histori:

Mos e lër frikën nga Zoti të largohet nga zemrat tuaja. Mos harroni që ju nuk mund të bëni asgjë pa ndihmën e Zotit, gjithmonë kujtoni që Islami është feja e paqes dhe dashurisë. Guximi i të Dërguarit të Zotit dhe qëndrimi i tij në udhën që Zoti ka caktuar, duhet të jenë gjithmonë një model për ju. Mos shkelni tokën dhe kopshtet e kultivuara. Respektoni priftërinjtë dhe murgjit që jetojnë në tempujt dhe ata që kanë dhënë veten për Zotin; mos i fyeni ata. Mos i vrisni civilët, mos veproni në një mënyrë të pahijshme ndaj grave dhe mos lëndoni ndjenjat e thyera. Mos pranoni dhurata nga popullsia vendase. Mos u përpiqni t'i strehoni ushtarët tuaj në shtëpitë e vendasve. Mos lini pas dore për të kryer lutjet tuaja pesë herë në ditë. Frikësojuni Zotit dhe mos harroni që vdekja mund t'ju gjejë në çdo kohë, edhe mijëra kilometra larg nga fusha e betejës. Prandaj, ji gati për vdekjen në çdo kohë.

Këto rregulla janë parimet që kryetarët e shteteve u kanë përkujtuar komandantëve të tyre gjatë gjithë historisë së Islamit, dhe ata i kanë ndjekur me përpikëri. Lufta, e cila mund të ndërmerret nga një shtet vetëm duke qenë i detyruar dhe brenda kornizës së parimeve të përcaktuara, nuk mund të shpallet nga individët dhe organizatat, përveç kësaj, është e qartë që aktet e terrorit të cilat nuk kanë kufizim, që vënë në shenjë vlerat njerëzore që duhet të jenë mbrojtur dhe që shkatërrojnë sigurinë, nuk kanë vend në Islam. Si rrjedhim, ashtu si një terrorist nuk mund të jetë mysliman i vërtetë, një mysliman nuk mund të jetë

terrorist. Një mysliman nuk mund të jetë terrorist sepse Islami urdhëron ndëshkime të rënda tokësore për ata që vënë në shenjë jetën dhe sigurinë e njeriut. Në jetën e përtejme, ata që mohojnë Zotin dhe që i njohin partnerë Atij, së bashku me ata që vrasin njerëz dhe me paramendim marrin jetë, janë përballur me ferrin e përjetshëm. Një person nuk është e mundur që të angazhohet në një akt që është bërë e ditur se ka një ndëshkim të tillë, ndërsa është një mysliman dhe manifeston karakteristikat e besimit dhe Islamit. Prandaj, nuk është e mundur që një terrorist të jetë mysliman i vërtetë, ashtu siç është e pamundur që një mysliman të jetë terrorist.

Problemet e shoqërive myslimane

Për më tepër, nëse aktet e terrorit vazhdojnë të kenë vend në këtë rrugë, në shoqëritë islame apo gjetiu, së pari duhet një diagnostikim i drejtë i situatës dhe atëherë mund të mbahet çdo qëndrim ndaj diagnozës. Nga që ky proces ka filluar, në vazhdim mund të renditim shkaqet kryesore pse ca individë në botën islame janë ngatërruar ose janë formuar për t'u përfshirë në këtë rrjet të terrorizmit dhe arsyet pse terrori është një problem serioz në botë:

a) Shoqëritë islame hynë në shekullin e XX si një botë e shtypur, e nëpërkëmbur dhe e kolonizuar. Gjysmën e parë të shekullit e zënë luftërat për liri dhe pavarësi që kishin filluar që në shekullin e XIX. Në të gjithë këto luftëra, Islami kishte rolin e një faktori të rëndësishëm duke bashkuar dhe nxitur popullin për të luftuar. Ashtu si këto luftëra ishin zhvilluar kundër atyre që ishin parë si pushtues, Islami, pavarësia kombëtare dhe çlirimi kishin synim të njëjtën gjë. Mandej, kur ishin themeluar shtetet kombëtare në këto pjesë të botës, ato nuk ishin në përputhje me popullsinë e tyre, ndërsa shtetet duhet të kenë udhëzuar popullsinë në Islam me identitetin dhe natyrën e saj të vërtetë, ata veprojnë në një

mënyrë mospërfillëse për popullsinë, në një mënyrë që është në kundërshtim me vlerat dhe traditat e popullit. Kjo e bën Islamin një shtyllë, një strehë mbrojtëse kundër qeverisjes në sytë e publikut. Për pasojë, është gabim të thuash që Islami ka ardhur për t'u vlerësuar si një ideologji politike tradicionale nga shumë popuj.

b) Në shumë rajone të gjeografisë Islame, qeveritë që shpërfillin dhe denigrojnë popullsinë dhe që janë oligarkike në natyrën e tyre, kanë punuar për mirëqenien e dinastive, familjeve, anëtarë të së cilave ata janë, më shumë se të punonin për prosperitetin e vendit të tyre dhe të përpiqeshin për të vendosur unitetin e popullit dhe të shtetit, dhe kështu këto qeveri kanë degraduar thjesht në pozitën e shtypësve dhe kanë merituar neverinë në sytë e popullit. Shtresat e varfra dhe të pashkolluara janë bërë armiqtë e qeverive të tyre.

c) Në shoqëritë islame dhe në kombet e tjera, rrënjët e terrorit gjenden gjithmonë në varfërinë, injorancën dhe në mungesën e arsimimit. Në shumë vende, ende vazhdojnë sistemet feudale dhe fisnore, ku pjesa më e madhe e popullsisë e vlerëson zhvillimin e vendeve të tyre me Perëndimin, që në një kohë i ka pushtuar dhe zaptuar ato, si mbrojtës dhe mbështetës të administratorëve sundues mbi ta, dhe kështu ata i konsiderojnë vendet perëndimore plotësisht përgjegjëse për nëpërkëmbjen dhe shtypjen që pësuan në vendet e tyre.

d) Vlerat si demokracia, të drejtat themelore njerëzore, përhapja e dijeve dhe arsimimit në të gjithë shoqërinë, prosperiteti ekonomik, barazia në prodhim, institucionalizimi i konsumit dhe të ardhurave në një mënyrë që shmang formimin e shtresave shoqërore, autoriteti i ligjit dhe drejtësisë, që janë pranuar përgjithësisht anembanë botës, nuk kanë qenë përmbushur kurrë plotësisht në shoqëritë islame, ose në rajonet e tjera të emërtuara si vende të botës së tretë. Pa dyshim, ata që janë së pari përgjegjës për këtë situatë, janë qeveritarët e këtyre vendeve dhe mbështetësit e tyre - vendet e zhvilluara perëndimore që i kanë ndihmuar për

të ardhur në pushtet. Prandaj, edhe nëse këto vende mund të mbahen si kampione të vlerave të lartpërmendura, siç popujt e botës së tretë janë të interesuar, ato nuk do të shihen si deklarime të sinqerta por qeveritarët e tyre do të vështrohen si shfrytëzues të këtyre vlerave.

e) Bota e sotme, ashtu siç e kemi trajtuar shkurtimisht, është tkurrur në madhësinë e një fshati të madh, si rezultat i zhvillimit të pandërprerë në shpërndarjen e informacionit dhe në komunikacion. Të gjithë popujt dhe vendet janë tani fqinj me njëri-tjetrin. Një pakicë fqinjësh, një minoritet, kanë gjetur kënaqësi në një oqean të pasurisë, ndërsa pjesa dërrmuese është e varfër, në mënyrë të skajshme e varfër. Kolonializmi ose shfrytëzimi, që është ushtruar shumë dinakërisht dhe fshehurazi, konsiderohet të jetë një nga arsyet më domethënëse për këtë varfëri, dhe për më tepër, pjesa më e madhe e popullsisë gjendet në atë nivel që nuk është në gjendje të plotësojë nevojat më jetike. Të gjithë këta faktorë kanë çuar tek ndjenja e smirës, zemërimit dhe armiqësisë. Përveç kësaj, sot fatkeqësisht gjendemi në një realitet ku aktet e paligjshme janë normale po aq sa edhe aktet e ligjshme. Korrupsioni, mashtrimi, dëshira për të fituar para pa punuar, egoizmi, individualizmi, bixhozi ndërkombëtar dhe kontrabanda ndërkombëtare (veçanërisht e drogës dhe e armëve) mund të gjenden sot pothuajse në çdo vend të botës. Organizatat mafioze që kryejnë aktivitete të tilla, dhe organizata të tjera të ngjashme, si korporata të mëdha, truste dhe kartele, janë të gjitha në rivalitet për vdekje, duke përdorur vrasës gjakësorë dhe kriminelë që përfaqësojnë dhunën më të egër fizike. Fakti që këto organizata i ushqejnë dhe mbështesin aktivitetet e tilla nuk ka dyshim se është një tjetër faktor i rëndësishëm dhe i pamohueshëm në përhapjen e terrorizmit në nivel ndërkombëtar.

f) Ndoshta më e rëndësishmja nga gjithçka më sipër është fakti që feja dhe vlerat fetare, spiritualiteti dhe etika që janë të lidhura me fenë janë gërryer vazhdimisht, anembanë botës, duke përbërë

burimin kryesor të terrorizmit dhe problemeve të tjera madhore shoqërore që kërcënojnë sot njerëzimin. Bota është duke kaluar një krizë shpirtërore. Të gjitha shtyllat thelbësore mbështetëse për njerëzimin janë shembur dhe shkatërruar. Filozofitë e depresionit, satanizmi, rryma që janë në mënyrë fundamentale materialiste dhe natyraliste, por që duken shpirtërore (çdo ditë mbin një e re), dhe kështu cilësohen kulte, përgatisin të gjitha terrenin për dhunë dhe vetëvrasje. Në të vërtetë, këto fenomene janë si një goditje epileptike, duke tronditur botën tonë ose duke e drithëruar me ethe të forta. Pyetja pse njerëzit kryejnë vetëvrasje, vrasin dhe drogohen kur humbin shpresën, kur e shohin të kaluarën si një varr të paanë dhe të ardhmen si një hon të pafund, duke e gjetur jetën të pakuptimtë, mund të jetë bërë vetëm për të fshehur injorancën, nëse nuk është një synim dhelparak i injorancës.

g) Fjala përfundimtare që është e nevojshme të thuhet për çështjen, është në vijim: fakti që nuk ka një përcaktim ose kategorizim të terrorizmit, të njohur nga të gjithë kombet, ose së paku nga Kombet e Bashkuara, është një problem serioz. Cilat akte duhet të përfshihen dhe cilat jo brenda termit "akte terrori", kush është terrorist dhe kush nuk është? Kam përshtypjen se gjithsecili arrin në një përfundim për këto pyetje. Terrorizmi i një personi është mohimi i lirisë së tjetrit, trimëria e një personi për idealet mund të konsiderohet si terrorizëm nga dikush tjetër. Nëse duhet të ketë një luftë kundër terrorit në nivel ndërkombëtar - më qartë duhet të jetë një fushatë serioze - së pari duhet një përcaktim për terrorizmin që së paku të jetë pranuar nga Kombet e Bashkuara. Nëse është arritur kjo, një fushatë ndërkombëtare kundër terrorizmit mund të fitojë një status të ligjshëm, një status që çdokush do ta pranojë, një formulim i çështjes ku asnjeri nuk do të jetë në gjendje që ta shtrijë përgjegjësinë tek dikush tjetër, dhe ndoshta kjo do të përbëjë hapin e parë në parandalimin e terrorizmit. Është shumë e nevojshme për të folur për vendimet, pasi ne kemi trajtuar problemet esenciale dhe çështjet që janë

përmendur si shkaktarë të tyre: diagnoza e problemit e përmban vendimin brenda saj.

Struktura e parimeve të jetës shoqërore

Struktura e parimeve të jetës shoqërore është mbështetur në fenë, ligjin, urtësinë dhe pushtetin. Një person ose shoqëri pa fe nuk do të jetë në gjendje të vazhdojë për shumë kohë, si edhe nuk do të jetë e dobishme për të tjerët. Në të vërtetë, feja është një element esencial që ka qenë përcaktuar përtej vetes sonë dhe që ka hyrë në jetët tona, ndonëse ne e pranojmë ose jo atë. Edhe nëse ne mund të jemi krijesat më të përsosura të lartësuara me vullnetin tonë të lirë, janë akoma shumë elementë të domosdoshëm që rrethojnë jetët tona dhe me të cilat ne jemi kufizuar. Për shembull, ku dhe kur kemi lindur, kur dhe ku do ta lëmë këtë botë, të gjitha janë planifikuar dhe vendosur jashtë vullnetit tonë. Gjithashtu, ne nuk jemi shprehur në vendimin për familjet tona - për nënën dhe babanë tonë - për racën, ngjyrën dhe karakteristikat tona fizike. Përveç kësaj, edhe funksionimi i trupit tonë është plotësisht i pavarur nga vullneti ynë. Ne nuk mund të ndërhyjmë në dukuritë e urisë, etjes dhe gjumit. Gjithashtu, rrugët dhe metodat përmes së cilave ne përmbushim nevojat tona, janë të pavarura nga vetvetja. Në çdo aktivitet të thjeshtë të përditshëm, siç janë ngrënia dhe pirja, roli ynë i vetëm është të sigurojmë ushqim dhe lëngje dhe të marrim vendimin për një gjë të tillë. Në një mënyrë, ne mund të themi që roli ynë në aktin e përmbushjes së nevojave tona nuk është më shumë se një përqind. Kjo do të thotë që nëse ne e dëshirojmë atë ose jo, veprimet tona janë të kufizuara nga disa kushte mbizotëruese. Feja, gjithashtu, është një prej këtyre kushteve të forta. Nëse ne e pranojmë ose jo atë, feja është një nga elementët më esencialë në jetët tona, një element që nuk mund të zëvendësohet me ndonjë gjë tjetër. Kjo është arsyeja pse ajo luan një rol jetik në organizimin dhe rregullimin e nevojave

tona shpirtërore, nevoja që kanë një domethënie të madhe dhe janë më të rëndësishme për ne se nevojat materiale. Feja nuk është e rëndësishme vetëm në vetvete, por gjithashtu në organizimin e jetëve tona individuale, familjare dhe shoqërore, si edhe në jetën tonë materiale. Feja luan një rol vendimtar në vendosjen dhe shpalljen e ligjeve që janë parimet rregulluese në aspektet e përcaktuara të jetëve tona. Qëllimi final nuk janë ligjet apo zbatimi i tyre, këto fitojnë vlera vetëm në atë shkallë me të cilën ata i shërbejnë njerëzimit dhe shoqërisë. Prandaj, kur aprovojmë ligjet, duhet të njihet mirë krijesa njerëzore me të gjitha karakteristikat e saj duke marrë në konsideratë natyrën esenciale të saj, gjithashtu të njihet shoqëria e cila është krijuar me njerëz me vetëdije dhe vullnet, nevojat dhe rrugët e mjetet me të cilat shoqëria i plotëson këto nevoja dhe, gjithashtu, duhet të njihet lloji i marrëdhënieve që ekzistojnë midis individëve brenda shoqërisë. Individët janë si atomet e një të tëre, dhe prandaj një njeri duhet të jetë i ndërgjegjshëm për marrëdhëniet dhe lidhjet që individët kanë me frymën kolektive të shoqërisë. Prandaj, në krijimin e familjaritetit në shoqëri dhe midis njerëzve që e përbëjnë atë, feja kryen një funksion të veçantë, meqë Krijuesi i Njerëzimit dhe Ai që Predikoi Fenë është Zoti. Si rrjedhim, roli i fesë në mirëkuptimin njerëzor dhe shoqëror është aq kritik sa që është e pamundur ta vlerësojmë rëndësinë e saj

Domosdoshmëria e fesë brenda rregullave shoqërisë

Së dyti, ashtu si pushteti ka një rol të pamohueshëm në zbatimin e ligjit, rëndësia e fesë në këtë fushë është gjithashtu e pamohueshme. Feja është bazuar në themelet e vendosjes së besimit në ekzistencë nga një Qenie që i sheh njerëzit, i kontrollon ata dhe nuk di vetëm gjithçka që ata bëjnë, por gjithashtu gjithçka që ata mendojnë dhe çdo gjë rreth qëllimeve dhe objektivave të tyre. Dhe ky besim është i natyrshëm për natyrën njerëzore dhe gjithmonë prehet i

përgjumur në ndërgjegjen e saj duke e bërë veten ta ndjejë gjatë gjithë kohës. Gjithashtu, meqë natyra njerëzore është e mundur t'i përvidhet ligjit, qeverisë dhe detyrimit në këtë tokë, akoma është e pamundur të jetë përjashtuar nga kufijtë e mbikëqyrjes hyjnore të Zotit, feja i mëson njerëzit se ata janë përgjegjës për gjithçka që bëjnë në këtë botë dhe që do të gjykohen në botën tjetër për veprat e tyre, dhe që në përputhje me rezultatin e gjykimit, atyre do t'u jetë dhënë lumturia e amshuar ose ndëshkimi. Në të vërtetë, në edukimin njerëzor, për t'u bërë poemë e virtyteve më mirë se e të këqijave, është e pakonceptueshme që ndonjë sistem tjetër tokësor të mund ta zëvendësojë këtë sistem besimi.

Së treti, në veçanti parimet etike të fesë kanë një prioritet, që është i pazëvendësueshëm nga ndonjë gjë tjetër tokësore, në edukimin e natyrës njerëzore. Në fakt, këto norma etike janë kriteret që të gjithë popujt i kanë pranuar gjatë gjithë kohës, ky është një fakt i pamohueshëm. Këto kritere sfidojnë ekzistencën dhe kohën. Nëse ato japin impaktin e nevojshëm në popull, kushtëzohen përsëri nga stadi i besimit fetar dhe i aplikimit të tij në shoqëri.

Feja në botën perëndimore sot

Disa njerëz mund të binden për të deklaruar që feja nuk ka vend në jetën e shoqërive në vendet e zhvilluara siç janë SHBA dhe ata të Europës Perëndimore. Ne menjëherë duhet të vëmë në dukje që një qëndrim i tillë nuk është korrekt dhe që këta vende kanë dhe janë bashkëngjitur me fetë e tyre. Ashtu siç e kemi shprehur më parë, megjithëse vlerat fetare mund të kenë qenë të venitura gjatë dy shekujve të fundit anembanë botës, njerëzimi sot është përsëri në kërkim të fesë dhe është edhe njëherë i predispozuar për të. Edhe nëse popullsia mund të jetë indiferente për fenë në një shkallë të caktuar në Evropën Perëndimore, ata që qeverisin duket se janë, në tërësi, mjaft fetarë. Midis tyre, në nivelet e larta të administratës ka pasur gjithmonë njerëz fetarë dhe ka akoma

sot. Për më tepër, ndonëse laicizmi është normë në këto vende, kurrë nuk ka qenë një mentalitet i diktuar që drejtimi fetar duhet të jetë braktisur në shoqëri ose edhe jetën politike të një vendi. Historianët perëndimorë shprehen që krishterimi është elementi më i rëndësishëm në formimin e strukturave shoqërore moderne në Evropë. Në përputhje me këta historianë, Krishtërimi ka luajtur një rol që shtrihet në fushën politike dhe shoqërore dhe po ashtu ka luajtur gjithmonë një rol vendimtar në fusha të veçanta, me sanksionimin e ligjeve të rëndësishme në lidhje me blasfeminë, pushimet për festat fetare, dhe adhurimin kolektiv.

Gjithashtu, në vendet si SHBA dhe Kanadaja, shumica e popullsisë i është kushtuar fesë së saj, pavarësisht nëse është thënë e kundërta, dhe përkushtimi fetar është vlerësuar seriozisht si në radhët e popullsisë, ashtu dhe në nivelet e ndryshme të qeverisjes. Kur ne vështrojmë përmbledhjen e ligjeve aktuale në këto vende, është e mundur të ndeshim ndikimin e fesë në to. Për shembull, në SHBA, dënimet për krimet e tilla siç është nxitja e vdekjes së një krijese njerëzore mund ta kalojnë vazhdimisht vlerën e zhdëmtimit të caktuar nga Islami. Së dyti, të gjitha kombet kanë karakteristika në vetvete, që rrjedhin nga natyra, historia dhe kultura e tyre. Turqit kanë qenë myslimanë për shekuj dhe është e pamundur t›i veçosh ata nga Islami. Në kohërat kur e kanë distancuar veten nga Islami, nuk kanë gjetur kurrë paqe apo progres, më saktë, në të kundërt, kjo rrugë ka çuar në degjenerim. Kjo për shkak të faktit që Islami është ndryshe nga fetë e tjera. Një hebre nuk beson as në Jezus as në Bibël, as në Muhamed dhe as në Kuran. Një hebre është konsideruar besimtar nëse nuk beson në këto gjëra. Një i krishterë, po kështu, është konsideruar të jetë besimtar edhe nëse nuk beson në Muhamed, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ose në Kuran. Kjo është arsyeja pse këto fe nuk i pranojnë sistemet dhe librat hyjnorë që kanë hyrë në strukturat e tyre. Prandaj, feja mund të gjejë një vend brenda spektrit të gjerë të feve hyjnore që rrjedhin nga judaizmi dhe krishterimi. Ky spektër është një libër,

një profet me të cilin është lidhur dhe kështu sistemi nuk mund të bëhet kurrë plotësisht i zvetënuar. Kur dikush e ka vënë poshtë atë, ai mund të jetë thartuar, si qumësht, por në të njëjtën mënyrë, ky produkt i thartuar mund t'i shërbejë akoma një qëllimi. Nëse ne përdorim një tjetër metaforë, feja mund të ketë gjetur strehë në një prej shumë dhomave të një pallati dhe është ndriçuar me dritën e kësaj dhome. Islami, në njërën anë, i përfshin të gjitha fetë. Besimi në Muhamed dhe Kuran është kryesori dhe esenciali, dhe prandaj besimi në të gjithë profetët dhe librat e shenjtë është një nga shtyllat e Islamit. Me fjalë të tjera, Islami është përfshirës, duke bashkuar gjithçka. Nëse ne i referohemi metaforës së pallatit përsëri, Islami është një sistem elektrik, gjeneratori kryesor për të tërë ndërtesën. Nëse ju e braktisni këtë sistem, i tërë pallati, e tërë bota do të jetë zhytur në errësirë. Nuk ka më dritë që ndriçon. Ata që e braktisin këtë dritë, janë anarkistët që mohojnë të gjithë rregullat.

Në këta tre shekujt e fundit, që kanë qenë vitet e nënshtrimit për myslimanët, dhe akoma në ditët e sotme, kur pamja e Islamit është errësuar nga ata që deklarojnë të jenë pjesëtarët më të sinqertë - në një kohë kur Islami është paraqitur duke u nxirë nga armiqtë e tij - numri i njerëzve që anohen nga Islami ose që drejtohen për te Islami, vazhdon të rritet me një ritëm të jashtëzakonshëm, ndërsa numri i njerëzve që e largojnë veten nga Islami, është akoma shumë i vogël. Kjo mund të na japë disa ide rreth çështjeve që ne kemi diskutuar. Prandaj ata që duan rregull dhe rend në Turqi dhe në botë, duhet t›i binden Islamit dhe ta përqafojnë atë, jo ta lënë në mëshirë të atyre që e keqinterpretojnë dhe e keqpërdorin atë. Në strukturën e shoqërive të shëndosha, ligji duhet të jetë formuluar me urtësi. Është për t›u theksuar që ai nuk duhet të jetë kundër natyrës esenciale të krijesës njerëzore dhe strukturës së natyrës, më shkurt, kundër ligjeve të krijimit. Ligji duhet të marrë në konsideratë karakterin e kombit dhe vlerat kombëtaro-fetare, të jetë i vëmendshëm ndaj këshillave të logjikës dhe gjykimit të

shëndoshë dhe të jetë i pranueshëm nga shumica. Së bashku me fenë, historinë, traditat dhe vlerat kombëtare, parimet kryesore të sociologjisë, antropologjisë dhe madje të fizikës dhe kimisë janë me rëndësi jetike për vendosjen dhe institucionalizimin e ligjeve. Ligji nuk është një shkencë e pavarur, por është një shkencë që përfshin fenë, historinë, filozofinë, sociologjinë, sociologjinë e historisë, psikologjinë, antropologjinë, fizikën, kiminë etj, dhe ka për t›u vështruar në këtë dritë. Ndryshe, rregullat e vendosura do të jenë si një veshje e papërshtatshme dhe ligji do të ketë nevojë për ndryshime të shpeshta. Materiali është cilësi e dobët, modeli është i palavdërueshëm, merre këtu lëre atje - një veshje e tillë do të jetë më shumë e keqe se e mirë për kompozimin e shoqërisë.

Forca nuk mund të jetë qëllim në vetvete

Një tjetër element i rëndësishëm në strukturën e shoqërisë, është forca. Pa dyshim, është edhe një arsye hyjnore për ekzistencën e forcës. Ashtu si pa forcë do të jetë e pamundur të zbatohet ligji, gjithashtu do të jetë e pamundur të mbrohet siguria e vendit, veçanërisht përballë fuqive të huaja. Po ashtu, forca ka një vend të veçantë në ruajtjen e rregullit dhe rendit kushtetues, dhe prandaj duhet të jetë respektuar. Por forca nuk është një vlerë, synim apo qëllim në vetvete, ajo mund dhe nuk duhet të jetë mjet për arritjen e objektivit final. Forca është e denjë për respekt vetëm nëse u shërben të drejtave njerëzore dhe drejtësisë. Forca që ka dalë jashtë kontrolli në duart e një pakice të mposhtur nga ambicia dhe egoizmi i saj, nuk do të adhurojë të drejtat ose drejtësinë, ajo nuk do të sanksionojë ligjin dhe urtësinë. Fakti që të drejtat duhet të jenë sakrifikuar për forcën, që konsideratat për interesin vetjak ngrihen mbi planin e të gjitha vlerave të tjera, që racizmi i egër duhet të zëvendësojë vlerat universale, që përpjekjet për të zgjidhur çështjet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të jenë ndërmarrë me forcë, ka qenë gjithmonë një problem për njerëzimin. Në një

situatë kur është përpjekur që problemet të zgjidhen me forcë, është e pamundur të flasësh për intelekt, gjykim, të drejta, drejtësi apo ligje. Në të kundërt, në vend të tyre janë jolegjitimiteti, padrejtësia dhe shtypja. Edhe nëse forca mund të jetë konsideruar një mundësi potenciale për eliminimin e problemeve - në duart e vërteta dhe përmes udhëheqjes së logjikës dhe gjykimit - ajo ka qenë gjithmonë një instrument për shkatërrim në duart e mizorëve që hidhen në boshtin e emocioneve. Është egërsia e forcës që aktet me hamendësimin e një lirie të pakufizuar nuk sigurojnë të drejta, drejtësi, ligje, intelekt ose gjykimin e vlerave të merituara. Është ky gabim fatal që e turbulloi Aleksandrin dhe e mjegulloi vështrimin e tij, që e dëmtoi gjenialitetin e Napoleonit, që e transformoi Hitlerin në njeriun më të çmendur të shekullit. Prandaj, nuk teprohet po të thuhet që prapa vargut të kaosit dhe kundërrymës që ne po përjetojmë sot, është forca e shfrenuar. Ajo tregon që ky kaos do të vazhdojë deri ditën që ata që përfaqësojnë forcën në botë t'ia dorëzojnë vetveten drejtësisë dhe turmat që i ndjekin këta njerëz, të jenë shkëputur nga përplasjet popullore të jetës së përditshme dhe ta vështrojnë botën përmes prizmit të drejtësisë.

Politika e luftës në ShBA

Pyetjet që ne jemi përpjekur deri më tani t'i adresojmë në strukturën e parimeve themelore dhe normave të përgjithshme, janë shprehur mjaft qartë jo për të kërkuar shpjegime individuale ose analiza të thella. Akoma, nëse ne kemi për të thënë gjëra specifike rreth ngjarjeve aktuale, lexuesit mund të shprehen: Të përsërisësh një të vërtetë sociologjike - një të vërtetë e cila ka qenë keqinterpretuar nga disa - që unë e kam treguar shumë kohë përpara: ka qenë dhe do të jetë gjithmonë një fuqi që mban balancën në botë. Kjo fuqi ishte njëherë Roma, për një kohë ishte Islami, së pari me arabët dhe pastaj me anë të myslimanëve turq,

që e morën këtë funksion. Duke filluar me shekullin e XIX, bota anglo-saksone kishte mbajtur pozitën e balancuesit të botës, së pari me Perandorinë Britanike, të ndjekur, pas luftës së II botërore, nga SHBA. Zoti deklaron në Kuranin e shenjtë që Ai pasuron këdo që dëshiron dhe gjithashtu i merr pasurinë kujtdo që Ai dëshiron. Ai e bën këdo që dëshiron të respektuar ose të degraduar, dhe, gjithashtu, Zoti shpall që Ai i qarkullon fitoret, humbjet, sovranitetin dhe nënshtrimin e një kombi.

Kjo do të thotë që koha nuk ndjek një kurs të drejtë, por më saktë një orbitë rrethore. Ashtu si toka përshkon një orbitë rreth diellit ose sistemi diellor sillet përqark një destinacioni, po ashtu koha dhe historia i aviten një fundi relativ. E gjithë kjo është përcaktuar nga Zoti, e padyshimtë, por edhe vullneti i natyrës njerëzore, performanca e fituar me vullnetin dhe punën e tij mund të kenë gjithashtu efekt në një shkallë të caktuar. Duke vështruar çfarë po ndodh në univers, ne zbulojmë aktin ekzekutiv të të Vetmit që ka krijuar dhe të të Vetmit që administron ekzistencën, dhe ne i thërrasim këto "ligje." Ashtu si ligjet e Zotit janë manifestuar si fe, Ai gjithashtu ka ligje që lidhen me aktet ekzekutive të Tij në jetën e njerëzimit dhe në univers. Ashtu si fakti i bindjes ose jo ndaj fesë apo dispozitave të saj, të cilat ne mund t'i quajmë ligjet e fesë, ka pasoja, shpërblime dhe ndëshkime të cilat do të jenë të dukshme pjesërisht në këtë botë, por përgjithësisht në botën e përtejme, po ashtu bindja ose injorimi i ligjeve të shkencave fizike, kimisë, biologjisë dhe astronomisë ka pasoja, shpërblime dhe ndëshkime, shumë prej të cilave vijnë përpara në këtë botë dhe disa në botën e përtejme. Për shembull, përmes ligjeve në lidhje me jetën në tokë është arritur një qëllim, në shumë raste, si rezultat i qëndrueshmërisë këmbëngulëse ose duke u zhgërryer në llumin e rrugës për shkak të padurimit. Pasuria është rezultat i punës së rëndë dhe varfëria rezultat i përtacisë. Suksesi është rezultat i studimit sistematik dhe metodik dhe dështimi rezultat i studimit josistematik dhe jometodik. Zoti i trajton njerëzit,

shoqëritë, kombet dhe shtetet në lidhje me bindjen e tyre ndaj ligjeve të kësaj gjinie dhe kështu shtetet dhe kombet zënë vendin e tyre në balancën e botës.

Sot, ShBA mbajnë pozicionin dominues në balancën politike të botës, ndonëse dominimi i tyre kushtëzohet nga vazhdueshmëria e akteve në bazë të të drejtave njerëzore dhe drejtësisë. Kam përshtypjen se në këtë moment makineria e sistemit punon mirë në Amerikë. Por ashtu siç çdo ditë ngërthen natën e saj dhe çdo pranverë dhe verë sjell dimrin, nëse ky sistem çon tek *verbimi i sistemit*, nëse Amerika fillon të shfaqë tradhtinë ndaj vlerave të tilla si demokracia, të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale, për të cilat ajo deklarohet kampione, nëse nuk e përdor dominimin që fati e ka vënë në duart e saj për parimet e drejtësisë dhe mbrojtjen e drejtave të njeriut, atëherë gjithashtu dita e saj do të kthehet në natë, vera e saj do të kthehet në dimër. Ashtu siç u përmend më sipër, asnjë sistem nuk mund të jetojë gjatë nëse ai mbështetet vetëm në forcën. Forca që nuk kushtëzohet në të drejtat dhe drejtësinë do të shkojë pashmangshmërisht drejt shtypjes dhe kështu përgatit fundin e saj. Sot, bota është duke u tronditur nga problemet e mëdha, të cilat u trajtuan pjesërisht më sipër. Përveç kësaj, vendet si Kina dhe India, të cilat janë bartëse të qytetërimit antik dhe të popullsive të mëdha, gjenden sot në stadin e zgjimit. Në Evropën Lindore, Rusia është një tjetër fuqi e madhe. Evropa është në udhën për t'u bërë një shtet i unifikuar - sido që është akoma e paqartë se sa e suksesshme dhe jetëgjatë do të jetë kjo përpjekje. Për më tepër, vendet e Azisë dhe Afrikës, të cilat e shohin vetveten të shtypur për shekuj, kanë potenciale që mund të merren në konsideratë. Të vendosësh një sistem të kushtëzuar në forcën, në një botë të tillë dhe të sigurosh jetëgjatësinë e një sistemi të tillë, nuk është një detyrë e thjeshtë. Unë sinqerisht shpresoj që SHBA nuk do të bëjnë një gabim të vajtueshëm që do të prishte balancën ekzistuese, duke u dhënë udhë ngjarjeve që do ta shndërronin botën në lumenj gjaku.

Regjimet e shtypjes: regjime jetëshkurtra

Fakti që bota ka, në shumë aspekte, tendencën për t'u tkurrur në madhësinë e një fshati, për shkak të zhvillimit të shpejtë të teknologjive të komunikimit, na shfaq një situatë ku regjimet e shtypjes, si sovrane përmes forcës, nuk kanë gjasa të vazhdojnë në mënyrë të pandalshme. Krijesa njerëzore është një qenie e lartë, krijesa njerëzore nuk mund të durojë të jetë skllave ose shërbëtore për shumë kohë. Për të mirën e tyre, është jetike për të gjithë shtetet dhe njerëzit që qeverisin, të vendosin një sistem qeverisës që i shërben popullit dhe vepron në përputhje me parimin «udhëheqës është ai që shërben.» Çdo individ ka dinjitet të natyrshëm, sedër dhe karakter të përshtatshëm për një krijesë njerëzore. Për sa kohë që dinjiteti, sedra dhe karakteri që Krijuesi i fali një personi nuk janë marrë në konsideratë, është e pamundur të vendosësh paqe dhe siguri në një vend ose në botë. Gjithë të drejtat bazë të krijesës njerëzore janë besimi, ushtrimi i besimit, mendimi i lirë, liria e shprehjes dhe liria e komunikimit dhe udhëtimit. Në një shoqëri që nuk mund të sigurojë dhe garantojë të drejtat më themelore, siç është e drejta e jetës, sigurisë, shëndetit, punësimit dhe fitimit dhe krijimit të një familjeje, në një shoqëri ku ndarja dhe konsumi i prodhimit dhe vlerave themelore që e mbajnë të gjallë shoqërinë, siç janë të drejtat, drejtësia dhe balanca, nuk janë mbrojtur, virtytet e tilla si dashuria, respekti i ndërsjellët dhe bashkëpunimi nuk mund të jenë kultivuar. Për çdo sovranitet është e pamundur të jetë jetëgjatë në një botë që është e varfër në këto aspekte. Në fakt, çdo qeveri ose sovranitet që nuk ka këto karakteristika vitale, do të ndjehet gjithmonë i pasigurt dhe thellësisht në ankth.

Edhe nëse gjykimi për botën si një fshat përforcohet dhe përhapet shumë mbi rrjedhën e kohës, besimet, racat, zakonet dhe traditat e ndryshme do të vazhdojnë të bashkëjetojnë në këtë fshat. Çdo individ është si një botë e veçantë në vetvete, prandaj dëshira

që të gjithë njerëzit të jenë të ngjashëm me njëri-tjetrin është asgjë më shumë se një dëshirë e pamundur. Për këtë arsye, paqja e këtij fshati global varet në respektimin e të gjitha këtyre dallimeve, duke i konsideruar të jenë pjesë e natyrës sonë dhe në sigurinë që njerëzit do t'i vlerësojnë këto ndryshime. Përndryshe, është e pashmangshme që botën do ta përpijë vorbulla e konflikteve, grindjeve, luftërave dhe lumenjve të gjakut, duke përgatitur kështu rrugën për fundin e saj.

RENDI I RI BOTËROR

Gjithsecili e ndjek çështjen e një rendi të ri botëror dhe e vlerëson nga një këndvështrim i ndryshëm, në përputhje me mendimet e tij. Kjo është plotësisht e natyrshme. Për shembull, popujt që kanë vuajtur nga një internacionalizëm i papëlqyeshëm për shumë kohë, mund ta pranojnë shovinizmin si një formë rrugëdaljeje dhe janë të prirur në drejtim të tij. Si një çështje në fakt, sot në Azi pothuajse çdo komb, nën idealin e kthimit prapa drejt historisë së tij të lashtë, është duke u kthyer në drejtim të vlerave të tij të veçanta në një shkallë të tillë që tani këto kombe e shohin veten si nacionalistë. Në vlerësimin e situatës aktuale, është e mundur të vlerësosh ndryshimet në Rusi, Uzbekistan dhe Kazakistan dhe në vendet e tjera në këtë rrugë. Sot një numër ndryshimesh me një domethënie të ngjashme po ndodhin në vende të ndryshme të botës. Derisa këto ndryshime dhe zhvillime nuk dëmtojnë askënd tjetër, mund të shihen si normale. Ndonëse ne mund të gjejmë një mënyrë dhe metodë që t'i bëjë këto ndryshime më të dobishme dhe atëherë do të jetë e mundur që të parandalohen tragjeditë e mëtejshme.

Disa nga këto zhvillime ndjekin një rrjedhë bazuar në fenë. Në lidhje me këtë, mund të përmenden aktivitetet e organizuara dhe të paorganizuara në pjesë të ndryshme të botës. Ndryshe nga të tjerat, ata i aviten çdo çështjeje nga parimi që "feja është themelore." Natyrisht që ata duan ta vlerësojnë situatën e sotshme të turbulluar në një linjë me mënyrën e tyre të të menduarit dhe t'i manipulojnë dhe drejtojnë njerëzit në pozicionin e kërkuar nga feja.

Përveç kësaj, fakti që shkeljet nga fuqitë që kanë shfrytëzuar

botën për shumë kohë, fitojnë epërsi në këtë periudhë ristrukturimi, duken normale nga perspektiva e tyre. A ka një harmoni të plotë midis këtyre fuqive? Sigurisht që jo. Megjithëse është shumë e besueshme që ata janë duke u përpjekur të jenë së bashku dhe të arrijnë një marrëveshje sa më shpejt që të jetë e mundur. Siç është e ditur, Britania nuk mendon ndryshe nga SHBA për këtë çështje. Ndonëse britanikët kanë një dallim të vogël për sa i përket çështjes së Sarajevës, tani po ndjekin linjën amerikane. Nganjëherë Franca shfaq një këndvështrim të ndryshëm, por që rrjedh më shumë nga përpjekjet për të bërë një ndarje në strukturën dhe formacionin e ri, se sa nga një pikëpamje vërtet e ndryshme.

Për më tepër, ka shumë vende për të cilat është e vështirë të thuash nëse ato ndjehen të qetë apo jo me rendin e ri botëror. Ashtu siç disa sëmundje është e vështirë të diagnostikohen, po ashtu është e vështirë për t'u kuptuar situata në këto vende. Si një çështje në fakt, ata nuk presin një kuotë nga avantazhet e përgjithshme. Në fakt, nuk është e qartë se çfarë ata duan në të vërtetë në kohët e sotme.

Gjithashtu është e nevojshme të komentojmë ndryshimet e brendshme që çdo vend pret nga vetja. Sigurisht, manifestimi i këtyre shpresave do të ndryshojë në përputhje me vendin dhe është e pamundur t'i trajtojmë dhe analizojmë një nga një të gjitha. Nëse ju dëshironi, le të bëjmë një përshkrim të shpejtë të pritjes për ndryshim në vendin tonë. Shoqëria jonë është e matur dhe vigjilente, gjithsesi, një ditë ajo do të ndjekë intuitën dhe ndërgjegjen që e karakterizon dhe duke adoptuar ndryshimet më të volitshme për natyrën e saj, do të realizojë këtë ndryshim. Kjo situatë është e hamendësuar, sepse shumë dallime në mendim janë shfaqur në vendin tonë. Shpresojmë që ata që zotërojnë të gjithë këto pikëpamje dhe mendime, të jenë të sinqertë në atë që thonë dhe duan të bëjnë. Në këtë spektër të gjerë, disa dallime në rrugën dhe motivet janë plotësisht normale, dhe në fakt, në një anë ato duhet të pranohen si të dobishme.

Pas këtyre komenteve të përgjithshme, ne mund ta shqyrtojmë shkurtimisht çështjen brenda një perspektive teknike. Bota paqësore e idealizuar nuk mund të krijohet nga lufta dhe gjaku i derdhur, ose do të kamuflojë agresionin dhe pushtimin që jep rezultate pozitive. Për këtë arsye, është e dobishme që ta përsërisim qartë dhe saktë edhe njëherë që çdo balancë e fuqisë që është vënë nga përdorimi i forcës do të shembet në periudhën më të shkurtër të kohës dhe ata që ishin përgjegjës për të, do të jenë të parët që do të digjen nën gërmadha.

Unë mendoj se, në një sens, ne kemi dëshmuar që Koreja, Vietnami, Gjiri Persik dhe Somalia janë disa nga shembujt më të dukshëm. Shembujt e reagimit ka mundësi që të jenë më të dhunshëm në të ardhmen. Solidariteti në mes popujve myslimanë në botën Islame, një solidaritet që ishte ndjerë dikur te udhëheqësit e botës së lirë, do të shkrihet ngadalë dhe urrejtja do të zërë vendin e saj. Ajo shfaqet nëse rendi i ri botëror është mbështetur në shfrytëzimin e qartë ose të nënkuptuar të forcës, në vend të mbështetjes në demokracinë dhe përmbushjen e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe atëherë kjo urrejtje do të vazhdojë në dimensione të zgjeruara.

Të parët tanë kanë thënë se "kana e ujit thyhet për të mirë." Ata që kanë fituar një pozitë nga shkatërrimi i diçkaje, do ta shembin vetveten dhe do ta humbin këtë pozitë më vonë, në të njëjtën mënyrë. Nëse vështrojmë sot gjithçka përreth nesh dhe marrim në konsideratë përsëritjen e historisë, ne do të jemi në gjendje të shohim më qartë se çfarë na pret nesër.

Edhe nëse bota nuk është në një proces përsëritës, dhe sot është e qartë që nuk është, ajo sigurisht është në një proces rikonstruktimi. Kur të vijë koha e duhur, ky rikonstruktim patjetër do të jetë realizuar. Kur kjo të ndodhë, në vend të një bote të tronditur nga ligësia dhe urrejtja, një botë befasuese që ka marrë formën e saj në klimën e dashurisë, tolerancës dhe

vetëpërmbajtjes do të shfaqet përpara nesh. Vetëdija kolektive do të mirëpritet me gëzim dhe do të zërë vend në zemër të saj, duke mos shpërfillur ata që kanë një pjesë në këtë reformim. Këta njerëz do të lënë gjurmë të pashlyeshme dhe, nëse nuk janë më fizikisht në këtë botë, gjurmët e tyre do të qëndrojnë për shekuj. Unë besoj me tërë zemrën që e vetmja gjë që duhet bërë sot me qëllim që të realizohen këto ëndrra me aromë pranverore, është të shfaqim këtë lloj shërbimi për njerëzimin. Për këtë arsye, në vend të përpjekjeve të përkohshme, kalimtare dhe joshpresëdhënëse, unë do të këshilloja një tip lëvizjeje që është e përhershme dhe plotësisht e dobishme në çdo drejtim. Unë mendoj që për sa kohë jam gjallë, nuk do të hezitoj t'i përsëris këto rekomandime.

RRETH EPOKËS SË INFORMACIONIT DHE PËRPLASJES SË QYTETËRIMEVE

Si në të shkuarën, gjithashtu sot po ngrihen hipoteza rreth së ardhmes. Një prej tyre është dhe pretendimi lidhur me të ardhmen si një epokë informacioni. Ata njerëz që janë duke e diskutuar të ardhmen në këtë mënyrë, janë futuristë në themel. Shumë i shohin njerëzit që ngrenë hipoteza të tilla si orakujt e mijëvjeçarit të dytë. Akoma, më shumë se të jenë vlerësime objektive, disa hipoteza në lidhje me të ardhmen në caqet e periudhave historike, janë përpjekje për të zhvilluar ide rreth disa dëshirave të veçanta dhe prandaj ata nuk kanë më shumë vlerë se parashikimet e tjera. Me fjalë të tjera, unë mendoj se si rezultat i këtyre pretendimeve, njerëzit krijojnë shpresa në të njëjtën mënyrë që ata presin një përgjigje nga një lutje. Kështu, ndërsa thuhet që shpresat e krijuara nga këto lloj pretendimesh që "e ardhmja do të jetë kështu" u japin jetë përpjekjeve të përcaktuara në këtë drejtim, këto shpresa në fund të fundit bëhen synime dhe qëllime. Sapo qëllimi është përcaktuar, do të krijohen strategjitë dhe politikat e ndryshme për ta arritur këtë qëllim dhe do të bëhen përpjekje për ta përmbushur atë. Unë mendoj se ky është thelbi i çështjes.

Përpos kësaj, është shtrirja e misionit profetik të të Dërguarit të Zotit deri në ditët moderne nëpërmjet linjës së përfaqësuesve, përmes njerëzve si Muhjidin Arabiu, Imam Gazaliu, Imam Rabaniu, Mevlana Halidi dhe Bediuzamani. Ne shpresojmë që funksioni i kësaj linje me fat të përçimit, është të përgatisë themelin për rilindjen e frymës profetike në vitet që vijnë dhe si rrjedhim ne shpresojmë që kjo frymë do të jetojë përsëri. Sigurisht,

Profeti nuk do të jetë aty, por Islami, në kuptimin e vërtetë të bashkëpunëtorëve, do të jetë gjithmonë gati të përshëndesë jetën edhe njëherë.

Por pavarësisht nga e gjitha kjo, meqenëse jetojmë në një botë ku shkakësia dhe ligjet e tjera të përcaktuara janë aktive, nëse ne veprojmë pa i marrë ligjet e tilla në konsideratë, do të jemi në rrezikun e rënies në determinizëm. Ndonëse, myslimanët, nga përdorimi i vullnetit të tyre, janë të aftë t›i shqyrtojnë shkaqet me mjaft kujdes, kështu që dikush që i vështron nga ana e jashtme do të mendojë që ata janë duke vepruar vetëm në përputhje me ligjet e shkakësisë. Në njërin krah, për sa u përket rezultateve të arritura nga veprimet, myslimanët duhet të jenë krejtësisht të nënshtruar dhe shpresëtarë në vullnetin e Zotit, që dikush që i vështron nga ana e jashtme të mendojë që ata i kanë hedhur plotësisht poshtë shkaqet. Duke vepruar në këtë mënyrë, tregojmë që, në njërën anë, shkaqet janë shumë të rëndësishme dhe gjithçka njerëzore duhet përfundimisht të jetë planifikuar rreth tyre dhe përkthyer sipas efektit. Në anën tjetër, ndërsa veprojnë kështu, nga frika e rënies në gabimin e partneritetit spekulativ me Zotin e Plotfuqishëm, ata gjithashtu duhet të dinë që nuk kanë arritur personalisht vetë ndonjë sukses, më saktë i gjithë suksesi është drejtpërdrejt nga Zoti.

Pas vendosjes së çështjes në këtë rrugë të mbarë, ne mund t'i përmbledhim mendimet tona në lidhje me të ardhmen në rrugën e ndjekur. Në të ardhmen, gjithçka do të jetë brenda orbitës së dijeve dhe horizontet që kanë qenë errësuar nga shpërfillja jonë për një periudhë, do të jenë prapë të ndriçuara. Në një shkallë të madhe, ne jemi veçanërisht të pakujdesshëm ndaj njohurive shkencore të arritura në shek IV dhe V h. që janë bazuar në Kuran dhe u kemi kthyer shpinën dinamikave shumë të rëndësishme që mund të na mbajnë në këmbët tona. Personalisht, jam gjithmonë i brengosur që *medresetë* e kanë hedhur tutje misticizmin, ose siç quhet, jetën shpirtërore të Islamit. Më pas, zvogëlimi i interesit të

tyre për shkencat eksperimentale dhe përjashtimi përfundimtar i tyre, i kontribuoi rënies tonë pas vendeve të sapozhvilluara shkencërisht. Prandaj, neglizhenca e treguar në të kaluarën nuk duhet të ekzistojë më dhe e nesërmja jonë do të jetë ndërtohet me dijet dhe gjithçka do të marrë fuqinë dhe forcën e saj nga njohuritë.

Dijet do të zënë një vend të rëndësishëm në një botë që është duke u bërë shumë shpejt e vogël dhe në një epokë kur koha dhe hapësira janë tkurrur. E rëndësishme është nëse ne do të jemi gati për një botë të tillë ose jo.

Sot ka shumë shkencëtarë në botë, në shumë vende të ndryshme, por në opinionin tim të thjeshtë, ata nuk janë të mjaftueshëm për të krijuar një botë të re dhe të gëzuar, edhe nëse ata do të punonin të gjithë së bashku. Për këtë arsye, sot është e nevojshme një mënyrë e re të menduari, një afrim i ri te shkencat, një filozofi e re jete dhe institucione edukative të reja. Gjeneratat e reja duhet të jenë të mobilizuar në çdo fazë të jetëve të tyre, nga kopshti i fëmijëve, në shkollë të mesme dhe prej tyre, në universitet. Meqë gjithçka do të fitojë fuqi nga dijet në të ardhmen, ajo do të jetë e mundur vetëm për të ndërtuar njohuritë për të ardhmen me këtë lloj përpjekjesh.

Tezat e Hantingtonit

Për sa u përket pretendimeve të Hantingtonit rreth përplasjes së qytetërimeve, unë mendoj që më shumë se vlerësime realiste në lidhje me të ardhmen, këto lloj pretendimesh ngjajnë për mua të jenë përcaktime të qëllimeve të reja në një përpjekje për të ndikuar në opinionin publik brenda strukturës së këtyre qëllimeve. Deri në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, ishte ideja e një përplasjeje midis Lindjes dhe Perëndimit, ose midis NATO-s dhe vendeve të Traktatit të Varshavës. Tani, nga krijimi i fronteve të reja armiqësore, është duke u përgatitur një përplasje në mes qytetërimeve bazuar në dallimet fetare dhe kulturore dhe një themel i ri është duke u vënë për vazhdimin e sundimit të blloqeve

të fuqive të mëdha.

Në të vërtetë, deri më sot, konflikti është diçka e dëshiruar nga qendra të caktuara të pushtetit. Masat kanë qenë vënë në alarm kundër një hipoteze të shpeshtë dhe armikut të frikshëm. Ky armik është më shumë imagjinar se real. Kjo është mënyra me të cilën masat janë përgatitur për çdo lloj lufte.

Në të vërtetë, asnjë fe hyjnore nuk është bazuar kurrë në konfliktin, nëse ajo fe është përfaqësuar nga Musai dhe Isai ose nëse feja është përfaqësuar nga Muhamedi, paqja qoftë mbi ta. Në të kundërt, këto fe, veçanërisht Islami, janë rreptësisht kundër rrëmujës, tradhtisë, konfliktit dhe shtypjes. Islam do të thotë paqe, siguri dhe mirëqenie. Prandaj, në një fe të bazuar në paqen, sigurinë dhe harmoninë botërore, lufta dhe konflikti janë aspekte negative. Në shkaqet e veçanta është e drejta për vetëmbrojtje, ashtu si trupi përpiqet të shpëtojë veten nga mikrobet që e kanë sulmuar atë, por kjo mund të jetë bërë vetëm në përputhje me parime të përcaktuara. Islami gjithmonë ka frymëzuar paqe dhe mirësi. Islami e konsideron luftën si një eventualitet dytësor. Normat janë vënë me qëllim që ta balancojnë dhe kufizojnë atë. Për shembull, Islami e konsideron drejtësinë dhe paqen botërore si themelore:

…mos lejoni që urrejtja ndaj të tjerëve t'ju shtyjë të bëni padrejtësi. (Maide, 8)

Islami, ashtu siç ka një sistem ligjor modern, shfaq një linjë mbrojtjeje bazuar në parime të përcaktuara me qëllim që të mbrojë lirinë e besimit, jetës, pasurinë, mendjen dhe pasardhësit e vet. Krishtërimi, si një fe e dashurisë abstrakte, që në zanafillë e ka dënuar kategorikisht luftën dhe nuk ka vënë ndonjë normë në lidhje me këtë realitet njerëzor dhe historik. Por ai nuk ishte në gjendje të ndalonte luftërat botërore ose luftërat njëqindvjeçare, apo incidentet e Nagasakit dhe Hiroshimës. Pikëpamjet e Hantingtonit, dhe të të tjerëve si ai, për të ardhmen, janë

fatkeqësisht të bazuara në konfliktin dhe reflektojnë planet për të vazhduar dominimin nëpërmjet konflikteve.

Me bekimet dhe mirësinë e Zotit, ne po përparojmë për të bërë më të mirën tonë për të ndihmuar flladin e tolerancës dhe dialogut të vazhdojë të fryjë. Ai është një fllad që vetëm pak më parë ka filluar të fryjë dhe shfaq një tendencë për t'u përhapur në mbarë botën. Me vullnetin e Zotit, ne do të provojmë që parashikimet e dijetarëve të tillë janë false. Ne besojmë që këto fllade janë mjaft të fuqishme për të mposhtur armët vdekjeprurëse, për të mundur njësitë e motorizuara ushtarake dhe shumë gjëra të tjera negative që mund të shfaqen. Fakti që çdo segment i shoqërisë është duke shprehur dhe përmbushur këtë mesazh të ri, rrënjët e të cilit shtrihen në të kaluarën, në mesazhin e profetëve, është një favor hyjnor për adhuruesit e sotëm të dashurisë. Si rrjedhim, ne deklarojmë që toleranca dhe dialogu duhet të përfaqësohen në vendin tonë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të jenë një shembull për mbarë botën. Një shembull i tillë do t'i inkurajojë njerëzit për t'u mbledhur së bashku përreth vlerave të njëjta themelore njerëzore dhe, me vullnetin e Zotit, njerëzimi do të jetojë një pranverë shumë para parashikimit të fundit të botës.

"UNË BESOJ NË BUKURINË E MBËSHTETUR NË PARAQITJEN E NATYRËS NJERËZORE"[85]

Hirësia Juaj shumë e nderuar!

Ju sjellim përshëndetjet e sinqerta nga populli i vendit të njohur si vendlindja e tri feve të mëdha, nga populli që është plotësisht në dijeni të misionit tuaj të shenjtë për ta bërë botën një vend të begatë në të cilin ne të jetojmë. Ne gjithashtu ju falënderojmë nga thellësia e zemrës për pranimin tonë në audiencë dhe për kohën e marrë nga kalendari juaj shumë i ngjeshur.

Ne jemi këtu për t'u bërë pjesë e misionit të pandërprerë të Këshillit Papnor për Dialog Ndërfetar (PCID), të themeluar nga Hirësia e tij Papa Pali VI. Ne dëshirojmë ta shohim këtë mision të kryer. Ne vijmë tek ju më thjesht se zakonisht, me guxim më të madh se ç'duhet, për të dhënë ndihmën tonë modeste në zbatimin e këtij misioni shumë të denjë.

Islami ka qenë një fe e keqkuptuar dhe për këtë përgjithësisht kanë përgjegjësi myslimanët. Një përpjekje në kohën e duhur në një vend të përshtatshëm mund të ndihmojë shumë në zvogëlimin e këtij keqkuptimi. Bota islame duhet ta mirëpresë mundësinë e një dialogu që do të punojë për çrrënjosjen e koncepteve të gabuara shumëshekullore rreth Islamit.

Njerëzimi, kohë pas kohe, ka mohuar fenë në emër të shkencës dhe ka mohuar shkencën në emër të fesë, duke nxjerrë në pah dy pikëpamje kundërthënëse. Të gjitha dijet i përkasin Zotit dhe feja

[85] Kjo letër iu parashtrua papës Gjon Pali II nga F. Gylen, në vizitën e tij në Vatikan në 8 shkurt të vitit 1998.

është prej Zotit. Atëherë si mund të jenë ato në konflikt? Prandaj, përpjekjet tona të përbashkëta drejtohen në dialogun ndërfetar për të përmirësuar mirëkuptimin dhe tolerancën në mes popujve që mund të kenë një rrugë të gjatë për të bërë.

Ne jemi sot për sot, në vendin tonë, në dialog me drejtuesit e sekteve të ndryshme të krishtera. Ne thjesht pretendojmë që këto përpjekje modeste të mos dështojnë. Qëllimi ynë është të vendosim vëllazërinë midis besimtarëve të tri feve të mëdha nëpërmjet tolerancës dhe mirëkuptimit. Ne së bashku mund të ngrihemi kundër atyre shpirtrave të drejtuar gabim dhe skeptikëve për të vepruar si amortizues, si barrierë nëse ju dëshironi, kundër atyre që duan ta shohin të ashtuquajturën përplasje të qytetërimeve të bëhet realitet.

Vitin e kaluar ne mbajtëm një simpozium për paqe dhe tolerancë midis qytetërimeve, të ndjekur me vëmendje nga studiues të shquar ndërkombëtarë. Të inkurajuar nga suksesi absolut i kësaj përpjekjeje, ne duam të provojmë ta përsërisim këtë eveniment. Ne jemi aktualisht në procesin e organizimit të një konference për dialogun ndërfetar të drejtuar në fuqizimin e lidhjeve në mes ithtarëve të tri feve të mëdha. Një eveniment në të cilin ne shpresojmë që Vatikani do të jetë i pranishëm.

Ne do të jemi të kënaqur dhe shumë të nderuar nëse do të jeni mjaft i përzemërt për të pranuar ftesën e bërë për ju nga z. Demirel[86] për të vizituar vendin tonë, që Hirësia juaj të ketë mundësi të shohë vendet e shenjta në Turqi. Populli i Anadollit pret me padurim të madh mundësinë për të demonstruar mikpritjen e tij dhe për t'ju pritur ngrohtësisht ju. Pas diskutimit të çështjes me udhëheqësit palestinezë, ne jemi në gjendje të sigurojmë një ftesë për të vizituar bashkërisht Jerusalemin, një vizitë që mund të shihet si një hap domethënës në përpjekjet për ta shpallur qytetin e shenjtë një zonë ndërkombëtare, një vend ku njëlloj si të krishterët, hebrenjtë dhe myslimanët të jenë të lirë për të shkuar në pelegrinazh pa

[86] Sulejman Demirel (l. 1924), presidenti i Turqisë asokohe.

kufizim, madje pa pasur nevojë për vizë.

Ne gjithashtu dëshirojmë të propozojmë mbajtjen e një seri konferencash në vende të ndryshme të mëdha, në bazë të një rotacioni, dhe e para të mbahet në Uashington D.C. me bashkëpunimin e tre udhëheqësve të tri besimeve të mëdha. Koha më ideale për mbajtjen e raundit të dytë do të jetë përvjetori i 2000-të i lindjes së Krishtit.

Një program i shkëmbyer studentor do të jetë gjithashtu shumë i dobishëm. Duke studiuar së bashku të rinjtë me besime të ndryshme, do të nxjerrin në pah afinitetin e tyre për njëri-tjetrin. Brenda strukturës së një programi mësimor të shkëmbyer, një kolegj teologjik është hapur në Harran, në provincën e Urfas, të njohur si vendlindja e profetit Ibrahim, i cili pretendohet të jetë patriarku i tri feve të mëdha. Kjo mund të jetë realizuar nga zgjerimi i programeve të universitetit të Harranit ose nga themelimi i një universiteti të pavarur me një program mësimor të përgjithshëm që do të plotësojë të gjitha nevojat e të tre besimeve. Problemi më i fundit mund të jenë pengesat për shkak të politikave shtetërore.

Programet e sugjeruara mund të tingëllojnë shumë ambicioze, por ato janë brenda mundësive. Ka dy lloj njerëzish në botë: konformistët dhe jokonformistët. Konformistët përpiqen ta përshtasin veten në çdo shtresë të shoqërisë, të tjerët përpiqen ta adoptojnë shoqërinë me vlera të përhershme dhe me zhvillimet e reja favorizuese. Kështu, i gjithë progresi i shoqërisë është në sajë të njerëzve jokonformistë. Falënderojmë Zotin për njerëzit jokonformistë.

M. Fethullah Gylen
Shërbëtor i përvuajtur i Zotit

MESAZHI LIDHUR ME SULMET TERRORISTE TË 11 SHTATORIT

Unë dua ta bëj të qartë që çdo aktivitet terrorist, nuk ka rëndësi nga kush është ndërmarrë ose për çfarë qëllimi, është një goditje e rëndë për paqen, demokracinë dhe njerëzimin. Për këtë arsye, asnjë njeri – dhe, sigurisht, asnjë mysliman - nuk mund ta aprovojë aktivitetin terrorist. Terrori nuk është pjesë e kërkimit të arritjes të pavarësisë apo shpëtimit. Ai merr jetë njerëzish të pafajshëm.

Edhe nëse në pamje të parë aktet e tilla duken se dëmtojnë objektivin, të gjitha aktivitetet terroriste në fund të fundit dëmtojnë më shumë terroristët dhe mbështetësit e tyre. Ky akt i fundit terrorist, i cili është më i përgjakshmi dhe më i dënueshmi, është më shumë se një goditje kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës - ai është një goditje kundër paqes botërore si edhe kundër vlerave demokratike universale dhe vlerave njerëzore. Ata që e kryen këtë krim të shëmtuar mund të konsiderohen vetëm si njerëzit më mizorë në botë.

Ju lutem, më lini t'ju risiguroj që Islami nuk e pranon terrorizmin në asnjë formë. Terrorizmi nuk mund të shfrytëzohet për të arritur ndonjë qëllim islam. Një terrorist nuk mund të jetë mysliman dhe një mysliman i vërtetë nuk mund të jetë terrorist. Islami kërkon paqe dhe Kurani kërkon që çdo mysliman i vërtetë të jetë një simbol i paqes dhe të punojë për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut. Nëse një barkë ka brenda nëntë kriminelë dhe një njeri të pafajshëm, Islami nuk lejon që barka të fundoset për të ndëshkuar nëntë kriminelët, duke dhunuar kështu të drejtat e një personi të pafajshëm.

Islami respekton gjithë të drejtat individuale dhe deklaron qartë që asnjeri nuk mund dhunohet, edhe nëse kjo është në interes të komunitetit. Kurani deklaron që kush merr një jetë pa të drejtë, ka marrë si rrjedhim jetët e të gjithë njerëzimit, dhe kush shpëton një jetë, si rrjedhim ka shpëtuar jetët e të gjithë njerëzimit. Gjithashtu, Profeti Muhamed deklaron që një mysliman është një njeri që nuk duhet të dëmtojë as me duar dhe as me gjuhë.

Unë e dënoj fuqimisht këtë akt të fundit terrorist në Shtetet e Bashkuara. Ai meriton vetëm dënim dhe përbuzje dhe prandaj duhet të jetë dënuar nga çdo njeri në botë. Unë apeloj tek gjithsecili për qetësi dhe vetëpërmbajtje. Përpara se udhëheqësit amerikanë dhe populli t'i japin përgjigje këtij sulmi të neveritshëm jashtë zemërimit dhe dhimbjes së tyre të justifikuar, më lini të shprehem që ata duhet ta kuptojnë që një ngjarje e tillë e tmerrshme ndodhi dhe nuk mund të kthehet prapa, pra, le të shohim se si mund të shmangen tragjedi të ngjashme në të ardhmen. Ata gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin që dëmtimi i masave të pafajshme me qëllim ndëshkimin e pak njerëzve të fajshëm nuk është në dobi të tyre, më saktë, veprime të tilla vetëm do t'u japin zemër terroristëve nga shtimi i ndonjë zemërimi ekzistues dhe nga lindja e më shumë terroristëve dhe më shumë violence. Më lini t'u kujtoj që terroristët përfaqësojnë një pakicë tejet të vogël brenda çdo shoqërie apo feje. Le të përpiqemi ta kuptojmë njëri-tjetrin më mirë, sepse vetëm nëpërmjet mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellët mund të parandalohet në të ardhmen një dhunë e tillë!

Unë e ndjej dhimbjen e popullit amerikan në thellësi të zemrës dhe i siguroj ata që unë lutem te Zoti i Plotfuqishëm për viktimat dhe lutem që Ai t'u japë atyre paqe dhe të gjithë amerikanëve të tjerë durimin e nevojshëm për ta mbajtur dhimbjen e tyre!

Unë dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për të transmetuar edhe një herë vlerësimin tim për gjithsecilin!